



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

Sistemi foljor në veprën e Jeronim de Radës

Specialiteti: Morfologji (Gjuhësi)

(Punim disertacioni në kërkim të gradës “Doktor i shkencave”)

Punoi

MA. Monika Hasani (Hoshafi)

Udhëheqës shkencor

Akad. Ethem LIKAJ

Mbrohet më, dt. _____. _____. përpara jurisë së përbërë nga :

- a. _____ Kryetar
 - b. _____ Anëtar
 - c. _____ Anëtar
 - d. _____ Anëtar
 - e. _____ Anëtar
-

STRUKTURA E PUNIMIT

Parathënie

Objekti dhe qëllimi

Falënderime dhe mirënjohje

KREU I

1. Historiku i shpërnguljeve dhe vendosja e arbëreshëve në krahinën e Kozencës
2. Përbërja e popullsisë në Makji.
3. Veçori të përgjithshme të të folmeve arbëreshe
4. Karakteristika të përbashkëta dhe veçori
5. E folmja e Makjit

KREU II

II. 1. Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës dëftore

Format e së tashmes; ndryshimet fonetiko-morfologjike dhe morfo-fonologjike

Format e së shkuarës(e pakryer, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar); ndryshimet fonetikomorfologjike dhe morfonologjike

Format e së ardhmes (e ardhmja, e ardhmja e përparme, e ardhmja e së shkuarës, e ardhme e përparme e së shkuarës)

Kuptimet e formave gramatikore:

- o Kuptimet e formave të së tashmes
- o Kuptimet e formave të së shkuarës
- o Kuptimet e formave të së ardhmes

II. 2. Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës lidhore

Format e së tashmes; ndryshimet fonetikomorfologjike dhe morfonologjike

Format e së shkuarës(e pakryer, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera);

ndryshimet fonetikomorfologjike dhe morfonologjike

Kuptimet e formave gramatikore:

- o Kuptimet e formave të së tashmes
- o Kuptimet e formave të së shkuarës

II.3. *Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës dëshirore*

Format e së tashmes; ndryshimet fonetikomorfologjike dhe morfonologjike

Format e së kryerës; ndryshimet fonetikomorfologjike dhe morfonologjike

Kuptimet e formave gramatikore:

- o Kuptimet e formave të së tashmes
- o Kuptimet e formave të së kryerës

II.4 *Format dhe kuptimet gramatikore të mënyrës urdhërore*

- o Format e urdhërores: ndryshimet fonetikomorfologjike
- o Kuptimet e urdhërores

II.5 *Forma dhe kuptime gramatikore të mënyrës habitore*

II.6 *Forma dhe kuptime gramatikore të mënyrës kushtore*

KREU III

Leksiku foljor

Folje të shqipes

Folje të huazuara

KREU IV

IV.1. Fjalëformimi

PËRFUNDIME DHE PËRGJITHËSIME

BIBLIOGRAFI

ABSTRAKTI NË GJUHËN ANGLEZE

ABSTRAKTI NË GJUHËN SHQIPE

PARATHËNIE

Vepra e Jeronim De Radës, kjo pasuri kombëtare, ka qenë vazhdimisht objekt studimi dhe referimi për mjaft breza lexuesish të thjeshtë dhe studiuesish, veçanërisht për filologët arbëreshë e shqiptarë. Në këtë kontekst edhe punimet në lidhje me të kanë qenë të shumta, ndaj ideja jonë për të punuar me këtë material të kërkonte kurajo shkencore.

Meqenëse interesat tona shkencore dhe formimi ynë gjuhësor, përkatësisht njohja e disa të folmeve të vjetra, me të cilat varianti i De Radës shfaq ngjashmëri të shumta, na jepte mundësi vëzhgimi në mikrostrukturë, menduam të kufizoheshim pikërisht në studimin e strukturës foljore të këtij korpusi që kemi në dorë.

Për të realizimin e një përshkrimi dhe analizimi sa më të plotë dhe të qartë të sistemit foljor të De Radës, kemi marrë në shqyrtim botimin origjinal të poemës “Canti Di Milosao, Figlio del Despota di Scutari”, botuar në Napoli 1836, si dhe punim e tij në origjinal të “Grammatica della lingua albanese. Firenze 1870/1871”, si dhe fragmente nga revista “Fiamuri i Arbërit”. Për të kapërcyer vështirësitë në transkriptimin e dy veprave jemi mbështetur në alfabetin alfabet latin të kombinuar me shkronja greke dhe kombinime shkronjash latine që De Rada ndërton dhe përdor për shkrimin e poemës në botimin e parë, si dhe në disa prej botimeve më të mira ndër vite për këtë poemë, duke veçuar translitimën, përshtatjen në gjuhën e sotme dhe përgatitjen për botimin të kësaj poemë nga Prof. Jup Kastrati, Prof. Gjergj Zheji, Giuseppe Gradilone, Dhimitër Shuteriqi, si dhe tek Fjalori i Arbëreshvet t’Italisë, E. Giordano, Bari, 1963 etj. Duke vlerësuar dhe përvetësuar arritjet e studimeve të mëparshme, për arbërishten, nëpërmjet këtij punimi jemi përpjekur t’i plotësojmë ato, duke e studiuar më gjerë sistemin foljor të De Radës, rrjedhimisht bashkë me të edhe një pjesë të sistemit foljor arbëresh, edhe duke i krahasuar veçoritë e këtij sistemi me ato të gjuhës standarde, dialektet si edhe të folme konservative të gjuhës shqipe.

Interes për veprën e De Radës në plan të mirëfilltë gjuhësor, kanë shfaqur gjuhëtarë të ndryshëm, këtej e andej kufirit me studime, artikuj, trajtime, qoftë edhe të përziera, letrare e gjuhësore rreth De Radës, të cilat, në tërësinë e tyre, na kanë dhënë një pamje të mirë të korpusit madhështor, të veprave dhe vlerave të Jeronim De Radës. Nga shqyrtimet mirëfilli gjuhësore për të folmet arbëreshe, përkatësisht edhe për

gjuhën e vlerat e De Radës, na ka rezultuar se janë të pakta trajtimet morfologjike jo vetëm për sistemin foljor që përmban vepra e tij, por edhe gjithë ligjërimet arbëreshe në tërësi. Punim i Prof. Gj. Shkurtaj: “Trajtat foljore të mënyrës dëftore të të folmeve arbëreshe të krahinës së Kozencës”, gjithashtu punimet i Prof. F. Altimarit: “E folmja e Maqit Arbëresh. Shënime fonologjike”, i Akad. Ethem Likaj: “Format analitike në gjuhën shqipe” si dhe vepra “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” e Prof. Sh. Demirajt, na kanë shërbyer si udhërrëfyes dhe si mbështetje për të zgjeruar trajtimin tonë në lidhje me sistemin foljor të De Radës.

Mbrojta e tezës së kësaj doktrate përkon bukurazi me 200 vjetorin e lindjes së poetit tonë të madh, paraprijësi i Rilindjes Kombëtare. Në kuadrin e nderimeve që po i bëhen kësaj figure të shkëlqyer të kombit tonë prej qeverisë shqiptare në këtë përvjetor është kënaqësi e veçantë që japim kontributin tonë në njohje dhe vlerësim të mëtejshëm të kësaj figure madhështore.

OBJEKTI DHE QËLLIMI

Objekti qendror i këtij punimi është përshkrimi dhe analizimi i sistemit foljor në veprën e Jeronim de Dadës, si një prej rrugëve për të hedhur dritë mbi gjendjen dhe zhvillimin e sistemit foljor në ligjërimet arbëreshe.

Dihet se gjuha e arbëreshëve ruan ende disa tipare të shqipes së kohës së mesme, që me kalimin e kohës janë zhdukur fare në të folmet e Shqipërisë, ose janë ruajtur pjesërisht në ndonjë nëndialekt konservator, prandaj punimi ka si synime kryesore:

1. Njohjen dhe analizimin e larmisë së formave dhe kuptimeve gramatikore, sipas mënyrave, mbasesave të tyre që dalin sipas kohëve vetave e numrit, zhvillimet e tyre të brendshme, sikurse paraqiten në veprën e autorit.

1. Analizimin e lëkundjeve të formave dhe kuptimeve gramatikore, ndërmjet dy veprave madhore të De Radës, siç janë: “Këngët e Milosaos” dhe “Gramatika e gjuhës shqipe”.
2. Duke u ndalur në disa raste të veçanta të ndërtimeve morfologjike së bashku me kuptimet gramatikore që ato mbartin, synojmë të hedhim dritë dhe të analizojmë edhe më tej disa prej zhvillimeve të sistemit foljor të gjuhës shqipe në këtë fazë të ekzistencës së saj, mjaft të vlefshme për të analizuar aspekte të historisë së shqipes mesjetare.
3. Të sjellim në vëmendje disa prej foljeve e shprehjeve foljore të përdorura prej De Radës të cilat dallohen për bukurinë e tyre dhe që mund të rigjallërohen, të paktën me funksione e stile të veçanta për një pasurim të vërtetë të gjuhës sonë standarde.
4. Të dëshmojmë edhe njëherë përpjekjet e De Radës për ruajtjen dhe mirë përdorimin e gjuhës sonë, si dhe punën e tij për kristalizimin e alfabetit të njësuar të gjuhës shqipe, duke dhënë kështu kontributin e tij të paçmuar si një ndër pararendësit e shqipes standarde.

MBËSHTETJA TEORIKE

Punimi është hartuar duke u mbështetur në një literaturë të gjerë të studiuesve shqiptarë këtej dhe andej kufirit, dhe në koncepte shkencore për dukuri të ndryshme gjuhësore të paraqitura veçanërisht në veprat “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe, Vëllimi I, Morfologjia, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002 dhe “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” e Prof. Shaban Demirajt, Tiranë 1986.

Korpusi i analizuar është nxjerrë nga vjelja tërësore për sistemin foljor në punimet në origjinal të dy veprave: “Këngët e Milosaos”, “Gramatika e gjuhës shqipe” si dhe nga vëzhgimet e pjeshme në revistën periodike “ Fiamuri i Arbërit”.

METODAT E STUDIMIT

Studimi ynë është mbështetur kryesisht në metodën analizuese dhe atë përshkruese, sipas veçorive të kapitujve, duke lakmuar dhënien dhe analizimin e një korpusi sa më të hapët e të plotë të formave dhe kuptimeve të foljeve, në poemën kryesore të De Radës “Këngët e Milosaos”, vepër madhore që ka qenë dhe vijon të jetë në dorën e shkollarëve qysh në shkollën e mesme dhe, pikërisht në ditët tona, kur me të drejtë po kërkohet e synohet edhe një formim gjuhësor sa më i gjerë i nxënësve dhe studentëve. Njohja konkrete e korpusit gjuhësor dhe sidomos e sistemit foljor të një vepre si kjo, përtej synimeve mirëfilli studimore të gramatikës shqipe, shpresojmë se do të vlejë edhe si ndihmesë për hapësira të reja e të vlefshme të analizës së tekstit në shkollat e mesme dhe të larta. Metoda të tjera që kemi përdorur janë metodat krahasuese dhe statistikore, të cilat janë përdorur për të krahasuar me njëra - tjetrën dy prej veprave më të rëndësishme të autorit; Poemën “Këngët e Milosaos” dhe “Gramatika e gjuhës shqipe”. Si burim për metodën statistikore kemi përdorur korpusin e foljeve të përdorura në poemë dhe në Gramatikën e autorit, për të nxjerrë në dukje disa prej proceseve të formimit të sistemit foljor. Këta metoda të gërshetuara me njëra - tjetrën sjellin një tablo më të gjerë të historikut të zhvillimit të arbërishtes së kësaj periudhe.

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Falënderimet janë të pafundme, së pari, falënderimet e mia më të sinqerta dhe më të thella shkojnë për udhëheqësin tim shkencor, Akademikun e nderuar, Prof. dr. Ethem Likaj, për ideimin, udhëzimet, ndihmën e tij të pakursyer, si dhe profesionalizmin e lartë që e karakterizon. Mbështetja e tij e pakursyer, vëmendja që i dha këtij punimi, për të kapërcyer vështirësitë që mbart tema dhe këshillat mjaft të vlefshme, më ndihmuan ta sjell punimin në trajtën e tij përfundimtare.

Shpreh mirënjohjen time për Departamentin e Gjuhës Shqipe, veçanërisht për përgjegjësen e këtij departamenti Prof. dr. Aljula Jubani, për komunikimin dhe bashkëpunimin e saj të shkëlqyer. Falënderoj Këshillin e Profesorëve të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, që ma miratuan këtë temë, veçanërisht Prof. dr. Shezai Rrokaj, për mbështetjen dhe kurajon që më ka dhënë për realizimin e studimeve të doktoratës.

Falënderoj për këshillat e tij të vlefshme Prof. Francesco Altimari, i cili nuk e kurseu ndihmën e kërkuar për gjetjen e materialeve origjinale të veprave të De Radës.

Shpreh mirënjohjen time më të thellë dhe më të sinqertë, për të gjithë stafin e profesorëve të Departamentit të gjuhës shqipe ndër vite, për formimin që na dhanë, për punën e tyre të përkushtuar dhe profesionale.

Falënderoj kolegët e punës në MAS, veçanërisht Ministren e Arsimit dhe Sportit, znj. Lindita Nikolla, e cila brenda hapësirave që lejon ligji, më bëri të mundur dhënien e një hapësire të veçantë kohore, të nevojshme për përfundimin e këtij punimi.

Falënderoj familjen time, prindërit, motrat, vjehrrën, bashkëshortin dhe fëmijët për durimin e treguar dhe mbështetjen e vazhdueshme.

HYRJE

Jeronim de Rada, i cili, në kohën e vet, me talentin dhe risitë e stilit të tij, mahniti deri poetët e studiuesit më të shquar të romantizmit evropian dhe, deri figura si Viktor Hygo, apo La Martini, i cili shkruante se “kurrë s’i kishte shkuar në mendje të përmendë në poezi një metaforë origjinale dhe mahnitëse si “ujë të ri ndë dejt” (uji i ri në det), nuk mund të mos mbetej edhe për studiuesit e letërsisë e të gjuhës shqipe një gurrë e bazë e rëndësishme studimi. Atij do t’i kushtonte rreshta të bukur edhe Prof. Eqrem Çabej, sidomos në studimin “Vatra dhe bota në poezinë e De Radës”, për të mos kaluar në kahun mirëfilli artistik e historiko-letrar, ku aq të shumta kanë qenë hulumtimet deradiane të studiuesve të mëdhenj shqiptarë, si akademikut Dhimitër S.Shuteriqi, Prof.dr.Jup Kastratit, Andrea Varfit, akad. Prof.dr. Alfred Uçit, akad. Prof.dr. Rexhep Qosja, Prof.dr.Ali Xhikut, etj. Në planin mirëfilli gjuhësor, natyrisht, vendin e parë e vendit e mbajnë studimet e Jup Kastratit, sidomos vendi që i jepet prej tij Jeronim de Radës në historinë e gramatologjisë shqiptare, po nuk kanë munguar edhe artikuj e trajtime, qoftë edhe të përziera, letrare e gjuhësore rreth De Radës, të cilat, në tërësinë e tyre, na kanë dhënë një pamje të mirë të korpusit madhështor të veprave dhe vlerave të Jeronim De Radës. Nga shqyrtimet mirëfilli gjuhësore për të folmet arbëreshe dhe përkatësisht edhe për gjuhën e vlerat e De Radës kanë rëndësi , së pari, studimet a disa studiuesve arbëreshë, si: Mikele Markiano, Francesco Solano, Antonio Guzzetta, Francesco Altimari, si dhe të studiuesve shqiptarë, hulli e nisur nga E.Çabej, Sh. Demiraj dhe e vijuar me përkushtim e ndihmesa të vazhdueshme edhe nga Gjovalin Shkurtaç, Anton N. Berisha, Rexhep Ismajl, Ethem Likaj, Aljula Jubani etj.

Me nxitjen dhe ideimin e akad. Prof. dr. Ethem Likajt, udhëheqësit tim shkencor, na u duk me interes që prej arbërishtes¹, nga kjo pjesë e çmuar e pandashme e qytetërimit dhe kulturës shqiptare, e cila me veçoritë e saj tipike është një tregues i pasurisë së gjuhës dhe rezistencës ndaj asimilimit prej gjuhëve f.inje, mes studimeve deradiane, të ndërmerrim edhe një studim mirëfilli gramatikor e pikërisht shqyrtimin e sistemit foljor në veprën “Këngët e Milosaos” të Jeronim de Radës.

Kishim tashmë edhe një mbështetje të mirë për krahasim me të folmen e Maqit (Machia Albanese) dhe përgjithësisht me të folmet e arbëreshëve të Kalabrisë, së pari,

¹ Shih F. Altimari “Rodhonjtë e zjarrit” nr 12, 1988

nga një varg studimesh të Gj.Shkurtajt, sidomos përshkrimin e hollësishëm të tij me titull “Trajtat foljore të mënyrës dëftore të të folmeve arbëreshe të krahinës së Kozencës” (Ligjërimet arbëreshe, 2006, f.205-228), si dhe pasqyrimin e sistemit foljor të arbërishtes në hartat e “Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe” (Napoli-Tiranë, vëll.I, 2007, vëll.II,2008). Natyrisht, një kuadër të mirë për krahasime e përqasje të formave përkatëse na japin edhe një varg studimesh të tjera, sikundër janë, shqyrtimet rreth sistemit fonetik e fonologjik të së folmes së Maqit, vendlindjes së De Radës, nga Prof.Francesco Altimari; për të folmet e Platacit e të Firmos dhe përgjithësisht për tiparet ruajtëse e inovacionet e të folmeve arbëreshe të Italisë nga Prof.F.Solano dhe për të folmen e Vakaricit (Vaccarizzo Albanese) nga albanologu i shquar amerikan Eric Hamp.

KAPITULLI I

HISTORIKU I SHPËRNGULJEVE DHE VENDOSJA E ARBËRESHËVE NË KRAHINËN E KOZENCËS

Arbëreshët e Italisë, kjo diasporë e hershme në dhe të huaj, megjithëse që nga shekulli XV ishin shpërngulur në krahinat jugore të Italisë, pavarësisht nga pësimet e fatet plot peripeci që patën, kurrë nuk pushojnë së menduari e së vepruari për të mirën e Atdheut të origjinës. Duke jetuar në bashkësi të vogla katundare të izoluara, të rrethuar nga popullata të ndryshme për nga gjuha, tradita dhe kultura, italo-shqiptarët kanë mahnitur botën me forcën ruajtëse të kujtimit dhe krenarisë shqiptare, me shpirtin e fortë të solidariteti dhe lidhjeve etnike² dhe, në pamundësi për t'u kthyer në vendin prej nga ishin shpërngulur, e rikrijuan “Arbërinë e moçme në dhe të huaj”, mbetën përjetësisht “italo-albanesi” shqiptarë të Italisë ose, sikundër e thoshte madhërisht Zef Skiroi:

*“Në mes disave pa përzier na jemi,
Të huaj te vendi tek u besa u rua,
Përpara syve mallet e tua po kemi,
Fushat e tua”.*

Arbëreshët e Italisë përbëjnë një diasporë të kahershme historike, të shtrirë në rreth 50 vendbanime në krahinat e Kalabrisë, Puljes, Bazilikatës, Molizes dhe në Sicili, po edhe një “diasporës së diasporës”, që është “shprishur” e mërguar me kohë gati në të gjitha qendrat urbane të Italisë Jugore (Kozencë, Napoli, Palermo, Bari etj.) dhe në shumë nga metropolet e Italisë së Veriut (Romë, Milano, Torino, Firenze etj.). Të shumta janë sot edhe “networket” arbëreshe në vise të tjera të Evropës Perëndimore, sidomos në qytetet e mëdha industriale të Gjermanisë, Francës, Zvicrës etj. si dhe në Amerikë e deri në Australi. Sipas disa studiuesve seriozë të antropologjisë sociale, sot në Itali janë rreth njëqind mijë arbëreshë, shumica edhe shqipfolës (albanofonë), si dhe gati po aq të tjerë që e pranojnë dhe e pohojnë se janë me origjinë etnike nga Shqipëria, ndonëse tashmë janë vetëm italishtfolës.³

² F. Altimari, *Mbi arbëreshët e Italisë*, në “Malësia”, 5, Podgoricë, 2010, f.41.

³ Shih: Gj. Shkurtaj, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, f.

Mërgimi i arbëreshëve në Itali ka pasur arsye historike dhe është kryer fillimisht në kuadër të një bashkëpunimi e ndihme të ndërsjellë midis princit të famshëm shqiptar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, dhe mbretit të Aragonës, Alfonsit I, i cili, ia njihte vlerat dhe ia provoi nderet e forcën ushtrisë që i dërgoi asokohe për ta ndihmuar fqinji trim e bujar i këndej Adriatikut. Por valët e mërgimit të arbëreshëve drejt Italisë fqinje, sidomos drejt Kalabrisë dhe Sicilisë, do të shtoheshin pas vdekjes së Skënderbeut (1468), kryesisht për shkak të rrënimit ekonomik dhe të dhunës e terrorit që ushtruan pushtuesit osmanë. Sidoqoftë, dyndja e arbëreshëve nga Shqipëria në Itali dhe përfshirja e tyre në jetën e bëmat e Jugut, gati gjithmonë të varfër e problematik, ku ata edhe u bënë qytetarë të përhershëm, ka qenë faktor pozitiv dhe urë miqësie midis Shqipërisë dhe Italisë.

Historia e Italisë në këta katër-pesë shekujt e fundit dëshmon se arbëreshët janë shquar gjithandej si bujq e punëtorë të mirë, si qytetarë të devotshëm dhe kanë rrojtur e rrojnë në harmoni të plotë me fqinjët e tyre italianë, ndonëse kanë ruajtur me krenari gjuhën shqipe dhe traditat kulturore e lidhjet shpirtërore me etninë prej nga e kanë zanafillën. Edhe sot, arbëreshët thonë se janë “*gjak i shprishur nga Albania*”, porse kjo gjë nuk i ka penguar ata për t’u përfshirë me plot dinjitet në rrjedhat e zhvillimeve pozitive të jetës në atdheun e tyre të dytë, në Itali. Ndiheza e arbëreshëve të Italisë në shumë fusha (dhe në të gjitha periudhat historike me rëndësi për popullin italian) ka qenë e dukshme dhe e njohur nga të gjithë. Në mënyrë të veçantë mund të përmendet ndihmesa e tyre në luftërat garibaldine për bashkimin e Italisë, ku arbëreshët e Kalabrisë dhe të Sicilisë qenë në ballë të luftëtarëve më të shquar, aq sa vetë Xhuzepe Garibaldi i quante ata “*heronj të njëmijë luftërave*” dhe, si mirënjohje e shpërblim për ta, ofroi një shumë të madhe të hollash për mëkëmbjen e Kolegjit Arbëresh të Shën-Adrianit në Shën-Mitër Koronë.⁴

Arbëreshët, gjatë periudhës tashmë më se pesë shekullore në Itali, kanë formuar edhe një fizionomi të tyren në lëmin e kulturës, të artit dhe, sidomos, të letërsisë. Nga kjo diasporë kanë dalë poetë dhe studiues të shquar të përmasave evropiane, si Jeronim de Rada, Vinçenc Dorsa, Zef (Giuseppe) Skiro Senior etj., të cilët mbeten figura të mëdha mendore, politike e kulturore të Rilindjes Shqiptare në shek.XIX. Këta burra të shquar italo-shqiptarë, veprat e tyre, si dhe jeta e puna e mëtejshme e bërë nga arbëreshët në hullinë e shembullin e tyre për të mbajtur gjallë

⁴ Shih: Gj.Shkurtaç, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, f.

gjuhën shqipe e kulturën arbëreshe, meritojnë të bëhen të njohura jo vetëm në librat studimorë për dialektet, folklorin dhe shkrimtarinë arbëreshe, por edhe nëpërmjet medias e sidomos me anën e dokumentarëve shkencorë. Të mirëpritur kanë qenë edhe librat për diasporën arbëreshe. Më 1984 Gj.Shkurtaj botoi librin “Shpirti i Arbrit rron” (Shënime e të dhëna për arbëreshët e Italisë), i cili jep të dhëna të shumta lidhur me origjinën dhe situatën e sotme të ngulimeve arbëreshe dhe sidomos të gjuhës e dialekteve të tyre, prandaj edhe ky libër u prit mirë dhe u vlerësua mjaft nga kritika, kurse historiani Koli Xoxe botoi studimin e gjerë “Shqiptarët dhe Garibaldi”, ku tregohen ndihmesat e arbëreshëve në lëvizjet përparimtare dhe për bashkimin kombëtar të Italisë.

Prof.Shkurtaj thekson se çdo katund a qendër arbëreshe ka pasur dhe ka përfaqësuesit e vet, në fusha të ndryshme të kulturës e të letrave, me të cilët mburren e krenohen përballë f.injëve. Maqi (Machia Albanese) është vendlindja e burrave të shquar të tillë si Jeronim de Rada, Mikel Markiano, Dhimitër Mauro; Frasnita (Frascineto) krenohet me Vinçenc Dorsën, Bernard Bilotën, Josif Ferrarin, Françesko Solanon; Shën-Benedikti (San Benedetto Ullano) është vendi ku u themelua së pari Kolegji arbëresh i Shën-Adrianit, po edhe ku lindën burra të shquar si: Arisrîtide Manes, vëllezërit Rodatà, Axhesilao Milano etj. Dhe, kështu, mund të thuhet se secili vendbanim arbëresh ka “idhujt” e vet të përparimit e të arbëreshësisë. Në ngulimet arbëreshe të Sicilisë: Hora e Arbëreshëve (Piana degli Albanesi) përmendet se aty kanë lindur shkrimtarë dhe figura të mëdha të kulturës e të letrave shqipe, si: Lekë Matrënga, Gjergj Guxeta, Zef Skiro (Senior), ashtu si Kundisa (Contessa Entellina) mburret se pati një bir si Nikollë Ketën, apo Palac Adriani (Palazzo Adriano), ku kanë lindur e jetuar Darenjtë e famshëm: Andrea Dara, Gavril Dara Plaku dhe Gavril Dara i Riu.⁵

Ka pasur edhe më herët njoftime, panorama dhe mëtime paraqitëse në librat e historisë së letërsisë shqiptare dhe arbëreshe, në monografitë kushtuar disa prej figurave madhore të diasporës arbëreshe si për De Radën, G. Darën e Ri, Santorin, Seremben etj. Prej tyre është formuar një kuadër historik dhe gjeografik i ngulimeve arbëreshe. Janë sjellë edhe jo pak dëshmi e të dhëna rreth kohës e situatës së formimit të tyre, është hulumtuar jo pak nëpër arkivat krahinorë e qendrorë të Italisë së Jugut dhe, në një farë mënyre, së paku në rrethet e studiuesve shqiptarë, tashmë dihet shumëçka për botën arbëreshe, për dialektet dhe sprovat e tyre drejt një gjuhe të

⁵ Shih. Gj.Shkurtaj, *vep.cit.*, f.

përbashkët letrare edhe para se të formohej gjuha shqipe standarde, njihet puna vullnetmirë e veprimtarëve dhe shkrimtarëve të sotëm arbëreshë për ta lëvruar gjuhën amtare duke iu përafuar sa më shumë variantit të përbashkët standard. Me interes ka qenë edhe puna që kanë kryer vetë arbëreshët e Italisë për t'ua bërë të njohur shqiptarëve dhe botës mbarë se çfarë ka mbetur e gjallë nga gjuha dhe kultura arbëreshe në Itali. Një rëndësi të madhe ka pasur, ndër të tjera, harta e vendbanimeve arbëreshe shqipfolëse në Itali, realizuar nga Katedra e gjuhës shqipe dhe e dialekteve arbëreshe pranë Universitetit të Kalabrisë, ku janë dhënë me saktësi të gjitha vendbanimet tradicionale arbëreshe, duke shënuar me saktësi edhe emërtimet e tyre në dy forma: në arbërisht, siç i shqiptojnë dhe i përdorin vendasit arbëreshë, dhe në formën zyrtare në italisht, siç njihen në dokumentacionin e shkruar dhe zyrtar të krahinave përkatëse. Vlen të theksohet se viteve të fundit, në shumë nga katundet arbëreshe, me nismën e veprimtarëve të komunave vendore, janë shkruar në dy gjuhë (shqip dhe italisht) emrat e rrugëve kryesore dhe emërtime të tjera me rëndësi të shesheve, qendrave kulturore dhe deri të vetë qendrave administrative, si p.sh.: Bashkia e Frasnitës-*Comune di Frascineto*, Bashkia e Shën-Mitrit - *Comune di San DemetrioCorone*, Bashkia e Qanës-*Comune di Cerzeto* etj.

Mjaft nga autorët arbëreshë që përmendëm janë të njohur edhe në Shqipëri e në mjediset e tjera shqiptare në Ballkan e më gjerë, sepse vëllimet me vjersha, si dhe drama e tregime apo edhe studime të tyre janë botuar dhe janë përcjellë me interesim e me vlerësime të mira nga kritika dhe nga lexuesit shqiptarë. Mjafton të përmendim, ndër të tjera, se në Shqipëri e në Kosovë këto dhjetë-njëzet vitet e fundit janë botuar shpesh vjersha të zgjedhura nga poetët arbëreshë në faqet e revistave letrare shqiptare, si dhe përmbledhje me vjersha të zgjedhura nga poetë arbëreshë si p.sh. nga Karmell Kandreva, Lluka Perrone, Agostin Xhordano (Buzëdhelpr), Zef del Gaudio, Vora Ujko, Zef Skiro Maji, Luis de Roza, Kate Zukaro, Matilde Ferrara etj. Teatri shqiptar i qytetit të Korçës ka shfaqur me sukses komedinë “Paja” të Di Maxhos, kurse Teatri Kombëtar i Operës dhe i Baletit, disa vjet më parë, mbi po atë vepër hartoi libretin e një operete të suksesshme me muzikë të kompozitorit të shquar shqiptar Nikolla Zoraqi.

Një njohje të mirë për poezinë bashkëkohore arbëreshe, lexuesit shqiptarë e më gjerë kanë fituar edhe nga antologjitë e ndryshme, prej të cilave, në rend kronologjik, duhen përmendur, së pari, “Rrënjë e fortë” (Prishtinë, 1978) nga R. Ismajli, pastaj “Degë e blertë” (Tiranë, 1980) nga N. Jorgaqi e H. Sinani dhe në një vëllim më të gjerë e të

plotë, “Antologji e poezisë së sotme arbëreshe” (Kozencë, 1999) nga Anton N. Berisha. Mjaft të vlefshme kanë qenë për kohën e vet edhe shënimet e udhëtimit ndër katundet arbëreshe të Italisë, prej të cilave mund të përmendet sidomos libri i Rexhep Zllatkut “Me arbëreshët” (1976) dhe “Shpirti i arbrit rron”, 1984 i Gj. Shkurtajt .

Arbëreshët, në çdo kohë, në Sicili, në Kalabri e Bazilikatë u qëndruan besnikë traditave dhe me krenari e quajnë veten arbëreshë. Me këtë shpirt qëndrese e vetëruajtjeje ata arritën t’u bënë ballë kohërave e rrjedhave të ndryshme të jetës në dhe të huaj, ndikimeve të mjedisit latin e të ruanin bashkë me cilësitë e tjera edhe një visar të çmueshëm: gojëdhënat, këngët tradicionale të kohës Skënderbeut, të cilat përbëjnë një nga faqet më të bukurat të historisë së kulturës sonë kombëtare.

Nuk duhet harruar se edhe në luftën e përpjekjet e popullit tonë deri në fitoren e Pavarësisë kombëtare më 1912, ka pjesën e ndihmesën e vet të vyer edhe një numër i mirë veprimtarësh të përmendur arbëreshë, të cilët në kohët më kritike të ekzistencës së kombit shqiptar, i kushtuan Shqipërisë mendjen e kthjellët e zemrën e ngrohtë prej vëllai, duke mos kursyer asgjë, as jetën. Mjafton të kujtojmë se dijetari dhe poeti i madh De Rada, në veprat e veta e me të përkohshmen “Fjamuri i Arbërit”, donte t’i paraqiste botës, kombin shqiptar plot virtyte dhe gjuhën e tij të lashtë, duke zgjuar e vënë në lëvizje shqiptarët e arbëreshët kudo që gjendeshin për të punuar për lëvrimin e gjuhës dhe lirinë e atdheut.

Arbëreshët u vendosën në Itali të Jugut në kohë të vështira për fshatarësinë italiane, në një periudhë shfrytëzimi të egër feudal. Me gjithë këtë gjendje të keqe e të mjerueshme të vegjëlisë, në të cilën u takoi të përfshiheshin edhe arbëreshëve në Itali të Jugut, ata nuk na paraqiten në atë kohë si robër aq të shtypur e si raja të feudalëve. Me qëndresën e burrërinë që i karakterizonte, ata mundën të fitonin disa të drejta e favore, si p. sh. që të kishin këshillin e pleqësisë, zyrtarët e gjyqtarët vendës, për të mos bërë punë angari e për të ushtruar lirisht doket e tradita e tyre kombëtare dhe ritin e tyre fetar. Këtë e dëshmojnë edhe aktet e diplomat, që gjenden nëpër arkiva të Napolit, të Palermos e të ndonjë qyteti tjetër të Italisë së Jugut.

Shqiptarët, sapo zunë cak në vise të ndryshme të Italisë Jugore, nisën të punonin. Disa u morën me bujqësi, disa me blegtori e disa edhe në ushtri si stratiotë. Kështu, jeta e tyre mori një udhë e rrjedhë të re: prenë shkurre e pyje, që mbulonin sukat e shpatinat e maleve, dliurën rrehjet nga gurët, drizat e bimët e këqija dhe i shndërruan ato në toka buke e vreshta, në kopshtije e livadhe. Kështu, për një kohë të shkurtër, ato vise të egra e të shkreta zunë të merrnin pamje të këndshme e pjellore.

Edhe sot në fshatra arbëreshe janë të zhvilluara bujqësia e blegtoria. P. sh. në Këmarinë (Kampomarino), në Qeuti, në Greci, në Ururi, në Kontesa Entelina, në Mezojuzo, në Horën e Arbëreshëve (Piana degli Albanesi) etj. bëjnë shumë grurë. Dikur Ururi quhej ‘grunari i provincës’.

Ngulimet e Kalabrisë Veriore janë më fort të përshtatshme për ullinj e vreshta, për fiq e gështenja, ndërsa ngulimet e Sicilisë prodhojnë edhe agrume, bajame, shqemë, mjaltë e dyllë.

Me blegtori merren më tepër ngulimet malore të Kalabrisë, si: Garafa, Falkonara, ngulimet e Sicilisë, Monteçilfones etj.

Në katundet arbëreshe të Kalabrisë ka pasur vend të gjerë edhe krimbi i mëndafshit, sidomos në Çerceto, Kavalerico e Shën-Japk, të cilat shquheshin edhe për pëlhurat e mëndafshita, të pambukta e të leshta.

Banorët e Fermës (*Firmo*) punojnë me mjeshtëri drurin, meqë kanë edhe shumë pyje, ndërsa Ungra (*Lungro*) rronte kryesisht me minierën e kripës që ka pranë.

I vështirë për t'u përcaktuar me saktësi mbetet edhe numri i banorëve shqipfolës të ngulimeve arbëreshe të Italisë. Statistikat e kohëve tona na shpjen në pak më shumë se njëqind mijë veta.⁶ Por është thënë e shkruar se në shek. XIX në Itali kishte rreth 200.000 arbëreshë.⁷ Sipas disa burimeve, më 1901 kishte 21554 familje arbëreshe me 96000 frymë, ndërsa më 1911 kishte 20113 familje me 80.282 frymë.⁸ Në shkrimet e vetë arbëreshëve ky numër na del më i madh: A. Skura na thotë se më 1901 kishte 203.235 arbëreshë në Itali.⁹ Dëshmi të tjera përmendin rreth 300 deri në 400 mijë arbëreshë të shprishur në 80 katunde fushore dhe në malësi deri 1000 m. mbi nivelin e detit.¹⁰

Sipas të dhënave të statistikave italiane, më 4 nëntor 1951, në Itali të Jugut e në Sicili rronin 101. 878 arbëreshë, të shpërndarë në 36 katunde, ndërsa më 31 dhjetor 1955 numëroheshin 103.234 banorë në të njëjtin numër ngulimesh, lartësia e të cilave shkon nga 320 m (Spixana) deri në 1000m (Platani).¹¹

⁶ Shih: G. B. Pellegrini, *Carta dei dialetti d' Italia*, 1987, pp.45.

⁷ Shih: E. Barbaroch, *Albania*, Roma, 1905, pp.331-333.

⁸ Shih: T. de Mauro, *Storia linguistica dell' Italia unita*, Laterza, Roma, Bari, 1974, f.283.

⁹ Shih: A. Skura, *Gli Albanesi in Italia*, 1912.

¹⁰ Shih: D. Zangari, *Le colonie italo-albanesi di Calabria, Storia e demografia, Secoli XV-XVII*, Caselli, Napoli, 1940, pp. 48-50.

¹¹ Shih: *Annuario statistico dei comuni italiani*, Istituto Centrale di Statistica del Ministero dell' Interno, Roma, 1958, pp.47-50,80-81.

Afërsisht këtë numër jepte edhe Eqrem Çabej, sipas të cilit "shqipja flitet sot në 49 ngulime të Italisë së Jugut, me rreth 100. 000 banorë".¹² Më 1963, studiuesi arbëresh Emanuel Xhiordano (Giordano) në veprën e tij të njohur "Fjalor i arbëreshëve të Italisë" theksonte se në Itali janë sot 55 katunde arbëreshe ku shqipja nuk flitet më.

Një paraqitje të përditësuar e të kohëve të fundit, sipas mendimit tonë mjaft të saktë e me mbështetje në regjistrimet më të reja, po edhe duke bërë përjasjen e krahasimin me të dhëna të mëparshme, ka dhënë studiuesi italian Daniele Gambarara, docent i antropologjisë sociale në Universitetin e Kalabrisë, në artikullin "Parlare albanese nell' Italia unita", botuar në "Zjarri", nr. 27, 1981, ku jepet edhe një pasqyrë e arbëreshëve shqipfolës sipas regjistrimit të vitit 1966. Të dhënat pasqyrohen në tabelën I.1 si më poshtë:

Tabela I.1

Krahina	Ngulimi	Numri i shqipfolësve	Numri i banorëve	%
Peskara	Badhesa (<i>Villa Badessa</i>)	48	169	28.4
Kampobaso	Këmarini (<i>Campomarino</i>)	2023	3706	54.8
	Muxhifuni (<i>Montecilfone</i>)	2500	2936	98.9
	Portkanuni (<i>Portocannone</i>)	2500	2773	90.1
	Ruri (<i>Ururi</i>)	3206	3710	86.4
	Gjithsej në Kampobaso	10638	13125	81.1
Foxhia	Qevti (<i>Chieuti</i>)	2213	2630	83.5
	Kazalveqi (<i>Casalvecchio</i>)	2620	2890	90.7
	Gjithsej në Foxha	4833	5540	87.2
Avelino	Greçi (<i>Greci</i>)	1989	2040	97.5
Taranto	Shën-Marcani (<i>San Marzano</i>)	5192	6792	76.4
Potenca	Barilli (<i>Barile</i>)	4180	4180	100
	Zhura (<i>Ginestra</i>)	1596	1636	97.6
	Mashqiti (<i>Maschito</i>)	3235	3235	100
	Shën-Kostantini	1608	1776	90.5
	Shën-Pali (<i>San Paolo Alb.</i>)	826	926	90.2
	Gjithsej në Potencë	11445	11753	97.4
Kozenca	Kastërnexhi (<i>Castroreggio</i>)	1253	1253	100
	Frasnita (<i>Frascineto</i>)	1601	1648	97.1
	Platani (<i>Plataci</i>)	2355	2525	93.3

¹² Shih: E. Çabej, *Ngulimet arbëreshe në Itali dhe gjuha e tyre*, "Studime gjuhësore", V, Prishtinë, 1978, f. 49.

	Firmoza (<i>Acquaformosa</i>)	1770	1800	98.3
	Ferma (<i>Firmo</i>)	2495	2745	90.9
	Ungra (<i>Lungro</i>)	3800	3844	90.8
	Shën-Vasili (<i>San Basile</i>)	1752	1819	96.3
	Spixana (<i>Spezzano Alb.</i>)	4000	6279	63.7
	Picilia (<i>San Caterina</i>)	437	2037	21.5
	Qana (<i>Cerzeto</i>)	2321	2441	95.1
	Shën-Mërtiri (<i>San Martino di Finita</i>)	800	1879	42.6
	Shën-Benedhiti (<i>San Bendedetto Ulano</i>)	1625	1735	93
	Fallkunara (<i>Falconara Alb.</i>)	1786	1986	89.9
	Strigari (<i>San Cosmo Alb.</i>)	915	1065	85.9
	Shën-Mitri (<i>San Demetrio Corone</i>)	4130	5290	78.1
	Mbuzati (<i>San Giorgio Alb.</i>)	1143	1943	58.8
	Vakarici (<i>Vaccarizzo Alb.</i>)	1858	1955	95
	Gjithsej në Kozencë	37877	42265	80.1
Katanxaro	Puhëriu (<i>Palagorio</i>)	2196	2196	100
	Shënkolli Psipër (<i>San Nicolo dell'Alto</i>)	2923	3640	88
	Karfici (<i>Carfizzi</i>)	1441	1471	98
	Andali	393	1691	23.2
	Marçedhuza (<i>Marcedusa</i>)	100	1326	7.5
	Vena (<i>Vena di Maida</i>)	1000	1228	81.4
	Zangarona	50	524	9.5
	Gjithsej në Katanxaro	10011	13844	72.3
Palermo	Hora e Arbëreshëve (<i>Piana degli Albanesi</i>)	6074	6815	89.1
	Shëndahstina (<i>Santa Cristina</i>)	804	924	87
	Kundisa (<i>Contessa Entellina</i>)	1660	2563	64.8
	Gjithsej në Palermo	9571	11830	81.7

Mikele Familjeti, një nga njohësit më të mirë të problemit arbëresh e të gjendjes gjuhësore të fundshekullit XX tek arbëreshët e Italisë, më se një herë në studimet e tij ka theksuar se "deri para pak dhjetëvjeçarësh ruanin fizionominë e tyre arbëreshe edhe shumë ngulime të tjera, të cilat pastaj u thithën gradualisht nga ndikimi i arealit kulturor i mjedisit rrethues, sidomos nga ndikimi i strukturave masive si administrata

shtetërore, fetare, ushtarake dhe, në dhjetëvjeçarët e fundit, sistemi shkollor, shtypi, radioja, televizioni dhe emigracioni apo diaspora e diasporës".¹³

Nga fundi i shek. XIX, prej ngulimeve arbëreshe si dhe prej shumë viseve të tjera të varfra të Italisë së Jugut e të Sicilisë, pati emigrime të dendura drejt Argjentinës, Brazilit, SHBA-së, Uruguait etj.¹⁴ Disa priftërinj të Buenos Airesit shënojnë se vetëm në atë qytet janë vendosur rreth 40.000 arbëreshë, të shpërngulur nga krahina e Kozencës.¹⁵ Sipas M. Bolonjarit, docent i antropologjisë sociale në Universitetin e Kalabrisë, llogaritet se sot janë më shumë arbëreshë të Kalabrisë që jetojnë në vise të tjera në emigracion, sesa ata që kanë mbetur në katundet arbëreshe tradicionale.¹⁶ Studiuesit theksojnë se ata, ndonëse larg katundeve e në mjedise amerikane, gjermane etj., ruajnë mirë gjuhën e tyre të parë, shqipen e moçme apo arbërishten e katundit të tyre, si *"gjuhë të zemrës", krahas gjuhëve të huaja të vendeve përkatëse ku janë shpërngulur, që janë për ta thjesht "gjuhë pune" apo "gjuhë e bukës". Në takim me mjediset jo italiane, për t'iu përshtatur kodit të komunikimit të atjeshëm në anglisht, gjermanisht etj. arbëreshët "harrojnë shumë shpejt italishten, porse ruajnë kodin e së folmes arbëreshe".¹⁷*

Shumë arbëreshë janë shpërngulur në kohët moderne nga ngulimet fshatare drejt qyteteve të kryeqendrave të tyre, si në Bari, Kozencë, Katanaxaro, Palermo, Koriliano, Kastrovillari etj. Sipas disa studiuesve, në qytetin e Palermos janë sot rreth 15000 arbëreshë, në Kozencë rreth 2000, në Milano rreth 3000 arbëreshë etj.¹⁸ Por, më të shumta kanë qenë dyndjet e emigracionit arbëresh në qytetet e mëdha të Italisë së Veriut, ku deri më sot vijojnë ta ruajnë edhe gjuhën shqipe si dhe traditat e tjera arbëreshe.¹⁹ Këtyre u duhen shtuar edhe shumë familje arbëreshe që kanë qenë vendosur qysh herët në qytetet e mëdha të Italisë, si në Venecie e sidomos në Napoli, ku, me kohë, shqiptarësia është tkurrur, megjithatë deri më sot rrojnë edhe disa mbiemra shqiptarë dhe ka ende familje që e ruajnë kujtimin e origjinës së tyre nga Shqipëria.

¹³ Shih: M. Famiglietti, *Sociopsicologia dell' educazione e lingua*, Bulzoni Editore, Roma, 1976, pp.11.

¹⁴ Shih: Matteo di Lena, *Gli Albanesi del Molise (Studi, testi e documenti)*, Parte prima, 1978, pp. 37.

¹⁵ Shih: R. Zllatku, *Me arbëreshët*, "Rilindja", Prishtinë, 1976, f. 18 e vijim.

¹⁶ Shih: M. Bolognari, *Il silenzio della tradizione*, Roma, 1978, pp.29.

¹⁷ Shih: M. Famiglietti, *op. cit.* pp. 41.

¹⁸ Shih: D. Gambarara, *Parlare albanese nell' Italia unita*, "Zjarri", 27, 1981, pp.65.

¹⁹ Shih: E. Çabej, *Studime gjuhësore*, V, Prishtinë, 1978, f.50; D. Gambarara, *art. cit.*, "Zjarri", 27, 1981, pp.59.

Ngulimet arbëreshe të Italisë, të cilat e ruajnë gjuhën shqipe

Gati të gjithë studiuesit që janë marrë me gjuhën dhe të folmet e arbëreshëve të Italisë, si E.Giordano, E.Çabej, K.Rother, D.Gambara, M.Bolognari, Gj.Shkurtaj etj kanë synuar të pasqyrojnë edhe albanofoninë e tyre dhe kanë shënuar ngulimet që vijojnë ta ruajnë gjuhën shqipe. Sipas tyre ngulime shqipfolëse sot atje janë:

Në Kalabri janë më se njëzet katunde në krahinën e Kozencës²⁰ : Spixana (*Sezzano Albanese*), Ungra (*Lungro*), Shën-Mitri (*San Denmetrio Corone*), Shën-Sofia (*S. Sofia d'Epiro*), Ferma (*Firmo*), Qana (*Cerzeto*), Frasnita (*Frascineto*), Picilia (*S. Caterina Albanese*), Fallkunara (*Falconara Albanese*), Vakarici (*Vaccarizzo Albanese*), Mbuzati (*S. Giorgio Albanese*), Çifti (*Civita*), Shën-Mërtiri (*S. Martino di Finita*), Shën-Vasili (*S. Basile*), Firmosa (*Acquaformosa*), Shën-Benedikti (San Benedetto Ullano), Pllatani (*Plataci*), Maqi (*Machia*), Kastërnexhi (*Castroregio*), Strigari (*S. Cosmo Albanese*), Ejanina ose Purçilli (*Ejanina*), Kajverici (*Cavallerizo*), Karfici (*Carfizzi*), Vina (*Vena di Maida*), Andalli, Zangarona.

Në Sicili, në krahinën e Palermos e ruajnë shqipen katundet Hora (*Piana degli Albanesi*), Shën-Kristina (*S. Cristina Gella*) dhe Kundisa (*Contessa Entellina*).

Në Pulje, në krahinën e Foxhës e ruajnë shqipen: Katundi (*Casalvechio di Puglia*) dhe Qeuti (*Chieuti*) dhe në krahinën e e Tarantos Shën-Marcani (*S. Marzano di S. Giuseppe*).

Në Molise, në krahinën e Kampobasos, e ruajnë shqipen: Ruri (*Ururi*), Këmarini (*Kampomarino*), Muxhufuni (*Montecilfone*), Portkanuni (*Portocannone*).

Në Bazilikatë, në krahinën e Potencës, e ruajnë shqipen: Barilli (*Barile*), Mashkiti (*Maschito*), Shën-Pali (*S. Paolo Albanese*).

Në Kampania, në krahinën e Avelinos, e ruan shqipen vetëm një ngulim arbëresh, Greçi, ndërsa në Abruc, në krahinën e Peskarës, shqipja ruhet në Badhesë (*Villa Badessa*).

Mjaft nga katundet arbëreshe ku ruhet shqipja, janë të banuara krejtësisht nga arbëreshë, si p. sh. Puhëriu, Kastërnexhi, Barilli, Maqi etj., por pjesa më e madhe e tyre janë vendbanime ku, përveç shumicës arbëreshe, jetojnë edhe italianë. Një studiues i njohur, K. Rother, shënon se në katundet arbëreshe ku flitet sot shqipja, 82.1 për qind e popullsisë së tyre janë arbëreshë.

²⁰ M. Bolognari, *Il silenzio della tradizione*, ('Heshtja e traditës'), Roma, 1978, f. 36.

I.2. ARBËRESHËT NË KALABRI

Aktualisht në Kalabri janë 31 fshatra arbëreshe, nga të cilat 24 në krahinën e Kozencës, 6 në krahinën e Katanxaros dhe një që i përket krahinës së Rexhio-Kalabros. Sipas numërimit të fundit, popullsia arbëreshe e fshatrave të Kalabrisë duhet t'i kalojë 100. 000 banorët.

Arbëreshët e Kalabrisë janë grupuar në qendra e lokalitete me shtrirje territoriale modeste, kryesisht në zona kodrinore e malore. Ato mund të grupohen në tri bërthama kryesore:

E para, që përfshin një zonë të brendshme të Kalabrisë Veriore, përbëhet nga bashkësitë arbëreshe të Platanit, Kastërnexhit, Çiftit, Frasnitës, Shën-Vasilit, Fermës, Ungrës dhe Firmozës.

E dyta, që shtrihet përgjatë vargut lindor të maleve Apenine, në pozicione piktoreske, përbëhet nga bashkësitë e Shën-Katerinës, Mongrasanos, Çervikatit, Çercetos, Shën-Mërtirit, Rota Grekas dhe Shën-Benedikt Ulanos.

E treta, e vendosur në të djathtë të Kratit, përbëhet nga Shën-Sofia, Shën-Mitër Korona, Strigari ose Shën-Kozmo, Vakarici dhe Mbuzati.

Një pozicion të veçantë e të veçuar nga fshatrat e tjera të Kalabrisë zënë Spixana dhe Falkonara Arbëreshe.

Në qoftë se do të kufizoheshim vetëm në vështrimin topografik dhe në formën e jetesës, bashkësitë arbëreshe nuk na dalin të ndryshme nga viset italiane që i rrethojnë. Këto bashkësi janë integruar si rrjedhojë e veprimtarisë prodhuese, kryesisht bujqësore e artizanale, si dhe për arsye të gjendjes ekonomiko-shoqërore që përfshihet në problemin e gjerë e të ndërlikuar të Italisë së Jugut.

Megjithatë, ruajtja e gjuhës shqipe, e kostumit të grave, e këngëve popullore tradicionale, e zakoneve dhe e traditave të bukura shqiptare përbëjnë kudo një tipar dallues.

Me rëndësi ishte edhe puna e arbëreshëve të Italisë, në shekullin XIX e në fillim të shekullit XX, në lëmin e studimeve shqiptare, sidomos të folklorit, gjuhës e letërsisë shqiptare.

Për mbledhjen e folklorit të arbëreshëve të Sicilisë e të Kalabrisë u dallua një numër i madh mbledhësish, ndër të cilët më të shquarit qenë: De Rada, Dhimitër Kamarda, Anton Skura.

Një numër studiuesish arbëreshë, si: Ëngjëll Mashi, Gjon Skiroi etj. mbrojtën tezën e lidhjeve gjuhësore të shqipes me gjuhën pellazge e të prejardhjes pellazge të popullit shqiptar, e cila u përvetësua më pas edhe nga De Rada e rilindas të tjerë dhe, në atë kohë, luajti rol pozitiv dhe ndihmoi për zgjimin e vetëdijes kombëtare. Më 1847, studiuesi i njohur arbëresh Vinçenc Dorsa botoi veprën e vet “Mbi shqiptarët, gjurmime e mendime”, të cilën ia kushtonte “kombit të vet të përçarë e të shpërndarë, po të njëjtë”.

Një vepër serioze në fushën e filologjisë që ajo e Dh. Kamardës “Sprovë gramatologjie krahasuese mbi gjuhën shqipe” më 1864. Në lëmin e historisë së letërsisë kërkime të vlefshme e studime me merita bënë arbëreshët Albert Stratikoi, Mikel Markiano, Viktor Gualtieri etj.

E gjithë kjo veprimtari, qoftë në fushën e letërsisë, qoftë në fushën shkencore e përgjithësisht kulturore e politike, që u zhvillua ndër arbëreshët e Italisë në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, synonte afirmimin e kombësisë së tyre dhe të drejtave të popullit shqiptar për të jetuar i lirë.

I.3. PËRBËRJA E POPULLSISË NË MAKJI

Makji, ose siç njihet ndryshe me emërtimin zyrtar italian Machia Albania, është një nga fshatrat e vogla arbëreshe, mjaft piktoresk, fraksion i komunës së Shën Mitër Koronës pjesë e provincës së Kozencës. Komuna e Shën Mitër Koronës shtrihet në një sipërfaqe 57,79 km me dendësi popullore 87 banorë. Sipas regjistrimeve në vite numri i popullsisë paraqitet si vijon:

Në vitin 1961 gjenden 5374 banorë, në vitin 1971 ka 4724 banorë dhe në 1981 5043 banorë.

Nga pikëpamja gjeografike Makji gjendet në një distancë prej 5 km nga Shën Mitër Korona dhe 8 km nga Strigari (San Cosmo Alb).

Ai gjendet në një areal gjuhësor shqipfolës, por edhe homogjen nga pikëpamja ekonomike e sociale e fetare pranë komunave të Santa Sofias, San Mitrit, Shën Kozmait, Vakarizit dhe Shën Giorgio. Arbëreshët e Makjit janë një komunitet që ka arritur t'i mbijetojë kohës me gjuhën, traditën dhe zakonet e tyre. Ky komunitet me një popullsi të vogël rezidente është një qendër e spikatur me histori dhe kulturë arbëreshe. Ndërkohë sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1981 përbërja e popullsisë në Makji ishte 480 banorë, jo të gjithë të përhershëm (rezidentë), ku përqindja e përdorimit të arbërishtes kalon shifrën 90%. Në regjistrimin e bërë në qershor 2005 përbërja e popullsisë është 274 banorë prej të cilëve italianë 15%, makiotë arbëreshë 3%, popullsi e përzier 82%.

Gjuha që flitet nga banorët paraqitet si vijon:

Banorë që flasin vetëm italisht 15%, banorë që flasin më mirë arbërisht se italisht 3%²¹, arbëresh që kuptojnë, por nuk flasin mirë shqip 6%, banorë që flasin në mënyrë të përzier shqip dhe italisht 76%.

Mosha e popullsisë paraqitet: fëmijë dhe adoleshtë 24%, të rritur 52%, mbi moshën mesatare 28%, të vjetër 7%.

Në regjistrimin e popullsisë qershor 2010, popullsia në Makji ishte 229 banorë prej të cilëve 51 % burra dhe 49% gra. Arbëresh dy gjuhësh (që flasin italisht dhe arbërisht) janë rreth 70%.

Arbëresh që kuptojnë, por nuk flasin arbërisht janë rreth 6% dhe arbëreshë që flasin më natyrshëm arbërishten sesa italishten 13%. Popullsia si aktivitet kryesor ka agrikulturën, si dhe shërbimet bazë si dyqane, ndërtime, shërbime elektrike, rrobaqepësi, agjenci funerale, farmaci etj. Ndërkohë sot nga burime të ndryshme thuhet se kjo popullsi nuk i kalon të 200 banorët.

Emri i Makjit është shumë i përmendur dhe i njohur, sepse aty ka lindur dhe ka jetuar arbëreshi më i shquar, Jeronim de Rada (1814-1903), patriot, poet, gazetar dhe studiues i njohur, autor i veprës poetike madhore "Milosao" dhe i shumë veprave të

²¹ Sot studiuesit arbëreshë faktojnë se në shumë ngulime vijon ende një gjendje njëgjuhësie (shqipfolëse) dhe se mungojnë kushtet e dygjuhësië. Me kalimin e kohës ndikimi i italishtes po shtohet dukshëm mbi arbërishten, duke ia zënë frymën asaj. Shih Gjovalin, "Ligjërimet arbëreshe" f. 45.

tjera, themelues dhe drejtues i revistës “Fjamuri i Arbrit”. Në Maqi lindën edhe Zef De Rada (1852-1883) gramatikan dhe poet; filologu Mikel Markiano, Dhimitër Mauro etj. Makjotët i mbajnë të gjalla edhe sot fjalët e figurës më të shkëlqyer arbërore, të mendimtarit të rrallë, mësuesit dhe publicistit dhe atdhetarit me vlera të jashtëzakonshme për kohën, Jeronim De Rada, *“Jemi krenar për të qenit arbëresh dhe të këtij vendthi ku kemi lindur”*.

Edhe në Makji gjuha arbëreshe është ruajtur mirë dhe të rinjtë e të rejat e këtij fshati, luftojnë gjallërisht për ruajtjen dhe vlerësimin e traditave kulturore arbëreshe. Shtëpia e De Radës në Maqi është kthyer në kopsht fëmijësh, ku nën kujdesin e mbesës së poetit, Nikolina de Radës, janë zgjedhur edhe edukatore arbëreshe, të cilat u mësojnë të vegjëlve këngë, vjersha dhe përralla në gjuhën shqipe.

Mikele Merchiono, studiues dhe pjesëtar i këtij komuniteti do të shprehej kështu: *“Makji është i vogël me banorë e shtëpi, por i madh me mendje e zemër”*.



Jeronim de Rada(1814-1903),

është një nga figurat qendrore të letërsisë shqiptare. Ai ka hyrë në historinë e letërsisë sonë si figurë e ndritur e atdhetar i kulluar, që shkriu tërë jetën e vet për ringjalljen e Shqipërisë, për zhvillimin e kulturës dhe të gjuhës shqipe. Në veprat e De Radës i bëhet jehonë vrullit të ri patriotik që kishte marrë lëvizja çlirimtare e popullit shqiptar. Ai ngrinte lart të kaluarën heroike të Shqipërisë, duke krijuar pamje të fuqishme artistike të kohës së Skënderbeut, me qëllim që të edukonte te shqiptarët ndjenjën e dashurisë

për atdheun dhe të forconte besimin në të ardhmen e Shqipërisë.

Veprat letrare të De Radës, me nivelin e lartë artistik, si dhe me përmbajtjen e tyre, merituan konsideratën dhe vlerësimin e lartë të shumë shkrimtarëve të njohur evropianë të kohës, duke ndihmuar kështu që populli shqiptar, kultura dhe çështja e tij kombëtare, të njihen dhe të çmohen në botën e jashtme.

Veprat madhore të De Radës ” *Këngët e Milosaos*”, ”*Serafina Topia* ”, ”*Pasqyra e një jete njerëzore* ”, ”*Skënderbeu i pafan* ”, ”*Rënia e mbretërisë së Shqipërisë* ”, lindën dhe u zhvilluan në kushtet e romantizmit dhe me tiparet e tyre kryesore ato përfshihen në këtë rrymë letrare. Kundrimin romantik e shohim në frymëzimin, përmbajtjen e formën e tyre. Ngjarjet e poemave të De Radës i përkasin gjysmës së parë të shekullit XV, kohës së luftërave të popullit tonë kundër turqve. Me këtë poeti u përpoq të ringjallte me artin e vet një epokë aq të lavdishme të historisë sonë, me skenat e çastet më dramatike e epike të saj për të fuqizuar krenarinë e vetëdijen kombëtare ndër arbëreshët e për të pohuar para botës të drejtat e Shqipërisë. Gjithë botën poetike të De Radës e përshkon ndjenja e dashurisë për atdheun.”²²

Në tekstet e letërsisë shqiptare, si dhe në studimet monografike, kushtuar veprës dhe jetës së De Radës, shkenca letrare shqiptare e vlerëson atë si njeriun dhe poetin që gjithë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare, krijimit të letërsisë artistike kombëtare shqiptare, misionit të realizimit të Rilindjes së Shqipërisë. Për ta kryer sa më mirë këtë

²² Intervistë e V. Minishit, me rastin e 250 –vjetorit të kolegjit të Shën-Adrianit, gazeta “Drita”, 22 janar 1983.

mision patriotik ai punoi dhe kontribuoi mjaft edhe si filolog, historian, publicist. Botimet folklorike që ai bëri u hapën rrugën përmbledhjeve të mëpastajshme të folklorit shqiptar dhe shërbyen si nxitje për patriotët tanë të Rilindjes, që iu përveshën mbledhjes së folklorit. Idetë e veprave të tij gjuhësore e historike patën përhapje të gjerë ndër rilindasit, si te Samiu, Naimi etj.

Veprat poetike e veprat e tjera, të shkruara shqip me përkthim italisht ose vetëm italisht, revista “Fjamuri i Arbrit”, veprimtaria e tij e palodhur, lidhjet me njerëzit më të shquar të botës letrare, shkencore e politike të kohës, bënë një punë të madhe për njohjen e propagandimin e popullit shqiptar e të çështjes së tij kombëtare. Ndër përpjekjet e tij madhështore për lëvrimin e gjuhës shqipe vend të vecantë zënë përpjekjet e tij për alfabetin e gjuhës shqipe

Duket qartë se De Rada si zgjidhje të problemeve që çështja e alfabetit shtronte, shihte përdorimin e shkronjave italiane dhe një shtesë me shkronja greke.

Në vitin 1871 “Gramatikën shqipe “ duke folur për alfabetin De Rada shkruan: *“Në zgjedhjen e alfabetit përdorur prej nesh, qëllimi ynë i vetëm ishte ai, që të përfitojmë nga mjeti më i shpejtë ekonomik për shprehjen e përsosur të të gjithë tingujve”*.

Ndërkohë De Rada bënte përpjekje të herëpashershme për përmirësimin e alfabetit, të cilin përdorte në shkrimet e veta. Në Revistën “Flamuri i Arbërit”, Viti i parë i botimit, numri i parë botuar në Corliano Calabri, 20 Qershor 1883, ai do të botonte një alfabet të përmirësuar, të plotësuar me shkronja shqipe dhe të pastruara nga shkronjat greke, përveç përdorimit të **χ** (hita) greke për shkrimin e bashkëtingëllores **h** shoqëruar me shembujt ilustrues : χee, raχ.

Në këtë botim vihet re edhe mungesa e paraqitjes së zanores y.

I njëjti alfabet do të botohej në “Fiamuri Arbërit” , viti i tretë i botimit Cozensa 15 tetor 1886. Ajo që vihet re është përsëri shmangia e shkronjave greke dhe zëvendësimi i tyre me shkronja shqipe të alfabetit latin. E vetmja shkronje greke që përdor autori është **χ** (hita greke) që shërben për realizimin e bashkëtingëllores fërkonjëse të aspiruar prepalatale **h** (χee)

Në gazetën e sipërpërmendur, në hyrjen e artikullit për “Alfabetin shqip” De Rada do të shprehej: *“Për të paraqitur pjesën fonetike të shqipes së folur nga kolonitë i jemi përmbajtur më shumë alfabetit italian, kemi pranuar pak shenja artificiale si dhe ndonjë nga shkronjat greke”*.

Me iniciativën e tij në vitin 1895 në qytetin e vogël Kalabrez të Korilianos u vendos ndër të tjera që të pranohej si alfabet i përbashkët për të gjithë arbëreshët, alfabeti i

tij. Ky rezultat ishte fryt i një pune të palodhur disa vjeçare. Kujtojmë se qysh në parathënien e “Gramatikës shqipe” e vitit 1870 ai do të shprehej se “*Një alfabet i përbashkët pret për t’u vendosur. Dhe një alfabet i tillë do të kihet, kur përsosmëria e librave shqip dhe themelimi i një shtypi shqiptar do ta bëjë të nevojshëm dhe do ta lehtësoj përdorimin*”.

Në Kongresin Kombëtar të Korlianos De Rada shprehte mendimin që “*të kemi një alfabet të thjeshtë dhe të lehtë për t’u mësuar*”. Të gjithë pedagogët më të shquar të kohës përqaфонin të njëjtën tezë; atë të përdorimit të alfabetit latin, i cili do të ishte më i lehtë për t’u mësuar. Me qindra artikuj politikë e pedagogjik të kohës të shkruar nga rilindësit si Kostandin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Pandeli Sotiri, Hoxha Tahsin, Mati Logoreci etj, do t’ia arrinin qëllimit për përdorimin e alfabetit latin, për ta përvetësuar më lehtë gjuhën amtare dhe për ta çuar me tej kulturën shqiptare”

Sistemi i fundit alfabetik që ai paraqet është në “*Abetaren e gjuhës shqipe*” e aprovuar dhe përshtatur nga Kongresi Kombëtar në tetor të vitit 1895, botuar në Korliano, në vitin 1896.

Në pjesën e parë të saj autori shtron një sistemin alfabetik të shoqëruar edhe me shembuj fjalësh për secilin tingull jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhën italiane dhe latine.

Siç vihet re më poshtë autori dallon bashkëtingëllore të thjeshta dhe të përbëra, si dhe përpiqet të bëjë një klasifikim të diftongjeve .

Veçojmë se në këtë botim De Rada ka reduktuar ndjeshëm përdorimin e shkronjave greke.

Konkretisht ai përdor χ (*chita*) për paraqitjen e bashkëtingëllores *hj* si dhe *x* për paraqitjen e dyshkronjësht *ks*, *si* dhe δ () për bashkëtingëlloren *dh*, ζ (*zita*) për *z* χ - (*hita*) për paraqitjen e dyshkronjësht *hj*, sh për *sh*, dh (për *dh*), th (për *th*)

Në hyrje të saj De Rada sqaron se: “*Alfabeti i gjuhës shqipe është i përbërë nga shtatë zanore dhe nga 31 bashkëtingëllore të thjeshta të përfaqësuara nga një ose dy shkronja*”.

Autori njih 7 zanore, 25 bashkëtingëllore, disa kombinime shkronjash, si dhe përdorimin e apaostrofit për zanoren *ë* të patheksuar.

Nisur nga varianti i fundit që jep për alfabetin, krahasuar me variantet që kemi hasur nga kërkimet tona), të krijuara prej De Radës, dallohet se në këtë variant ai ka zëvendësuar zanoret greke υ dhe γ (variante të cilat i përdorte për të shprehur *ë*- në)

me zanoren ë të shqipes, gjithashtu ai ka zëvendësuar σ me *sh*-në e shqipes, të vetmet shkronja të cilat mbarten prej alfabetit grek janë θ (që zëvendëson th-në) ñ Δ (që zëvendëson dh-në) Θ dhe χ për realizimin e h-së ose hj-së.

Për sa më sipër duket qartë se përpjekjet e De Radës për krijimin dhe unifikimin e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe zënë një vend të rëndësishëm në historinë e alfabetit të gjuhës sonë dhe për unifikimin e një gjuhe letrare arbëreshe. Por, sikurse shprehet studiuesi i njohur arbëresh F. Solana; *“Me gjithë përpjekjet e De Radës e të Skiroit për të krijuar një gjuhë letrare arbëreshe nuk u arrit një gjë e tillë. Sot vepra e De Radës mbete si një monument i së folmes së Shën Mitrit dhe zonës përreth”*

Prirja për të ruajtur dhe përdorur gjuhën shqipe me alfabet latin ,për krijimin e një alfabeti për të gjitha kolonitë shqiptare të Italisë vihen re fuqishëm ajo do të ishte pararendëse e punës që do të bënin rilindësit për unifikimin e një alfabeti të përbashkët për të gjitha trojet shqiptare. Emra të fuqishëm të rilindjes sonë kombëtare si Sami Frashëri. Hoxha Tahsini do t’i përmbaheshin të njëjtës ide asaj të De Radës: *“alfabeti duhet të jetë i lehtë dhe i thjeshtë për t’u mësuar, i pastruar nga shkronjat greke”*.

Vepra madhështore e De Radës në gjuhësi, publicistikë, krijimtari letrare, studime te karakterit albanologjik pasur nga gjithë plejada e shkrimtarëve arbëreshë të kësaj periudhe do të jepnin ndihmesën e tyre për të ardhmen e gjuhës së shkruar shqipe, për krijimin e një alfabeti të vetëm De Rada dhe arbëreshët e Italisë dhanë kontributin e tyre historik për përpunimin e alfabetit tonë të përbashkët (*kujtojmë shkronjat ë/ gj./ një/të cilat u sollën si risi në atë që sot e njohim si Alfabeti i Manastirit*).Ajo është pjesë e përpjekjeve të gjithë patriotëve dhe mendimtarëve të kohës, të cilët i paraprinë Kongresit të Manastirit duke dhënë kontribut të çmuar për zhvillimin e gjuhës shqipe në lidhje të pandërprerë me gjuhën e folur popullore duke bërë të mundur që gjuha shqipe me kalimin e kohës të zhvillohej në formatet e saj më të larta.

Duke u përlulur përpara kësaj figure të madhe të shqiptarisë mund të themi se:

Jeronim de Rada mbetet si një nga figurat e shquara të Rilindjes sonë. Ai luftoi, pa u epur, kundër çdo armiku të çështjes sonë kombëtare, kundër politikës së shovinistëve ballkanas e në mënyrë të veçantë atyre grekë, që donin të mbytnin lëvizjen kombëtare të popullit tonë. Admiruesit e De Radës qenë të shumtë dhe ndonjëherë nga figurat më të njohura. Një revistë e Parisit, “Melusinë”, e quajti atë *“Orfeu pellazg dhe Homer*

shqiptar”, ndërsa Dora d’Istria shkruante se “*poezitë e tij janë agimi i ditëve të lumtura të Shqipërisë*”. Natyrisht, vlerësim të lartë dhe vend të merituar De Rada ka marrë edhe në atdheun mëmë, në Shqipëri me studimet, botimet dhe trajtesat e shumta që iu kushtuan jetës dhe veprës së tij.

Breza të tërë nxënësish kanë përjetuar emocionin dhe mesazhin e fortë që përcjellin “Këngët e Milosaos”. Shprehja e Milosaos, heroit shqiptar që dashuron me forcë jetën, por që në të njëjtën kohë vdes si ushtar për mbrojtjen e mëmëdheut “*Erdhi dita e arbit*” tingëllon ende sot si burim frymëzimi, krenarie dhe atdhedashurie për shqiptarët e kudondodhur nëpër botë.

Vepra e tij madhështore është burim frymëzimi dhe objekt studimi për një plejadë albanologësh, gjuhëtarësh dhe mësuesish të gjuhës shqipe.

Shumë nga aktet dhe përpjekjet e arbëreshëve të Italisë për shkolla, arsimin dhe veçanërisht për lëvrimin e gjuhës së tyre amtare, shqipes, tashmë janë bërë të njohura edhe me anën e botimeve përgjithësuese, sidomos të teksteve të letërsisë sonë, në të cilat letërsia arbëreshe zë vendin e vet të merituar, si një pjesë përbërëse me vlerë e letërsisë dhe e kulturës shqiptare. Është me interes të përmenden disa nga momentet dhe ngjarjet më të rëndësishme të jetës e të përpjekjeve të arbëreshëve të Italisë në fushën arsimore, të lidhura gjithmonë me luftën e tyre të pareshtur për t’u afirmuar si etnitet kulturor dhe për t’i bërë ballë asimilimit nga kultura italiane që i rrethon.

Arbëreshët e Italisë kanë tradita të mira në historinë e arsimit kombëtar, të shkollës shqipe, të mendimit pedagogjik shqiptar.²³ Një ndihmë të mirë kanë dhënë dy kolegjet arbëreshe, institucione mësimore që u çelën në gjysmën e parë të shek. XVIII, në Sicili dhe në Kalabri. Ato përbëjnë një faqe shumë interesante e të ndritur të kulturës së arbëreshëve të Italisë. Prania e Kolegjit të Shën-Adrianit në Kalabri, si dhe ajo e Seminarit arbëresh të Palermos, në Sicili, u siguroi komuniteteve arbëreshe të këtyre krahinave të Italisë një trashëgim të vyer dhe të rëndësishëm historiko-kulturor mbi të cilin u zhvillua zotimi i shumë intelektualëve fetarë dhe laikë, që dolën nga këto institucione dhe që u dhanë një ndihmesë të çmuar luftërave për bashkimin e Italisë, Risorxhimentos e përgjithësisht kërkesave liridashëse dhe përparimtare të shoqërisë italiane brenda së cilës arbëreshët jetojnë.²⁴

²³ Shih: “Revista pedagogjike”, nr. 3, 1977, f. 116.

²⁴ Shih: Revista “Nëntori” nr. 3, 1983, f. 187.

Kolegji i Shën-Adrianit. U hap për here të parë më 1732 në mesin e abacisë në Shën-Benedikt Ulano. Siç shprehej De Rada, ky kolegji u çel “*si një derë e madhe drite të re e të butë, për të gjitha shtëpitë arbëreshe, nga të cilat, ata që patën mundësi, menjëherë dërguan bijt e tyre për të mësuar e për t’u arsimuar*”. Duke punuar në kolegji, De Rada bashkëpunoi me rilindës të shquar shqiptar si Zef Jubani e Thimi Mitko. Bashkëpunimi periodik pati edhe me revistën “Hylli i Dritës”, Shkodër. Patrioti i madh shqiptar, heroi dhe mësuesi i popullit, drejtori i parë i shkollës normale të Elbasanit, Luigj Gurakuqi ishte nxënës i De Radës.

Lëvruesi dhe studiuesi i çmuar i gjuhës shqipe Aleksandër Xhuvani për tri vjet shërbeu si mësues i gjuhës shqipe në Shën Mitër Koronë.

Nën vëmendjen e De Radës u zhvillua fuqishëm edhe publicistika. Në vitin 1848 ai botoi “Fiamuri i Arbërit”, e para fletore e shtypit shqiptar, e cila do të bëhej një flamur i vërtetë i çështjes sonë kombëtare, tribunë e atdhetarisë dhe mbrojtëse e çështjes kombëtare, ku mes çështjeve të u shtrua edhe kërkesa për autonominë e Shqipërisë. Në numrin e gjashtë të revistës “*Flamuri i Arbërit*” De Rada do të shprehte pikëpamjet e tij politike e patriotike, duke u shprehur mes të tjerash: “*Ne nuk shkojmë me Malin e Zi/ as me serb me Austri/as me Turk e me Greqi/duam vetëm autonomi. /Ç’është ky turp për Shqipëri të humbasë kombësi.*”

Përpjekjet e De Radës për lëvrimin dhe vlerësimin e gjuhës shqipe si më të vjetrat dhe më të pasurat gjuhë kanë qenë të vazhdueshme. Në vitin 1899 në shtypshkronjën e Katanzarës De Rada boton “*Caratteri della lingua Albanese , Suoi Monumenti Nell’ eta Preistorika*” pasuar nga “*Grammatica della lingua albanese*”, “*Antologjia albanese*”, “*Abecedario dellalingue albanese*” si dhe një nga një sërë veprash letrare. Botimet e De Radës u bënë objekt i punës studimore të albanologëve në kohë. Gjatë punës si kryeredaktor i revistës “*Shejzat*” Martin Camaj njihet së afërmi me botën arbëreshe dhe e bën objekt të punës së tij studimore, duke u bërë profesor i studimeve albanologjike. Një nga figurat më të shquara të shkencës arsimit dhe kulturës shqipe Eqrem Çabej mbron doktoraturën në fushën e studimeve arbëreshe, shoqëruar me një varg studimesh në këtë fushë, pasuar me emra shumë të rëndësishëm për kulturën dhe gjuhën shqipe si Shaban Demiraj, At Justin Rrota, Androkli Kostallari, Jup Kastrati, Jorgji Gjinari, Gjovalin Shkurtaj, Ethem Likaj etj. Kolegji i Shën-Adrianit u bë shpejt një vatër që përgatiti dijetarë e shkrimtarë të njohur, që i lanë nder e lavdi gjuhës amtare e letërsisë shqiptare. Ai që vendi ku u bashkua dhe u fuqizua kultura arbëreshe e personalitete shqiptare dhe kjo jo vetëm se

në të kanë studiuar aq personalitete të shkëlqyer të kulturës shqiptare, si: Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, heronj të popullit shqiptar si Avni Rustemi etj., që kanë punuar e luftuar për t'i ruajtur të pastra traditat kombëtare, por edhe sepse ky kolegji u bë vatër e kulturës shqiptare dhe arbëreshe, si dhe luajti rol në pasurimin e kulturës përparimtare italiane.

Për çeljen e kolegjit, pionierët e parë që ndihmuan qenë Stefan Rodotá dhe Samuel Rodotá nga familja e shquar e Koronjeve të Shën-Benediktit. Për disa vjet, nga 1732 deri më 1740 kolegjin e drejtoi Samuel Rodotá. Pas vdekjes së tij, drejtimin e mori Kolë de Markis nga Ungra. Më 1792 në krye të kolegjit erdhi Françesko Buliari nga Shën-Sofia, i cili drejtoi me zotësi dhe i dha emër kolegjit jo vetëm ndër arbëreshët, por edhe në mbarë Kalabrinë. Ky, pasi siguroi ndihma të konsiderueshme nga ana e qeverisë së kohës, nxori edhe lejen që ta shpërngulte kolegjin nga Shën-Benedkti në Shën-Mitër Koronë. Më 1 mars 1794 Kolegji u vendos në manastirin e Basilianëve të Shën-Adrianit dhe mori emrin “Kolegji i Shën-Adrianit”.

Në Shën-Mitër kolegji lulëzoi mjaft, por pas ca kohësh erdhën çaste të turbullta e plot trazira, sidomos nga çetat e kardinalit Rufo, që luftonin për të vënë në fron mbretin Ferdinand. Njëra prej këtyre çetave hyri në kolegji dhe bëri bastisje e shkatërrime, si dhe vrau në Shën-Sofi plakun e ndershëm, drejtuesin e kolegjit Françesko Buliarin, më 17 gusht 1799. Pas këtyre trazimeve kolegji mbeti i mbyllur deri më 1807, kur e rihapi Domeniko Bellushi nga Frasnita, profesor i gjuhës greke dhe gojëtar i dëgjuar. Ky e rregulloi dhe e zbukuroi mjaft kolegjin, duke e drejtuar për 25 vjet radhazi. Deri në vitin 1842 kolegjin e drejtoi Gabriele de Markis nga Ungra, pastaj erdhi Anton Markiano nga Maqi, mirëpo për shkak të mendimeve të tij lirishtetërore u hoq si drejtues dhe më pas edhe u burgos. Të njëjtin fat pati edhe pasuesi i tij, Vinçenc Rodotá. Është koha kur Ferdinandi II i Burbonëve kishte marrë mllef të madh ndaj studentëve të këtij kolegji, që shquheshin për idetë lirishtetërore, dhe dha urdhër që kolegji të mbyllej. Pas ca kohësh u hap sërishmi, mirëpo me vdekjen e De Markisit nga Ungra, drejtimin e mori peshkopi A. Franko nga Mezojuso (Sicili), i cili ishte njeri me ide e mendime të vjetra dhe për pasojë Kolegji nuk pati asnjë përparim, prandaj arbëreshët u mblodhën dhe protestuan në qeveri për ta hequr. Këtë qëllim e realizuan, por Kolegji i kaloi peshkopit të fshatit italian Rosano, i cili e mbajti deri më 1860 kur në Kalabri hynë forcat e Garibaldit. Ky i fundit, me këshillën e kërkesën e arbëreshëve që bënë pjesë në ushtrinë e tij, e shkëputi përsëri kolegjin nga Rosano dhe dhuroi një kontribut prej 12 mijë dukatësh për rindërtimin e pajisjen e tij, si dhe

caktoi një komision për ta drejtuar atë. Në komision bënë pjesë Antonio Markiano nga Maqi (kryetar), Benedeto Skura nga Vakarico dhe Saverio Elmo nga Firmoza, të cilët me punën e zellin e tyre e zbukuruan dhe e lulëzuan kolegjin si në kohët e para.

Kolegji i Shën-Adrianit, siç dihet, në origjinë ishte një seminar për përgatitjen e klerikëve arbëreshë të ritit grek-bizantin. Megjithëkëtë, asnjëherë nuk pati ndër intelektualët arbëreshë një përzierje identifikimi, madje edhe në periudhën e parë të historisë së këtij institucioni, në shekullin XVIII, kur kollaj identifikohesh një popull jo sipas gjuhës që fliste apo kulturës që kishte, por sipas ritit fetar që e karakterizonte. Që më 1796, arbëreshi Mikele Bellushi, duke iu përgjigjur peshkopit të Rosanos, në Kalabri, që vepronte me të gjitha mjetet për t'u imponuar komuniteteve arbëreshe përreth (Mbuzatit, Vakaricos, Strigarit, Shën-Mitrit, Maqit) juridiksionin e kishës latine, theksonte:

“Zotëria juaj bën një gabim trashanik kur, duke përzier grekët me shqiptarët, i quan këta të fundit grekë kryelartë dhe gënjeshtarë. Shqiptarët, që përbëjnë popullsinë e Mbuzatit dhe të bashkësive të tjera të Kalabrisë, që ruajnë ritin grek, nuk janë njësoj si grekët; kanë origjinë të ndryshme, dallohen prej gjeneze, prej natyre e prej zakoni. Njëllojshmëria e të njëjtit rit fetar që ushtrojnë, nuk mjafton për të futur një përputhje të përgjithshme në të gjitha karakteret e tjera, që zakonisht ndryshojnë kombet midis tyre”²⁵

Si gjuhë mësimi në fillim ishte greqishtja, por mësohej edhe latinishtja. Më pas u përdor italishtja. Shqipja përdorej nga nxënësit vetëm në kumtimet me gojë me njëri-tjetrin. Në vitin 1849, me ndërhyrjet dhe përpjekjet e Jeronim de Radës u lejua të futej në Kolegjin e Shën-Adrianit mësimi i gjuhës shqipe. Për këtë ishte krijuar me kohë klima e nevojshme, sidomos me përparimin e lëvizjes mendore, letrare e shkencore ndër arbëreshët. Një numër i mirë dijetarësh arbëreshë ishin marrë me studimin e gjuhës shqipe, me folklorin, etnografinë dhe historinë e popullit shqiptar. Mësimi i shqipes iu besua De Radës, i ***cili u bë kështu mësuesi i parë i shkollës shqipe***. Katedra e shqipes, falë punës dhe përpjekjeve të De Radës, u bë mbrojtëse e kombësisë shqiptare. Ajo që një çerdhe e dashurisë së pakufishme të arbëreshëve për mëmëdheun e parë, për Shqipërinë, për virtytet e vetitë e shqiptarëve, për cilësitë e tyre të mira.

Kolegji i Shën-Adrianit e mbajti kurdoherë lart prestigjin e vet si institucion. Dëshmi e qartë është fakti se prej tij dolën shumë njerëz të përmendur, të cilët, frymën që morën aty e përhapën kudo duke dhënë ndihmesa të vyera në lëmin e arsimit,

²⁵ Revista “Nëntori” nr. 3, 1983, f. 188.

kulturës e shkencës. Mund të përmendim, ndër të tjerë, nxënësit e De Radës, poetët e njohur arbëreshë Zef Serembe e Bernard Bilota.

Krijimi i katedrës së gjuhës shqipe në Kolegjin arbëresh të Shën-Adrianit ndihmoi për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe me shkrim nëpër ngulimet arbëreshe të Italisë dhe u bë gjithashtu një qendër kërkimesh e hulumtimesh shkencore. Në 1851, me dekret mbretëror, katedra u mbyll dhe De Rada u pushua nga puna për idetë e tij përparimtare e demokratike. Pas kësaj De Radës iu desh të punonte shumë, qoftë për rivendosjen e katedrës së shqipes, qoftë për vetë ekzistencën e Kolegjit. Më 1866 ai e shtroi me forcë këtë çështje, duke vënë në dukje nevojën e *“një strehe për gjuhën shqipe”*. Ai argumentonte se *“nuk ka kuptim kolegji arbëresh kur në të nuk mësohet shqipja”*.

Më 1889 De Rada shkoi vetë në Romë dhe kërkoi me këmbëngulje në Ministrinë e Arsimit që katedra të hapet përsëri. Me përpjekjet që bëri ai mundi të siguronte rivendosjen e mësimin të shqipes në Kolegjin në vitin shkollor 1889-1890. Megjithëse plak, ai punoi me entuziazëm të madh për arsimin shqiptar. Më 15 nëntor 1902, vetëm tre muaj para se të vdiste, në fjalën përuruese të vitit shkollor, De Rada theksonte: *“Rihapja e një shkolle shqipe në Kolegjin tonë na mbush, o djelmosha bashkatdhetarë, me një kënaqësi e me besim në të ardhmen. Prandaj, ngritjen e katedrës së re të gjuhës shqipe, mund ta konsiderojmë, në radhë të parë, si faktor historik, me anë të së cilës do të përkrahim ringjalljen e popullit shqiptar”*.²⁶

Gjatë periudhës që zgjati mësimi i shqipes në Kolegjin e Shën-Adrianit u botuan një varg tekstesh shkollore, programesh e planesh mësimore, që janë me shumë rëndësi për historinë e mendimit pedagogjik shqiptar dhe të shkollës shqipe. Mund të përmendim *“Leksione të gjuhës shqipe”* (1892), *“Konferenca mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe”* (1893), *“Tiparet e gjuhës shqipe dhe gramatika e saj”* (1894), *“Abetarja e gjuhës shqipe”* (1896) etj. Që të gjitha me autor De Radën. Kolegji i Shën-Adrianit, pikërisht në kohë të vështira e të turbullta për Shqipërinë, shërbeu edhe si qendër kulture e edukimi për rininë shqiptare. Që prej vitit 1898 deri më 1919 aty ndoqën mësimet mbi njëqind intelektualë shqiptarë, të cilët u bënë veprimtarë entuziastë në shërbim të atdheut e të arsimit kombëtar.

²⁶ Jup Kastrati, “Jeronim De Rada”, 1979, f. 140.

I.5. VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË TË FOLMEVE ARBËRESHE

E FOLMJA ARBËRESHE E MAKJIT

E folmja arbëreshe e Makjit u lëvrua nëpërmjet shkrimeve të një prej përfaqësuesve më të denjë të botës arbërore, Jeronim de Radës.

Për të folmen arbëreshe të Maqit meritë të veçantë ka dhënë Prof. Francesco Altimari me botimin në “Zjarri”, viti 1984, nr 29 të studimit “La parlata di Macchia Albanese. Apunti fonologici”.

Vlerësimi i parë themelor që del prej studimit është *se sistemi fonologjik i së folmes së Maqit nuk ka dallime thelbësor nga pjesa dërrmuese e të folmeve të tjera të jugut.*

Edhe Prof. Altimari ashtu si gati të gjithë dialektologët e njohur, e ka filluar hetimin e studimin dialektologjik me të folmen e vendlindjes së vet, pra me të folmen e Maqit (Machia Albanese), një nga studimet interesante dhe ku ai, me njohjen e plotë që i jepte të qenët vendas, po edhe me përgatitjen që kishte fituar në lëmin e dialektologjisë duke punuar me F. Solanon, si nxënës, bashkëpunëtor dhe, më pas, si vijuesi i tij më i shquar në lëmin e albanologjisë në Itali, na dha në vitin 1984 punimin e parë dialektologjik me titull “La parlata di Macchia Albanese. Appunti fonologici”²⁷ (E folmja e Maqit Arbëresh. Shënime fonologjike), në “Zjarri”. Anno XVI, (1984), nr. 29.

Studimi mbështetet në të dhënat e mbledhura në vend prej autorit në vitin 1982, të kontrolluara e të verifikuara edhe në vitin 1983, duke ndjekur e plotësuar kështu të gjitha drejtimet e duhura për një përshkrim e paraqitje sa më të besueshme të sistemit fonetik e fonologjik të një të folmeje interesante si ajo e Maqit. Duhet të përmendim, ndër të tjera, rrethanën që prej atij ngulimi ka qenë poeti dhe mendimtari i shquar Jeronim de Rada, veprat e të cilit, në radhë të parë, pasqyrojnë pikërisht të folmen e Maqit dhe të Shën-Mitër Koronës, ku ai jetoi e punoi për shumë vjet.

Vlerësimi i parë themelor që del nga studimi i Altimarit është se *sistemi fonologjik i së folmes së Maqit nuk paraqet dallime thelbësore nga shumica e të folmeve arbëreshe të Italisë, të cilat, sikundër dihet, paraqesin dukuri të përbashkëta me dialektin e shqipes jugore.*

²⁷ Shih: F. Altimari, “La parlata di Macchia Albanese. Appunti fonologici” (E folmja e Maqit Arbëresh. Shënime fonologjike), në “Zjarri”. Anno XVI, (1984), nr. 29.

E folmja e Maqit ka 36 fonema: /p/, /b/, /t/, /d/, /q/, /gj/, /k/, /g/, /ç/, /x/, /f/, /v/, /th/, /dh/, /s/, /z/, /sh/, /zh/, /ç/, /j/, /lj/, /m/, /n/, /nj/, /l/, /lj/, /r/, /rr/, /a/, /e/, /i/, /u/, /o/, /ë/.

Në krahasim me shqipen letrare të sotme, kjo e folme, sipas Altimarit, paraqet këto dallime në inventarin e fonemave:

a) prishjen e kundërvënies ndërmjet fonemave zanore /y/ -/i/, kështu që, në të folmen e Maqit, si kudo ndër arbëreshë, y-ja duke u delabializuar, ka përfunduar në /i/: *si* “sy”, *shtinj* “shtynj=shtyj”, *di* “dy”;

b) praninë e fonemës bashkëtingëllore /hj/ (API: /ç/), frikative qiellëzore e shurdhët, në një numër të kufizuar fjalësh, si */hje/* “hije”, */hjeth/* “hedh”, dhe në disa fjalë të huazuara nga greqishtja, si */hjiromer/* “ushunj”, */rahji/* “rrah, rrahishte”, */hjeta/* “palë fiqsh të thatë”;

c) sonorizimi i frikatives velare të shurdhët /h/ në /gh/ (API): */ghëngral/* “hëngra”, */prëghem/* “prëhem, pushoj”, */njogh/* “njoh”.

Ndërsa dy dukuritë e para (a) dhe (b) e bashkojnë të folmen e Maqit me të folmet e tjera arbëreshe, dukuria e tretë (c), dmth. kalimi i velares së shurdhët në përgjegjësen e saj të zëshme, duke ndjekur skemën e klasifikimit fonologjik të të folmeve arbëreshe të propozuar nga F. Solano (1979 b, f.6), paraqet një tipar karakteristik dhe përfshihet në izoglosën e ngushtë të areales kozentine, që përfshin të folmet e Falkonarës, Marrit, Shën-Sofisë, Shën-mitër Koronës, Maqit, Strigarit (San-Cozmo Alb.), Vakaricit dhe Mbuzatit (S. Giorgio Alb.).

Po ashtu, për sa u përket grupeve të moçme /kl/, /gl/ dhe për evolucionin e mëtejme të grupeve /pl/, /bl/, /fl/ dhe /vl/ ,e folmja e Maqit përfshihet në arealin II, ku hyjnë pjesa më e madhe e të folmeve arbëreshe të Kalabrisë Jugore: *aty*, grupet e vjetra kanë dhënë /q/ e /gj/: *klanj>qanj=qaj*, *glëmb>gjëmb*; *plak >pjak*, *blenj >bjenj =blej*, *fleta>ffeta* “fletë”, *vlonj>vjonj* “ruaj”.

Tipare të tjera që e dallojnë të folmen e Maqit nga shqipja e sotme e përbashkët janë: shqiptimi i anësore /lj/, që në shqipen se sotme del kudo /l/, p.sh. *ljumi*, *ljajta* “lava”, ose /j/ *buljar* “bujar”, *e bilja* “e bija”, *uljk* “ujk”, *dëljgonj* “kuptoj”; kalimi i grupit *fsh* në të gjitha pozicionet në /sh/: *shinj* “fshinj=fshij”, *qosha* “qofsha”, *mundash* “mëndafsh”.

Në studimin jepet tabela e sistemit fonologjik të zanoreve, e përbërë nga: /a/, /e/, /i/, /ë/, /o/, /u/ ,duke shënuar rrethanën interesante për t’u pasur prasysh se në të folmen arbëreshe të Maqit, zanoret e theksuara, në disa kushte kontekstuale, paraqesin një realizim fonetik më të zgjatur, duke u karakterizuar kështu si variante kontekstuale të

fonemave përkatëse. Gjithashtu, në pozicione të theksuara, qoftë zanoret e përparme, qoftë të prapmet, përveçse sasiorisht të gjata, janë edhe diçka më të hapura e më të shtrira sesa në shqipen letarere. Në aso pozicione, zanoret /i/, /u/, /e/, /o/ realizohen përkatësisht si allofone të : /I:/, U:/, E:/, /O:/). Në të njëjtat pozicione edhe fonema /a/, përveçse paraqitet me zgjatim zanor, shqiptohet më e hapur se në pozicione të patheksuara.

Me shumë interes është trajtimi i gjatësisë së zanoreve. “Gjatësia e zanoreve, sipas materialeve që dalin nga folësit e moshës së re, nuk duket të ketë funksion dallues, por, përkundrazi, sipas pohimit të Jakobsonit, në këtë të folme dhe në të folmet e tjera arbëreshe, duket të kemi një dukuri prozodike “pertinente” por jo “distintive”, përderisa ajo mbart vetëm përmbajtje shprehëse ose emotive në komunikimin gojor”. Zgjatimi i zanoreve realizohet zakonisht në të folurit e “ngadalshëm” dhe në të folurit “e shpjetë” vetëm në rrokje të theksuara të fjalëve që ndodhen në fund të sintagmës, ose të frazës. Brenda sintagmës dhe frazës ka, përkundrazi, neutralizim të kësaj dukurie prozodike, p.sh.: /ai ë.sht nj-burr i-mi:r/ - /sa mir-e-dish at-bu:rr/.

Në përcaktimin e zgjatimit (ose jo) të një zanoreje marrin pjesë përveç theksit, edhe faktorë të tjerë kontekstualë të natyrës fonetike: dukuria e zgjatimit është e ndërvarur, në një masë të madhe, nga kushtet fonetike sinkronike, si pozicioni dhe natyra e rrokjes dhe veçoritë nyjetimore të bashkëtingëlloreve që vijnë pas tyre dhe, në disa raste, me kushtet fonetike diakronike, si ruajtja e gjatësisë zanore origjinare, zgjatimi kompensator që ndodh pas rënies së një ë-je fundore dhe nga tkurrja (kontraksioni) i dy a më shumë tingujve në një të vetëm.

Zgjatimi i zanoreve, sipas studimit të F. Altimarit për Maqin, duhet konsideruar një tip i sistemimit dhe i shpërndarjes fonetike të realizimit të zgjatuar të zanoreve në varësi të disa tipareve, rregullave, kontekstit, që shkojnë sipas skemës: /+ theks/, /+ bashkëtingëllore të tingullt/, qenia në kufi të fjalës etj. Gjatësia ose zgjatimi i zanoreve në të folmen arbëreshe të Maqit, del jashtëzakonisht problematike, për arsye se lidhet me kryqëzimin e një vargu faktorësh sinkronikë dhe diakronikë, megjithatë ai mbërrin në një shkoqitje se kur mund të kemi zanore të gjata ose të zgjatura. Dukuria e zgjatimit të zanoreve shfaqet në poemën “Këngët e Milosaos” hera – herës në situata të ndryshme.

Realizohen përgjithësisht të gjata:

a) zanoret e theksuara fundore në rrokje të hapur: /dhe:/, /folje:/" çerdhe, fole zogu", /gra:/, /ra:/, /pa:/, (shpi:/ "shtëpi", /shi:/

b) zanoret e theksuara në rrokje të mbyllur, që ndiqen nga bashkëtingëllore lëngëtore: /bo:r/, /bi:r/ “djalë”, /mi:r/ “mirë”, /gju:r/ “gju-gjuri”, /t-ke:r / “të ketë”, /vE:r/ “verë si stinë dhe verë”, /ka:l/ , /pa:l/ “pajë”, /shka:l / “shkallë”, /za:l/ “zall, ranishte”, /sko:l/ “shkollë”;

c) zanoret e theksuara në rrokje të mbyllur, që ndiqen nga bashkëtingëllore të tingullta mbyllëtore: /gji:z/ “gjizë”, /mI:z/ “mizë”, /ljU:g/ “lugë”, /dE:g/ “degë”.

Përkundrazi, sipas studimit të Altimarit, realizohen të shkurtra:

a) zanoret e patheksuara: /in'zot/ “Zoti”, /trImi/ “djali” i ri”, /kusha:l/ “xhep”, /ljepur/ , (theristi/ “qershor”, /nUse/, /vorEa/ “era e fortë”;

b) zanoret e theksuara në rrokje të mbyllur, që ndiqen nga mbylltore të shurdhërta: /mEs/ “jetë, mjet”, /shok/ , /bUk/ “bukë”, /rrEth/;

c) zanoret e theksuara në rrokje të mbyllur, që ndiqen nga grupet bashkëtingëllore: /ghelq/ “tërheq”, /gjims/ “gjysmë”, /arbrisht/.

Në studim paraqitet gjendja e diftongjeve dhe e grupeve zanore. Diftongjet aty dalin dy llojesh:

a) ngjitës:

/aj/: /pstaj/, /maj/, /ajer/;

/ej/: /vej/ “vente”, /atej/ “andej”;

/ij/: /pij/ “pinte”, /frij/ “frynte”, /stij / “shtynte”;

/oj/: /moj/ “mese”, /vjoj / “ ruaj”;

/uj/: /uj/ “ujë”, /ruj/ ”shoh”;

/ëj/: /bëj/, /vëj / “vëre”, /xëj/ “nxë, mëso”;

b) zbritës:

/ja/: /jap/, /mialj/ “mjaltë”, pjaku “plaku”;

/je/: /i-vjeghrri/, /vjesht/ “vjeshtë”, /pjeshk/ “pjeskë”;

/jo/: /pjot/ “plot, /mbjon/ “mbush”, /vjonj/ “ruaj”;

/ju/: /pjughur/ “pluhur”, /bjujtur/ “bluar”;

/ue/: / kuelj/ “kuaj”, /ghuerr/ “luftë >it. guerra”.

Grupet zanore /ua/, /ie/, /au/, /eu/, /iu/, duke e pasur theksin në rrokjen e parë, shqiptohen si dy rrokje të veçanta:

/ua/: /thua/, /grua/, /mua/;

/ie/: /mile/ “miell”, /u-ndie/;

/au/: /vlau/ “vëllai”, /shkau/ “rrëshqiti, shkau”, /kau/;

/eu/: / dheu/ , /preu/, /rrëmbeu/;

/iu/: / miu/, /shiu/, /siu/ “syri”.

Përshkrimi i sistemit të fonemave bashkëtingëllore

E folmja e Maqit, sipas përshkrimit të F. Altimarit, ka këto fonema bashkëtingëllore:

8 fonema zanore mbylltore:

/p/: mbyllëtare dybuzore e shurdhët: /pjot/, /pes/ “pesë”, pastronj.

/b/: mbyllëtare dybuzore e zëshme: /bughua/ “pluhur”, /bath/ “bathë”, /mbola/ “mbolla”.

/t/: mbyllëtare dhëmbore e shurdhët: /trimi/ “djali i ri”, /menat / “nesër”, /taksa/ “premtova”.

/d/: mbyllëtare dhëmbore e zëshme: /drita/, /ndanj / “ndaj”, /dardha/.

/q/: mbyllëtare qiellëzore e shurdhët: / qish/ “kishë”, /paq/ “paqe”, /qindronj/ “ndalem”.

/gj/: mbyllëtare qiellëzore e zëshme: /gjegjinj/ “dëgjoj”, /gjuri/, / magjja/.

/k/: mbyllëtare velare e shurdhët: /kalj/ “kal”, / mjekër/, /kalarem/ “zbres”.

/g/: mbyllëtare velare e zëshme: /grusht/, /grisinj/ “harxhoj, konsumoj”, /sheg/ “shegë”.

4 zanore afrikate:

/c/: afrikate dhëmbore e shurdhët: /cjap/, /cnohem/ “plagosem”.

/x/: afrikate dhëmbore e zëshme: /xathur/ “zbathur”, /xë/ “nxë, mësoj”, /rrux/ “ndryshk”.

/ç/: afrikate qiellëzorealveolare e shurdhët: /çer/ “faqe, çehre”, /çonj/ “gjej”, /maçe/ “mace”.

/xh/: afrikate qiellëzorealveolare e zëshme: /xheshur/ “zhveshur”, /xhapier/ “zhapik, çapin”.

11 fonema frikative:

/f/: frikative qiellëzorealveolare e shurdhët: / famul/ , /furr” “furrë”, /fanmir/ “fatmirë”.

/v/: frikative qiellëzorealveolare e zëshme: / vap/ “vapë”, /lavem” preokupohem, marrosem”, /vete/ “unë vete”.

/th/: frikative majoredhëmbore e shurdhët: /thesi/ , /thom/ “unë them”, /rreth/.

/dh/: frikative majoredhëmbore e zëshme: /dhri/ “hardhi”, / lidhinj/ “lidh”, /dheljper/ “dhelpër”.

/s/: frikative dhëmbore e shurdhët: /sot/, / besa/, /stisa/ “ndërtova”.

/z/: frikative dhëmbore e zëshme: /zonj/ “zonjë”, /zgjohem/ , /miza/.

/sh/: frikative qiellëzorevelare e shurdhët: /shurbeva/ “punova”, /shpi/ “shtëpi”, /kasht/ “kashtë”.

/zh/: frikative qiellëzorevelare e zëshme: /gozhd/ “gozhdë”.

/hj/: frikative qiellëzore e shurdhët: /hjim/ “tatëpjetë, dishezë”, /hjiromer/ “ushunj, dhajmë derri”, /ehjinj/ “mpreh”.

/j/: frikative qiellëzore e zëshme: /jasht/ “jashtë”, /jatri/ “ilaçe, barna mjekësore”, /maj/ “maji”.

/gh/: frikative velare e zëshme: /ghare/ “hare, gëzim”, /ghunda/ “hunda”, /shogh/ “shoh”.

5 zanore lëngëtore:

/l/: lëngëtore anësore aveolare: /lavem/ “preokupothem”, /lam/.

/lj/: lëngëtore anësore qiellzore: /ljalja/ “daja, xhaxhai”, /ljëmsht/ “lëmshi”, /kalji / “kali”.

/r/: lëngëtore njëdridhëse dhëmbore: /rist/ “të qeshur”, /dera/, /tru/.

/rr/: lëngëtore shumëdridhëse dhëmbore: /rriqe/ “rriqër”, /trusht/ “rrushi”, /marr/.

4 bashkëtingëllore hundore:

/m/: hundore dybuzore: /mola/ “molla”, /muli/ “mulliri”, /nëm/ “mallkim, nëmë”.

/n/: hundore dhëmbore: /nisem/, /nënkrie/ “përkresë, jastëk”, /nana/ “gjyshja”.

/η/: hundore velare (vetëm para mbyllëtores qiellëzore të zëshme /g/): /ηgE:/ “nge, kohë në dispozicion”, /mëηg/ “mëηgë”, /ljëηg/ “lëηg”.

/ŋ/: hundore velare (vetëm para mbyllëtores qiellëzore të zëshme /gj/): /ŋgjitem/ “hip, ngjitem”, /ŋgjaljat/ “ngjalat”, /ŋgjienj/ “ngjyjej”.

Në studim trajtohen edhe raste të neutralizimit dhe të kombinimit të fonemave bashkëtingëllore, të cilat janë me interes dhe japin një pamje të plotë të sistemit fonetik të së folmes arbëreshe të Maqit.

Sikurse shume prej studiuseve kanë pranuar, veçanërisht për sa u përket formave foljore, të folmet e katundeve arbëreshe të krahinës së Kozencës nuk kanë ndonjë ndryshim me rëndësi midis tyre. Dialektologët arbëreshë (F.Solano, F.Altimari, A.Guzzetta, M.Mandala, P.Scutari etj.) dhe shqiptarë (M.Camaj, Sh. Demiraj, Gj.Shkurtaj etj.) që janë marrë me studimin e të folmeve arbëreshe, pohojnë se sistemi foljor i të folmeve arbëreshe, në pikëpamje të morfosintaksës, ka ecur nëpër një rrugë pothuajse unike. Kjo duket si në trajtat e ruajtura që shpjegohen me ekzistencën më se pesëshekullore të këtyre të folmeve si ishuj gjuhësorë, të shkëputur

nga trunngu i gjuhës shqipe, ashtu edhe në risimet (inovacionet) morfosintaksore që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe.

Nisur edhe nga hulumtimet tona gjatë studimit të veprës së De Radës për të folmet e Maqit mund të veçonim si vëzhgime gramatikore do të veçonim se:

E folmja e Maqit, sikurse të gjitha ligjërimet arbëreshe ka tipare kryesore që përkojnë me toskërishten jugore, veçanërisht me të folmen më skajore, çamërishten. Vihet re gjithashtu larmi dialektore, dhe përzierje të lehta me greqishten bizantine e më pak me italishten. De Rada, sikurse gjithë shkrimtarët e përmasave të tilla e pasuron të folmen e Maqit dhe të arbërishtes në përgjithësi duke sjellë në vepër përdorime të munguara në këto të folme, siç janë shprehja e mënyrës kushtore, habitore, apo përdorimi i paskajores.

I.6. TIPARE KRYESORE MORFOSINTAKSORE TË TË FOLMEVE ARBËRESHE TË ITALISË

Studimet e deritanishme, si ato mbi gjuhën arbëreshe të shkruar sikurse edhe përshkrimet dialektologjike të mirëfillta, të bëra mbi bazën e vëzhgimeve të të folurit të gjallë, kanë treguar se *format gramatikore paraqiten më homogjene sesa fonetika dhe leksiku*. Veçanërisht përse u përket formave foljore, të folmet e katundeve arbëreshe të krahinës së Kozencës nuk kanë ndonjë ndryshim me rëndësi midis tyre. Dialektologët arbëreshë (F.Solano, F.Altimari, A.Guzzetta, M.Mandala, P.Scutari etj.) dhe shqiptarë (M.Camaj, Sh. Demiraj, Gj.Shkurtaj etj.) që janë marrë me studimin e të folmeve arbëreshe, pohojnë se sistemi foljor i të folmeve arbëreshe, në pikëpamje të morfosintaksës, ka ecur nëpër një rrugë pothuajse unike. Kjo duket si në trajtat e ruajtura që shpjegohen me ekzistencën më se pesëshekullore të këtyre të folmeve si ishuj gjuhësorë, të shkëputur nga trunngu i gjuhës shqipe, ashtu edhe në risimet (inovacionet) morfosintaksore që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe.

Na duket me interes të ravijëzojmë këtu disa prej aspekteve më kryesore të nxjerra nga studimet dialektologjike, në mënyrë që më pas të mund të bëjmë edhe disa përjasje e krahasime me paradigmat përkatëse të zbatuara në veprën e De Radës.

a) Të folmet arbëreshe të Italisë paraqiten me disa trajta foljore të dallueshme jo vetëm nga ato të gjuhës letrare, po edhe nga ato të gjuhës së sotme dialektore. Kjo veçori e tyre është vënë re dhe është përmendur nga ndonjë studiues, po pa u ndalur

në shpjegimet dhe argumentimet e nevojshme dhe veçanërisht, pa depërtuar në të gjitha hollësitë e saj. Kështu p.sh. studiuesi arbëresh F. Solano shënon se “*dallimet themelore midis dy dialekteve të shqipes*²⁸ *janë në të pakryerën dhe në të ardhmen e dëftores*”²⁹. Ky vlerësim, sipas Gj.Shkurtajt është i miratueshëm vetëm përse i takon së pakryerës, ndërsa përse i takon së ardhmes, ai mbështet mendimin e J. Gjinarit, i cili ka theksuar: “*Bindja se dy dialektet e shqipes dallohen në mënyrë absolute për shkak të dylllojshmërisë së ndërtimit të futurit, me sa duket, është formuar më tepër nga shqipja e shkruar në dy variante dialektore. Të dhënat e të folmeve të shqipes nuk flasin për ekzistencën e një futuri të tipit ballkanik në Jug e të një tjetri të tipit romanoperëndimor në Veri. Futuri i tipit **do të punoj** gjendet kudo në shqipen e folur, madje ai përdoret shumë edhe në gegërishten veriore*”³⁰.

b) Po kështu, nga analiza e materialit dialektor që ka mbledhur në të folmet arbëreshe të Kozencës, si dhe nga kundrimi i të dhënave të tjera, nëpër punime e studime për të folme të tjera të arbëreshëve të Italisë (si p.sh. për atë të Molises, të Grecit etj.), po edhe nëpërmjet krahasimit me trajtat e gjuhës letrare shqipe si dhe ato të gjuhës dialektore të sotme në Shqipëri e në hapësirat shqiptare ballkanike, Shkurtaj thekson se mund të shihen edhe të tjera dallime në format gramatikore të kohëve dhe mënyrave të foljes. Sigurisht që për këtë nuk mjafton vetëm vështrimi i trajtave foljore të thjeshta, sepse duhet të merren parasysh edhe trajtat foljore të përbëra. Me këtë rrugë del se nuk janë vetëm trajtat e së pakryerës dhe të së ardhmes të të folmeve arbëreshe të Italisë që paraqesin interes për t’u studiuar dhe krahasuar me ato të dialekteve dhe të folmeve të tjera të shqipes. Me të njëjtën vlerë e interes studimor paraqiten edhe trajtat foljore të së tashmes së dëftores.

Trajtat e kohës e tashme e mënyrës dëftore

Trajtat e kohës së tashme të mënyrës dëftore në të folmet arbëreshe të Italisë, në krahasim me ato të shqipes së sotme dallohen mjaft qartë për këto dy arsye: Së pari, për ekzistencën e disa mbaresave të cilat në dialektet e të folmet e tjera të

²⁸ Është rasti të vemë në dukje se Solano i përbahet mendimit më të përgjithshëm që i përfshin të folmet e arbëreshëve të Italisë në dialektin shqiptar të Jugut, ndërsa ekziston edhe mendimi që ato përbëjnë një dialekt të tretë të shqipes.

²⁹ Fr. Solano, *Manuale di Lingua Albanese, Elementi di morfologia e sintassi, esercizi – cenni sui dialekti*, Corigliano Calabro, 1972.

³⁰ J. Gjinari, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, “Studime filologjike”, 4, 1968, f. 159.

shqipes ose janë zhdukur ose nuk kanë ekzistuar dhe, së dyti, për ekzistencën e përdorimit të dendur të trajtave analitike të së tashmes, të tipit: *jam + e + vinj*.

1. Jo vetëm në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, po edhe në të folme të tjera të arbëreshëve të Italisë, vihet re shtimi i mbaresës -inj, në trajtën e vetës i njëjës edhe tek foljet me bashkëtingëllore p. sh.: (unë) *ghapinj, qepinj, ikinj, ecinj, lidhinj, ndihinj* etj. të cilave u përgjigjen në toskërishte trajta pa mbaresë (e ashtuquajtura mbaresë-zero): *hap, qep, ik, ec, lidh, ndih*, dhe forma me mbaresën -i: *hapi, qepi, iki, eci, lidhi*, kryesisht në të folme të gegërishtes veriore, po edhe në disa të folme të toskërishtes³¹. Për ta pasur më të qartë gjendjen e kësaj dukurie Prof. Shkurtajt jep edhe paradigmen e zgjedhimit të disa prej këtyre foljeve në kohën e tashme:

njëjës:	v. I	ghapinj	v. II	ghapën	v. III	Ghapën
		qepinj		qepën		qepën
		ikinj		ikën		ikën
		ecinj		ecën		ecën
		ljidhinj		lidhën		lidhën
		ndihinj		ndihën		ndihën

shumës:	v. I	ghapmi	v. II	ghapni	v. III	ghapnjën
		qepmi		qepni		qepnjën
		ikmi		ikni		iknjën
		ecmi		ecni		ecnjën
		ljidhmi		ljidhni		ljidhnjën
		ndihmi		ndihni		ndihnjën

Sipas studimit të Shkurtajt rezultojnë që në të folmet arbëreshe të Kozencës, në këtë lloj zgjedhimi kanë kaluar shumë nga foljet me temë në çdo bashkëtingëllore përveç s/t, të cilat, në tri vetat e njëjësit dalin me mbaresë -zero, ndërsa në shumës kanë mbaresat: v. I -mi, v. II -ni, v. III -ën. Shembujt i kemi të plotë për trajtat e foljeve ngas, vras, flas, pres:

³¹ Po ai, *Dialektologjia shqiptare*, dispensë, Tiranë, 1966, f. 54.

njëjës:	v. I	ngas	v. II	nget	v. III	nget
		vras		vret		vret
		fjas		fjet		fjet
		pres		pret		prêt
shumës:	v.I	ngasim	v.II	ngini	v. III	ngasën
		vrasmi		vrini		vrasën
		fjasmi		fjini/ fjisni		fjasën
		presmi		prini		presën

2.Nuk marrin mbaresa në tri vetat e njëjësit edhe foljet *dal, marr: dal, del, del, dalmi, dilni, daljën; marr, merr, merr, marrmi, mirrni, marrën.*

Njësoj si foljet me bashkëtingëllore (të tipit të parë) zgjedhohen edhe të gjitha foljet e marra nga italishtja. Ne vumë re se, në rastet kur të folmet arbëreshe e kanë bjerrë foljen përkatëse të brumit amtar, u drejtohen foljeve të italishtes (ose të dialektit kalabrez), por duke u dhënë atyre trajtat zgjedhimore arbëreshe. Si temë e së tashmes në këto raste merret trajta e paskajoren p.sh, *kapirinj* nga it. *capire* “kuptoj”, *condinuarinj* nga it. *continuare* “vazhdoj”, *guadhanjarinj* nga it. *guadagnare* “fitoj, nxjerr të ardhura” etj. Po një shtresë më e vjetër e foljeve të huazuara nga italishtja kanë kaluar në zgjedhimin e foljeve me zanore dhe i janë shtruar një asimilimi më të fortë. Kështu p.sh. *qandonj* (nga it. *piantare* “mbjell”) përveç zgjedhimit me mbaresat foljore të të folmeve arbëreshe, ka pësuar edhe ndryshime të tjera, sidomos fonetike (grupipj i italishtes ka kaluar në q, ashtu si tek *qac,-a* “shëtitore” nga it. *piazza, qaga* “plaga” nga it. *piaga*), *penxonj* nga it. *pensare* “mendoj”, *kaerconj* nga it. *c arezzare* “ledhatoj” etj.

- c) Foljet me zanore të tipit *bëj, frij, kërktoj, punoj, shkruaj, lyej* etj. në të folmet arbëreshe të Kozencës, në vetën e parë njëjës të së tashmes dalin me mbaresën -nj: *bënj, frinj < frynj, kërkonj, punonj / pënonj* “lëroj, plugoj”, *shkru:nj, lienj* etj. Në vetat e tjera marrin mbaresat: -n, -n, -mi, -ni, -njën:

Njëjës:	v. I	Bënj	v. II	bën	v. III	bën
		frinj		frin		frin
		kërkonj		kërkon		kërkon
		punonj /pënonj		punon		punon /pënon
		shkru:nj		/pënon		shkruan
		lienj		shkruan		lien
				lien		

Shumës:	v. I	Bëmi	v. II	bëni	v. III	bënjën
		frimi		frini		frinjën
		kërkomi		kërkoni		kërkonjën
		punoni /pënoni		punoni		punonjën
		shkru:mi		shkruni		shrunjën /shkruanjën

Foljet pi, rri, fle në të tri vetat e njëjësit dalin pa mbaresa, ndërsa në shumës kanë mbaresat -mi, -ni, -në:

shumës:	v. I	pë: “pi”	v. II	pë: “pi”	v. III	pë: “pi”
		rrë: “rri”		rrë: “rri”		rrë: “rri”
		fj3 “fle”		fj3 “fle”		fj3 “fle”
shumës:	v. I	pimi	v. II	pini	v. III	pi:në
		rrimi		rrini		ri:në
		fj3mi		fj3ni		fj3:në

4.Nga kjo paraqitje e zgjedhimit të foljeve në kohën e tashme, Prof. Shkurtaaj dallon që në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, ashtu si te autorët e vjetër, gjejmë të ruajtur *-nj-* (në mbaresën e vetës së parë njëjës). Ky fakt është me interes, kur dihet që në gegërisht *nj-*ja qysh nga shekulli XVIII është kthyer në palatalen *-j*, ndërsa në toskërisht *nj-*ja u ruajt deri në shekullin tonë³². Vrojtimet e studimet dialektologjike të këtyre viteve të fundit tregojnë se, në gjendjen e sotme, përhapje më të gjerë kanë në toskërishten trajtat me *-j*; trajtat me *-nj* janë kufizuar kryesisht në

³² M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, dispensë, Tiranë, 1961, f. 45.

toskërishten veriore, po edhe aty ka të folme si ato të Korçës, Pogradecit etj. që kanë trajtën me -j³³.

Edhe në mbaresat e vetës së dytë e të tretë në folje të tilla me bashkëtingëllore si *ghapën, qepën, ikën, ecën, ljidhën* etj. shohim një gjendje paralele me trajtat *ecën, ikën* të shpesha në gjuhën dialektore shqipe. Siç është shpjeguar nga historianët e gjuhës: “Këto e kanë burimin në pseudombaresat e foljeve më -n”³⁴.

5. Trajta të përbashkëta me ato të mbarë shqipes ose përkime të pjesshme me ato të të folmeve të ndryshme të toskërishtes shohim edhe në raste të tjera të zgjedhimit të foljeve në kohën e tashme. Të tilla janë p.sh. trajtat e tri vetave të njëjësit të foljeve *ngas, vras, flas, pres*, si dhe të foljeve *marr, dal*. Për nga ana morfologjike, të njëjtën gjë mund të themi edhe për trajtat e tri vetave të njëjësit të foljeve *pi, rri, fle* të cilat, ndërkaq, paraqiten të dallueshme nga ana fonetike, duke qenë se kanë pësuar kalimin *ei-së* në një etë hapët: *rrëç; pëç*: dhe të grupit -fjnë fj: *ffz*.

Njësoj si në mbarë shqipen, paraqiten në të folmet arbëreshe edhe trajtat e vetës së dytë shumës, si të foljeve me zanore ashtu edhe të atyre me bashkëtingëllore; ato ndërtohen me mbaresën -ni (*qepni, ecni, kërkoni, bëni* etj.).

6. Të dallueshme nga shqipja letrare dhe dialektet e të folmet e saj, paraqiten trajtat e vetës së parë shumës të të folmeve arbëreshe. Në mbaresën -më- të shqipes, që del si vazhdim i mbaresës indoevropiane -mos, në të folmet arbëreshe është bërë shndërrimi fonetik *ë > i = -mi*. Me interes është se dukuria vihet re në foljet me bashkëtingëllore (*kapmi, marrmi, ngasmi*), ashtu edhe në ato me zanore (*bëmi, pënomi, fjmë, rrimi* etj.). Përsa i përket kalimit *ë > i*, i cili, siç ka shpjeguar M. Domi, është një inovacion i vonshëm³⁵, shohim një zhvillim paralel me mbarë shqipen, ku gjithashtu mbaresa -më e së tashmes ka dhënë -im nëpërmjet kalimit fonetik *ë > i*, (khs. arb. *marrmi* dhe shqip *marrim*). Sipas Prof. Shkurtajt mesa duket, kemi të bëjmë me të njëjtën dukuri, të përfutur në dy rrugë të ndryshme: në rastin e parë (në të folmet arbëreshe) nga *marrmë* tek *marrmi* kemi të bëjmë me një kalim të drejtpërdrejtë *më > mi*, ndërsa tek *marrim* procesi i kalimit *ë > i* ka ardhur pas një metateze të *marrmë > marrëm*, prej nga më pas ka dalë *marrim*. Për këtë na dëshmon prania e trajtave të tilla si *marrëm, japëm, presëm, qesëm* etj., të cilat përveç se te Matrënga (*jesëmë*),

³³ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, dispensë, Tiranë, 1966, f. 117.

³⁴ M. Domi, *vep. e cit.*, f. 48.

³⁵ M. Domi, *vep. e cit.* f. 46.

Bogdani (*presëmë, shofëmë*)³⁶ etj. i gjejmë edhe sot në disa të folme të Jugut, po edhe në ndonjë të folme të Veriut, në gojën e brezit të vjetër, si variante të trajtave me *-im*.

7. Edhe trajtat e vetës së tretë shumës të të folmeve arbëreshe paraqiten të dallueshme nga ato të mbarë shqipes. Përballë trajtave me mbaresat *-in*, për foljet me bashkëtingëllore (*marrin, ecin, presin*) dhe me *-jnë, -në* për foljet me zanore (*punojnë, shkojnë, pinë*) të përgjithshme jo vetëm në gjuhën letrare po edhe në gjuhën dialektore shqipe, në të folmet arbëreshe kemi trajtat me mbaresën *-njën* për foljet me zanore të tipit *bënj, punonj* (si dhe të foljeve me bashkëtingëllore që kanë kaluar në zgjedhimin si ato me zanore (shih *ghapnjën, ndihnjën, bënjën, frinjën, kërkonjën*), me *-në* për ato të tipit *pi* (shih *pi-në, rri:në, f3:në*) dhe me *-ën* për foljet me bashkëtingëllore të tipit *vras, ngas* (shih: *ngasën, vrasën, fjasën, presën*).

8. Po, sigurisht, dallimin më të dukshëm midis të folmeve arbëreshe dhe gjuhës shqipe të sotme e shohim në trajtat e dyta, analitike të së tashmes (të tipit *jam + lidhëzën e + foljen* në kohën e tashme p.sh. *jam e vinj*). Kështu p.sh. kudo nëpër katundet arbëreshe, të bien në vesh menjëherë pyetjet: *ku je e vete* ose *ku in veni / ku ini e veni* si dhe përgjigjet po me trajtë të tillë analitike p.sh. *jam e vete mbë skolët* ose *jemi e vemi mbë skolët*.

Kjo trajtë e dytë e së tashmes, siç u tha, del si një ndërtim i përbërë nga tri gjymtyrë: 1) folja *jam* 2) lidhëza bashkërenditëse *e, e cila*, në ndonjë rast edhe mund të mungojë, në pasojë të elizionit etj. 3) folja që shpreh veprimin themelor në kohën e tashme. Trajtat e së tashmes me këtë ndërtim janë shumë të dendura në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës. Sipas regjistrimeve në Frasnitë: nani *jam e rëfienj* një prralez // *jam e vete* bënj një mbashatë // në Shën Mitër, Maqi, Vakarico e Mbuat (katunde të afërta me njëra-tjetrën): se u *jam e t'ru:j* me zemër kudo je // *ku je: vete* cop lëdrun? // te albergu jini e f3ni? // *është e t'ikën* thumbëza // shomi *ç'janë e bënjën* // në Spezano: *jam e rrëmonj* silatat te vreshta // në Platan: *jam gjith dje:rs* çë *janë e më dalën* // në Çivita: tha: *veni ka pllasi se tata është e na pret* // thuaju: "*jam e peshkarinj* pishq" // etj.

9. Nga ana strukturore për këtë trajtë janë për t'u shënuar këto dukuri: a) folja që shpreh kuptimin themelor mund të jetë në trajtën veprorë p.sh. *jam e lanj* po edhe në trajtën pësore p.sh. *jam e laghem*; b) lidhëza *e* të shumtën e herës është e pranishme p.sh. *jam e vinj, jam e vete, është e gha* etj. po ka edhe raste që bie, si

³⁶ Po ai, po aty, f. 46.

pasojë e elidimit a kontraktimit (në prani të zanoreve të tjera) p.sh. *ku je vete, ku je e vete*; c) midis foljes *jam* dhe foljes që shpreh kuptimin themelor mund të hyjnë edhe trajta të shkurtra të përemrit vetor p.sh. *jam e t'gjegjinj // tata është e napret // jam gjith dje:rs që janë e mëdalën // është e t'ikën thumbëza* etj.

Për nga funksioni sintaksor, të tri gjymtyrët e kësaj trajte shkrihen në një trajtë të vetme, e cila është e krahasueshme me trajtat e italishtes *sto* + gerund, tipi *sto lavando* apo *sto lavandomi* dhe shpreh një veprim të zgjatur (durativ).

10. Trajta e tipit *jam e vinj* është e përhapur në mbarë të folmet e arbëreshëve të Italisë; atë e ka vënë re dhe është përpjekur ta shpjegojë Kamarda, i cili e quan “të barasvlershëm me gjerundin e .që vlen për të shënuar një veprim që vazhdon...”³⁷, por, një kthjellim në lidhje me ndërtimin dhe kuptimet e kësaj trajte, nuk mund të arrihet vetëm me përqasjen e thjeshtë të saj me ato të italishtes *sto* + gerund (*sto venendo*). Lidhur me këtë formë, na duket me vend të sjellim në vështrim edhe pohimin e Prof.Shkurtajt, i cili thotë: “Pa mohuar një ndikim të mundshëm nga kjo trajtë e italishtes me të cilën (gjuhë) të folmet arbëreshe bashkëjetojnë prej pesë shekujsh, neve, ndërkaq, na duket e domosdoshme të kthejmë sytë dhe të marrim parasysh edhe dritën që lëshon mbi këtë trajtë krahasimi me simotrat e saj në të folme të tjera arbëreshe p.sh. *jam ç lanj* në të folmen e Grecit nëpërmjet së cilës gjejmë edhe një lidhje me të folmet e skajit jugor të shqipës, si p.sh. me atë të Labovës së Kryqit në lokalitetin e Libohovës (pranë Gjirokastrës) ku gjëllinë pikërisht trajta të tilla analitike “të ndërtuara nga folja ndihmëtare *jam*, lidhëza *që* dhe e tanishmja e foljes themelore: *jam që laj duart, është që ha bukë, është që shkruan*³⁸ etj.”³⁹.

- Studiuesi thekson se “duke dalë në lëmin më të gjerë të gjuhës dialektore shqipe, krahasimi mund të shkojë edhe më tej duke përfshirë në vështrim edhe trajtat e ngjashme (gjithashtu analitike) të gegërishtes veriore (tipi *jam ka vi*), të cilat janë të ngjashme nga forma dhe krejt të njëjta nga kuptimi me ato të të folmeve arbëreshe”.Kjo trajtë, përveçse në disa të folme të toskërishtes jugore e gegërishte, të cilat janë përmendur në punimin e Prof. Shkurtaj⁴⁰, shfaqet edhe në çamërisht në trajtën; *jam ç vete ka ime motërë, jam të shkoj, jam të thom di fjalë*. Të dhëna të tilla e përforcojnë mendimin e Prof. Shkurtajt se trajtat

³⁷ D. Camarda, *Saggio di Grammatologia Comporata sulla Lingua Albanese*, Livorno 1864, f. 329.

³⁸ E. Lafa, *E folmja e Nikaj-Mërturit*; “St. fil.” 3, 1964, f. 130 (shënim).

³⁹ Shih:Gj.Shkurtaj, stud.cit.,

⁴⁰ Shih. Kap. I, F.. 38.

analitike të të folmeve arbëreshe (tipi jam + e + foljen në kohën e tashme) duhet ta ketë zanafillën jo jashtë shqipes tek gerundi i italishtes, siç mendonte Kamarda, po, përkundrazi, brenda vetë asaj d.m.th. kemi të bëjmë me një trajtë⁴¹

që arbëreshët e kanë marrë me vete nga Shqipëria, ku gjurmët ruhen si në Jug ashtu edhe në Veri⁴².

E pakryera e mënyrës dëftore

E pakryera e mënyrës dëftore, ashtu si e tashmja, në të folmet arbëreshe të Kozencës del me dy trajta: a) me një trajtë të thjeshtë, mbaresat e së cilës, në pjesën më të madhe janë të njëjta ose afrojnë me ato të të folmeve të skajit jugor të Shqipërisë, b) me një trajtë të dytë, analitike të formuar nga e pakryera e foljes jam + e + foljen themelore në të pakryerën (tipi: *inja e vinja*).

Për dy vetat e para të njëjësit dhe për tri vetat e shumës mbaresat e së pakryerës (për foljet e trajtës veprorë) janë të njëjta si për foljet me zanore ashtu edhe për ato me bashkëtingëllore: v. I -nja, v. II -nje, shumës: v. I -jim, v. II -jit, v. III -jim, ndërsa në vetën e tretë njëjës gjendja është disa formëshe: me mbaresën -nej p.sh. b3nej “bënte” -nij p.sh. *bjenij* “blente”, pa mbaresë p.sh. *prit* “priste”, *vej* “vente” etj. Për ta kthjelluar gjendjen e kësaj trajte po japim paradigmen e disa foljeve kryesore:

a) Foljet ndihmëtare *jam* dhe *kam* në të pakryerën kanë këto trajta:

njëjës:			shumës		
v. I	<i>inja</i>	<i>kinja</i>	v. I	<i>ishim</i>	<i>kishim</i>
v. II	<i>inje</i>	<i>kinje</i>	v. II	<i>ishit</i>	<i>ishit</i>
v. III	<i>ish</i>	<i>kish</i>	v. III	<i>ishin</i>	<i>kishin</i>

b) Foljet me zanore:

njëjës	v. I	<i>shkonja</i>	v. II	<i>shkonje</i>	v. III	<i>shkonej</i>
		<i>qandonja</i>		<i>qandonje</i>		<i>qandonej</i>
		<i>bënja</i>		<i>bënje</i>		<i>bënej /bënij</i>
		<i>ljanja</i>		<i>ljanje</i>		<i>ljanij/ ljanej</i>

⁴¹ Mendojmë se kjo është një trajtat më konservatore të shprehjes së të tashmes së vazhduar.

⁴²Shih: Gj.Shkurtaç, stud.cit.

<i>bjenja</i>	<i>bjenje</i>	<i>bjenej / bjenij</i>
<i>vinja</i>	<i>vinje</i>	<i>vinej / vij</i>
<i>rrinja</i>	<i>rrinje</i>	<i>rrinej / rri:j</i>
<i>shurbenja</i>	<i>shurbenje</i>	<i>shurbenej</i>
<i>venja</i>	<i>venje</i>	— <i>ve:j</i>

shumës	v. I	<i>shkojim</i>	v. II	<i>shko.jit</i>	v. III	<i>shko.jin</i>
		<i>qandojim</i>		<i>qandojit</i>		<i>qandojin</i>
		<i>bëjim</i>		<i>bëjit</i>		<i>bëjin</i>
		<i>ljajim</i>		<i>ljajit</i>		<i>ljajin</i>
		<i>bjejim</i>		<i>bjejit</i>		<i>bjejin</i>
		<i>vijim</i>		<i>vijit</i>		<i>vijin</i>
		<i>rrijim</i>		<i>rrijit</i>		<i>rrijin</i>
		<i>shurbejim</i>		<i>shurbejit</i>		<i>shurbejin</i>
		<i>ve:jim</i>		<i>ve:jit</i>		<i>ve:jin</i>

c) Foljet me bashkëtingëllore

njëjës	v. I	<i>prisnja</i>	v. II	<i>prisnje</i>	v. III	<i>prit</i>
		<i>vrisnja</i>		<i>vrisnje</i>		<i>vrit</i>
		<i>shihnja</i>		<i>shihnje</i>		<i>shih</i>
		<i>thonja</i>		<i>thonje</i>		<i>thoj / thonej</i>
shumës	v. I	<i>prisjim</i>	v. II	<i>prisjit</i>	v. III	<i>prisjin</i>
		<i>vrisjim</i>		<i>vrisjit</i>		<i>vrisjin</i>
		<i>shihim</i>		<i>shihjit</i>		<i>shihin</i>
		<i>thojim</i>		<i>thojit</i>		<i>thojin</i>

Nga kjo paraqitje Shkurtajt thotë se del e qartë se në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, trajta e thjeshtë e të pakryerës ka një fytyrë të afërt me atë të folmeve anësore të toskërishtes të tilla si çamërishtja. E njëjtë me atë të çamërishtes

del trajta e vetës së tretë njëjës me mbaresën *-nej*: *ikënej, dëgjonej*, si dhe mbaresat e tri vetave të shumësit *-jim, -jit, -jin*: *bijim* (= bënjim), *bijit bijin*^{12/1}.

2. Ashtu si e tashmja edhe e pakryera e mënyrës dëftore, krahas trajtës së thjeshtë ka edhe një trajtë të dytë, analitike që ndërtohet nga e pakryera e foljes jam + lidhëzën bashkërenditëse e + foljen që shpreh kuptimin themelor në të pakryerën. Të dyja gjymtyrët e kësaj trajte analitike, njësoj si tek e tashmja e tipit *jam e vinj*, shërbejnë si një kallëzues i vetëm: ki ulku e piti ku *ish e venej* // këjo i tha se *ish e venej* gjënej mëmën tats // (Frasnitë); një he:r *ish e hanij* ki biri regjit e preu nj'glisht // kur *ish e hajin* gjith mbë trietzt ... // një ditë pa se kjo grua e ljugë ç'i shoqi kish kllarë ndë shpi:t *ish e i binej* së biljes // (Çivita); kur shihnja mallin se *ish e partirnej* (Shën Mitër-Koronë) etj.

Këto trajta analitike të së pakryerës janë më pak të përdorshme se ato të së tashmes.

E kryera e thjeshtë

Në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, ashtu si edhe në të folmet e tjera të arbëreshëve të Italisë, zotërojnë aoristet asigmatike. Në dallim nga gjuha e sotme shqipe, në vend të aoristit me *-va* për foljet me zanore, mbizotërojnë trajtat e aoristit me *-ta*; po edhe aoristi me *-va* shfaqet në këto të folme, veçse me një denduri më të pakët se ai me *-ta*.

a. Folja *jam* ka trajtat:

Njëjës	<i>qeva</i>	shumës	<i>qe:më</i>
	<i>qeve</i>		<i>qe:të</i>
	<i>qe</i>		<i>qe:në</i>

b. Foljet me zanore të tipit *shkruanj* marrin mbaresat *-ta, -te, -ti, -tim, -tit, tën*:

Siç shihet në vend të aoristit me *-va* për disa prej foljeve me zanore, mbizotërojnë trajtat e aoristit me *-tapsh*: *frita, ruati, ndajti, përthaiti, thaiti, ngrëiti*,

^{12/1} Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në *Dialektologjia shqiptare I*, 1971, f. 180.

ffëiti, ndejti duke marrë mbaresat *-ta, -te, -ti, -tim, -tit, tën*: Kjo ⁴³ dukuri është një zhvillim vetjak i arbërishtes i përfutur pas shkëputjes nga trangu i shqipes

Njëjës	v. I	<i>shkruajta</i> <i>frita</i>	v. II	<i>shkruajte</i> <i>frite</i>	v. III	<i>shkruajti /shkrujti</i> <i>friti</i>
shumës	v. I	<i>shkrujtim</i> <i>fritëm</i>	v. II	<i>shkrujtit</i> <i>fritët</i>	v. III	<i>shkrujtën</i> <i>fritën</i>

Po këto trajta nuk janë të vetmet për këtë kategori foljesh. Krahas tyre ekzistojnë edhe trajtat me mbaresat *-a, -e, -i, -m, -t, -n* dhe me *v* epentetike, si në shqipen e sotme standarde p.sh. *kërkova, kërkove, kërkoi, kërkua, kërkuan, kërkuan;* *qandova, qandove, qandoi, qanduam, qanduat, qanduan* etj.

c) Foljet e tipit *marr*, njësoj si në mbarë shqipen, edhe këtu pësojnë apofoninë e zanores rrënjore *a>o* dhe marrin këto mbaresa: në njëjës: *-a, -e, -i (-ti)*, dhe në shumës: *-tim, -tit, -tim*.

Njëjës	v. I	<i>mora</i> <i>vola</i> <i>sola</i> <i>mbola</i>	v. II	<i>more</i> <i>vole</i> <i>sole</i> <i>mbole</i>	v. III	<i>mo:ri/ murti</i> <i>vuoli</i> <i>suoli</i> <i>mbuli</i>
shumës	v. I	<i>murtim</i> <i>vuoltim/ vultim</i> <i>suoltim/ sultim</i> <i>mbultim</i>	v. II	<i>mu:rtit</i> <i>mjuoltit/ vultit</i> <i>sjuoltit/ sultit</i> <i>mbultit</i>	v. III	<i>murtin</i> <i>vjuoltit/ vultin</i> <i>sjuoltin/ sultin</i> <i>mbultin</i>

ç) Foljet *vinj* “vij” dhe *vete* në aorist dalin:
erdha, erdhe, erth; erdhtim, erdhtit, erdhtin;
vajta, vajte, vate; va:më, va:të, va:në.

d) Foljet *shoh, them* dalin me trajtat:

(unë) *pe:*, (ti) *pe:*, (ai) *pa:*, (na) *pa:më*, (ju) *pa:të*, (ata) *pa:në*.
(unë) *the*, (ti) *the*, (ai) *tha:*, (na) *tha:më*, (ju) *tha:të*, (ata) *tha:në*.

⁴³ Gj. Shkurtaj, art.cit.f.32

Nga kjo paraqitje e skicuar e trajtave të së kryerës së thjeshtë që ka bërë Prof.Shkurtaj në studimin e tij, mund të shihet që, në themel se të folmet arbëreshe kanë pothuajse ato trajta që shohim edhe në të folmet e tjera të shqipes, me disa dallime të cilat mund të shihen, herë si ruajtje trajtash më të lashta si p.sh. aoristi josigmatik i foljevejam, shoh, them: (unë) qeva (ti) qeve; (unë) pe, (ti) pe; (unë) the, (ti) the, herë si zhvillime të reja, vetjake që janë përftuar në këto të folme pas shkëputjes nga trangu i shqipes,por që njihen edhe në disa të folme të toskërishtes. I tillë është p.sh. shtimi i aoristeve me -ta në vend të atyre me -va në foljet me zanore (tipi: shkruajta, frita në vend të shkrova, friva).

Me interes paraqitet edhe trajta e vetës së tretë njëjës të foljes me apafoni (tipi marr - mora) ku shohim një gjendje me variante dhe lëkundje. Në themel aty kemi trajta me mbaresën -i (muri / murti; moli etj.) po edhe me zberthim të zanores së temës. Me sa duket kemi të bëjmë me një kryqëzim të trajtave me mbaresën -i (të tipit doli, mori) me ato pa mbaresë (të tipit dual, muar) të cilat i gjejmë edhe sot në të folme të ndryshme të gjuhës shqipe.

Koha e ardhme

Një nga dukuritë që i dallon të folmet e shqipes është edhe formimi i trajtave të së ardhmes me ndihmësen kam: tipi kam me ba përdoret vetëm në të folmet gege, sidomos në gegërishten veriore, tipi kam për të bërë del më dendur në të folmet jugore dhe në atë të Shqipërisë së Mesme⁴⁴ dhe tipi kam të bëj gjendet kryesisht tek arbëreshët e Italisë⁴⁵. krahas tyre, me të njëjtën shtrirje dialektore përdoren edhe format e tipit kisha me ba, kisha për të bërë dhe kisha të bëja me vlerën e së ardhmes në të shkuarën përkatësisht të kushtores⁴⁶.

E ardhmja e tipit “kam” + lidhore në të folmet arbëreshe është e vjetër. Këtë trajtë e gjejmë që në dokumentimet e para të arbërishtes së shkruar te Matrënga, ku, “të shumtën e herës përdoret si futurum necessitatis: kemi të anastisemi 27 (= të ringjallemi). Po kështu edhe te Santori: s’kemi te nderomi tin zonë (Emira, I, 2) etj.”⁴⁷.

⁴⁴ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, dispensë, 1966, f. 59.

⁴⁵ Sh. Demiraj, Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe, “St. fil.”, 3, 1970.

⁴⁶ Po ai, po aty.

⁴⁷ M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, dispensë, 1961, f. 69.

Këtë trajtë, siç na dëshmojnë Kamarda⁴⁸, Lamberci⁴⁹ e studiues të tjerë, e kanë mbarë të folmet e italo-shqiptarëve, po gjurmë të saj gjejmë edhe jashtë këtyre të folmeve si p.sh. në përshkrimet e Anonimit të Elbasanit ndeshim: “*ke të helmohesh tepër*”⁵⁰.

Trajta e së ardhmes me “*kam*” + lidhore ndeshet dendur në të gjitha të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës ku, sipas vëzhgimeve dhe materialeve tona, ajo del në dy forma: a) folja “*kam*” (e cila e ruan trajtën e saj të pangurosur d.m.th. ndryshon sipas vetave dhe numrit) + lidhoren me pjesëzën të: p.sh. *kam të thom, ke të thuash, ka të thotë, kemi të thomi, keni të thoni, kan(ë) të thonjën*; b) me foljen “*kam*” + lidhoren pa pjesëzën të: p.sh. *kam thom, kam bënj, kem i thomi* etj.

Veta I njëjës

Për vetën I njëjës shembujt i kemi edhe me ruajtje të pjesëzës të dhe me rënie të saj. Trajtat me rënie të pjesëzës të siç do të shihet edhe në shembujt e mëposhtëm janë më të dendura:

a) trajta me ruajtje të pjesëzës të: *kam t'e thom* in italiano? (Shën Mitër-Koronë), *kam t'e njoh* se kush është (Vakaricë), e bila u kish bën 18 ani e tha: “*kam t'e martonj*” (Vakaricë), *ka të të ngas* (Platan), *kam t'ja jap* (Ejaninë), *kam të marr* një trëndofilje (Maqi), *si kam të bënj* / tha / se jam e ljothët (Çivita), jam e bënj kshet se *kam të martohem* (Frasnitë).

b) trajta pa pjesëzën të: *kam thom* atë me zogat // *kam e thom* // *kam ju thom* kanxuna // *kam, e thom*, puru arbrisht // *kam ju e thom* // *kam ethom* një shurbe:s (Frasnitë), *kam e thom* // nani *ç'kam thom* (Spexano), *si kam thom* (Maqi), *kam e thom* // *ç'kam thom* nane? (Shën Mitër-Koron?), *kam i thom* atë ... (Ejaninë), aj xapaturi i nëmuri tha: “*si kam i thom* kshtu sime bilje? // *kam thom* prallëzën // *kam ju thom* një vjersh kurorje // (Çivita), më ljireve vetëm / nani me kta bilj *si kam e bënj?* // mbsomë o malli im *si kam e bënj* (Shën Mitër-Koronë), gjith kuarjën / nani u *ç'kam bënj?* (Ejaninë), *ç'kam bënj* (Çivita), *ç'kam bënj* me kët solled? (Frasnitë), *kam e pinj* pra këndonj // nani *kam vete* ndërtonj / *kam e dhiovasinj*; (= lexoj) // e bilj'e regjit zu e qaj distinin: “papa çë bëre, nani ktë *kam marr u?*” // *kam e rra* ngaditë // *kam partirinj* (=

⁴⁸ D. Camarda, vep. e cit., f. 266

⁴⁹ M. Lambetz, vep. e cit.

⁵⁰ M. Domi, vep. e cit. f. 69.

nisem) // kam qandonj // *kam kurrinj // kam shkru:j // kam dal // kam ikinj // kam runj // kam ja qellinj* (shpie, çoj) (Shën Mitër-Koronë); *kam gha e kam pi // em një kal /tha/ se kam vete // kam penxohem // kam ja jami* (= japim) (Vakaricë); *kam vinj* të të shoh (Platan), nani kam një vashës çë *kam e martonj* puru a Roma // kam i bjenj një kumblimend nani (Maqi), *kam e kondinuarënj* (= vazhdoj) // *kam e tiganisinj // kam rri* ndë shpit (Frasnitë), *kam ja qellinj // u kam paguanj* për një shërbesë çë nëng bëra // ke të jash një pal tirq se *kam i arnonj* (Çivita).

Veta II njëjës

Në vetën II njëjës pjesëza *të* e lidhore nuk bie⁵¹: in italiano *ç'ke t'i bëç // një cik dhokacion* (= edukim) *ke t'ja japç*, njimos kur bëhen t'kroc nëng t'kalkularnjën fare // bëj t'ngreheç se *ke t'viç* me mua // ke t'fjëç (Shën Mitër-Koronë), *ke t'më bësh* një pjaxhir // ma ti *ke të bësh* një shurbesë // e foli ki kobaç e tha: “ma ti *ke t'vesh* tek rregji (= mbreti) // *ke t'vesh* ka rregji e thuj: “*ke të më jash* (= japësh) një pal tirq se kam i arnonj” // tha / però *ke të marrsh* shërbesën çë të pëlqen më shumë te pllasi // ajo papa u sëmur e tha t'shoqit: “ma /tha/ ti *ke të presh* at purtugalj // *ke t'me siellsh* (Çivita), *ke t'veç* (Platan), *s'ke të thuash* më të shtrëmbura (Ejaninë); për mua *ke të jeshi* një mace ljulje // e zoti për këtë gjalpër tha: “ti *ke t'jesh* i mallkuar ka të gjith kta brrutet animalt e dheut, e me barkun tënd *ke t'shtrashinarsh* dhet ngaditë // me shumë dulur ti *ke t'xjerrç* bilt tënd // ke t'seguirç (= ndjekësh), u prur tek gruaja e / tha: “ti *ke t'rriç* sempre nën ordrin e tit shoqi” (Maqi).

Veta III njëjës

Edhe për vetën III njëjës ne kemi ndeshur vetëm trajta me ruajtje të pjesëzës *të*⁵²: *ka të verë* ndë shpi se ka të verë bënë të ngrënit // nusja ka të verë duart ngriq // është një shërbesë çë ka të vinjë (Shën Mitër-Koronë), kur është il momendo *çë ka të verë* mbë qishë // kur e do nj'guanjun një vashëz / *ka të verë* guanjuni direktamente t'ia thotë // te shpija çë *ka të rrirë* nusja // e ngjaten një cikë buzen për un po di tempo / ma pra *ka të trankilaret // ka t'e dirë* e jëma e i jati // ndëse thotë e jëma e jati ë // pra

⁵¹ Në vetën e dytë dhe të tretë ruhet-të-ja. Folja del në trajtat e lidhore së plotë, sepse shfaq trajta të veçanta që ndryshojnë nga dëftorja .

vashëza *ka të thotë* puru ë (Frasnitë), thuj tit et se *ka të t' bëjë* nj' vest me de:tin me gjith pishqit (Vakaricë), edhe sempre *ka të të jap* gjëmbe e shërtime (Maqi), puru nani *ka të martohet* ime biljë // vete ka rregji se ka një bi:r që *ka t' e martonjë* (Çivita), *ka të marrë* një bir zoti (Ejaninë), alora ki dhëndërrri ka të *dërgo:jë* thënë tek i jati nuses (Platan).

Veta I shumës

Për vetën I shumës vihen re vetëm trajta ku pjesëza *të* e lidhoret ka rënë: *kemi mbjellmi*⁵³ ullinj // *kem' e bëmi* zjarrin // kemi pe:m një qelqe ve:r // kem rrasparmi këpucët dhopu që i vemi shollën (Shën Mitër-Koronë), *kem' e mbjellmi* // *kem ikmi* (Ejaninë), kur të mbjidhemi *kemi e hami* bashkë // *kem pundarmi* (Frasnitë), dhëndërrri me nusen rraxhunojen / thon kur kem takojëm ta këpujëm shkuqi:në (Platan), vierçit kemi këndomi? // kem thomi gjë arbrisht? // kem i thomi si thomi na? (Spexano), amurin *kem e bëmi* na di vet // *kem shkomi* (Maqi).

Në një numër jo të vogël rastesh, kryesisht në katundin Frasnitë, për vetën I shumës, në vend të *kem(i)* u dëgjua *kam* p.sh. *kam e bëmi* // *kam e shoshmi* me sitën // *kam vem* marrmi ... / *kam bëmi* shum shërbise // *kam e penxomi* // na jemi arbresh e *kam distinguiremi* sempri” na thoni sempri atire lti:njve se *kam folmi* arbrisht / ma ata nëng do t'na kapirjën se thon: *kam folmi* lti:sht // *kam folmi* me kta gjiri // Ndonjë rast të rrallë kemi edhe për Çivita: ngreu se *kam vem*.

Veta II shumës

Për vetën e dytë shumës shembujt dalin të pakët, po që të gjithë janë të tillë ku pjesëza *të* ka rënë: nani *kin' leni* makinën ktu (Frasnitë), sa dit *kin' rrini* (Shën Mitër-Koronë), tha: “mos *ken veni* mëngu një ndë grikë (Ejaninë).

Veta III shumës

Për vetën III shumës shembujt që disponojnë janë po ashtu me rënie të pjesëzës *të*: kan *shkonjën* ventikatr orë // ata që duhen mirë kshtu *kan vdesën* (Shën Mitër-Koronë), dhopu ata që *kan ve:n* gha:n te nusja venë e gha:në (Maqi), *kanë*

⁵³ Mbaresat shfaqen njësoj si e tashmja e dëftores

nxjerrjën mbroljat hapt mbi shtrat se kan ja shohjën gjindja // kan marrën nusen // e uzi është se kan xjerrjën mbroljat hapt mbi shtrat // i japën ç'kanë i japën (Frasnitë).

Nga paraqitja e trajtave të foljeve në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, Shkurtajt ka arritur në këto përfundime:

1) Në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, krahas trajtave të së ardhshmes me “*kam*” + lidhoren e tashme me pjesëzën *të* që ndeshim në vetën I, II dhe III njëjës, dalin edhe trajta pa *të*, në të tri vetat e shumësit dhe në vetën e tretë njëjës (krahas atyre me ruajtje të *të-së*). Trajtat pa pjesëzën *të* mendojmë se janë formime të së ardhmes me “*kam*” + foljen në kohën e tashme të mënyrës dëftore

2) Gjymtyra e parë e kësaj trajte analitike, folja *kam* nuk është ngurtësuar në trajtën e vetës së tretë (*ka*) siç ka ndodhur nëpër të folme të tjera të arbëreshëve të Italisë⁵⁴.

Mbi këtë bazë, të një mendjeje me Kamardën⁵⁵, Demirajn⁵⁶ e studiues të tjerë që janë shprehur për vjetërsinë e së ardhshmes me *kam* + lidhore, ne, ndërkaq, nuk mendojmë që ngurtësimi i *kam* në *ka* të jetë një argument i qëndrueshëm për të dëshmuar vjetërsinë e kësaj trajte. Fakti që kjo trajtë në të folmet e katundeve arbëreshe të Kozencës si dhe në ndonjë nga të folmet e skajit jugor të Shqipërisë, si p.sh. në atë të Bregdetit të Poshtëm⁵⁷, rron si një formë morfosintaksore analitike ku “*kam*” ruan veçoritë e veta morfologjike si folje, tregon se origjinare nuk janë trajtat me “*kam*” në formën e vetës së tretë (*ka*), por përkundrazi ato me ruajtjen e vlerës foljore të “*kam*”. Megjithatë, duhet thënë se, edhe në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, në raste të rralla, dalin edhe trajta të së ardhshmes ku “*kam*” nuk zgjedhohet, po mbetet në formën e vetës së tretë *ka*. Në materialet e mbledhura prej nesh na rezultojnë vetëm këta shembuj: *ka t'më siellsh* (Vakaricë) në vend të “*ke t'më siellsh*”, *s'ka t'e duash* (Ejaninë) në vend të “*s'ke t'e duash*”, *s'ka t'm'i thuaç* (Shën

⁵⁴ D. Camarda, *vep. e cit.* f. 266.

⁵⁵ Po ai, po aty.

⁵⁶ Sh. Demiraj, *art. cit.* f. 72.

⁵⁷ Sipas M. Totonit, “Në Piqeras e Nivicë e në ndonjë rast në Borsh është e gjallë edhe një trajtë e vjetër e së ardhmes e formuar nga e tashmja e dëftores së foljes “*patur*” dhe e tashmja e lidhores së foljes që mban kuptimin leksikor. Kjo e ardhme që haset edhe tek arbëreshët e Italisë dhe që këtu përdoret rrallë në krahasim me trajtat e tjera, ka zakonisht kuptimin e një të ardhmeje të domosdoshmërisë: *kam t'i thom një gjë // ka të ver* edhe ai pjesën e tij // *kemi të japëm* këtu more Naqe // *Ka të dërgoj* di procesverbale” (*E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në “Studime Filologjike”, 1, 1964, f. 154).

Mitër-Koronë), në vend të “s’ke t’mi thuash”, *ka të martonen* (Platan) në vend të “kan të martonen”.⁵⁸

3. Edhe në të folmet arbëreshe, ashtu si në mbarë shqipen, përdoret edhe e ardhshmja në të shkuarën. Kuptimi i saj themelor është të tregojë veprime që pritëshin të kryheshin pas një çasti të caktuar të së shkuarës. Karakteristikat e kësaj trajte janë pothuajse ato që u theksuan tek e ardhshmja e tipit “kam” + lidhoren e tashme. Ndërtohet me të pakryerën e foljes “kam” + kohën e pakryer të foljes që shpreh kuptimin themelor: *kish t’i thoja, kish t’i vriç* etj. krahas formave ku ruhet pjesëza të e foljes në lidhore gjenden edhe ato pa të: *kish ligj ime bil çë më thonej se ti më mirrje për çot e s’kish vija* (Çivita), njera çë ti më the se *kish mirrja* shërbesën çë më pëlqenej më shumë / tha / u kish merrja ti: / u të kisha thënur se nuk *kish mbishkaresh* ndër shërbiset time.

Së fundi theksojmë se në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, sikundër edhe në të folmet e tjera të arbëreshëve të Italisë, ndeshen edhe trajtat e së ardhshmes me *do* + lidhore: ti *do të ghaç?* “do të hash?”, po në krahasim me trajtat me *kam*, ato me *do* janë më të rralla. Zakonisht ato vlejné për të shprehur një *futur volitiv* d.m.th. për të shprehur një dëshirë, një veprim që duam ta kryejmë. Duke qenë se edhe në veprën e De Radës ato hasen rrallë, mendojmë se janë zhvillime të mëvonshme në këto të folme.

* * *

Nga kjo paraqitje e skicuar e fytyrës së trajtave foljore të mënyrës dëftore, shihet qartë se të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës tërheqin vëmendjen dhe interesimin e studiuesit me një varg dukurish interesante, ndër të cilat më kryesoret janë:

I. Dukuri a tipare të njëjta me mbarë gjuhën shqipe ose me ndonjë nga të folmet e saj, më fort me ato të skajit jugor.

1. Dukuri a tipare të njëjta me ato të mbarë shqipes janë:

a) Trajatat e kohës së tashme, numri njëjës për foljet: *vras, ngas, fjas* “flas”, *pres* për foljet *dal, marr*; për foljet *pe* “pi”, *rre* “rri”, *ffz* “fle”.

b) Trajatat e vetës së dytë shumës, si të foljeve me zanore ashtu edhe të atyre me bashkëtingëllore (*qepni, ecni, këkoni, bëni* etj.).

⁵⁸Shih: Gj.Shkurtaç, studim i cit.

c) Trajatat e aoristit, veta e parë dhe e dytë njëjës për foljet me apofoni: (unë) *mora*, (ti) *more*.

ç) Trajatat e aoristit për vetën e parë dhe të dytë shumës të foljeve: *shoh*, *them*: (na) *pa:më*, (ju) *pa:të*, (ata) *pa:në*; (na) *tha:më*, (ju) *thatë*, (ata) *tha:në*.

2. Dukuri a tipare të njëjta me ndonjë nga të folmet e skajit jugor të Shqipërisë:

a) Ruajtja e mbaresës -nj për vetën e parë të foljeve me zanore të tipit *bënj*, *punonj*. Me këtë tipar të folmet arbëreshe të Kozencës pihen me të folmet e toskërishtes veriore.

b) Përdorimi i -ën në trajtat e vetës së dytë dhe të tretë të kohës së tashme për foljet *hap*, *qep*, *ik*, *ec* etj. (ti) *qepën*, (ai) *qepën* (ti) *ikën*, (ai) *ikën* etj.

c) Trajta e thjeshtë e së pakryerës del me trajta të afërta ose të njëjta me ato të folmeve të çamërishtes ose të ndonjë të folmeje tjetër të toskërishtes. Veçanërisht e qartë është kjo afëri tek trajtat e vetës së tretë njëjës me mbaresën -nej(*ikënej*, *dëgjonej* etj.).

ç) Trajta e së ardhshmes e tipit do + lidhore, e cila përdoret krahas, por mjaft më rrallë sesa trajta e tipit kam + lidhor

Dukuri e tipare të veçanta të të folmeve arbëreshe që nuk gjenden në të folmet e tjera të gjuhës shqipe:

1. Shtimi i mbaresës -inj në vetën e parë njëjës edhe tek foljet me bashkëtingëllore (p.sh. *ghapinj*, *qepinj*). Rezulton që në këtë lloj zgjedhimi kanë kaluar shumë nga foljet me çdo bashkëtingëllore tjetër përveç s/t, të cilat në të tri vetat e njëjësit dalin pa mbaresë (*vras-vret-vret* etj.).

2. Në rastet kur të folmet arbëreshe e kanë bjerrë foljen përkatëse të brumit amtar, u drejtohen foljeve të italishtes (ose të dialektit kalabrez), por duke u dhënë atyre trajtat zgjedhimore arbëreshe. Si temë e së tashmes në këto raste merret trajta e infinitivit (*kapirinj* nga it. *capire* “kuptoj”).

3. Të dallueshme nga shqipja e sotme dhe nga të folmet e saj paraqiten trajtat e vetës së parë shumës. Në mbaresën -më të shqipes së lashtë, në të folmet arbëreshe është bërë zhvillimi fonetik ë>i-mi: *kapmi*, *marrmi*, *ngasmi*, *bëmi*, *punomi*, *fjzmi*. Pra shohim një zhvillim paralel me mbarë shqipen, ku gjithashtu mbaresa e lashtë -më e së tashmes ka evoluar në -im nëpërmjet kalimit fonetik ë>i(krh. arb. *marrmi* dhe shqip *marrim*). Me sa duket kemi të bëjmë me të njëjtën dukuri të përfutur në dy rrugë të

ndryshme: në rastin e parë (në të folmet arbëreshe) kemi të bëjmë me një kalim të drejtpërdrejtë -më > mi (marmë > marrmi), ndërsa tek -më > im (*marmë > marrim*) procesi i kalimit ë>i ka ardhur pas një metateze të *marmë > marrëm* prej nga, më pas, ka dalë *marrim*. Për këtë na dëshmon prania e trajtave të tilla si *marrëm, japëm, presëm* etj. të cilat, përveç se në arbërishten e shkruar (tek Matrënga *jesëmë*) dhe tek autorë të tjerë të vjetër të shqipes (Bogdani *presëmë, shofëmë*) i gjejmë edhe sot në disa të folme të Jugut, po edhe në ndonjë të folme të Veriut, në gojën e brezit të vjetër, si variante të trajtave me -im.

4. Të dallueshme nga shqipja e sotme paraqiten edhe trajtat e vetës së tretë shumës. Në të folmet arbëreshe përdoret mbaresa -njën: *bënjën, frinjën, kërkonjën, ghapnjën, ndihnjën* etj.; në shqipen e sotme u përgjigjen: *bëjnë, fryjnë, kërkajnë, hapin, ndihin* etj.

5. Dallimin më të dukshëm midis të folmeve arbëreshe dhe gjuhës së sotme shqipe e shohim në trajtat e dyta analitike të së tashmes tipi jam + e +foljen në kohën e tashme:jam e vinj, dhe të së pakryerës tipi inja + e + foljen në të pakryerën:inja e vinja. Këto trajta dalin si ndërtime analitike, të përbëra nga tri gjymtyrë: 1) folja jam përkatësisht në të tashmen ose në të pakryerën 2) lidhëza bashkërenditëse e, e cila, në ndonjë rast edhe mund të mungojë, në pasojë të elizionit 3) folja që shpreh veprimin themelor përkatësisht në kohën e tashme ose të pakryer.

Trajtat analitike në fjalë janë të përhapura në mbarë të folmet e arbëreshëve të Italisë; ato i ka vënë re dhe është përpjekur t'i shpjegojë së pari Kamarda, i cili i quante të barasvlershme me gerundin e italishtes, por një kthjellim në lidhje me ndërtimin dhe kuptimet e këtyre trajtave, nuk mund të arrihet vetëm me përqasjen e thjeshtë të tyre me ato të italishtes (tipisto + gerund: *sto venendo*). Pa mohuar një ndikim të mundshëm nga kjo trajtë e italishtes me të cilën (gjuhë) të folmet arbëreshe bashkëjetojnë prej pesë shekujsh, neve, ndërkaq, na duket e domosdoshme të kthejmë sytë dhe të marrim parasysh edhe dritën që lëshon mbi to krahasimi me simotrat e tyre në të folmet e tjera arbëreshe p.sh. *jam ç lanj* në të folmen e Grecit, nëpërmjet së cilës gjejmë edhe një lidhje me të folmet e skajit jugor të shqipes, si p.sh. me atë të Labovës së Kryqit në lokalitetin e Libohovës (pranë Gjirokastrës), ku gjëlljnë pikërisht trajta të tilla analitike të ndërtuara nga folja jam + lidhëzaqë + folja që shpreh kuptimin themelor p.sh. *jam që laj duart*.

Duke dalë në lëmin më të gjerë të gjuhës dialektore shqipe, mund të bëhet edhe një krahasim i trajtave analitike të të folmeve arbëreshe me ato të disa të folmeve

të gegërishtes veriore tipi: *jam ka shkoj, kjeç ka shkoj*, të cilat, neve na duken të ngjashme nga forma dhe krejt të njëjta nga kuptimi (me ato të të folmeve arbëreshe). Mbi këtë bazë ne shprehim mendimin se këto trajta analitike të tipit *jam e vinj, inja e vinja* duhet ta kenë zanafillën jo jashtë shqipes tek gjerundi i latinishtes, siç mendonte Kamarda, por, përkundrazi, brenda vetë asaj d.m.th. kemi të bëjmë me trajta që arbëreshët do t'i kenë marrë me vete nga Shqipëria, ku, edhe sot, siç u shjelluar, ruhen gjurmët e tyre si në Jug ashtu edhe në Veri.

6. Në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, ashtu si nëpër të folmet e tjera të arbëreshëve të Italisë, përdoret dendur e ardhshmja e tipit kam + lidhore. Nga analiza e kësaj trajte ne arrijmë në këto përfundime.

a) Në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, krahas trajtave të së ardhmes me *kam* + lidhoren e tashme me pjesëzën të që ndeshim në vetën I, II dhe III njëjës, dalin edhe trajta pa *të*, në të tri vetat e shumësit dhe në vetën III njëjës (krahas atyre me ruajtje të të-së). Trajtat pa pjesëzën *të* mund të vështrohen si trajta të lidhores me rënie të kësaj pjesëze, por nuk përjashtohet mundësia që ato të jenë edhe formime të së ardhshmes me kam + foljen në kohën e tashme të mënyrës dëftore. Një supozim i tillë gjen mbështetje, nga një anë në përdorimin aq të dendur të së tashmes së dëftores me vlerën e së ardhshmes, në të folmet arbëreshe dhe në mbarë shqipen; nga ana tjetër, me shfaqjet, sado sporadike të tilla si *kam jam* në vend të *kam të jem / kam jem* që kemi ndeshur në këto të folme.

b) Gjymtyra e parë e trajtës analitike të së ardhshmes *kam* + lidhore (folja *kam*), në të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës, nuk është ngurtësuar në trajtën e vetës së tretë (*ka*), siç ka ndodhur në të folme të tjera të arbëreshëve të Italisë. Mbi këtë bazë, të një mendjeje me Kamardën, Demirajn e studiues të tjerë që janë shprehur për vjetërsinë e së tashmes me *kam* + lidhore, ne, ndërkaq nuk mendojmë që ngurtësimi i *kam* në *ka* të jetë një argument i qëndrueshëm për të dëshmuar vjetërsinë e kësaj trajte. Ne mendojmë se origjinale nuk janë trajtat me *kam* në formën e vetës së tretë, por ato ku *kam* ruan vlerën foljore dhe ndryshon sipas vetave dhe numrit. Këtë e mbështesim edhe në trajtat e tilla që gjëllijnë nëpër të folme të toskërishtes të tilla si ajo e Bregdetit të Poshtëm.

KREU II

Për të analizuar sistemin foljor në veprën e De Radës, u mbështetëm në veprën e tij më të arrirë **“Këngët e Milosaos”**,⁵⁹ vlerësuar si e tillë nga studiues vendas dhe të huaj. Nëpërmjet kësaj poeme, shpesh të quajtur edhe roman në vargje, De Rada u bë i pari shkrimtar arbëresh, që e përdori gjuhën e thjeshtë të popullit për të shkruar vepra të tilla letrare, të cilat do të vlerësoheshin nga njerëz të shquar të artit dhe kulturës botërore, si: Viktor Hygo, Lamartini, Vincens Dorse, Frederik Mistrali, Bukholci, Haserti etj. Vlerësimin më të lartë për poemën “Këngët e Milosaos” e ka dhënë V. Hygoi, kur shprehet se: *“Kush dëshiron të shohë plotësimin e poezisë romantike moderne, të lexojë “Këngët e Milosaos”, të zotëri Jeronim de Radës⁶⁰”*.

Jemi ndalur në këtë poemë mjaft të vlerësuar, e cila i dha poetit famë botërore, nisur nga disa arsye që lidhen me:

- a) Veçanti të krijimit dhe realizimit të saj
- b) Shkrirjen në poemë të gjuhës popullore të Krahinës së Kozencës⁶¹
- c) Përpunimin që De Rada i bëri gjuhës së popullit gjatë krijimit të vargjeve
- d) Aftësinë e tij për të krijuar fjalë shqipe, apo për t’i paraqitur ato në formën më të mirë të mundshme
- e) Dashurinë e madhe që ai përcjell në poemë për atdheun e të parëve dhe gjuhën shqipe në veçanti.

Synimi i veprës në tërësi dhe këtij kreu në veçanti është të njohim sistemin foljor të veprës, të analizojmë zhvillimet e brendshme të sistemit foljor, të shohim vendin që ky sistem zë në kuadrin e ligjërimeve arbëreshe, të dallojmë veçoritë, përdorimet e veçanta, si dhe prirjet e sotme gjuhësore. Poema na tërheq vëmendjen nga pikëpamja gjuhësore, duke dalluar brenda poezisë tipare morfo-sintaksore të sistemit foljor brenda të folmeve arbëreshe.

Kjo pasuri kombëtare, e vjelë dhe e paraqitur me kujdes është fryt i përpjekjeve të një studiuesi, si Jeronim de Rada të shkruara me përkushtimin dhe përgjegjësinë absolute

⁵⁹ Në botimin në origjinal të saj: “Canti Di Milosao, Figlio del Despota di Scutari”, Napoli 1836

⁶⁰ Shih D. Kokozi, “Gazeta shqiptare”, f. 14, 13 Prill 2014.

⁶¹ Në vitin 1883, pasi kryen mësimet e para dhe të mesme në Kolegjin e San Benedetto Ulanos, i ati nuk e çon në universitet, por e mban në fshat që të forcohej nga shëndeti. Poeti gjatë kësaj kohe mbledh këngë folklorike nga gjyshja Torrëtosheja dhe nga një plakë tjetër, krushka Orizhie. Në vitin 1883 kthehet nga universiteti duke sjellë me vete botim e parë të “Milosaos”.

për të paraqitur format dhe shprehjet më të larmishme gjuhësore të arbërishtes së Italisë, por edhe në të njëjtën kohë dëshirës e dashurisë për të krijuar fjalë e shprehje të reja, duke pasuruar më tej gjuhën tonë.

“Këngët e Milosaos” u botuan për herë të parë në Napoli në vitin 1836. Poema, sikurse pohojnë njëzëri të gjithë studiuesit, është vepra e parë e De Radës dhe më e njohura.

Siç shprehet vetë autori, ajo i është kushtuar: “*Shkëlqesisë së tij, Gjeneral, Zotni Dhimitër Lekës, këto këngë që të jenë dëshmi e afrimit ndaj zakoneve të lashta në gjindjen e humbur të Epirit*”, dhe frymëzuar nga një melodi mallëngjyese popullore:

“*Mos më garrosh, oi trim , assai uudh*

Se saa të desha miir u nëng e dii”⁶²

Me këtë poemë tepër të veçantë, poeti afirmohet si individualitet i fuqishëm dhe origjinal. Poema është e rëndësishme jo vetëm për vlerat e saj letrare, por edhe gjuhësore, pasi siç dihet ajo është një shprehje e shpirtit poetik të De Radës, ku trajta poetike e veprës dhe ndonjë pjesë e veçantë e saj është marrë nga përzierje këngësh popullore shqiptaro-arbëreshe, të cilat ai kishte filluar t’i mblidhte qysh i ri.⁶³

Jeronim De Rada është poeti , i cili kuptoi dhe vlerësoi se letërsia popullore e përdorur në vepra të shkruara luan rol të rëndësishëm në pasurimin e tyre. Ai, siç dihet, mblodhi krijimtari folklorike në viset e ndryshme ku jetonin arbëreshët, në radhë të parë, në viset e Kalabrisë, sidomos të fshatit të tij të lindjes, Makjit (Machia Albanese). Pas mbledhjes së krijimtarisë gojore arbëreshe, poeti botoi vepra origjinale me vlera të mëdha artistike. Edhe për shkrimin e Milosaos, sikurse edhe për veprat e tjera, De Rada u mbështet shumë në truallin e poezisë popullore, aq sa gjatë gjithë veprës ndihet fort fryma e krijimtarisë gojore, natyrisht e përpunuar mjeshtërisht në shpirtin e poetit, me përjetimin që i tha zemra. Në këtë vepër, si edhe në të tjerat, De Rada, letërsinë popullore e shfrytëzoi në mënyrë asimiluese dhe krijuese. De Rada huazon vargje të letërsisë popullore dhe njëkohësisht i përpuno ato. Ndikimi i drejtpërdrejtë i poezisë popullore arbëreshe të Kalabrisë ndihet në shumë pjesë të veprës “Këngët e Milosaos”. Në vepër De Rada, përfshiu edhe vargje të paprekura ose të prekura në mënyrë diskrete dhe mjeshtërorë. Vargjet, *Duro zemër duro/ Sa duroi mali me borë*, sjellin përkujtim të freskët të poezisë popullore.

⁶² Shih. De Rada. Poesie Albanesi del Secolo XV. Canti di Milosao, Figlio del despota di Scutari, f.,2,3,”Gutenberg”, Napoli 1836.

⁶³ Kastrati. Jup (1956), “Kangë të Milosaut”, Ndërmarrje Shtetërore e Botimeve”, Tiranë, f 13.

Lidhur me marrëdhëniet e artit të De Radës dhe poezisë popullore, Dhimitër Shuteriqi ka bërë një analizë të hollësishme⁶⁴, ku pohon se De Rada kishte shfrytëzuar një dorëshkrim me këngë popullore arbëreshe të mbledhura nga prifti i fshatit, Thoma Belushi. Ai me plot bindje thekson se dorëshkrimin në fjalë, De Rada e ka shfrytëzuar “*në mos për vëllimin folklorik qëbotoi, sigurisht për të shkruar poemën e Milosaos*”. Pra, dy këngët e atij dorëshkrimi me ndryshime minimale, u bënë dy këngët më të bukura të poemës “Këngët e Milosaos”, kënga e IV dhe kënga XII. Gjithçka dëshmon se sa afër qe De Rada me popullin, me shpirtin e tij: poezinë.

Huazimet e elementeve të këngës popullore, De Rada i mori me vetëdije të plotë poetike, duke mos u bërë asnjëherë imitues i thjeshtë. Dhe, pikërisht këto elemente bënë që vepra e tij të ngrihet në kulmet më të larta artistike, të bëhet më popullore, më e përjetshme.

Parathënies së poemës autori i bashkëngjiti alfabetin e parë të hartuar prej tij.⁶⁵

Në hyrjen e kësaj poeme të mrekullueshme lirike, kushtuar mikut të tij Raffaele Zagarese, De Rada do të shprehë gjithashtu edhe shqetësimin e thellë për ruajtjen e identitetit arbëresh dhe të këngëve popullore arbëreshe, “*E shijes së këtyre këngëve*”, sikurse thotë ai. “*Mes këtyre pështjellimesh gjeti fillesën frymëzimi tij për të shkruar Milosaon*”.⁶⁶

Ndërkohë që vështirësia e parë me të cilën përplasjet ishte alfabeti, i cili do të bënte të mundur shkrimin dhe ruajtjen e këngëve popullore.

Sikurse shumica e shkrimtarëve dhe studiuesve arbëreshë, edhe De Rada zgjedh alfabetin latin të kombinuar me shkronja greke. Për këtë vetë poeti i madh në parathënien e “Këngëve të Milosaos” do të shprehej: “*Po mendoj si mund të fiksoj një alfabet për gjuhën e këtyre këngëve të ruajtura në mes të Italisë, të cilat desha t’i bëj të njohura në këtë poezi. Mendoj se shqipja ndoshta shumë e lashtë mes gjuhëve të Evropës ka lindur gati njëherësh me ndjesitë. Ka më shumë elementë se italishtja, prandaj u ktheva drejt idiomave të gjuhës greke, ashtu sikurse bashkëkombësi im gjenial Skiroi.*”

⁶⁴Shih revistën “Nëntori”, nr. 3, të vitit 1963

⁶⁵ Për të qenë sa më pranë gjuhës së përdorur autori, kemi sjellë të plotë alfabetin që ai përdor për ndërtimin e poemës.

⁶⁶ Shih. De Rada. Poesie Albanesi del Secolo XV. Canti di Milosao, Figlio del despota di Scutari, f.2-3.Napoli 1836

Për shkrimin e “Këngëve të Milosaos”, De Rada harton një alfabet, i cili në përbërjen e tij ka kryesisht shkronja latine, disa shkronja greke dhe një sajese shenjash të krijuara prej atij vetë.

Në parathënien e Milosaos ai do të shprehej:

“Ideja për të zbuluar me tingujt e favellës së Epirit, harmoninë e vërtetë të idiomës helenike u la më pas mënjanë për dyshimet mbi ekzistencën e një të tille harmoni, dyshime të mbështetura nga shpirti im i padurueshëm dhe nga një situatë jo e qetë. Prandaj unë kompozova një të tretën e shenjave (germave) italiane dhe një suplement me shenja greke, të cilën më pas e kam përdorur në mënyrë konstante, si ai që është i bollshëm dhe nuk ofron vështirësi të mëdha. Unë e vendos në fillim të këngëve, në mënyrë që leximi i tyre të jetë më i lehtësuar për italo-grekët”.

Alfabeti i hartuar prej tij është alfabet latin i gërshetuar me shkronja greke dhe kombinime shkronjash latine.

Ka gjithsej 35 shkronja, prej të cilave: 6 zanore përkatësisht : a/ e/ i/ o/u/, të cilat realizohen me alfabetit latin, përveç zanores /ë/, e cila realizohet me shkronjën greke u(ipsilon) dhe në disa raste me zanoren /y/.

Autori përdor 29 bashkëtingëllore:

17 bashkëtingëllore të thjeshta + 9 shkronja të përbëra që i krijon me huazime nga alfabetit grek + 3 kombinacione me shkronja latine, të cilat vijnë si më poshtë:

b,/ c,/d,/ f/ g,/h,/j,/l,/m,/n,/p/r,/ s,/ t/, v/ x/,z.

Prej alfabetit grek përdor shkronjat si më poshtë:

Δ - δ dhelta/ dhe Θ (theta) për të paraqitur bashkëtingëlloret ndërdhembore fërkonjës⁶⁷ e **-th**, **-dh**. psh: *Calthyruar (kalthëruar), Deut (dheut), e barda (bardha) etj.*

ζ (zeta) për të paraqitur bashkëtingëlloren fërkonjëse alveolare **-z** psh: *Calvçoret (kallëzoret), pyrçien (përzien), çacoon(zakon) etj*

χ (chita) për të paraqitur bashkëtingëlloren fërkonjëse të aspiruar prepalatale **-h**, që është karakteristike për të folmet e fshatrave të Kalabrisë, psh: *χee(hije), ty χedhura (të hedhura) si dhe bashkëtingëlloren qiellzore -q psh: χiumvçti , χylonej etj*

v- (ipsilon) të cilin autori e ka përdorur krahas shkronjës latine **y** për të paraqitur zanoren **ë** tëpatheksuar psh: *atv (atë), ndv (ndë), gkurvet (gurve) etj*

λ (lambda) për të paraqitur likuiden prepalatale **-l** ose **-lj** psh: *lum, (lumi), lus (lus), e ligx(lig) etj*

⁶⁷ Jubani.A, “Karakterizimi funksional i sistemit bashkëtingëllor të shqipes standarde, Buletini shkencor, f 64, Nr 1, nëntor 2010, Universiteti Planetar i Tiranës

σ- (sigma) për të paraqitur bashkëtingëlloren e shurdhët qiellzore **-sh** , psh: *σπυρβεστα*, (*shpërveshta*), *σκουνδур* (*shkundur*) , ρστ (rusht) etj

Kombinacionin :γγ përkatësisht për shprehjen e bashkëtingëllores-mbylltore qiellzore të zëshme **-gj**psh; *γγιetur* (*gjetur*), *γγeel* (*gjell*) etj

Kombinimin γχ për realizim e **ngj** e **gj** psh;

γχ ymbat (*gjembat*), *πυργχaccura* (*përgjakura*) *γχιθ* (*gjith*), si edhe dyshkronjësja e trishkronjësja të sajuar mbi bazën e alfabetit latin, renditur si më poshtë:

Dyshkronjëshi **gn** për realizimin e **nj**, psh: *pargagnottit Miloçin*, **gh** për **g**, psh: e *ligh* (e lig)', **ch** për **k**, psh: *çochvt* (shokët), *mespurtech* etj.

Për të qenë sa më shterues dhe për ta sjellë e analizuar sa më të plotë sistemin foljor të përdorur prej De Radës, jemi mbështetur, gjithashtu te “**Grammatica della lingua albanese**”, botuar në Firence në vitet 1870 dhe 1871, të cilën De Rada e shkroi dhe e botoi në emër të birit, Zefit, si dhe në materiale të shkëputura nga revista “**Flamuri i Arbrit**”.

Dihet se në fushën gjuhësore dy gjëra vërehen gjithmonë si të vështira: *të shkruash fjalorë dhe gramatika*. Por, edhe pse ishte punë e vështirë dhe kërkonte përgatitje të gjerë dhe njohje të shqipes e të modeleve të hartimit të veprave të mirëfillta kodifikuese, Jeronim De Rada iu përvesh punës me dëshirë e zell të papërshkueshëm për botimin e saj, për të cilën Prof. Jup Kastrati ka shkruar me të drejtë se: “*Gramatika e De Radës është një traktat i shkurtër gramatologjie, me vlera në fushën e dialektologjisë, por edhe në fushën e morfologjisë dhe sintaksës*”⁶⁸.

Kur kundrojmë paraqitjen e kategorive gramatikore dhe pjesëve të ndryshme të ligjëratës në gramatikën e De Radës shohim se ai kishte edhe një konceptim të vetin për sistemin gjuhësor të shqipes në përgjithësi dhe të arbërishtes së Italisë në veçanti.

Gjatë rrugës për të parë trajtimin që ai i bën foljes, veçorive dhe problematikave që spikasin, kemi pasur si model krahasimi *Gramatikën e Akademisë së Shkencave*, botim i vitit 2002, e cila përbën padyshim veprën më të madhe e më të plotë, ku paraqitet struktura gramatikore e shqipes standarde dhe si e tillë ajo mund të shërbejë edhe si bazë e mirë krahasuese dhe si udhërrëfyese e përfshirjes së dukurive të shqipes së shkruar që nuk përfshihen në standard, por janë pasuri e shqipes dhe duhen njohur.

⁶⁸ J. Kastrati, *Gramatika shqipe e De Radës e vitit 187-1871*, në Buletini shkencor, Instituti i Lartë Pedagogjik, Shkodër, 1976, nr 1(19), f 93.

Në të dyja pjesët e gramatikës së De Radës, vëmë re se fushës së morfologjisë autori i ka kushtuar vendin më të gjerë (80 faqe).

Ai trajton disa pjesë të ligjëratës, si emri, përemri, mbiemri, ndajfolja, por kreu kushtuar foljes zë vendin qendror (rreth 30 faqe), fakt që na tregon edhe njëherë se folja është klasa më e rëndësishme dhe më e madhe prodhuese mes pjesëve të tjera të ligjëratës, duke mbështetur gjithashtu interesin e punimit tonë për të vënë në dukje format më të përdorura foljore të kësaj etape gjuhësore të arbërishtes, format më përfaqësuese dhe më pragmatike, si edhe dallimin e forma të tjera dysore, të cilat edhe sot jetojnë në gjuhën shqipe, por që janë jashtë normës morfologjike të pranuar nga GASh.

Gjatë analizës i kemi qëndruar besnik trajtimit të autorit duke paraqitur në të njëjtën formë edhe paradigmat që ai jep.

Nga hulumtimet e bëra rreth foljes në veprat e tij do të shohim se herë pas here, gjuha që De Rada përdor ka elemente të përbashkëta me shqipen standarde, numri i huazimeve foljore është i pakët dhe se arbërishtja e tij ruan veçori karakteristike të ligjërimeve arbëreshe që nuk i kundërvihen sistemit të gjuhës normative. De Rada gjithashtu përdor forma gramatikore, të cilat janë pika takimesh mes ligjërimeve arbëreshe dhe gjuhës standarde.

Autori përdor edhe forma gramatikore, të cilat janë në gjuhën standarde, por jo në ligjërimet arbëreshe. Këto do t'i shohim të detajuara sipas kohëve dhe mënyrave në vazhdimësi të kapitullit.

DISA VEÇORITË TË FORMAVE FOLJORE SIPAS RRAFSHEVE TË NDRYSHME TË STUDIMEVE GJUHËSORE

MËNYRA DËFTORE

Në sistemin foljor të gjuhës së De Radës, tek vepra “**Këngët e Milosaos**”, mënyra dëftore ka korpusin më të madh të foljeve që përdoren në poemë (rreth 730 raste)⁶⁹. Kjo mënyrë paraqitet me një shumëllojshmëri formash, nëpërmjet së cilave shprehen dallime kuptimore me karakter kohor dhe aspektor. Një fakt i tillë është i pritshëm, pasi edhe paradigma aktuale e kësaj mënyre në shqipen e sotme ka numrin më të madh të formave, në krahasim me mënyrat e tjera.

Në poemë, vihet re mungesa e kohëve të mbipërbëra, përkundrazi në Gramatikën e hartuar prej tij hasim të trajtuara disa prej këtyre kohëve.

Sistemi foljor i shqipes është mjaft i ndërlikuar, prandaj është i vështirë grupimi i foljeve në zgjedhime. Dihet se vetëm për shqipen ekzistojnë një sërë modelesh në lidhje me këtë problem. Në këtë kontekst jemi munduar të bëjmë një klasifikim të foljeve të korpusit të Milosaos, shoqëruar me plotësime nga paradigmat që De Rada jep në Gramatikën e tij, në varësi të klasifikimit të sotëm të shqipes.

Në bazë të ndarjes që jepet në Gramatikën I të Akademisë pasqyrohen fillimisht tri grupime të mëdha, përkatësisht foljet e zgjedhimit të parë, të dytë e të tretë. Përveç tyre jepen edhe foljet e çrregullta dhe plotësisht e pjesërisht të çrregullta.

E TASHMJA E DËFTORES

Në poemën “**Këngët e Milosaos**”, e tashmja e dëftores është kohë që zë një numër të konsiderueshëm rastesh, në të gjitha vetat e formës veprorë me mbaresa të shqipes së sotme, si dhe me variante dialektore, të cilat janë karakteristike kryesisht për toskërishten, por në disa raste shfaqen edhe variante të gegërishtes. Kjo kohë shfaqet si në situatën e dialogëve, qoftë edhe të brendshëm, ashtu edhe në përshkrime.

⁶⁹ Korpusin e plotë të foljeve të mënyrës dëftore e gjeni të bashkëlidhur në fund të këtij kreu.

Në kohën e tashme, në poemë, dallojmë këto veçori strukturore morfologjike:

- Ekzistencën e disa mbaresave, të cilat në dialektet e të folmet e tjera të shqipes, ose janë zhdukur, ose nuk kanë ekzistuar si të tilla :
- Foljet me zanore të tipit *běj, frij*, dalin, në vetën e parë njëjës, shumës dhe të tretë shumës të së tashmes me mbaresën *-nj*: *bějnj, frinj, shkonj*.
- Shtimi i mbaresës *-inj/ějnj* në vetën e parë njëjës edhe tek foljet me bashkëtingëllore (p.sh. *ghapinj, ljip-ějnj*). Rezulton që në këtë lloj zgjedhimi e kanë disa folje me çdo bashkëtingëllore, përveç atyre me s/t, të cilat në të tri vetat e njëjësit dalin pa mbaresë (*vras-vret-vret* etj.).
- Foljet *do rri, marrnë* të tri vetat e njëjësit dalin pa mbaresa, ndërsa në shumës kanë mbaresat *-mi, -ni, -në*:
- Mbaresa karakteristike, ndryshe nga shqipja e sotme del tek foljet me temë në bashkëtingëllore, veta e tretë shumës *-ën*.(*lampariss-ën, potiss-ën, pres-ën, shoh-ën, gareps-ën*
- Veta e parë shumës e foljeve të zgjedhimit të dytë shfaqet mjaft e larmishme: *ec-im, shes-ěmi, nga-ssěmi dredh-ěm*. Folja *ec* del me formën e sotme, ndërsa në foljet e tjera shfaqen format e arbërishtes së kësaj periudhe.
- Kemi raste kur folja e ka rrëzuar foljen përkatëse të brumit amtar dhe u drejtohen foljeve të italishtes (ose të dialektit kalabrez), por duke i dhënë asaj trajtat zgjedhimore arbëreshe. Si temë e së tashmes në këto raste merret trajta e infinitivit psh;(*cumandonjnë* nga it. “komandojnë”).
- Të dallueshme nga shqipja e sotme dhe nga të folmet e saj paraqiten trajtat e vetës së parë shumës. Në mbaresën *-më* të shqipes së lashtë është bërë zhvillimi fonetik *ě>i-mi*: *kapmi, marrmi, bëmi, shkonjěmi, frinjěmi thomi, romi*. Pra shohim një zhvillim paralel me mbarë shqipen, ku gjithashtu mbaresa e lashtë *-më* e së tashmes ka evoluar në *-im* nëpërmjet kalimit fonetik *ě>i*(krh. arb. *marrmi* dhe shqip *marrim*).
- Të dallueshme nga shqipja e sotme paraqiten edhe trajtat e vetës së tretë shumës. Në foljet e kohës së tashme përdoret mbaresa *-njën*: *bějnjën, frinjën, shkonjën, ghapnjën, ljagchějnjën* etj.; në shqipen e sotme u përgjigjen: *bějnjë, frynjë, shkojnë, hapin, lugin* etj.

- Në format e së tashmes joveprore , zgjedhimi i parë, vihet re shpesh mungesa e *h-së*, alomorfit mbaresor të sotëm, i cili shfaqet në dy forma *em, esh* ose *hem, hesh* etj
- Krejt të veçanta shfaqen format e vetës së dytë njëjës, joveprore të zgjedhimit të dytë të cilat dalin pa një pjesë të mbaresës së sotme, përkatësisht pa *t-në*: *digj-e, shit-e*.
- Trajtat e kohës së tashme të mënyrës dëftore me prapashtesës – *th/ith* si mbaresë foljore.⁷⁰ .

Për këtë mbaresë Prof. Topalli është shprehur se përdorimi i këtij elementi pranë foljes është një dukuri e zhvilluar mbas shkëputjes së të folmeve arbëreshe nga trangu mëmë, duke qenë se nuk gjendet në të folme të tjera⁷¹. Por gjurmë të prapashtesave me *-ith* pranë foljesgjegjmë ende sot në çamërisht, veçanërisht tek folja qan- *klanith*. Ky fakt na bën të pohojmë se elementi *-ith* pranë foljes nuk është një risi e krijuar në arbërisht, por një element i mbartur prej gjuhës mëmë. De Rada e përdor disa herë në poemë, ndërkohë që në Gramatikë nuk dëshmohet asnjë shembull me këtë trajtë. Duke pasur parasysh origjinën e Këngëve të Milosaos me bazë këngët e vjetra popullore, ku ky element është përdorur bashkëngjitur edhe në disa prej pjesëve të ligjëratës, sikurse do ta shohim edhe në shembujt e shkëputur, përforcuar nga fakti se ky element del në po të njëjtat pjesë të ligjëratës edhe në çamërisht, e cila është një prej të folmeve më koservatore të shqipes, mund të arrijmë në përfundimin se elementi – *th/ith* është një element arkaik i toskërishtes.

Sikurse u shprehëm, kjo trajtë, tek De Rada del vetëm tek “Këngët e Milosaos”, në ndryshim edhe nga sa trajtohen në GASH⁷², shfaqet bashkëngjitur pranë disa prej pjesëve të ligjëratës, jo vetëm me nuanca zvogëluese e përkëdhelëse, por edhe me nuanca të tjera semantike si p.sh tek :

⁷⁰ Shih: Topalli. K, “*Tipare dialektore në sistemin foljor të arbëreshëve të Italisë*” në “Gjuha dhe letërsia e arbëreshëve”. Aktet e Simpoziumit Ndërkombëtar për arbëreshët, Tetovë, 2011, f., 256-262.

⁷¹ Edhe në punimin e Prof. Gj. Shkurtaj “Trajtat foljore të mënyrës habitore të të folmeve arbëreshe të krahinës së Kozencës”, nuk dëshmohet kjo prapashtesë.

⁷² Shih Gramatika I, Tiranë 2002, f. 144.

1. Emrat, ku shfaqen njëkohësisht nuanca semantike dhe modale të zvogëlimit dhe përkëdhelisë psh : Uli *kriethit*, me ullinj *e qumështin*, m'i ngriti *xerkëthin*, më këputi *gjumëthin*, bëmë *këshetëthin*;
2. Mbiemrat, ku vihen re nuanca stilistike përkëdhelëse: Me këshen *të pjeksurith/shpjeksurith*, vatte trimi *i nisurith* (i rrëmbyer), gjunë *ezbuluarith*
3. Ndajfoljet, ku vihet re se ky element shfaqet edhe si një mjet sintetik që jep nuanca të shkallëzimit të ndajfoljes; Me një dorë *ngrëjturith* (*krahaso ngrëjturë*), *me siellt përparanith* (*sa më afër, shumë afër*), *rri vetëmith* (*krahaso- rri fare vetëm*), *vejim afërith* (*krahaso- shumë afër*)

Sikurse vihet re nga përdorimet kjo prapashtesë, sikurse edhe prapashtesa tjetër zvogëluese –z, e shfaq qartë karakterin e saj përkëdhelës apo zvogëlues tek emrat e mbiemrat, por edhe si mjet sintetik i shkallës tek ndajfoljet.

Tek folja këtë element në poemë e gjejmë në këto përdorime :

- Në kohën e tashme kryesisht në vetën e tretë njëjës, në formën joveprore, psh: mbi shtrat na *vemënith* (këng V), çehren më i *shuan-ith*, gjumi mua më *ljodhën-ith* (kënga VIII), dielli që dihet vashës i *qeshënith*, noerit më *bienith* (kënga XI), vera më e *magjepsënith* (kënga XXVI), shkone jëma e *klanith* (këng XXIII) bushtërën njerë të *kanith* (këng XXVII).
- Në kohën e pakryer të mënyrës dëftore psh: *gjdhëtith* (zgjidhte) nga një tuf re, *zilepsënith*, *kurmin t'im fiantaksënith* (shëmbëllen) këng XI).
- Në të kryerën e thjeshtë të veprores: Vashës lot i *ranith*, kurmi i vet i *qeshënith* (këng XXII)
- Në pjesore: *vdekur-ith*, *garruam-ith*, *përljipur-ith*, *ngrëitur-ith*

Në përdorimin pranë foljes, vihen re ndryshime në kuptimin që ky element përcjell. Kështu foljet e pajisuara me –ith, përgjithësisht shfaqen për të shprehur nuancat e habitores dhe në ndonjë rast edhe të dëshirores.⁷³ Ky variant⁷⁴ në pjesën më të madhe të rasteve mendojmë se është një mjet i veçantë gramatikor me karakter stilistik që përdoret për të shprehur nuanca të mënyrës habitore Krahaso: Dielli që dihet vashës i *qeshënith* (po i qeshka). Shkon e jëma e *klanith* (e qaka). E rriti ajo zonjë , atë *kish gharruarith*(paska harruar).

- Koha e tashme e foljes në poemë dallohet edhe për ekzistencën e formës analitike, e cila në dialektet e të folmet e tjera të shqipes, ose është zhdukur, ose nuk ka ekzistuar si e tillë:
 - ❖ E tashmja arbërisht, ose trajta analitike e së tashmes (e tipit jam+ lidhëza e + folje në kohën e tashme) shfaqet vetëm në një rast: Ç'është ikën si ajëri?⁷⁵ Këng VI

Në fakt në shembullin e përdorur nga De Rada lidhëza bashkërenditëse e, mungon si pasojë e kontraktimit (në prani të zanoreve të tjera) dhe folja *ikën* shpreh veprimin themelor në kohën e tashme, një veprim të zgjatur me kuptimin *po vij, jam duke ardhur*: të cilat janë të ngjashme nga forma dhe krejt të njëjta nga kuptimi me ato të së folmeve arbëreshe. Kjo strukturë paraqet nuanca të aspektit të vazhdimësisë. E veçanta e saj është elipsa. Nuanca të tilla në shqipen e sotme i shprehin strukturat e së tashmes dëftore + pjesëzën po, ose vetë përcjellorja.

E tërë struktura na shfaq raste të shprehjes së aspektit ende të pastudiuara mirë në gjuhën shqipe. Duhet të theksojmë se nga ana aspektore struktura e mësipërme nuk është analizuar përfundimisht, por nga përdorimi i mësipërm është i qartë se:

- Është semantika e foljeve, që mund të lejojë ndërtime të tilla, sikurse dhe rrethanat e ligjërimit
- Shprehin një veprim të mbyllur, të përqëndruar në çastin e ligjërimit. Grafikisht do ta paraqisnim në këtë mënyrë ⁷⁶.

⁷³ Mund të ketë origjinën nga përforcues të veprimit me origjinë nga një pjesëz përforcuese-thirrëse e prapangjitur që shërben për të shprehur një ngjyrim emocional shprehës të folësit si habi, dëshpërim, për të rritur fuqinë shprehëse të veprimit , kushtëzuar nga konteksti.

⁷⁴ Gjurmë të prapashtesave zvogëluese, përkëdhelëse me –ith-, gjejmë edhe në çamërisht në përdorime pranë emrave, mbiemrave të gjinisë mashkullore: djalthim (*djalthi* im). *I voglthi* i nanës(në thirrore). Përdorim të saj gjejmë edhe tek folja qan- *klanith*. Në përdorime të tjera foljore në vend të prapashtesës zvogëluese-*ith/th-* përdoret prapashtesa –z-/zë; e cila është e kudogjendur në toskërishten jugore.psh: Ish etje djegur-zë.Etjen më ishuan-iz. (*i shuaka*).

⁷⁵ Gjurmë të tilla kemi në çamërisht :Ç'ishtë e bënet tani?!(Ç'po bëhet tani)?!

⁷⁶ Dhrimo.A(1996),Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe, SHBLU,Tiranë, f.38, f. 70.

- Kjo formë e së tashmes e quajtur nga studiuesit si *kohë e caktuar* apo *e tashme e caktuar perfektive*, nga mënyra se si e paraqet veprimin mund të emërtohet edhe si *e tashmja e komunikimit, ku e tashmja përdoret në momentin konkret të aktit ligjërimit*, duke qenë se nëpërmjet saj folësi hyn në komunikim të drejtpërdrejt me bashkëfolësin, në kundërvënie me të tashmen e pacaktuar. Krahaso: *Shkoj çdo ditë në shkollë/ jam çë vete ka ime motërë. Ç'është ikën si ajëri?* etj. Kjo e tashme i përshtatet situatës kur veprimi realizohet dhe del kryesisht në dialogë.
- Kjo trajtë, përveçse në disa të folme të toskërishtes jugore e gegërishte, të cilat janë përmendur në punimin e Prof. Shkurtaj⁷⁷, shfaqet edhe në çamërisht në trajtën;

jam ç vete ka ime motërë, jam të shkoj, jam të thom di fjalë. Të dhëna të tilla e përforcojnë mendimin e Prof. Shkurtajt se trajtat analitike të të folmeve arbëreshe (tipi *jam + e + foljen në kohën e tashme*) duhet ta ketë zanafillën jo jashtë shqipes tek gerundi i italishtes, siç mendonte Kamarda, po, përkundrazi, brenda vetë asaj d.m.th. kemi të bëjmë me një trajtë⁷⁸ që arbëreshët e kanë marrë me vete nga Shqipëria, ku gjurmët ruhen si në Jug ashtu edhe në Veri⁷⁹.

FORMAT VEPRORE TË KOHËS SË TASHME

Tek “Këngët e Milosaos” e tashmja e dëftores është një nga kohët më të përdorshme. Kjo për arsyen se në shqipe ajo mund të përdoret, jo vetëm për të shprehur veprim që lidhet me çastin e ligjërimit, por edhe mund të përfshihet në kuadrin e së tashmes historike, zakonisht në kontekste të tilla si, stili letrar. Ka dhe folje që nuk gjenden fare në shqipen e sotme, *ziljepset* (XV), *kalbiet* (XV), *shture* (Vjershë e së bijës së Kalogres), *proseksa* (kënga XX) etj.

⁷⁷ Shih. Kap. I, f. 38.

⁷⁸ Mendojmë se kjo është një trajtat më konservatore të shprehjes së të tashmes së vazhduar.

⁷⁹ Shih: Gj. Shkurtaj, stud.cit.

Në vepër gjenden mjaft folje të kohës së tashme, por jo vetëm, të cilat shfaqin ndryshime fonetike specifike dialektore, të tilla si:

Në vend të bashkëtingëlloreve të zëshme të formave të sotme, dalin me të pazëshme si folje zbardh, zbuloj, zgjedh, zgjeroj, të cilat na dalin me formën *sbardh-ën/sbuluar* (*sbarthën para sivët*), *sgjedh*.⁸⁰

- ❖ Prishjen e kundërvënies ndërmjet fonemave zanore /y/ -/i/, y-ja duke u delabializuar ka përfunduar në /i/: *friinj* “fryj”, *ghiign*, “hyj”.
- ❖ Prania e fonemës bashkëtingëllore /hj/, në një numër të kufizuar foljesh, si */hjeth/* “hedh”.
- ❖ Sonorizimi i frikatives velare të shurdhët /h/ në /gh/ ose /g/; */gholq/* “heq”, */ghiin/* “hyn”, */shoghën/* “shohin”, */garronen/* “harrojnë”, */gapën/* “hap” etj.
- ❖ Bashkëtingëllorja /lj/, që në shqipen e sotme del kudo /l/, p.sh., *ljaj* “laj” */ljehëmistin/* “lehin”.
- ❖ Në jo pak raste tingulli *h* është në shoqërinë e një *g*-je të zëshme, e cila në shqipen e sotme nuk është:
Leghen djalë, kënga X, f. 42. *Gnighen* plot hare, kënga XIII, f. 48
L-ja në jo pak raste na del me *j*, një formë konservatore që ka mbeturina dhe në shqipen e sotme: Dheut t’errëtit tek ti *ffjë* (XV).
- ❖ Grupi- *fsh* në të gjitha pozicionet del në /sh/: *shinj* “fshij”, *qosha* “qofsha”.
- ❖ Përdorimi i zanoreve të gjata, të cilat nga ana grafematike shfaqen me dyfishim zanorësh: Më *laa*⁸¹ të veshurat, *friin* asaj udhe, *ltheet/* “thot”, *ngriin/*, *rii/* etj.

⁸⁰ Shih ‘Fiamuri i Arbërit’, Viti i parë i botimit, nr 10, f 4.

⁸¹ De Rada i quan zanore të theksuara, shih “Grammatica della lingua Albanese”, f. 70.

Prof. J. Kastrati te përshtatja dhe komente që u bën Këngëve të Milosaos, f. 123, shprehet se: “*Asht karakteristike e poetit dyfishimi i zanoreve. Kjo veçansi ndihej për të folmen shkodranishte të qindvjetit të kaluem*”.

⁸¹ Zgjatimi i zanoreve, sipas studimit të F. Altimarit për Maqin, duhet konsideruar një tip i sistemimit dhe i shpërndarjes fonetike të realizimit të zgjatuar të zanoreve në varësi të disa tipareve, rregullave, kontekstit, që shkojnë sipas skemës: /+ theks/, /+ bashkëtingëllore të tingullit/, qenia në kufi të fjalës etj. Zgjatimi i zanoreve realizohet zakonisht në të folurit e “ngadalshëm” dhe në të folurit “e shpjete” vetëm në rrokje të theksuara të fjalëve që ndodhen në fund të sintagmës, ose të frazës. Brenda sintagmës dhe frazës ka, përkundrazi, neutralizim të kësaj dukurie prozodike.

Siç vihet re zanoret –a, dhe –i , -e, realizohen të gjata me funksion theksimin e tyre në rrokje të mbyllur,të ndjekur nga bashkëtingëllorja alveolare- n. Në poemë del qartë se zgjatimi i zanoreve mbart përmbajtje shprehëse ose emocionale.

Zgjedhimi i parë

Nga përdorimet në këtë vepër, më karakteristike janë zakonisht përdorimet që sipas klasifikimit sinkronik dalin në grupin e foljeve të zgjedhimit të parë, të tilla si: *gjëmonj* në kohën e tashme të formës veprare.

Këto përdorimedalin me mbaresat : njëjës v.I.-*nj*, v.II, -*n*,v.III-*n*, shumës v.I.-njëm dhe shko-*njëmi*, v.II.-*ni*, v.III-*njën*.

Vihet re se sistemi paradigmatic i mbaresave përveç mbaresës -*nj* nuk ka ndryshime të shumta me atë që haset ende sot në një pjesë të të folmeve toske. Në vijim po japim edhe shembuj të tjerë të korpusit të këtyre foljeve për të mbështetur vëzhgimet e mësipërme. Shembuj për trajta të disa foljeve:

- Veta e parë njëjës pusho-*nj*, bë-*nj*, shko-*nj*
- Veta e dytë kujto-*n*, këndo-*n*, la-*n*, llamparndri-*n*, shko-*n*
- Veta e tretë dishëro-*n*, zgjo-*n*, rro-*n*, ljeso-*n*

Sipas Prof. Shkurtajt në punimin “Trajatat foljore të mënyrës dëftore të të folmeve arbëreshe të krahinës së Kozencës”, “Gjatësia e zanoreve, sipas materialeve që dalin nga folësit e moshës së re, nuk duket të ketë funksion dallues, por, përkundrazi, sipas pohimit të Jakobsonit, në këtë të folme dhe në të folmet e tjera arbëreshe, duket të kemi një dukuri prozodike “pertinente” por jo “distintive”, përderisa ajo mbart vetëm përmbajtje shprehëse ose emotive në komunikimin gojor”.

Sipas nesh, zgjatja e zanoreve, përveçse për theksim dhe përmbajtje shprehëse emocionale, tek foljet, mendojmë se mund të shihet edhe si një mënyrë për të shprehur vazhdimësinë e veprimit. Përdorimi i zanoreve të gjata mund të fsheh edhe nuanca modale të habitës, apo mbeturina të fjalive pyetëse tërësore.

Dyfishimi i bashkëtingëlloreve duhet parë si në rrafsh historik fonetik, ashtu edhe në rrafsh historik morfologjik e sintaksor .Aty mund të gjejmë gjurmë sintezë të fjalive pyetëse

- Veta e parë shumës shko-*jëm*, shko-*njëm*, shko-*njëmi*,⁸²
- Veta e dytë—shko-*ni*,
- Veta e tretë qeshë-*njën*, gjëmo-*njën*, mba- *njën*, rua-*njën*, ro-*njën*,
fiuturo-*njën*,shko-*njën*

Mendojmë se dy format e para të vetës së parë shumës janë variante të njëra- tjetrës, ndërsa forma e tretë e mbaresës mund të jetë ndonjë formë së cilës mund t'i jetë mbishtresuar dhe modaliteti i fteses (le te shkojmë).

Po japim shembull për trajtën e foljes *fryj*⁸³

- Veta e parë njëjës frii-*nj*
- Veta e dytë frii-*n*
- Veta e tretë frii-*n*
- Veta e parë shumës frinj-*ëmi*
- Veta e dytë fri-*ni*
- Veta e tretë fri-*njën*

Mund të shihet se nuk kemi ndonjë ndryshim të rëndësishëm me sistemin e mbaresave që hasen sot te e njëjta folje. Duket dyfishimi i *i-së*⁸⁴ në temë që mendojmë se është tregues i një zanoreje të gjatë. Veta e parë shumës është specifike ndryshe nga sot. Natyrisht është i kuptueshëm kalimi nga -*nj* në -*j* për vetën e dytë e të tretë njëjës dhe të dytë shumës, pasi ky është një proces i përfunduar për shqipen e sotme.

Zgjedhimi i dytë

Foljet e zgjedhimit të dytë shfaqen më të shumta nga pikëpamja numerike. Dihet se në përdorimet e sotme temat e këtij grupimi shfaqen me temë në bashkëtingëllore dhe në tre vetat e para të njëjësit zakonisht dalin me mbaresë zero, por një pjesë e mirë e tyre pësojnë ndryshime të shumta fonetike. Një gjë e tillë për ligj mungesën e mbaresës, pasi ndryshimet fonetike në këtë rast janë mjet sintetik trajtëformues.

⁸²Shih De Rada, “Grammatica della lingua albanese, Prima parte, Firenze 1871”, f. 70

⁸³Shih De Rada, “Grammatica della lingua albanese, Prima parte, Firenze 1871”, f. 63

Në korpusin e Milosaos ka nga këto folje, të cilat shfaqin të njëjtat karakteristika me përdorimet e tyre të sotme (me ndryshime të vogla). E tillë është folja *shoh*: (ti) *sheh*, (ai) , (ata) *shoh-ën*. Më e shpeshtë në përdorim haset veta e tretë njëjës-shumës.

Shembuj me disa prej foljeve:

- Veta e parë njëjës⁸⁵ -shes, dredh,
- Veta e dytë - shet, dredh
- Veta e tretë- *sqep-ën*, *terjoss-ën*, *oreks-ën*, *tagjiss-ën*, *laftariss-ën*, *shakëmiss-ën*, *garepss-ën*,
- Veta e parë (shumës) - *ec-im*, *shes-ëmi*, *nga-ssëmi* *dredh-ëm*
- Veta e dytë –*shitt-ëni*, *dredh-ëni*, *ngi-ttëni*
- Veta e tretë - *lutënj-ën*, *lampariss-ën*, *potiss-ën*, *pres-ën*, *shoh-ën*, *gareps-ën*

Vihet re se mbaresë karakteristike, ndryshe nga shqipja e sotme e vetës së tretë shumës është –*ën*. Kjo është e ngulitur dhe nuk shohim raste përjashtimore. Veta e parë shumës shfaqet mjaft e larmishme dhe njëra nga foljet *ec* e cilanë poemë del me formën e sotme, ndërsa në dy format e tjera nëformat e arbërishtes së kësaj periudhe. Veta e dytë paraqitet më e rregullt, përveç *ë-së* mbështetëse e cila sot ka rënë.

Projektimet e së tashmes shfaqen në trajtat karakteristike të lartpërmendura, po ato shoqërohen me përdorime specifike kuptimore të foljeve në fjalë. Kështu kemi në jo pak raste, kur gjejmë të njëjtat forma dhe të njëjtat kuptime me ato të përdorimeve të sotme:

Si gara që *del* për sish, kënga I .Më *presën* ndë roliet, kënga IV etj

Në këto forma dalin dhe folje të tilla si: (ai) *prish* (ti) *merr* , *pret* (*press-ën*), *ik-ën*, *lip-ën*, *dheziet* (*ndizet*), (ai) *ngjet* .

Shembull me foljen lqip,- pyes.

- Veta e parë njëjës lqip-ënj
- Veta e dytë lqip-ën
- Veta e tretë lqip-ën
- Veta e parë shumës lqip-ënjëmi
- Veta e dytë lqip-ënjëni
- Veta e tretë lqip-ënjën

⁸⁵ Paradigmat e zgjedhimit për foljet *shes*, *dredh* janë marrë nga Gramatika e De Radës, f 71

Siç vihet re mbaresat e shumësit nuk dalin jashtë kuadrit të mbaresave të foljeve të zgjedhimit të parë.

E tashmja veprorë e disa foljeve të zgjedhimit të dytë në disa raste shfaqet pa pësuar ndryshimin *j/l* dhe me tingull fundor të temës *th* e pazëshme, e cila sot del në formën e saj të zëshme me *dh*: kënga 7: ndë cerkut je *mbjeth* ndë gji; kënga 8: cë e *sbarthën* para sivet etj.

Nga ana tjetër, në shumicën e strukturave vihet re se ajo projektohet pikërisht në perspektivën e mësipërme, por pa krijuar shmangie të rrafshit të figurshëm.

Cuur vaiç*a* e ngrohët *ndien*, *Mbajn* kangjelje, si garea cë *dejl* për sish, si e pa ftesë u *xheshiem* (zhvishem) te shtrati, se të m'i *fjit*, ajo *ruan* deitin,

Zgjedhimi tretë

Foljet e zgjedhimit të tretë dalin zakonisht në temë në zanore dhe në tre vetat e para marrin mbaresë zero, si në shqipen e sotme. Në vetat e shumësit dalin me mbaresat – *më*, *-ni*, *- në*.

Shembull zgjedhimi folja *ljëë- lë*

- Veta e parë njëjës – ⁸⁶ljëë
- Veta e dytë ljëë
- Veta e tretë ljëë
- Veta e parë shumës- ljëëm, ljëëmi
- Veta e dytë - ljëni
- Veta e tretë ljëën

Foljet e zgjedhimit të tretë ruajnë zanoren e gjatë e cila del si zanore e dyfishuar në të shkruar. Kjo gjë bën që në mbaresa të shumësit të mos shfaqet ë-ja fundore, pasi ajo shmanget në shqiptim nga zanorja e gjatë *-ë* parafundore.

Tek Milosao gjemë dhe folje të tilla, të cilat në ato përdorime që dalin përputhen me zhvillimet e sotme paradigmatiche si të temave, ashtu dhe të mbaresave. Të tilla janë foljet: *marr*, *rri*, *di*, *do*, *dal*:

⁸⁶ Paradigma e zgjedhimit është marrë nga Gramatika e De Radës, f 71

Ka folje të tjera si folja *vete*, e cilat në në strukturë me kuptimin e foljes *shkoj*. Kjo e fundit nga ana tjetër del shumë rrallë. Mendojmë se ndikimi kryesor i kësaj strukture është ai dialektor.

Na *vejim* asaj udhe , kënga II, f. 18 *Veim* ashtu poshtë, kënga IV, f. 26 Sipër illëzit *vein*.

Shembull zgjedhimi për foljen *vej*-(vij) shkëputur nga Gramatika e De Radës

- Veta e parë njëjës - *vej*⁸⁷
- Veta e dytë *vej*
- Veta e tretë *vej*
- Veta e parë shumës- *ve-jim*
- Veta e dytë -*vini*
- Veta e tretë - *vein*

Folja e mësipërme në tri vetat e njëjësit del me të njëjtën formë, pra pa mbaresë, si folje e zgjedhimit të tretë (pavarësisht se sot *j*-ja fundore del si mbaresë), ndërsa në tri vetat e shumësit del me mbaresat e foljeve të zgjedhimit të dytë.

Nga korpusi i mësipërm vëmë re se pavarësisht përkatësisë në zgjedhim, mbaresat e vetave të shumësit janë ato që sot marrin foljet e zgjedhimit të dytë (*ve-im*, *ve-in*).

Tek folja *lë* shfaqet dyfishimi i zanores fundore , si tregues i gjatësisë së saj (*lëë*), në vetën e tretë njëjës duke qenë, sipas klasifikimit të F. Altimarit në studimin për të Folmen e Maqit, hyn në grupin e zanoreve të theksuara fundore në rrokje të hapur: */lëë/*, gjë që e kemi parë dhe për folje të tjera të zgjedhimit të parë⁸⁸.

Foljet e çrregullta plotësisht dhe ato gjysmë të çrregullta ne i kemi grupuar në një grup. Përveç foljeve *kam* dhe *jam* këtu del dhe folja *them* , *dua* e ndonjë tjetër. Këto

⁸⁷ Shih Gramatika e De Radës, f. 74, 83

⁸⁸Zgjatimi i zanoreve, sipas studimit të F. Altimarit për Maqin, duhet konsideruar një tip i sistemimit dhe i përndarjes fonetike të realizimit të zgjatuar të zanoreve në varësi të disa tipareve, rregullave, kontekstit, që shkojnë sipas skemës: */+ theks/*, */+ bashkëtingëllore të tingullt/*, qenia në kufi të fjalës etj. “Gjatësia e zanoreve, sipas materialeve që dalin nga folësit e moshës së re, nuk duket të ketë funksion dallues, por, përkundrazi, sipas pohimit të Jakobsonit, në këtë të folme dhe në të folmet e tjera arbëreshe, duket të kemi një dukuri prozodike “pertinente” por jo “distintive”, përderisa ajo mbart vetëm përmbajtje shprehëse ose emotive në komunikimin gojor”.

Zgjatimi i zanoreve realizohet zakonisht në të folurit e “ngadalshëm” dhe në të folurit “e shpjëtë” vetëm në rrokje të theksuara të fjalëve që ndodhen në fund të sintagmës, ose të frazës. Brenda sintagmës dhe frazës ka, përkundrazi, neutralizim të kësaj dukurie prozodike,

forma po i diskutojmë duke përfshirë të gjithë përdorimet e tyre kohore në një syth të veçantë, i cili vijon në vazhdimësi.

Format joveprorë të kohës së tashme

Më sipër u njohëm me përdorimet foljore të së tashmes veprorë. Në tekstin që ne kemi marrë në analizë, dalin dhe mjaft forma foljore të së tashmes joveprorë. Të tilla si: *zëgjonet, frihjen, dighet, pririem, dighet, zëgjonem, xheshiem, shprishen, përpiqem, ulet, ulem, fanarosset, thughiet, shihet, ulem, veshet, laghiet, fiantakset, rittiit, zëgjonet, mbjidhen, trëmbiet etj.*

Zgjedhimi i parë

Nga korpusi i foljeve në joveprorë në zgjedhimin e parë elemente të tilla si : *zëgjonet, zëgjo-nem, fri-hjen.*

Në mbaresat e dy foljeve të para vihet re se alomorfi i përdorur ndryshon nga ai i sotmi vetëm nga n-ja e cila sot del si -h.(zgjonom-zgjohem). Gjithashtu tema e foljeve del me theks dy rrokje para fundit, e cila sot është shndërruar në fjalë me theks parafundor, pasi ka rënë ë-ja.

Tek folja e dyte vihet re h-ja në mbaresë, po gjithashtu ekziston dhe j-ja e një *nj-je* më të vjetër (frihnjen). Mendojmë se ky rast ka përbërë dhe fazën më të hershme të zhvillimit të joveprores.

Shembull zgjedhimi folja *ljaj- laj*

- Veta e parë njëjës- lja-ghem⁸⁹
- Veta e dytë lja-ghe
- Veta e tretë lja-ghet
- Veta e parë shumës lja-gh⁹⁰emi
- Veta e dytë lja-gheni
- Veta e tretë lja-ghen

⁸⁹ Shih Gramatikën e De Radës, f 95

⁹⁰ De Rada në Gramatikë jep këtë shpjegim për mbaresat e foljes: “Në foljet ku tema mbaron me zanore të theksuar midis temës dhe mbaresës vendoset si *h, gh*, por edhe *-n*.”

Mendojmë se dy format e para janë variante të njëra- tjetrës, ndërsa forma e tretë e mbaresës mund të jetë ndonjë formë së cilës mund t'i jetë mbishtresuar dhe modaliteti i ftesës.

Siç mund të dallohet, pavarësisht ndryshimeve tematike të caktuara, mbaresat e atyre formave që dalin për të tashmen shfaqen të njëjta (*-et* veta e tretë, *-em* veta e parë, njëjës dhe *-en* veta e tretë shumës).

Ka raste, kur formalisht kemi shprehjen e së tashmes joveprore, por kuptimisht del një e tashme me kuptim të përgjithësuar në kuadrin e formulave popullore. Këtë e thekson dhe dativi etik që e shoqëron atë psh;

E te bota na *garronen* shokët e vëllezërit.

Leghen djalë, kënga X, f. 42.

Gnighen plot hare, kënga XIII, f. 48

Në format e së tashmes joveprore vihet re shpesh mungesa e *h*-së, alomorfit mbaresor të sotëm, i cili shfaqet në dy forma; *em*, *esh* ose *hem*, *hesh* etj

Kjo gjë vihet re jo vetëm në bashkëtingëlloret e fillimit, por edhe në trup të fjalës si te kënga X, f. 42, (E vihet e më *kënton*).

Në shembullin e mësipërm mund të vëmë re përdorimin e foljes *vë* në joveprore si një folje aspektore (ajo ruan deitin/ e *vëghet e më kënton* strofat që mi thoja vet (këng XI), Kët gherë *vëghet fjën(fle)* te shtrati im(këng XXI)

Ky përdorim i saj është dialektor dhe i rrallë në shqipen e sotme⁹¹, ndërsa në poemë ai shfaqet disa herë. Ky fakt na çon të mendojmë se mund të jetë një arkaizëm që ruhet ende në këtë mjedis gjuhësor. Ndërtimi sintaksor që vihet re është i tipit me bashkërenditje. Ndërkohë në poemë shfaqet edhe tipi me nënrenditje, ku folja e dytë është në mënyrën lidhore: Kënga 13: U më *vihem të pështjeri*. Mbizotërimi i ndërtimeve me bashkërenditje i afron këto të folme me dialektin jugor të shqipes, sepse në dialektin verior shfaqen rrallë⁹².

Zgjedhimi i dytë

Foljet e zgjedhimit të dytë shfaqen më dendur: *dighet*, *shihet*, *ulem*, *laghiet*, *fiantakset*, *rittiyet*, *sholariet*, *mbjidhen*, *rodhet*.

⁹¹ Ndërtimet me foljen *vihem* përputhen me dialektin verior të saj. Ky ndërtim hyn në grupin e ndërtimeve me folje që tregojnë fillimin e veprimit.

⁹² Shih. Gjinari. J; "Ndërtimet foljore që tregojnë fillimin e veprimit në të folmet e arbëreshëve", Studime Filologjike, Nr 3, 1975.

Shembuj për format foljore

- Veta e parë njëjës – *ul-em, shitem*⁹³, *digjem*
- Veta e dytë- *digj-e, shit-e, ul-e*
- Veta e tretë *digh-et, shi-het, digj-et*
- Veta e parë shumës- *digj-emi, shit-emi*
- Veta e dytë *digj-eni, shit-eni*
- Veta e tretë *mbjidh-en, digj-en, shit-en*

Specifike shfaqen format e vetës së dytë njëjës, të cilat dalin pa një pjesë të mbaresës së sotme, përkatësisht pa *t*-në. Mendojmë se ky fakt mund të jetë ndikimi i kontekstit specifik situativ në të cilën përdoret zakonisht kjo vetë. Dihet se zakonisht kjo është veta e dialogut. Në këtë kuadër këto forma mund të kenë përdorur format homologe të urdhërores.

Më e zakonshme është veta e tretë numri njëjës, e cila mund të dallohet lehtësisht sepse në të gjitha rastet shfaqet me një mbaresë të njëjtë(-*et*).

Në një rast del folja *mbjedh* në vetën e tretë numri shumës me mbaresë të njëjtë me atë të sotmen (-*en*).

Zgjedhimi i tretë

Paradigma e zgjedhimit folja *lë*⁹⁴

- Veta e parë njëjës *ljëri-em*
- Veta e dytë *ljëri-e*
- Veta e tretë *ljëri-et*
- Veta e parë shumës – *ljëri-emi*
- Veta e dytë *ljëri-eni*

Foljet e zgjedhimit të tretë në joveprore shfaqin forma analoge me ato të sotmet në shumës, në lidhje me mbaresat, po ndryshojnë në njëjës nga këto të fundit. Veta e dytë dhe e tretë njëjës shfaqin dy mbaresa të veçanta, *-e, -et*.

Tek folja *vjen* vihet re se mbaresat me të cilat del kjo folje me temë në zanore në shumës janë të ndryshme nga ato të sotmet. Kështu veta e parë e shumës për këtë folje, por edhe për të tjerat del me mbaresën *-im, -in: ajo vie-n, (ata) ve-in*.

⁹³ Paradigmat e foljeve *shitem, digjem* janë marrë nga Gramatika e De Radës, f. 86

⁹⁴ Shih Gramatikën e De Radës f., 75

E pakryera

Sipas Gramatikës I, koha e pakryer tregon një veprim në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës⁹⁵. Dihet se ky lloj kuptimi krijon mjaft mundësi që kjo formë foljore të përdoret në përshkrime. Formalisht vihet re se në vepër e pakryera e formës veprare shfaqet e larmishme. Në lidhje me ndajshitesat trajtëformuese mund të themi seka forma që gjenden në trajtën e shqipes së sotme.

Format e së pakryerës veprare:

E pakryera e mënyrës dëftore në poemë del me trajtën e thjeshtë me mbaresa.

Në materialin e marrë në shqyrtim ky tip i së pakryerës dëftore dallohet:

1. Për ekzistencën e disa mbaresave, të cilat në dialektet e të folmet e tjera të shqipes, tashmë janë drejt zhdukjes, ose nuk kanë ekzistuar si të tilla :

- ❖ Trajta e vetës së tretë njëjës ndryshe nga sot del me mbaresën - *nej: sit i ruanej, shkonej vasha mespurtek (këng VII), nd'era tundënej vadhezit (këng VII) një erë ngrënej pluhurin, shtëfrinej mureve (këng XVIII), ljuanej Milordeza (këng XVI), shtrushulojen Zoghëza (këng 16-të, gjithë m'ë thojn se vinej koj ditë/ e si mund vinej u ng' pata besë), mbi tufa pa ilit parë bukurith , çë dritësonej, e jëma çë i qanej mb'anë (këng XIV), si një marmur me logaaz ruanej (këng X), trimi ghipënej murgiarit(kënga IX), pors i ajo si kish zakon mëë së vinej Kroiri (kënga IX), te ferri cë na fsheghnej ka udha(këng XI).*
- ❖ Folja *flas* në formën e vetës së tretë numri njëjës, shfaq një nga format më të vjetra të përdorimit me mbaresë zero (*ffi*).
- ❖ Folja *them* del pa *-sh*, në variantin e vjetër thonin
- ❖ Në disa folje të parregullta forma e vetës së tretë njëjës është ndërtuar mbi bazën e kohës së tashme, duke i shtuar mbaresën *-ej* ;
- ❖ Nga materiali i marrë në shqyrtim nga Gramatika e De Radës shohim se koha e pakryer e mënyrës dëftore formohen nga tema foljore duke i shtuar

⁹⁵ Gramatika I, f. 308.

mbaresat *-nja, -nje, -nej, -njim, -njit, -njin*. Siç shihet trajtat e të gjitha vetave, përfshirë vetën e tretë njëjës, shfaqin formën e vjetër të temës me mbaresës *-nj*, ku ende nuk ka rënie të *-j-së*.

Mbaresat janë të njëjta si për foljet me zanore, ashtu edhe për ato me bashkëtingëllore, ndërsa në vetën e tretë njëjës gjendja shfaqet disaformëshe:

Me mbaresën *-nej* p.sh. *bënej* “bënte” *-ij/-j* p.sh. *ljë-ij, dil-j*, pa mbaresë p.sh. *prit* “priste”, *vej* “vente” etj

- ❖ Veçoria e përdorimit të prapashtesës *-th* shfaqet edhe në kohën e pakryer të mënyrës dëftore psh: *gjidhëtith* (zgjidhte) nga një tuf re, *zilepsënith, kurmin t'im fiantaksënith* (shëmbëllen) këng XI).
- ❖ Në ndonjë rast shfaqen ndryshime fonetike të temës: (*vaita* në Salonik; mua sa më *ndeiti; këntuan* një valle; kënga III: etj.

2. E pakryera e analitike që ndërtohet nga e pakryera e foljes jam + lidhëzën bashkërenditëse e + foljen që shpreh kuptimin themelor në të pakryerën, në materialin tonë nuk dëshmohet.

3. Për të qartësuar më tej gjendjen e kohës së pakryer forma veprorë po japim paradigmën e disa foljeve të shkëputura nga Gramatikën e De Radës, përkatësisht për foljet *laj, dal, lë*⁹⁶:

○ Veta e parë njëjës	<i>lja-nja</i>	<i>dilj-ë-nja</i>	<i>ljë-nja</i>
○ Veta e dytë	<i>lja-nje</i>	<i>dilj-ë-nje</i>	<i>ljë-nje</i>
○ Veta e tretë	<i>lja-nej</i>	<i>dilj</i>	<i>ljë-ij</i>
○ Veta e parë shumës	<i>lja-njim</i>	<i>dilj-ë-njim</i>	<i>ljë-njim</i>
○ Veta e dytë	<i>lja-njit</i>	<i>dilj-ë-njit</i>	<i>ljë-njit</i>
○ Veta e tretë	<i>lja-njin</i>	<i>dilj-ë-njin</i>	<i>ljë-njin</i>

Tek foljet e mësipërme shfaqet forma e vjetër e temës dhe mbaresës me *-nj*, ku ende nuk ka rënie të *-j-së*.

Korpusi i foljeve në poemë është : *fjiss-in flit, fjëjt-in, ri-ja, leghëmis-tin, llampariss-ëjin: ti ruaje e së kultoje; së gërvishtnin; nuk ishin, ecia për ndë ullinjt; ndër dier fjüisin*. Në këtë korpusi me format e së pakryerës veprorë të mënyrës dëftore, në lidhje

⁹⁶ Shih Gramatikën e Da Radës f., 83

me sistemin e mbaresave mund të themi se nuk vëmë re ndonjë ndryshim me ndonjë përjashtim si folja *flit* në vetën e tretë njëjës.

Përgjithësisht nga kjo paradigmë në poemë del së shumti forma e vetës së tretë shumës, e cila shfaq të njëjtën mbaresë si sot, *-in*.

Shumica e formave të tjera shfaqen në kuadrin e vetës së tretë të numrit shumës dhe dalin me mbaresën *-in* (në ndonjë rast tema mund të lidhet me mbaresën dhe nëpërmjet ndonjë elementi mbështetës siç është *ë-ja*, e cila këtu del si *-ë-* mbështetëse, *llampariss-ëjin*).

Sasia numerike e këtyre foljeve nuk është e madhe dhe në lidhje me temat vihen re dhe ndryshime të caktuar fonetike për ndonjë prej tyre. Kështu folja *flas* pëson në temë ndryshimin fonetik nga *-a-* në *-i-*⁹⁷

Gjithashtu foljet që në temë kanë *-l-* sot nuk dalin me këtë të fundit, por me *-j-*, e cila nuk ka ndryshuar.

Në ndonjë rast shfaqet dhe veta e parë dhe dytë njëjës, e cila shfaq të njëjtat mbaresa si sot

(*-ja, -je*). Këto forma përgjithësisht projektohen në sfondin e dialogëve ose, kur personazhi kryesor i drejtohet vashës edhe virtualisht.

Gjithashtu, ashtu siç thekson dhe prof Koleç Topalli, tek folja *flas* në formën e vetës së tretë numri njëjës, shfaqet një nga format më të vjetra të përdorimit me mbaresë zero (*fji*).

Prof.Çabej e quan *të pakryer të pazgjeruar*.⁹⁸

Siç vihet re në foljet e këtij grupimi forma e vetës së tretë (njëjës) tek foljet *ro-nej*, *shtrushullo-nej*, *qia-nej*, por edhe në disa folje të parregullta është ndërnuar mbi bazën e kohës së tashme, duke i shtuar mbaresën *-ej* që e ka burimin në joveprore. Kjo është një dukuri që shfaqet njësoj edhe në të folmen e Çamërisë psh; *dërgo-nej*, *marto-nej*, *ngrënej* etj

- Veta e tretë (shumës) leghjëmist-in, *llampariss-ëjin*, *rrumpular-ëshin*, *vir-ëshin*
- Veta e parë(njëjës) ri-ja
- Veta e tretë *ngrë-nej* e parregullt

⁹⁷ Topalli.K (2010), “Sistemi foljor i gjuhës shqipe, Plejad”, Tiranë, f. 69

⁹⁸ Shih Çabej “Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre”, Konferenca e dytë e Studimeve albanologjike” III, Tiranë 1970

Forma jo veprorë; *mbahej, dukëshin, dukej, ndahëshin, shprishej, pririej, grihej, përpiqej, pjeks-ënej, fshi-nej, rua-nej, shko-nej, gip-ënej, qia-nej, , ngrë-nej, shtëfri-nej, shtrushullo-nej, ljuar-nej, kulott-ënej, rumpular-ëshin, vi-nej, ntin-ej(tingëllonte), hapej, nkuqënej.*

Forma e së pakryerës joveprorë, dëftore, del më e shumë numerikisht se format e veprorë. Ato shfaqen larmishmëri si në trajta ashtu dhe në kuptime.

Shembull me foljet *djeg, laj* shkëputur nga Gramatika

- | | | |
|----------------------|------------|------------|
| ○ Veta e parë njëjës | digj-ësh | ljag-hesha |
| ○ Veta e dytë | digj-ësh | ljag-heshe |
| ○ Veta e tretë | digj-ej | lja-ghej |
| ○ Veta e parë shumës | digj-ëshim | lja-gëshim |
| ○ Veta e dytë | digj-ëshit | lja-gëshit |
| ○ Veta e tretë | digj-ëshin | lja-gëshin |

Tek foljet e zgjedhimit të dytë vihet re që alomorfi del me *-ë* dhe jo me *-e*, si në shqipen e sotme. Mendojmë se është ndikim dialektor.

Në foljet e zgjedhimit të parë vëmë re shfaqjen e alomorfit të sotëm *-hesha, heshe, hej, heshim, hëshit, hëshin*. Në vetën e dytë dhe të tretë shumës reflektohet ndryshimi i *ë-së* në *-e*, ndryshe nga shqipja e sotme, si një variant dialektor.

Në poemë format e së pakryerës joveprorë shfaqen më specifike në lidhje me kuptimet e tyre. Ka raste kur formalisht shfaqen si joveprorë, por kuptimisht në strukturën e shqipes së sotme dalin si veprorë Kënga 1: *ronej* në Temp e moçme.; Kënga 4: që këshen më *pleksënej*, mos njeri *shkonej* etj.

Semantikisht këto trajta foljore, në përgjithësi janë folje lëvizjeje, gjendjeje shpirtërore etj.

Pjesa tjetër e tyre shfaqet me format e sotme: Kënga 4 *duhëshin* e se *thonin*, kënga 12 në atë mot që *duhëshin* (me ndonjë errësim të *ë-së* etj), *ngjitej* tek e bukura etj.

Në lidhje më format e së pakryerës joveprorë, mund të themi se ato përgjithësisht shfaqen si trajta të vetës së tretë njëjës dhe shumës. Mbaresat janë karakteristike dhe nuk janë të ndryshme nga ato të sotmet, me ndonjë përjashtim të vogël në lidhje me

alomorfin e vetës së tretë, njëjës. Ky i fundit në mbaresë nuk shfaqet mbas temave që mbarojnë me zanore elementi lidhës-*h-* që del sot, po në vend të tij *-n*.⁹⁹

Në të pakryerën joveprore dalin folje të zgjedhimeve të ndryshme. Nga zgjedhimi i parë kemi folje të tilla si: *ro-nej*, *shtrushullo-nej*, *qia-nej*.

Nga zgjedhimi i dytë shfaqet ky korpus: *hap-nej*, *ntin-nej*, *pleks-ënej*, *kullot-ënej*, *nkuq-ënej*, *ljua-nej*.

Format e zgjedhimit të tretë janë shumë të pakta. Ato nuk shfaqet në të pakryerën me formën e temës së sotme, por me temën e pjesores. Për këtë arsye këtë formë do e shohim të foljet e çrregullta.

E kryera e thjeshtë

Nga materiali i marrë në shqyrtim edhe në kohën e kryer të thjeshtë shfaqen mbaresa të shqipes së sotme dhe me trajta dialektore. Në fakt në disa kontekste ligjërimore ajo shfaqet dhe jashtë kornizave të përcaktuara, duke marrë nuanca konotative specifike, dallojmë këto veçori:

1. Aoristet asigmatike, ku në dallim nga gjuha e sotme shqipe, në vend të aoristit me *-va* për disa prej foljeve me zanore, mbizotërojnë trajtat e aoristit me *-tapsh*: *frita*, *ruati*, *ndajti*, *përthaiti*, *thaiti*, *ngrëiti*, *ffjëiti*, *ndejti* duke marrë mbaresat *-ta*, *-te*, *-ti*, *-tim*, *-tit*, *tën*: Kjo¹⁰⁰ dukuri është një zhvillim vetjak i arbërishtes i përfutur pas shkëputjes nga trangu i shqipes.

2. Foljet e tipit *marr*, dalin njësoj si në mbarë shqipen, edhe këtu pësojnë apofoninë e zanores rrënjore *a>o* dhe marrin këto mbaresa: në njëjës: *-a*, *-e*, *-i (-ti)*, dhe në shumës: *-tim*, *-tit*, *-tim*.

3. Foljet *vinj* “vij” dhe *vete* në aorist dalin:

erdha, *erdhe*, *erth*; *erdhtim*, *erdhtit*, *erdhtin*; *vajta*, *vajte*, *vatte*; *va:më*, *va:të*, *va:në*.

4. Aoristi josigmatik i foljeve *jam*, *shoh*, *them* del në variante dialektore arkaike: (unë) *keva* (ti) *keve*; (unë) *pe*, (ti) *pe*; (unë) *thom*, (ti) *thua* (*ai*) *thet*.

5. Trajta e vetës së tretë njëjës e foljeve me apafoni (tipi *marr - mora*) del pa mbaresë p.sh: *dual*, *muar pruar*), sikurse në të folme të ndryshme të gjuhës shqipe.

⁹⁹ Topalli.K (2010), “Sistemi foljor i gjuhës shqipe”, Plejad, Tiranë, f. 140

¹⁰⁰ Gj. Shkurtaç, art.cit.f.32

6. Në të kryerën e thjeshtë të veprorës sikurse edhe në disa kohë të tjera gjejmë edhe përdorimet karakteristike me mbaresën *-ith*. Vashës lot i *ranith*, kurmi i vet i *qeshënith*(*këng XXII*)

7. Folja *fle* shfaqet në temën e vjetër të saj: - *ffëjta*, në të cilën nuk ka ndodhur ndryshimi i *-j-së* në *-l*.

8. Folja *lind* del në formën dialektore *lej* dhe merr mbaresat e zakonshme të së kryerës së thjeshtë: *leva, leve*.

Për të qenë sa më të qartë dhe konkret po sjellim shembuj zgjedhimesh nga Gramatika e De Radës dhe po analizojmë të gjithë shembujt që kemi nxjerrë nga poema.

Shembuj me paradigma të foljeve *laj, fryj pyes*, shkëputur nga Gramatika e De Radës

Forma veprorë

➤ Veta e parë njëjës	ljaita	friita	piejta
➤ Veta e dytë	ljaite	friite	piejte
➤ Veta e tretë	ljaiti	friiti	piejti
➤ Veta e parë shumës	ljaitëm	friitëm	piejtëm
➤ Veta e dytë	ljaitët	friitët	pietët
➤ Veta e tretë	ljaitën	friitët	pietët

Te folja *laj*, folje e zgjedhimit të parë, shfaqet tema e vjetër e foljes ku elementi fundor, i cili sot konsiderohet mbaresë, këtu del si pjesë e temës. Specifike shfaqet mbaresa e vetës së parë shumës e cila del në formë të ndryshme nga shqipja e sotme. Ajo, megjithëse nuk përputhet me standardin, ka përputhje me shumicën e të folmeve të shqipes. Folja *pyes* shfaq të njëjtën strukturë si zgjedhim i parë, ndërkohë që sot hyn në foljet e zgjedhimit të dytë.

Forma jo veprorë e foljeve; *djeg, laj*.

➤ Veta e parë njëjës	u dogja	u ljaita
➤ Veta e dytë	u dogje	u ljaite
➤ Veta e tretë	u dogj	u ljaa
➤ Veta e parë shumës	u dogj-ë-tim	u ljaitim

- | | | |
|----------------|------------|-----------|
| ➤ Veta e dytë | u dogjëtit | u ljaitit |
| ➤ Veta e tretë | u dogjëtin | u ljaitin |

Tek këto folje mbaresat e tri vetave të njëjësitet shfaqen njësoj si sot, ndërsa në vetat e shumësit në të dy zgjedhimet shfaqet mbaresa karakteristike dialektore.

Te Milosaoja, gjithashtu haset në një numër të madh foljesh (rreth 100 përdorime të së kryerës së thjeshtë). Në pjesën më të mirë të përdorimeve shfaqet në rrafsh asnjëanës, pa u veshur nuanca figurative.

Nga ana formale një pjesë e mirë e trajtave gjenden pa ndryshime thelbësore nga përdorimet e sotme. Format e së kryerës së thjeshtë herë shfaqen pa ndryshime me shqipen e sotme: larg e *pa*, *u pataks* mizoreja, *dielli ra* tek shtrati, *cë shkararti* pesë ullinj dhe herë me disa dallime të cilat mund të shihen si ruajtje trajtash më të lashta si p.sh. aoristi josigmatik i foljevejam, *shoh*, *them*: (unë) *qeva* (ti) *qeve*; (unë) *pe*, (ti) *pe*; (unë) *the*, (ti) *the*, herë si zhvillime të reja, vetjake që janë përfutuar në këto të folme pas shkëputjes nga trangu i shqipes. I tillë është p.sh. shtimi i aoristeve me *-ta* në vend të atyre me *-va* në foljet me zanore (tipi: *friti ka deti*,)

Në poemë hasen të dy format e përdorimit si ajo veprorë, ashtu dhe ajo joveprorë.

Foljet e formës veprorë: *ruata*, *zëgjo*, *thajti*, *përgjaku*, *ngrëiti*, *vaita*, *ndieit*, *erth*, *reshta*, *duall*, *dola*, *vu*, *çoi*, *lotënjën*, *përbaltën*, *ljeu*, *doli*, *gëzoi*, *bëri*, *rëmpeu*, *sbardhën*, *sbardhëtin*, *ngrëiti*, *fjëiti*, *uli*, *pa*, *garroi*, *thoi*, *ruati*, *dual*, *sbardhëluan*, *vatte*, *ëndërri*, *bëre*, *buartim(fituam)*, *këputti*, *pa*, *shkundi*, *shkararti*, *mori*, *vu*, *raa*, *bëri*, *puthi*, *ikku*, *njohu*, *ru (arrite)*, *pështoi*, *ndajti*, *doli*, *priita*, *pe*, *fërnoi*, *ra*, *soi*, *shtrure (hodhe sytë)*, *arruer(erdhe)*, *pruari*, *mbaiti*, *zëgjova*, *ngrohu*, *mbuzati*, *zuu*, *proseksa*, *ngriti*, *ndigu(ndihu)*, *piu*, *qëndroi*, *ruata*, *putha*, *shruan*, *vaita*, *ruati*, *hiri*, *bëre*, *reshti*, *la*, *qeshi*, *piksi*, *përthaiti*, *shkundën*, *friti*, *rëzoi*, *lee*.

Siç mund të shihet numerikisht këto forma janë të konsiderueshme dhe u përkasin zgjedhimeve të ndryshme.

Nga zgjedhimin e parë hasen folje të tilla si: *zëgjo/va*, *gëzoi*, *garroi*, *ëndërri*, *pështoi*, *qëndroi*, *ngriti*, *fërnoi*, *thajti*, *ruata/ruati*, *ngrëiti*, *fjëjti*, *ndejti*, *çoi*, *bëri/bëre*, *rrëmpeu*, *ru*, *ndajti*, *përthajti*, *frijti*, *rëzoi*

Nga zgjedhimi i dytë shfaqen folje të tilla si: *përgjaku*, *reshta/i*, *vajta/vatte*, *duall*, *përbaltën*, *doli*, *sbardhën/sbardhëluan*, *buartin*, *këputti*, *shkundi*, *shkararti*, *mori*, *puthi/a*, *ikku*, *njohu*,

Priita, shtrure, arrure, ngrohu, mbuzati, proseksa, ndihu, hiri, qeshi, piksi

Nga zgjedhimi i tretë kemi këto folje: *vuu, ljeu, , uli, pa/pe, zu, piu, la/ee,*

Folje të çrregullta; thoi, ra, pruar (dalin veç në të kryerën e thjeshtë, ose pjesore, natyrisht infinitivë -me pru). Folja **vij**, e cila në shqipen e sotme e shfaq temën me një formë supletive të shoqëruar me mbaresat karakteristike të së kryerës së thjeshtë, këtu shfaqet por me ndryshim supletiv, tingulli fundor i të cilit del shurdhët dhe jo i zëshëm si sot.

Nga ana tjetër, në vetën e tretë kjo folje nuk shfaq mbaresë, pra del me mbaresë zero:

Erθ ka majli dheljpëra, kënga II, f. 16. *Erθ* e bile e Kallogrees, kënga III, f. 20.

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për foljen tjetër supletive **bie, apo shoh**, që dalin në këto trajta:

Raa bora ndë det, kënga VI, f. 26. *Paa* një re, kënga VIII, f. 32.

Ajo që duket qartë nga korpusi i mësipërm është fakti se përgjithësisht foljet që dalin janë në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë dhe më pak në vetën e parë dhe të dytë, po njëjës.

Në lidhje me mbaresat mund të themi se ato janë të njëjta si sot. Për vetën e tretë njëjës del mbaresa-*i*- për foljet që mbarojnë me temë në zanore të patheksuar ose bashkëtingëllore, kurse për foljet që mbarojnë më temë në zanore të theksuar shfaqet alomorfi *-u*.

Në lidhje me temat mund të themi se është zbatuar parimi fonetik i shqipes, sipas të cilit , ndryshe nga italishtja, *z*-ja mes dy zanoreve shkruhet po *z*.

Folja *shkoj* gjendet sikurse për kohët e tjera me infinitiv: **me vajt**. Përkatësisht këtu shfaq mbaresa karakteristike dhe ndryshime fonetike të temës së fjalës. Në vetën e tretë veprorë, del pa *j* e temës dhe mbaresën *-tte*, ndërkohë që sot është *-ti*:

Nd'ë uj një ditë *vatte* te mali, kënga I.

Folja *dal* shfaqet në temë me një *-ll-* dhe në vetën e tretë *-o-* shndërrohet në *-ua-*. Kjo formë e veprorës del pa mbaresë ndërkohë që sot ka mbaresën *-i*: Fanëmirë kush na *duall*, kënga 3, f. 20.

Përveç kësaj forme të vjetër me mbaresë zero, shfaqen dhe format me mbaresat e sotme *-doli*.

Me një pjesë foljesh të tjera shfaqet dhe mbaresa e sotme *-i*. Kështu folja *zbardh*, vërtet shfaqet me dy zanore të pazëshme , një në fillim dhe një në fund të temës (megjithëse e para është e dyshimtë, pasi mund të jetë nën ndikimin e italishtes në ortografi), por merr mbaresën e sotme: E më *sbarθi* udhëvet, kënga VI, f. 26.

Edhe vetat e parë dhe e dytë veprorë zakonisht dalin me format e sotme, si në temë, ashtu dhe në mbaresë:

Vetat e shumësit të formës veprorë zakonisht shfaqen në formë të rregullt:

Chyntuan një valle, kënga II, f. 16.

Një pjesë e foljeve të zgjedhimit të parë ruajnë mbaresën *j*, e cila haset dhe sot në folje të caktuara zakonisht të përdorimit geg, por këtu grafikisht del me *i*:

Ngryiti deg ulliri shkundur, kënga VIII, f. 32.

Folja *vë* na del në vetën e tretë të veprorës, pa mbaresë, por me një zanore të gjatë e cila në shkrim shfaqet me dyfishim të tingullit fundor:

Më ja *vuu* në dorët, kënga IV, f. 22.

Foljet e zgjedhimit të parë dhe të tretë e shfaqin vetën e tretë të veprorës në kryerën e thjeshtë si sot në mbaresë:

E *garroi* shpizën, kënga X, f. 40. E *ruati* mbë menat, kënga X, f. 40. *Σcundi* borën e fushavet, kënga XVI, f. 50.

Folja *fle* na shfaqet në temën e vjetër të saj, në të cilin nuk ka ndodhur ndryshimi i *j*-së në *l*, dhe në mbaresë me një *-j*- tjetër si një pjesë foljesh që pamë më lart:

Fjëjta natën, kënga XV, f. 54.

Folja *lind* del në formës e saj të shqipes së sotme dialektore *lej* dhe merr pastaj mbaresat e zakonshme të së kryerës së thjeshtë:

Kur *leva* për herë të parë, kënga XVI, f. 58.

Folja *fryj* del në temë me *-i*- si në format e toskërishtes së sotme, prej nga mendohet se janë dhe ndikimet kryesore të arbërishtes:

Fryiti ka deti, ose *frihej* ka gjiri, kënga XVI, 58

H-ja si tingull nistor i temës zakonisht del me *-g-*. Këtë e vëmë re dhe te folja *harroj* (sikurse e kemi cituar më lart), ashtu dhe te *hyj*, *hapetj*:

Gapi derien, Kënga XVI, f. 56.

Në tekst na shfaqet dhe një strukturë e tillë: *Vasha* me një psherëtim/*bëri e shiti* lotëzit (zuri e fshiu lotët)

Në pjesën e dytë të saj kemi dy folje në të kryerën e thjeshtë që lidhen me një lidhëz bashkërenditëse. Specifik është përdorimi në të i foljes *bëj*, e cila është përdorur në kuptimin e foljes aspektore *nis*.

Foljet e formës joveprorë, dëftore janë më të pakta se ato të veprorës: *u pataksa*, *u rodh*, *u pruar*, *u sbulua*, *u resht*, *u ra* (koment), *u hjimisa*, *u shehëtin*, *u mbite*, *u nissa*,

u tund, u leve, u ulj, u lëshua, u skotis, u përpoqa, njoga, u lehtë, u errët, u fanarossa, u ul, u vesht,

Format e joveprores shfaqin të gjitha formantin analitik u përpara, që është karakteristik për këto forma edhe sot.

Në lidhje me temën, vihet re se në këtë të fundit një ndikim të madh ka luajtur dhe tema e pjesores së foljes.

Me këtë formë shfaqen si foljet e përdorshme në shqipen e sotme, ashtu edhe ato që janë shuar, qoftë dhe semantikisht. Semat me të cilën i gjejmë në vepër janë:

Gni garee *m'u roth* te curmi, kënga I. E *s'u pruar* si e kish zakon, kënga I.

Folja *fsheh*, e cila del vetëm në formën e vetës së tretë shumës joveprore (*u shehët*), shfaqet pa *-f*-në.

Mendojmë se ndikon trysnia e bashkëtingëllores tjetër të pazëshme që e pason, *-sh-së*.

Nga ana tjetër në këtë formë nuk del mbaresa e sotme-*ën*, po *-in*, e cila mund të paraprihet nga një tingull mbështetës *-t-* si në rastet e *u shehët*, *u errët*.

Krahas këtyre formave, në folje të tjera shfaqet dhe mbaresa e sotme. E tillë është: *u lehtë*.

Veta e parë dhe veta e dytë njëjës del me të njëjtat mbaresa si sot: *u njoha, u mbite, u nissa*.

Foljet e zgjedhimit të tretë në vetën e tretë njëjës dalin me mbaresë zero njësoj si sot: *u ul*.

Folje të zgjedhimit atematik

Në gjuhën shqipe këtij modeli i përkasin vetëm tri folje: ***kam, jam*** dhe ***them***. Duke qenë se ky grup foljesh del jo rrallë në vepër dhe foljet kanë si tipare të përbashkëta ruajtjen e formave të vjetra vetore, i kemi analizuar së bashku.

Paradigma të plota të zgjedhimeve për foljen *jam* dhe *kam* jepen në Gramatikën e De Radës, i cili i ka trajtuar të plota pasi sipas tij ato janë: “*Folje shumë antike që ndërtojnë forma të ndryshme foljore, kohët e përbëra, si edhe të rëndësishme nga pikëpamja gjuhësore historike*”.

Mënyra dëftore: koha e tashme

Tabela II.1

folja kam		folja jam	
Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës
Cam	chemmi	Jam	Jemmi
chee	chinni	Jee	Jinni
caa	caan	Ësht	Jaan

E pakryera

Tabela II.2

folja kam		folja jam	
Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës
Chishënja/chësh	Chishënjim /chëshëm	Ishënja/ jësh	Ishënjim/jeshmë
Chishënje/ chëshnje	Chishënjit	Ishënje	Ishënjit
Chish	Chishënjit	Ish	Ishënjin

Mendojmë se në paradigmat që jepen për foljet *jam* dhe *kam*, për kohën e pakryer, varianti i parë tregon për trajta të këtyre foljeve, të cilat¹⁰¹ janë ende të pranishme në disa të folme jugore, ndërsa varianti i dytë i cili përputhet plotësisht me çamërishten mendojmë se është formë arkaike. Këtë mendim e përforcon edhe Prof. Demiraj në “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, f. 741 kur pohon se: “*Tek format e shumësit jesh(ë)shëmë, kesh(ë)më, thosh(ë)më, më të vjetra janë ato pa zanoren mbështetëse – ë-*“, si dhe kur shpjegon¹⁰² shndërrimin *-e* në *i-*, që foljet *jam* dhe *kam*, kanë pësuar në kohën e pakryer, e cila sipas tij është përfutur fillimisht në vetën e tretë shumës dhe në kohë më të vonë është shtrirë për analogji edhe në vetat e tjera.

Tabela II.3

¹⁰¹ Demiraj. Sh. Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, “Mihal Duri”, f. 741, Tiranë 1986

¹⁰² Demiraj. Sh. Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, “Mihal Duri”, f. 745, Tiranë 1986

E kryer e thjeshtë, folja kam		E kryer e thejshtë, folja jam	
Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës
Patta	Pattëtim	Keva/ kjeva/ kjesh	Keem/kjemë/chieem
Patte	Pattëtit	Keve/ kleve	Keet/kjeet/chieet
Patti	Pattëtin	Ke/kje	Keen/kjeen/chieen

Në kohën e kryer të thjeshtë ndryshime të dukshme paraqet folja *jam*, e cila del në një variant dialektor, i cili ndeshet vetëm tek arbëreshët e Greqisë¹⁰³.

E kryera e tejskUAR

Tabela II.4

folja kam	
Numri njëjës	Numri shumës
Patta/ passur	Pattëtim/passur
Patte/passur	Pattëtit/passur
Patti/ pat/passur	Pattëtin/passur

Kohë të mbipërbëra

Tabela II.5

folja vrarë	
Numri njëjës	Numri shumës
Patta me passur vjaar	Pattëtim me passur vjaar
Patte me passur vjaar	Pattëtit me passur vjaar
Patti me passur vjaar	Pattëtin me passur vjaar

¹⁰³ ShihDemiraj. Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, f. 747, Tiranë 1986, ku citon disa forma të kësaj foljeje të mbledhura në ishullin Hydra. Edhe toponimia e emrave të përdorur në poemë na tërheq vëmendjen në ndihmë të këtij arsytimi: Kështu në këngën XV thuhet : Nëng ai ndaiti *Idriotten* (me origjinë nga Hidra) siichëqi, në f. 50, kënga XIV kemi: Fanëmirat nd’at *Greqi*, kënga XVIII, f. 62: *Pargagniotit* Miloshin. Nga shembujt vihet re qartë lidhja me arbëreshët e Greqisë prej nga mund ta kenë burimin këngët popullore në të cilat u mbështet autori.

Tabela II.6

folja vrarë, joveprore	
Numri njëjës	Numri shumës
Patta me kjenun vraar	Pattëtim me kjenun vraar
Patte me kjenun vraar	Pattëtit me kjenun vraar
Patti me kjenun vraar	Pattëtin me kjenun vraar

Siç vihet re nga shembujt e dhënë tek foljet *kam* dhe *jam* në kohën e tashme shfaqet si veçori dyfishimi i zanores fundore në vetën e dytë njëjës, edhe pse e pandjekur nga një bashkëtingëllore, ndërsa në dy vetat e para të shumësit shfaqet dyfishim i bashkëtingëlloreve. Për kohën e pakryer De Rada paraqet dy tipa paradigماش, ku e para ka mjaft ngjashmëri me disa të folme të shqipës së sotme. Ajo që vihet re është tema e cinguar antike –*kish*, –*ish*, e cila siç shihet është një ndër temat me të cilën del e pakryera edhe tek Gramatika e De Radës. Në variantin e dytë shfaqen ngjashmëri të dukshme me forma konservatore, të cilat i gjejmë edhe sot në të folmen e çamërishtes. Dëshmia e dy formave dialektore, mes të cilave njëra është arkaike dhe tjetra ka elemente që i gjejmë ende sot në disa të folme, na paraqet një gjendje të përzierjes së elementeve gjuhësor të mbartura prej gjuhës mëmë, si dhe një tablo të zhvillimeve të mëtejshme të arbërishtes gjatë kësaj periudhe

Në kohën e kryer të thjeshtë, folja *kam* shfaqet me dyfishim bashkëtingëlloresh. Tri vetat e njëjësit dalin njësoj si sot me formë supletive, ndërkohë në numrin shumës vihen re mbaresat; –*ëtim*, –*ëtit*, –*ëtin*, të cilat nuk i gjejmë në shqipen e sotme, përveçse në çamërisht. Folja *jam* shfaqet me temën e vjetër, ku ende nuk ka ndodhur qiellzorizimi i –*k* në –*q*, nga velare te qiellzore. Tema e kësaj folje në numrin njëjës dhe në variantin e dytë të numrit shumës del si në gegërishten veriperëndimore. Veta e dytë njëjës, e cila sot del me mbaresë zero, këtu shfaq mbaresën karakteristike të foljeve të rregullta. Varianti i parë i vetave të shumësit del njësoj si në çamërisht. Në kohën e kryer të thjeshtë folja *jam* shfaqet njësoj si në dialektin e veriut, në vetën e dytë dhe e tretë njëjës shfaqen zanoret e gjata. Në vetën e dytë njëjës, folja *kam* del *kini*, një formë e vjetër ku ende s'ka ndodhur kalimi i –*i*-së në –*e*. Pjesorja e foljes *jam* del si temë e vjetër pa rënie e –*j* –së. Edhe në variantet që shfaqen në të kryerën e

tejskUAR shfaqet dyfishimi i zanoreve tek folja *kam*, për të cilën mendojmë se është një dukuri dialektore që sot shfaqet vetëm në të folmen konservative të çamërishtes.

Tabela II.7

Kohët e përbëra të mënyrës dëftore			
E kryer, folja kam		E kryer, folja jam	
Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës
Kam passur	Kemi passur	Kam kjenur	Kemi kjenur
Kee passur	Kini passur	Kee kjenur	Kini kjenur
Kaa passur	Kan passur	Kaa kjenur	Kaan/keen kjenur

Tabela II

Mënyra lidhore			
folja kam		folja jam	
Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës
Të cheem	Të chemi	Të jeem	Të jemi
Të cheesh	Të chijëni	Të jeesh	Të jeni/Të jini
Të cheet	Të cheen	Të jeet/Të jee	Të jeen

Tabela II.9

folja kam, e pakryera	
Numri njëjës	Numri shumës
Të chishja/ të kesh/të kija/	Të chishëjim/ të kijim
Të chishje/të kije	Të chishëjit/ të kijit
Të chish/të kiij	Të chishëjin/ të kishjin/ të kijin

Tabela II.10

folja jam, e pakryera	
Numri njëjës	Numri shumës
T'ishëja/ t' jesh/t'ija	T'ishëjim/ të jeshim/t'ijim
T'ishe/ t'ije / t'isje	T'ishëjit/ t'ijit
T'ish/ t'ij	T'ishjin/ t'ijin

Në mënyrën lidhore, në kohën e tashme foljet *kam* dhe *jam* shfaqin si veçori përdorimin e zanoreve të gjata. Në numrin shumës folja *kam*, në vetën e dytë shfaq një temë më të zgjeruar se e zakonshmeja në të cilën jo vetëm nuk ka ndodhur shndërrimi i *-i* –së në *-e*, sikurse te folja *jam*, veta e dytë shumës, por shfaqet edhe një element i ndërmjetëm *-jë*. Në kohën e pakryer shfaqen për disa veta edhe variante dytësore, të cilat janë më arkaike se të parat dhe janë njësoj me çamërishten. Folja *jam* në kohën e tashme në vetat e njëjës shfaq dyfishim zanoresh, ndërkohë në vetën e tretë njëjës vihet re mungesa e *ë-së* fundore, e cila justifikohet nga ekzistenca e zanores së gjatë brenda temës. Folja *kam* në kohën e pakryer shfaqet në dy variante ku varianti i parë është afër shqipes së sotme. Në variantin e dytë, i cili është më konservator dhe njësoj si në çamërisht, veta e tretë njëjës nuk del mbaresat e sotme.

Mënyra urdhërore

Numri njëjës:	Chij	Iij
Numri shumës:	Chijëni	Ijëni

Siç vihet re në mënyrën urdhërore, në numrin shumës shfaqet një temë më e zgjeruar, me *-jë*. Numri njëjës përputhet në temë me format e sotme, megjithëse vihet re zanorja e gjatë që mendojmë se është shprehje dialektore.

Tabela II.11

folja kam, mënyra dëshirore	
Numri njëjës	Numri shumës
Pasha/ paçia	Pashim/paçim
Pash/ paç	Pashit/ paçit
Past	Pashin/ paçin

Tabela II.12

folja jam, mënyra dëshirore	
Numri njëjës	Numri shumës
Kiosha/ kioçia	Kioshim/kioçim
Kioshë/ kioçë	Kioshit/kioçit
Kiotë	Kioshin/kioçin

Tek dëshirorja vihet re, larmi të formave të të dy dialekteve dhe të standardit. Në variantet e dëshiores dallohet ekzistenca e prapashtesave trajtëformuese të dëshiores, përkatësisht e alomorfit – *sh(kioshim, kioshit, kioshin)*, ashtu si në gegërishten veriperëndimore dhe mëgjerë. Po kështu edhe veta e parë dhe e dytë për të dy foljet janë mjaft të zakonshme në kontekste situatave në gegërisht, sikurse folja *kam* në vetën e tretë shfaq variantin me *-ft*, *kioftë* ose vetëm me *-t*, *kiotë*. Kjo do parë, ndoshta, jo si veçori e ligjërimeve arbëreshe, por si një sprovë e autorit për të sjellë ndonjë afrim me shqipen e shkruar me dialektin geg.

Pjesorja:

Passur – Kênur

Siç vihet re tek pjesorja e foljes *jam* nuk ka ndodhur qiellzorizimi i *k*-së në *-q* nga velare në qiellzore, një bashkëpërkim ky me gegërishten e sotme.

Në poemën “Këngët e Milosaos” foljet *kam* dhe *jam* shfaqen në paradigma si më poshtë:

Tabela II.13

Folja kam	e tashme	koha e pakryer	koha e kryer e thjeshtë
Veta e parë njëjës			e patta
Veta e dytë	ke		
Veta e tretë	ka	kish,kishë	pat
Veta e parë shumës	kemi		patëm
Veta e dytë			
Veta e tretë		kin	

Tabela II.14

Folja kam	e tashme	e pakryer
Veta e parë njëjës	iam	jesh, isha
Veta e dytë	je	
Veta e tretë	ëë, ësh, ësht	ish
Veta e parë shumës	jemi	
Veta e dytë		
Veta e tretë	jaan	iin

Së pari, duhet të theksojmë se në krahasim me variantet e paradigmave, që De Rada paraqet në Gramatikë, gjatë vëzhgimeve në poemë na tërheq vëmendjen fakti se më shpesh dalin format e reja të këtyre foljeve krahasuar me trajtat arkaike të tyre.

Siç shihet foljet *jam* dhe *kam* në të pakryerën veta e tretë shumës dalin me trajtën e sinkopuar *kin* për *kishin* dhe *iin* për *ishin*. *Vreshtat in të verdhullore; Dheut ën i kin hije*. Duke qenë se këto forma shfaqen në të dy dialektet e shqipes, mund të themi se janë forma të sjella nga gjuha mëmë.

Në kohën e kryer të thjeshtë folja *kam* del me temë supletive (pata), ndërsa folja *jam* nuk na shfaqet. Zakonisht kjo formë del si e pakryer, ose në kuadrin e kohëve të përbëra si më se e kryer. Mendojmë se një përdorim i tillë vjen si rezultat i mënjanimin dhe në italisht të së kryerës së thjeshtë (për rastin e përdorimit vetëm në të pakryerën), ndërsa rasti i dytë është natyral dhe në shqipen e sotme. Në Gramatikën I,

cilësohet fakti se më se e kryera dhe kryera e tejshkuara sot nga pikëpamja semantike shihen si analoge, për këtë arsye e kryera e tejshkuar zakonisht haset rrallë dhe përdorimet e saj i kryen më se e kryera.

Këto folje edhe në gjuhën e De Radës krahas përdorimit të tyre të zakonshëm, përdoren si folje ndihmëse për të krijuar format analitike.

Foljet *kam* dhe *jam* nuk shfaqen si forma të pashtjelluara .

Përveç mënyrës dëftore, ato dalin në mënyrën dëshirore në rastet:

Kioft i but dimri

Dox(lavdi) *pas-t* zotti ndër qiel

Siç vihet re folja *kam* është përdorur në vetën e tretë, njëjës merr mbaresën *-t-* karakteristike për foljet me temë në bashkëtingëllore dhe ka për bazë temën *pas(ë)* të pjesores.

Folja *jam* është përdorur në vetëm e dytë dhe të tretë njëjës, merr mbaresën *-ft-*, dhe ka shndërruar zanoren *-e-* të rrënjës në *-o-*. *Ky përdorim është i ngjashëm me dialektin e veriut.*

Dihet se dëshirorja del nëpërmjet formulimeve, sipas konteksteve specifike situative (ditëlindje, vdekje, martesë, largime etj.). Në këtë kontekst nuk mund të pritët që një përdorim i tillë të na ofrojë të gjithë paradigmen përkatëse të zgjedhimit në dy kohët përkatëse. E , megjithatë, në shembujt e mbledhur vihen re përdorime si të së tashmes së dëshirores, ashtu dhe të së pakryerës.

Folja them

Në kuadrin e këtyre dy foljeve plotësisht të çrregullta që në pamë sipër, menduam që të sqarojmë këtu edhe një folje që sot shihet si jo plotësisht e çrregullt, por që paradigmatisht shfaq ndryshime të konsiderueshme të temave përkatëse. E kemi fjalën për foljen *them*. Kemi parasysh që kemi të bëjmë me një nga format më të vjetra të zgjedhimit atematik të indoeuropianishtes, të ruajtura në shqipen e sotme.

De Rada përdor pikërisht formën më të vjetër, atë me zanoren *-o-*, e cila në fakt është formë e përbashkët për të gjitha dialektet, përdoret nga autorët e vjetër dhe që sot gjallon në të folmen e Çamërisë.

Paradigma e kohës së tashme folja *them*:

- Veta e parë njëjës thom¹⁰⁴
- Veta e dytë thua¹⁰⁵
- Veta e tretë thot/ thet
- Veta e parë shumës thomi
- Veta e dytë thoni
- Veta e tretë thon/ thoin

Sikurse vihet re folja *them* del në trajtën e saj më të vjetër *thom*, ku ende nuk është bërë shndërrimi i *-o-së* në *-e*, përveç vetës së tretë e cila del edhe me variantin *-e*, i cili është një zhvillim i mëvonshëm. Është e qartë se folja *them* ende nuk u është nënshtruar shndërrimeve të mëvonshme si pasojë e proceseve fonetike apo veprimeve rrafshuese të analogjisë¹⁰⁶.

Në poemë, siç vihet re nga shembujt e vjelë, përdorimet shfaqen vetëm në vetën e tretë njëjës, ose shumës. Ajo del në mënyrën dëftore, por edhe në lidhore dhe urdhërore.

Në dëftore shfaqet në kohën e tashme: Veta e tretë(njëjës) mi *thot*, i *thot*, m'i *thet*/ Veta e parë (shumës) *tho-mi* /Veta e tretë (shumës) i, ia, *thoon*, të *thoo-n*, *tho-in* . Në kohën e pakryer del veta e dytë shumës; *tho-shin*. Në kohën e kryer të thjeshtë del veta e tretë njëjës ; *tha/thoi*.

Folja *them* : (ai)*tho-t*, (ai)*the-t* ,*kemi një shndërrim nga-o-, në -e-*, (ne)*tho-mi(ato) thoin*.

Ajo-*tho-i*,(tha) ata *tho-shin*, ata-thon , më *tho-i*- mali, (ata) (ata)-ia thon

Kush *thoi*(mendoi) se do më lije. Kënga 24 , Si ia *thon* këtij katundi? *thoin*(përflasin) vashën e nëmur.

Siç vihet re kjo folje zakonisht ka dalë në tashmen e dëftores dhe përgjithësisht në formën veprorë. Kontekstet karakteristike ku bën pjesë janë zakonisht ato bisedore. Karakteristike janë lëvizjet e brendshme kuptimore. Jo në të gjitha përdorimet shfaqet me të njëjtin kuptim. Herë del me kuptimin normal të saj *tregoj*, herë si *mendoj*, herë si *quhet*. Këto elemente semantike nuk dalin nga kuadri i sotëm i përdorimit, gjë që dëshmon për vjetërsinë dhe ngulitjen e hershme të saj në strukturën e shqipes.

¹⁰⁴ Shih; “Fiamuri i Arbërit”, viti i parë i botimit, nr10, f., 3,4

¹⁰⁵Mos ja *thua* ti satt’ëëm, Gramatika, f. 60

¹⁰⁶ Shih Sh. Demiraj: Gramatikë historike e gjuhës shqipe, f. 752.

Më pak folja *them* del në mënyrat e tjera si lidhore dhe urdhërore:

Kujt *të m'i thet?*, *Thuam* ndë do gjë. *Thomnie* ju të dashurit e mi

Përgjithësisht ajo shfaqet e lidhur ngushtë në përdorim me trajtat e shkurtra, që justifikojnë nga ana semantike dhe kontekstet e sipërpërmendura të përdorimit (Dihet se dhanorja dhe kallëzorja kur u referohen tipareve të tilla semantike, si këtu, +frymor, +njerëzor parakuptojnëkonteste ligjërimore zakonisht bisedore.

Koha e ardhme

Kjo kohë në poemë del e përdorur kryesisht në formën analitike konservatore me karakter dialektor, të nëntipitë së ardhmes me “*kam*” + lidhore, e cila është mbizotëruese në të gjitha të folmet arbëreshe të krahinës së Kozencës.¹⁰⁷, por edhe në disa të folme të skajit jugor¹⁰⁸¹⁰⁹. Në poemë gjejmë përdorim të tipit do+ lidhore, por në mjaft raste koha e ardhme shprehet me forma të tjera si: me anë të mënyrës lidhore, apo me ndihmën e kohës së tashme të mënyrës dëftore. Këto të dhëna flasin për zhvillimet e brendshme të shqipes, e cila për të shprehur kuptimin kohor të së ardhmes ka krijuar forma analitike nga togje foljore, ku si folje ndihmëse ose modale shërbejnë foljet *dua* dhe *kam*, ndërsa folja kryesore mund të jetë në mënyrën lidhore ose në formën e paskajores.¹¹⁰

Në poemë trajtat e kohës së ardhme paraqiten në tri forma:

1. Me foljen “*kam*” (e cila e ruan trajtën e saj të pangurosur d.m.th. ndryshon sipas vetave dhe numrit) + lidhoren me ruajtje të pjesëzës *të*¹¹¹: p.sh. *jetër sa kam të rronj*, pra çë zot *kee të na ljëësh*; pse na *kem t'ikim?*
2. Trajta me mungesë të foljes dhe ruajtjen e pjesëzën- *të*,¹¹² të lidhores: Trajtat e së ardhmes së dëftores në raste të veçanta dalin edhe në forma të shkurtuara, si

¹⁰⁷ Shkurtaç. Gj. (2006), Ligjërimet arbëreshe, Julvin, Tiranë, f. 205

¹⁰⁸ Shih, Sh. Demiraj, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, f. 835.

¹⁰⁹ Sipas disa gjuhëtarëve tanë si: Domi, Ajeti, Mansaku, Topalli, Demiraj etj, format e ndryshme të së ardhmes së shqipes janë formime të brendshme dhe shkaqet e arsytet e përhapjes së ndryshme të tyre në dialektet e shqipes gjenden në vetë zhvillimin e brendshëm të gjuhës

¹¹⁰ Siç do të vihet re edhe nga shembujt në gjuhën e De Radës, sikurse në mbarë të folmet arbëreshe format *kam+ lidhore* dhe *do+lidhore* përdoren me kuptimet modale të orgjinës.

¹¹¹ De Rada e quan eardhme e qëllimshme dhe jep shembujtkam (të) viòn,kam (të) rrëmpèn.

De Rada njih edhe të ardhmen analitike të tipit *kam të bën* /kam për të bërë, të cilën e shpjegon si:

“*Kohë e tashme nga ku mendimi lëviz për tek e ardhmja në të cilin anon*” si psh; *kam të bën*-kam për të bërë *dua të vette*. Sipas tij foljet e mësipërme mbartin kuptimin e së ardhmes. De Rada propozon formimin e kohës së ardhme si në gjuhët romane, mbështetur në teorinë e mbaresave, si mbeturina të fjalëve formale. Sipas Max Muller në leksionet e tij kushtuar kohës së ardhmes psh *Avrai –avro* (në gjuhën italiane) nga *avoir* (nga gjuha frenge) *kam mepas* (ne shqipen e sotme).

me mungesën e foljes *kam*, e cila formalisht del si në të tashmen e lidhore, por mund të zëvendësohet fare natyrshëm me kohën e ardhme të dëftores; *Dialërat që të m'i ljeghen*, që do t'i lindin. Të riut tim cili varr të *ghee* (do ta hajë) te kisha? Kënga XXIII. Kush të huaj staan tënd mua të *më bëënj*? Kënga XXIII. Oh, kur *t'ikënjën* këto ditë! Ka të *niset* e magjepsur? kënga III Kur të *pririem* ndër të guaj/të frighies/Si të guaj ti të *më diish*.(si të huaj do të *më dish*).Formalisht format foljore shfaqen të ngjashme me të tashmen lidhore joveprore, por kuptimisht zëvendësohen natyrshëm me të ardhmen. Duhet thënë se si strukturë gjendet dhe në shqipen e sotme.(Nga të niset këtë herë). Këtë lëvizje kuptimore foljes ia lejon modaliteti i lidhore.Fanëmir ajo kopile cë te krahu *ti pushoonj!*Në këtë rast folja del formalisht si e tashme, por kuptimisht si e ardhme e thjeshtë. Në mbaresë ruhet (të paktën në të shkruar) *n*-ja që sot ka rënë në shumicën e të folmeve tona dhe vihet re mungesa e ë-së fundore.

Di u ndë trimi i gardhjar *më të shkonj* kësaj udh (në do të shkoj).

3. Trajta pa pjesëzën *-të*, tëlidhore: që na vien nesërith / *kanë daljen*(do të *dalin*) ndër dherat anë. Në shembujt e mëposhtëm: Nesër mbë të serposur *shkon* vasha ka dera ime/ e më *sheh* shumë gare/ *pien* ç'ë kjo gare?, kënga XVII, siç vihet re që kjo trajtë foljore shërben edhe për të shprehur idenë e së ardhmes, sikurse edhe të domosdoshmërisë. Përdorime të tilla, ku folja shfaqet në të tashmen e dëftores, po me kuptimin e së ardhmes, janë të zakonshme në shqipen e sotme.
4. Në raste të tjera kuptimi i së ardhmes realizohet në forma në të cilat mungon dhe folja *kam* dhe *të* –ja e lidhore, kryesisht me formën e kohës së tashme të mënyrës dëftore: Pas vëdekur tha *na rommi* (kështu do rrojmë edhe ne pas vdekjes). Në katund *vëdes* e para (kam për të vdekur) këng XIII). Ëë gare e të birit të Zotit cë *vien* nesërith (me kuptimin që do të vij) .Të njeten bënet e bardhë/ di unë ndë pat të dielën (të enjten do të bëhet e bardhë) këng VII. kënga XIX.Se ti *vije* somenat gjer këtej unë s'e pandehja kënga XIX. Ti më *ruan* kalivien e më *laan* të veshura kënga XX. Më atje *së zgjoniem* nga lulet që tund era kënga XXX.

¹¹² E tashmja lidhore , kuptimisht për shkak të natyrës së modaliteteve të saj, shpreh të ardhmen. Format e së ardhmes së dëftores më shumë afrojnë me lidhoren, sesa me dëftoren. Shih; E. Likaj “ Format analitike në gjuhën shqipe” , f. 108.

5. Në shembullin; Ti tek hije e shtëpisë sate nën të huaj po të rrih/ cë ndër njerëz na *jemi*(çdo të *jemi në mes njerëzve*) kemi të tashme në kuptimin e mirëfilltë sëardhmes.
6. Në shembullin; T'ë njëten bënet e bardhë/ di u ndë *pat* të dielën(në do të ketë të dielë), formalisht shfaqet forma supletive e foljes *kam* në të kryerën e thjeshtë, e cila e shoqëruar me lidhëzën kushtore *ndë* i jep kuptimin e një të ardhmeje të së shkuarës.
7. E ardhmja e tipit do+ lidhore është përdorur vetëm një herë në vepër në formën e *së ardhmes së të shkuarës*, ku vihet re ndryshim i konsiderueshëm fonetik për foljen *do*¹¹³ : *Dee*¹¹⁴ të *garroja* se te bora/ biren kronjet dhe të mbjellat që na mbajnë gjallë. Kënga VI, Milosao. Mendojmë se varianti *dee* është një përdorim dialektor i foljes *do*, në kohën e pakryer me ndikim nga veta e dytë *do + e > dee*. Ekzistencë e saj në arbërisht e përforcon edhe shpjegimi dhe shembulli që autori jep në Gramatikë. Sipas nesh është një togfjalësh, ku folja *dua* është duke u shndërruar në një mjet gramatikor për të shprehur së bashku me foljen në lidhore kuptimin e së ardhmes, por ruan megjithëse zbehtë kuptimin e saj leksikor.
8. Tipi i së ardhmes së të shkuarës është përdorur edhe në funksion të mënyrës kushtore Fanëmir *ndë pixënej* rëmpet e diellit (fatmir, nëse do të endte rrezet e diellit) /do ta ndiente veten të lumtur nëse do të endte rrezet e diellit.¹¹⁵

¹¹³Edhe në Gramatikë, De Rada e njez këtë formë të dëftores duke shpjeguar se: “Tingëllimi i *deevorrei*(italisht) – do të doja (shqip), i foljes *dašur* –me dash zëvendëson një dëshirë që realizohet me folje në lidhore ndërkohë që plotësohet dëshirorja e pastër, E gje ša attié Se io la il trovil-Dee t'e gjeja attié =Do ta gjeja atje. Në foljet ndihmëse në gjuhën shqipe kohët nuk kanë të gjitha një rrënjë sipas modelit të foljes *essere* (me qenë)në latinisht, frengjisht, etj. Por fenomeni ndoshta unik që në shqip dha gjurmë të reja origjinaliteti është në akord fonetik *de*”.

¹¹⁴Nga shembujt dallohet qartë se ardhmja e tipit *kam+ të punoj*, është e përdorur më gjerë se ajo e tipit *do+të punoj*, kjo mund të shpjegohet me aftësinë dykuptimshprehëse të tipit me *kam*.

¹¹⁵Sic dëshmohe nga shembujt në këtë moment ende shqipjanuk e ka formuar mënyrën kushtore, por e shpreh me mjete të tjera gramatikore.

Kohët e përbëra të mënyrës dëftore

Në shqipen e sotme format e kohëve të përbëra të dëftores shfaqen të larmishme e me paradigmë të plotë përdorimi. Kështu sot kemi të kryerën, më se të kryerën dhe të kryerën e tejshkuar, përgjithësisht në standard e në dialekte . Në ndonjë rast shfaqen dhe disa forma si *jam/isha/qeshë duke punuar*, të cilat formalisht shfaqen si të përbëra, kurse semantikisht mund të diskutohet vlera e tyre.

Në tekst shfaqet një rast i tillë: Prifëtëra janë të na martojnë, i cili sipas nesh duhet parë në kuadrin e strukturave të mësipërme.

Interpretimi do të ishte: Prifëtëra janë për të na martuar/me na martue. Siç shihet format e paskajores: janë për të na martue/ me na martue, të cilat sot japin nuancat e domosdoshmërisë, në poemë këtu realizohen me foljen jam+ lidhore.

Prej kohëve të përbëra në vepër është përdorur *koha më se e kryer*, e cila shfaqet në formën veprorë dhe joveprorë në vetën e tretë, numri njëjës. Për nga ndërtimi ajo shfaqet me foljen ndihmëse *kam* ose *jam + pjesoren* e foljeve p.sh.:

Lis jeta *kishë ndërruar*,/ nga dheu i huaj *kishë arryyn*/ ahjena ndër time motëra ; ushtrit *kishë harruar*/; e rriti ajo zonjë , atë *kish gharruarith*,/trimi ktu *kishë vdekur kënga XXIII* . *Kish ndenjur* atje brenda. Në vepër shfaqet edhe një, shprehje e veçantë e formës joveprores, e cila gjendet vetëm në të folmen e çamërishtes me paravendosjen e formatit -u : *U pati mbjedhur* ai ndë shpi.

Deljet tona *u kinë gapur* , /veç e mban nën një kumbul *u kish uljur* me trim (këng XX)¹¹⁶. Ajo çfarë vihet re është mungesa e -sh tek veta e tretë shumë kohë epakryerën , e cila del me trajtën e sinkopuar *kin*. Të dyja format janë variante dialektore prej së cilës forma e parë është më arkaike.

Nisur nga shembujt edhe në Gramatikën e De Radës mund të themi se në arbërisht kohët e përbëra të joveprores krijohen me pjesëzën – u. Duke qenë se kjo formë e zgjedhimit jovepror del me shtrirje të kufizuar gjeografike¹¹⁷ mund të themi se është një formë dysorë e shqipes. E diskutueshme mund të jetë çështja e vjetërsisë së saj, por për këtë mbetet për t’u parë shtrirja që kjo formëgramatikore merr në të këto folme.

¹¹⁶ Edhe në “*Grammatica della lingua albanese*”, botuar në Firence në vitet 1870, De Rada i përmbahet idesë se forma joveprore e kohëve të përbëra në të gjitha mënyrat ndërtohet me paravendosjen e formatit -u-, duke dhënë shembujt : *u kaam ljaar, u pata ljaar*

¹¹⁷ Shfaqet në të folme konservatore si çamërisht, apo në të folmen e Gjirokastrës

Në një rast të vetëm na shfaqet një formë e përmbysur, në të cilën folja ndihmëse *kam* del pas pjesores :Ç’ë së prita ,por u nisa?/*Ardhur kisha* me uratën.

Por kjo formë e përmbysur, duke u nisur edhe nga konteksti i përdorimit të saj në poemë si shprehje e qëndrimit afektiv emocional të personazhit, na tërheq vëmendjen për t’u parë edhe si dëshmi pararendëse e procesit të krijimit të formave foljore të kushtores, si një moment kur format e përmbysura analitike të mënyrës dëftore marrin vlerën e mënyrës kushtore, për t’u zëvendësuar dalëngadalë me format e konsoliduara të kushtores. Kjo formë e përmbysur formalisht del si format e së ardhmes dëftore, por kuptimisht realizon kushtoren, pasi mund të zëvendësohet shumë lehtë nga forma etipit do të kisha ardhur me vlerën e së kryerës kushtore.

Në ndonjë rast gjejmë edhe të **kryerën e tejshkuar** si psh:

Priftërat e arbëreshëve i *pattëtin besuar*¹¹⁸

Në poemë na tërheq vëmendjen shembulli: Forëmadhe mëma ime *pat bes* me ushtërin Arbërit t’i ndihja”, pasi nuk kemi shfaqje të ndonjë kohe të përbërë, por përdorimin e një lokucioni foljor mjaft të bukur, i cili përdoret edhe sot në gegërisht, duke shprehur forma të marrëdhënieve sociale të kohës, ku besa ishte virtyt i paçmuar. Kuptimi i saj është: A mund të kem besë tek ty? A mund të të besoj?

Kohët e mbipërbëra shfaqen rrallë.

Tek “Fiamuri i Arbërit” ndeshim këtë shembull mjaft interesant:Atje prannë **t’u kish passur rritur** i pagëzuari i arbëresh. Ajo që na tërheq vëmendjen është përdorimi formal i formës veprare. Përdorime të tilla shfaqen si formula tipike letrare të prozës popullore. Në të folurën e çamërishtes kjo formë përdoret ende dendur në ligjërimin bisedor, për të shprehur edhe nuanca të habitshme. Krahaso: Atje na na qenkësh rritur i pagëzuari i arbëresh.

Sikurse vihet re nga materiali i marrë mes dy veprave kryesore të autorit, dallohet se në Poemë ngjashmëritë më të mëdha shfaqen në dialektin tosk, veçanërisht me të folmen e çamërishtes, e cila në fakt sot del si e folme mjaft konservatore, ndërkohë në Gramatikë, përveçse përkimeve të shumta me çamërishten, dalin edhe mjaft përkime me gegnishten. Pra mund të themi se pikëtakimet me gegnishten mund të jenë, jo veçori të ligjëtimeve arbëreshe, por një sprovë e autorit për të sjellë afrim me shqipen e shkruar të dialektit gegë. Këtë ide e ndihmon edhe fakti se Gramatika , përveçse një

¹¹⁸ Shih “Fiamuri i Arbërit”, viti I,nr 10.

punim vetiak i autorit, është edhe një vepër e punuar më vonë pra, pasi poema “Këngët e Milosaos, e kishte parë dritën e botimit.

Sikurse vihet re, format gramatikore të mënyrës dëftore shfaqen sintetike, por një pjesë e mirë e tyre dalin analitike, si rrjedhojë e zhvillimeve të mëtejshme të ndryshimeve aspektore.

Pavarësisht rasteve të veçanta vihet re se paradigmën e mënyrave dhe kohëve shfaqen pa ndryshime të konsiderueshme me shqipen e sotme.

Korpusi i foljeve të mënyrës dëftore në poemën “Këngët e Milosaos”

Tabela II.15

Nr. rendor	Folja e përdorur nga De Rada	Folja e transkriptuar	Kënga	Nr. i faqes
1.	Ndien - Cuur vaiζα e ngrohet ndien	Kur vajza e ngrohet ndien	I	1
2.	Χισον ndyruar	Lis jeta kishë ndërruar		
3.	ronej	Por lumbardh e Anakreontit në Temp ronej		
4.	vatte	Nd’uj një dit vate te mali		
5.	S’u pruar (kthye)	E s’u pruar si kish zakon		
6.	Χισι arryyn ahjena nder time motera	Kish arrën	I	
7.	Θοι	Thoi- e mëma ime emërin tim thoj për ndë shpi	I	
8.	U roθ- Gny garee (hare) m'u roθ te curmi	U rodh	I	
9.	Caa i goi	Po i këndonin	I	
10.	Mbain cayyελε	Mbajn kangjelje	I	

11.	Ruaje	Ruaje	I	
12.	Cυλτοje: Ti ruaje e së cυλτοje	Kυλτοje	I	
13.	Xeavgnyn- Nd'at ninυλ xeavgnyn	Qeshënjën- Nd'at ninυlj qeshënjën	I	
14.	Tundyn	Tundën	I	
15.	Pyrçien- Nd'era i tundyn pyrçien	Përzien	I	
16.	Chiin- Deut yyn i chiin xee	Kin - Dheut ën i kin hje	I	
17.	U pataxa	U patakxa	I	
18.	Ruata- M'u pataxa	Ruata- e ruata jashtin	I	
19.	ζvçxoi- tue fituruar	Zëgjoι - Mua më zëgjoι, tue fjuturuar	I	
20.	Frighien- sist cv mi frighien	Frijhen-Sist që m'i frihjen	I	
21.	Deλ	Dejl- si garea cë dejl për sish	'	
22.	U sbυlua	Uzbuljuan je dejtι	I	
23.	θaitι	Thajti- Vet cë atë s'e thajti bora	I	
24.	U reçt	Se m'υ resht (larga)njëra që ra tek e bardha shpia ime	I	
25.	U ra	U ra- se mu resht njera që ra	ii	
26.	Chiç	Kish- e s'υ prura si kish zakon	i	
27.	Ronej - ronej teemp	Ronej temp e mocëme	I	1
28.	Chie çndyrruar	Kishë ndërruar-Lis jeta kishë ndëruar		
29.	Pyrçxaccu (Përgjaku)	Vet çë s'e thajti bota s'e përgjaku akulli		
Kënga 2				
30.	Duchyçim	Dukëshim- Di buzë të qesheme, at mbrëma dukëshim	II	18
31.	Reçta	Reshta (me llërt përgjakur unë nga ballët ia reshtja)		

32.	Gkyrviçtvitin	Gërvishtëtin- Së gërvishtëtin at kopilje	II	18
33.	Virvçin	Virëshin- gjëmbat cë virëshin tek udha		18
34.	Vejim	Vejim- Na vejim asaj udh		18
35.	Ngrÿiti	Ngrëjti ballët e sbuljuar		18
36.	Jam- e bile e Calogrees	Jam		18
37.	Ngrynej	Ngrënej- fucinë ajo ngrinte		18
38.	Nyng için	Ishin- Vasha nëng ishin ndë katund		18
39.	Vaita- e Salonix vaita	Vajta		18
40.	jeσ	kur jesh djalj		18
41.	Je	mos më je ti e dheut guaj?		18
42.	Je	Je- kujt e bilje je ti vash?		18
43.	M' u pruar	M' u pruar-Shtruara vasha m'u pruar		16
44.	Ngit	Ngit- Skemantilj i ngit (I prek) mbë truall		16
45.	Ndiëti	Ndjejti- mua sa më ndjejti		16
46.	Kish	Kish- një këshill i kish hje		16
47.	Iç	Ish- ish tek kroi një vashë		16
48.	U Ximissa	U hjjmisa- Kur në fjokat u më rashë		16
49.	Chÿntuan	Këntuan- këntuan nje valle		16
50.	Sxepet - dieli	E atëhere ndër sheshet sqepet (fshihet) djelli	II	16
51.	paru	Vreshtat in të vardhullore porsa paru (me të mbaruar) in te vjela		16
52.	Erθ	Erth - ka malji dheljpëra		16
53.	Reçta	Reshta- ka ballt u më ja reshta		18
54.	lin	In- vreshtat in të verdhaullore		16
55.	Reçta	Reshta- ka ballt u më ja reshta		18

56.	lin	In- vreshtat in të verdhullore		16
Kënga 3				
57.	Na duall	Na duall- Fanëmir kushë na duall	III	20
58.	Dnchvçin	Dukëshin- kallëz të korpisur	III	20
59.	Erθ	Erth- e bile e Calogrees		20
60.	Ezzia	Ecia- për ndë ullinjet	III	20
61.	Dola	Dola - në Roodh	III	20
62.	Mbagnyn	Mbajnë- vecë garen e tire	III	20
63.	Prittej	Prittej- nata tek na	III	20
64.	Ndaghyçin	Ndahëshin- ar e Ijiner		
65.	Zvi	Zëj- Paru e zëj	III	18
66.		nj'anankasi		
67.	S'iin	S'in- se ndë vatërat s'in të jatërat	III	18
68.	Fjissin	Flisnin- ndër dier flisnin	III	18
69.	Iç	Ishte- mbrëmja e shën Mërisë	III	18
70.	Dighet	Dihet- si ajo që dihet me një fat të bardhë	Vjershë e të bijës së Kallogres	22
71.	Zoçxonem	E zëgjonem e garepsur	Vjershë e të bijës së Kallogres	22
72.	Geçiem	Xheshiem- si e pa ftesë u xheshiem(zhvishem) te shtrati	Vjershë e të bijës së Kallogres	22
73.	Erθ	Erth- ka m'erth te kurmi gjith këja gadhi?	Vjershë e të bijës së Kallogres	22
Kënga 4				
74.	Vuu	Vu- më ia vu në doret	IV	22
75.	Mbanej	Mbanej- mbi veshin e bardh	IV	22
76.	My pressyn	Më presën- ndë roljiet	IV	22
77.	uçt	Ësht- C është ikën si ajri?	IV	22
78.	Ichyn	Ikën- C është ikën si ajri?	IV	22
79.	Dughyçin	Duhëshin-ata duhëshin e s'e thoshin	IV	22
80.	θoçin	Thoshin- ata duhëshin e s'e thoshin	IV	22

81.	Më pjeksënej	Më plekëste- që këshen më pjeksënej	IV	22
82.	Cioi	Coi- vetëm e coi ndë vatëret	IV	22
83.	Ish dieghuriθ	Ish djehur-se ish e djehurith	IV	22
84.	λipyn	Ljipën- të m'i Ijipën një pik uj	IV	20
85.	Tçittej	Ngjitej- tek e bukura	IV	20
86.	Ish	Ish- e diela menat	IV	20
Kënga 5				
87.	U çeghutin	U shehëtin- ruatin pran 'u shehëtin	V	24
88.	sbarutin	Sbardhëtin- anizit	V	24
89.	Ty veen	Të ven- Cë të ven ndë dejtit mendimet	V	24
90.	Rughien	Ruhjen- vet cë sit na ruhjen	V	24
91.	Θeçjet	Dhezjet- cera më i dhezjet	V	24
92.	λottvgnyn	Ljotënjën-garruamith	V	24
93.	Pyrba λtyn	- paru më përbaljtën udhët	V	24
94.	Garronen	Harrojnë - e te bota na harrojmë	V	24
95.	Vemuniθ	Vemënit- mbi shtrat na vemënit	V	24
96.	Erθ	Erth- dita e arberit	V	24
Kënga 6				
97.	My caa	Më ka-ajo mua më ka hje	VI	28
98.	dyθinia	Dëthinia-zemër(që më mori zemrën)	VI	28
99.	Diçyron	Dishëron- sa më dishëron te kragu	VI	28
100.	sbarθyn	Sbardhën- ndë sbardhën dita	VI	28
101.	Sy λeu	Së ljeu	VI	28
102.	Σinej	Shinej- më shinej me skemantilj	VI	28
103.	Ruanej	Ruanej- sit i ruanej	VI	28
104.	Buten	Buten - sit i ruanej e m'e buten	VI	28
105.	Zyi	Zëj- tërkuzën të	VI	28

		përtrollën		
106.	Ichen	Ikën- ndë një leg gra	VI	28
107.	My λυçonej	Më Ijëshonej-ndo se kalj më Ijëshonej	VI	28
108.	λυρεjin	Na Ijërej in iljëzit	VI	28
109.	Fanepsëjin .	Na fanepsëjin-mbë të aguar	VI	28
110.	Veim	Veim- ashtu posht, veim	VI	26
111.		Më qëllonej	VI	26
112.		Më qëllonej tue fjantaksur	VI	26
113.	I θoon	I thon	VI	26
114.	Γxymognon	Gjëmonjën- të vresht e largët	VI	26
115.	Ruagnyn	Ruanjën-këtë gjell cë nga ruanjën	VI	26
116.	Së xëloi	Së qëlloi- gjell edhe cë së qëlloi	VI	26
117.	Σegh	Sheh- si shuhet	VI	26
118.	Se çëghet	Si shuhet- Sheh si shuhet	VI	26
119.	Reçëtiet	Reshtjet -mbrëmanet i reshtjet shtrushf I trokashkave	VI	26
120.	Vette	Kurmi vete- tue m'u reshtur	VI	26
121.	λοθyniθ	Ljodhënith-gjumi mue më Ijodhënith	VI	26
122.	Sbarθi	Sbardhi- e më sbardhi udhëvet	VI	26
123.	Raa	Ra-bora ndë det	VI	26
Kënga 7				
124.	Rii	Ri at dit më ri me mall	VII	32
125.	E paan	E pan- nëng e pan	VII	30
126.	Doli	Doli- njer që doli	VII	30
127.	E ruan	Ruan- në të nisur e ruan	VII	30
128.	E mbieθ	Mbjeth- ndë cerkut je mbjeth ndë gj i	VII	30
129.	M'i bie	M'i bie ndë cerkut	VII	30
130.	Ghoλx	Holjq (heq)- pra cë e holjq	VII	30
131.	Reeçtyn	Resht- ajo e resht kryethit	VII	30
132.	vyn buçën mby gkaç	Ajo vë buzën mbë gaz	VII	30

133.	sçZonet	Zgjonet- mos zgjonet mëma	VII	30
134.	Trymbiet	-Por trëmbjet	VII	30
135.	Ruan	Ruan- e me ruan si nj'ill	VII	30
136.	E ζγεζγγη	E gjegjën-ajo e dëgjion	VII	30
137.	Gkyçoi	Gëzoi-dita e kaljthërëz	VII	28
138.	Zëçxonet	Zëgjionet- djali zëgjionet	VII	32
139.	Byri	Bëri- cë do ku bëri (sec bëri)	VII	30
140.	θot	Thot- mi thot	VII	30
141.		E uljën	VII	30
142.		Pret-ai e pret e më e uljen	VII	30
143.	Gapyn	Gapën-ajo gapën prehërin	VII	30
144.	I ruajin	I ruatin-të dashurit	VII	28
145.	Chemi	Kemi- ndë ktë jet cë kemi më?	VII	28
146.	Trintëligη	U trintëljinj-kitaren	VII	30
147.	Daλon	Dalën- kur dalën te dera ime	VII	30
148.	λottignyn	Ato të perveshura Ljotënjën	VII	30
149.	σuaniθ	Shuanith - ceren më i shuanith	VII	30
150.	Chemi	Kemi-më të mirën ëndërr	VII	30
151.	M'u mbilvtin	M'u mbillëtin-pra cë shpit m'u mbillëtin	VII	30
152.	Xel	Qell (sjell)-c'i qell (sjell) trimit vajzën	VII	30
153.		Ai e pret	VII	30
154.	Mu e uλyn	M'ë e uljën	VII	30
155.	Gapyn	Gapën ajo hapën prëhërin	VII	30
156.	pret	E pret-ai e pret tek dera	VII	30
Kënga 8				
157.	Pat	Ndë pat te diellën	VIII	34
158.	Di u	Di- u ndë pat të diellën	VIII	34
159.	Bynnet	Bënet-t'enjeten bënë e bardh	VIII	34
160.	Ruan	Ruan- e më ruan katund	VIII	34
161.	Priret	Priret- e më ruan katund	VIII	34
162.	Mer	Mer- vucën mer e vien te lumi	VIII	34
163.	E vien	Vucën mer e vien te lumi	VIII.	34

164.	Daλ	Kur u dalj te Shureza	VIII	34
165.	Ruan	Ruan- c' ill atë kopilje ruan?	VIII	34
166.	sbarθyn	Sbardhën- cë e sbardhën para sivet	VIII	34
167.	Caa	Ka -dita dielin ka	VIII	34
168.	My roθet	Më rodhët (dridhem)	VIII	34
169.	Σogh	Sa te shoh	VIII	34
170.	Bieniθ	Noerit më bienith (më ikën mendia)	VIII	34
171.	Rympeu	Si më rëmbëu	VIII	34
172.	U rit	Pra cë u rit	VIII	34
173.	shtija	Shtija gur e lastimisej	VIII	34
174.	lastimisej	Shtija gur e lastimisej	VIII	34
175.	Γconej	Shkonej- vaiza me- spurtek	VIII	34
176.	Ty my cioja	Të më coja mbrëmanet	VIII	34
177.	λuttia	U ljtja për hirin e mëmës	VIII	32
178.	Tundënej	Nd'era tundënej vadhet	VIII	32
179.	Monu frija	Sa monu frija-mezi merja frym	VIII	32
180.	Ngreghia	Kur ngreghja paidhet	VIII	32
181.	Gaiθi	Gajdhi - hijeshon	VIII	32
182.	Caa	Ka- atë e ka si llambadhe	VIII	32
183.	Xettet	Qetet- jeta e madhe që së qetet	VIII	32
184.	dreθ	Derdh- kur unë e dredh	VIII	32
185.	Parasten	Parasten- duketë në valle	VIII	32
186.	E garruam	E garruam- harruar vëllezërve	VIII	32
187.	Ngryiti	Ngrëjti deg ulliri shkundur	VIII	32
188.	Puçpgn	U pushonj ndë kët dimër	VIII	32
189.	λuttëgnyn	Ata lutin të korrat	VIII	32
190.	Paa	Pa një re	VIII	32
191.	Caan garee	Kan garee(vën veshin) te shtrushi ljumit	VIII	32
192.	Biu	Biu një re monosaqe	VIII	32
Kënga 9				
193.	Rughiet	Ruhjet - dhja se i goi ruhjet	XI	36

194.	σcundi	Shkundi- e më shkundi rezën	XI	36
195.	Υλι	Uli- kriethit	XI	36
196.	Pruar	U pruar-e uli kriethit	XI	36
197.	Fjëiti	Fjeti- trimi i helmuar	XI	36
198.	Paa	Pa- nd'ënder pa derën e saj	XI	36
199.	Paa	Pa- e më pa të dashurin	XI	36
200.	Zγjidhtiθ?	Zgjidhte- nganjë tufë rezë	XI	36
Kënga 10				
201.	Chynton	Kënton- e vihet e më kënton	X	42
202.	Vihet	Vihet-e më këton	X	42
203.	Fiuturognyn	Fluturonjën-ndallanishet	X	42
204.	Ruan	Ajo ruan deitin	X	42
205.	Të më Xepign	Të më qepinj linjzën	X	42
206.	T'ulet	Cë t'uiet ashtu mbë derën	X	42
207.	Vien	Vien- një dit	X	42
208.	θughet	E thuhet- nusia e trimit guaj	X	42
209.	λyy	Lijj- ajo liij katund	X	42
210.	θot	Thot- vec attire mos i thot	X	40
211.	θet	Thet- kujt të m'i thet?	X	40
212.	Duan	Ata duan	X	40
213.	Caa	Ka- vetëm ka t'emën e fan	X	40
214.	yçt	Është- është ajo i vashë e mjer	X	40
215.	lamparissyn	Por sa mbrenta lamparisën	X	40
216.	Garroi	E harroi shpizën	X	40
217.	Friin	Si një qeljqë cë mi frin	X	40
218.	θoi	Thoi - më thoi mali	X	40
219.	Ruajti	E ruati- mbë menat	X	40
220.	Dual	Dual- E ruati mbë menat	X	40
221.	Sbarθuluan	Sbardhëluan kumbulat	X	40
222.	Shchepëtin	Shkepëtin -nëntë diej	X	40
223.	Rii	Ri- si s'ri me ne?	Vjershë e të bijës së Kallogres	44
224.	Deλ	S'del me nder	Vjershë e të bijës	44

Kënga 11				
225.	Caan	Kan- besën e kan mbi veten	XI	36
226.	So çoghyn	S'shohin- nga zoti unë s'shohin mirë	XI	36
227.	Tir	Tjer- tir mbë shpi	XI	36
228.	Erθ	S'erdh me to	XI	36
229.	U gapëtin	U hapën- plot pare u hapën	XI	36
230.	Vatte	Vate-pranë m'i vate nd' ëndër	XI	36
231.	Vinej	Vinej-më së vinej kroiri	XI	36
232.	Potissyn	Potisën- kroiri të m'e potisën	XI	36
233.	Ngryiti	Ngrejti- ajo ngrejti sit	XI	36
234.	Vyi	Vej- e m'e vej ndë prehërit	XI	36
235.	Ghipënej	Hipënej- trimi hipënej (paska hypur) kalit	XI	34
236.	Mbaghej	Mbahej- me gjitonjet	IX	34
237.	Yndërrri	Ëndëri - ëndër e lig c'ëndëri trimi	IX	34
238.	λeghen	Ljehen- djalë	X	42
239.	Deλ	Del- del kopilja për tu martuar	X	42
240.	Vy	Ë (është)- mali trimavet	X	42
241.	Stisin	Ndërtojnë	X	42
242.		Fjantaksënith-kurmin tim	X	42
243.	Uλyn	E më uljën kriethit	X	42
244.	Garron	harron- zotin e saj	X	42
245.		Duhëshim- në atë mot cë duhëshin	X	42
246.	θoja	I thoja- m'i thoja vetë	X	42
247.	Ë	Është- atie s'është kopshti it	Vjershë e të bijës së Kallogres	44
248.	Chee	Ke- s'ke ti shpi ?	Vjershë e të bijës së Kallogres	44
249.	Chee	Ke-s'e ke të foljit an	Vjershë e të bijës së Kallogres	44
250.	Byre	Bëre-se njeriu s'i' bëre	XII	44

		keq		
251.		Heljmove kopiljet	XII	44
252.	Usse	Së dëmtove të nëmurën	XII	44
253.	Shprishën	Shprishen- ljetëve cë nëng shprishen	XII	44
254.	θunoja	Dhunoja- sa edhe të të dhunoja	XII	44
255.	Panteça	Pantehja- aq i mjei s'u pandehja	XII	44
256.	Ruaj	Mos më ruaj ndë legiet	XII	44
257.	Pyrpix	U përpiq-udhëvet mos m'u përpiq	XII	44
258.	Do	Do -trim ti mua ndë më do më ?	XII	44
259.	Ciova	E cova në Karqiollon	XII	44
260.	θoin	Thoin - mose lijinj thonj(veç për të linjtat flasin)	XII	44
261.	mbjiθvoin	Mbjlidheshin- më t' errëtit	XII	44
262.	Mbaghej	Mbahej- kopilja mbahej mose me gjitonet	XII	44
263.	Zilëpsoniθ	Zilepsënth-cë i biri i zonjës	XII	44
264.	0oin	Thoin(flasin) vashën e nëmur	XII	44
265.	Veen	Ven- ashtu gratë ndo ven mbë krua	XII	42
266.	Ruan	Ruan- nëng ruan më për anien?	XII	42
Kënga 13				
267.	Do	Të do- ai Zot më të do mir	XIII	48
268.	luttyñ	Ljutën- sa një katund ljutën për ty	XIII	48
269.		Të veshi- djepi të veshi me ar	XIII	48
270.	Bucuroi	Bukuroi- djalërin të bukuroi	XIII	48
271.	Jemi	Cë nder njerëzit na jemi?	XIII	48
272.	Je	Je trim i pasurith	XIII	48
273.	Gnighien	Njihjen- gjith gjërit të mbjedhura njihjen plot	XIII	48

		hare		
274.	Ruagnyn	Ruanjën- zonjat me djali mbë dorë ruanjën	XIII	48
275.	Driθiet	Valles çë dridhet	XIII	48
276.	Fanarosset	Nusja së fanaroset	XIII	46
277.	Buartim	Lirisë çë buartim	XIII	46
278.	Siελvς	Siellësh- ti një ushtri fanëmir	XIII	46
279.	Vëghem	U më vëhem të pështieri	XIII	46
280.	λεeson	Gjumin e njerëzve ljeson	XIII	46
281.	Tunden	Er e lehët çë tundën fietat	XIII	46
282.	garepsyn	Më garepsënzemërën	XIII	46
283.	Cam	Cë kam te dera	XIII	46
284.	Bier	Dritën nëng bjer tek udh e tij	XIII	46
285.	Ke të na λyyς	Pra cë Zot ke të na ljësh		
286.	Këputti	M'i këputi gjumëthin	XIV	52
287.	Ngriti	Cë mi ngriti cerkëthin	XIV	52
288.	U ngre	Porse u ngre vore i ftohtë	XIV	52
289.	Sbardhen	Sbardhën të këputurith	XIV	50
290.	Tundet	Si një fiutur çë tundet	XIV	50
291.	Paa	Larg e pa	XIV	50
292.	Ruati	Prapa e ruati	XIV	50
293.	Zyyn	Ndë një spart ajo e zën	XIV	50
294.	Vatte	Vate trimi i nisurith	XIV	50
295.	E gapi	Poshtë rehjet e hapi	XIV	50
296.	Σcundi	Shkundi borën e fushavet	XIV	50
297.	Njotta	Porsi njota (ja befti)nj' er e keqe	XIV	50
298.	I vej buza në gaz	Vashës i vej buza në gaz	XIV	50
299.	Të nkuqëtin	Duart si më të nkuqëtin	XIV	50
300.	Pikullojin	Shqëntet (rrobat) i pikulojin	XIV	50
301.	In	Fushat mban ishin pjot bar	XIV	50
302.	Dιλ	Cë m'i dil tek udha	XIV	50
303.	Duch	Trimi nd'ëndërr më ju duk	XIV	50
304.	Xyloi	Atie e qëlloi gjumi	XIV	50
305.	U porsiljis	Tek i pesti u porsiljis (ndejt)	XIV	50

306.	Shkararti	Cë shkararti (shkundi) pes ullinj	XIV	50
307.	Xianej	Mbjidh ullinj e qanej	XIV	50
308.	Mbjidh	Mbjidh ullinj	XIV	50
309.	Vatte	E më vate nga ullinjte	XIV	50
310.	Mori	Mori teel e trastien	XIV	50
311.	θa	Tha me vetehen	XIV	50
312.	U pruar	U pruar tek shpia e sai	XIV	50
313.	Vatte	Vate- tha me veten	XIV	50
314.	I gjegjen	Çë të foljet i dëgjojnë	XIV	50
315.	Shkonj	Më të shkonj (në do të) kësaj udh	XIV	48
316.	Di	Di u ndë trimi i gardhjar më të shkonj (në do të) kësaj udh	XIV	48
317.	Fjit	Vetëm flit te buz' e udhës	XIV	48
318.	Shkonej	Mos njeri shkonej atie	XIV	48
319.	Shtufrinej	Ja e shtëfrinej mu revet	XIV	48
320.	Ngronej	Nj' erë ngrënej pluhurin	XIV	48
321.	Rij	Dual ka rij i biri i zotit	XIV	48
322.	Dual	Dual ka rij i biri i zotit	XIV	48
323.	Vuu	Vu shpejt të veshurat	XIV	48
324.	U pataX	M'u pataks micoria	XIV	48
325.	Raa	Pra çë dielli raa tek shtrati	XIV	48
Kënga 15				
326.	Θa	Pas vëdekur- tha-na romi	XV	56
327.	Romi	Pas vëdekur- tha-na romi	XV	56
328.	Ron	Rron për tej	XV	56
329.	Ikku	Si ajo ç' iku	XV	56
330.	Gnogu	Trimi njohu skemantilj	XV	56
331.	Lutte	Ljutu shenjt e shën Mëri	XV	56
332.	U mbitte	Se nëng u mbite	XV	56
333.	Veç	Kur të vesh te zalli i huaj	XV	56
334.	Do	Ndë do gjë	XV	56
335.	θuam	Thuam ndë gjë	XV	56
336.	Vette	Nd'at dhe cë vete vet	XV	56
337.	Puθi	Trimi e puthi	XV	56
338.	Ru	Çë ja e ru (arriti) trimi	XV	56
339.		Mblidhej- për natën e fundit	x.v	56
340.	Byri	Çë bëri nana	XV	54

341.	Vuu	Vu paljacat (mbulesat)	XV	54
342.	Ndajti	Nëng ai ndajti Kallabri	XV	54
343.	Bëri	Zoti çë m'i bëri	XV	54
344.	ziljepsën	Trimi ziljepsën (e do)	XV	54
345.	Pyçtoi	Ka golja të përshtoi	XV	54
346.	Ndyrrogyn	Jetën s'ëndërrojën	XV	54
347.	Duhjen	Di kopilj cë duhjen	XV	54
348.	Doli	Dielli i doli ka mali	XV	54
349.	Ronjën	Njerëzit ronjën	XV	54
350.	Ertha	Erdha të të ljevrosinj(të ngushëlloj)	XV	54
351.	Dola	Dejt në mes cë dola	XV	54
352.	Fjë	Dheut të errët tek ti fjë	XV	54
353.	Shohën	Sa gare cë të na shohën	XV	54
354.	Rije	Tek ti rije	XV	54
355.	θon	Si ia thon këtij katundi	XV	54
356.	Doli	Më doli veshur i bardhë	XV	54
357.		Fjëjta natën	XV	54
358.	Arrura	Tek arrita	XV	54
359.	Parcalessa	Udhës ashtu parkaljesja	XV	54
360.	Ndë dughien	Se duhen	XV	54
361.	Jaan	Jan ftes (në faj)	XV	54
362.	Σoghën	Ata së shohën	XV	52
363.	Calbiet	Çë kaljbiet te bota	XV	52
364.	Ë	S'ë për njerin	XV	52
365.	ocogn	Më së shkonj asaj udh	XV	52
366.	Trinitvlin	Ndo m'i trintëllin vegja	XV	52
367.	Fiervn	Ndo tjerr ndë der	XV	52
368.	Frihjen	Çë me buk së frihjen	XV	52
369.	Arθur chiçia	Ardhur kishja me uratën	XV	52
370.	U nissa	Por u nisa	XV	52
371.	Priita	Çë së prita (pse nuk)	XV	52
372.	θoon	Gjith të thon	XV	52
373.	Deλ	E ti del për ndë katund	XV	52
374.	Dighet	Dihet e djell	XV	52
375.	Parcalesa	Udhës ime parkajesa (lutesha)	XV	52
Kënga 16				
376.	Ngrin	Më ngrin eshtrat	XVI	58
377.	Fjissin	E m'i flisnin sizit	XVI	58
378.	çpriçej	E m'i shprishej shtekëthi	XVI	58
379.	Pririej	Frihej gjiri e	XVI	58

		prirej(rrotullohej)		
380.	Grighej	Frihej gjiri	XVI	58
381.	Στρουçulonej	Shtrushullonej cohëza	XVI	58
382.	Ljuanej	Luanej millordeza (vasha)	XVI	58
383.	Garepsë(V)n	Garepsën (gëzon)dita me diell	XVI	58
384.	Pee	Mos ti pe ?	XVI	58
385.	U tund	Dushku u tund	XVI	58
386.	λεva	Kur leva të parën	XVI	58
387.	U leve	Ti s'u leve ndë dhe të huaj	XVI	58
388.	Caa	I ka hije	XVI	56
389.	Zë(v)çxon	Se më zëgjon	XVI	56
390.	Më reçti	Më reshti gjumëthin	XVI	56
391.	Μυλvi	Më muljvi(përkëdheli) cerjen	XVI	56
392.	Gapi	Gapi derien	XVI	56
393.	Friti	Friti ka deiti	XVI	56
394.	Νδρεçi	Ajri që ndreqi motn	XVI	56
Kënga 17				
395.	Se κπλton	Se kuljton trimat	XVII	60
396.	Pa taxet	E patakset	XVII	60
397.	Σεgh	Sheh pasqirën	XVII	60
398.	Zεgh	Sheh të jëmën	XVII	60
399.	Chëputtyn	M'i këputën gjumëthin	XVII	60
400.	Gapjet	Drita çë m'i gapjet	XVII	60
401.	Dighet	Çë i dihet me gadhi	XVII	60
402.		Shkepëtin (shndrit) vasha	XVII	60
403.	Gagnë(v)nyçit	Udhëvet ganjuzit (ndjekin)	XVII	60
404.	Veen	Ven me urë ndë dorë	XVII	60
405.	Jaan	Janë plot ziarre	XVII	60
406.	Deλ	Del te porta	XVII	60
407.	Ulet	Ulet, ngrëhet ,del te porta	XVII	60
408.	Ngrøhet	Ulet, ngrëhet ,del te porta	XVII	60
409.	Mbjiθet	Mblidhet ndërtë motërat	XVII	60
410.	I laftarissyn	Zemëra vashës i llaftarisën	XVII	60
411.	Vien	Që ka vien nesërith	XVII	58
412.	Yy	Ë (është)hare të birit të Zotit	XVII	58

413.	Yy	Cë këjo gare	XVII	58
414.	Σεgh	E më sheh shumë gare	XVII	58
415.	Σcon	Shkon vasha	XVII	58
416.	Λαçgnyn	E vashat që ljanjën	XVII	58
417.	Σogh	Shoh hjillon (bregun)	XVII	58
418.	Σogh	Dje menat unë ju shoh	XVII	58
419.	U mbioθ	Çë duall e nëng u mbjoth	XVIII	64
420.	Dua'li	Çë duall e nëng u mbjoth	XVIII	64
421.	Shqirjet	Pyjeve mërrëshqiset	XVIII	62
422.	Cu λtoogn	Mos kuljtonj të bardhën ëm	XVIII	62
423.	λee	Lje të fjër	XVIII	62
424.	Xyloi	Djalit i qëlloi gjumi	XVIII	62
425.	λyreu	Ljëreu (lëshoi) fërshëllimën	XVIII	62
426.	Uλ	E m'u ulj	XVIII	62
427.	Gapi	Gapi krahët	XVIII	62
428.	Fyrnoi	Cë fërnoi (frenoi)tagjisuri	XVIII	62
429.	taçaxissyn	M'ë tagjisën (më ushqeu)	XVIII	62
430.	Vuu	E m'u vu	XVIII	62
431.	Iç	Cë ish tek shtrati	XVIII	62
432.	Raa	Ra te krei i djalit	XVIII	62
433.	çcoi	Shkoi qeramidhet	XVIII	62
434.	λω(v)çua	Kur thëllëza m'u lëshua	XVIII	62
435.	lin të fritura	Fryjnë	XVIII	62
436.	lufton	Cë ljufton vëdekja	XVIII	62
437.	lin	S' iin të trimave	XVIII	62
438.	Iça	Isha ndë vallet	Vjershë e të bijës së Kallogres	60
439.	Llampar (ndrin) një her	Shkëlqen	Vjershë e të bijës së 514. Kallogres	60
440.	Përpiqet	ndë të takohet një herë	Vjershë e të bijës së Kallogres	60
441.	M'u skotis	M'u errësua ronia (jeta)	Vjershë e të bijës së Kallogres	60
442.	Σtare	Më shtrure sytë	Vjershë e të bijës së Kallogres	60

443.	Arruer	I ndërruam erdhe	Vjershë e të bijës së Kallogres	60
444.	Pruari	Të përlyotëm kthehu sit	XIX	68
445.	Mbaiti	U përmbajt	XIX	68
446.	Vejim	Vejim afër	XIX	68
447.	Ecim	Ecim afër	XIX	68
448.	Shkojmë	Shkojmë afër	XIX	68
449.	Pririem	Kur të pririem ndër të huaj	XIX	68
450.	Rii	Nëng ri i vetëmith	XIX	68
451.	Ulet	Tek ulet mbrëmanet	XIX	68
452.	Ron	Sa ka dieli që ron	XIX	66
453.	Fanarosset	Vasha tani më së fanaroset	XIX	66
454.	Vije	Së munt vije prëëm	XIX	66
455.	Fivite	E sonte fëjte mbi truall	XIX	66
456.	Mbjidh	Mbjith dhe di parkalidhe	XIX	66
457.	θa	Tha mëma	XIX	66
458.	Dyrgkoimi	Me kë dërgojmi bukën	XIX	66
459.	Paam	S'ë patëm me kë dërgojmi bukën	XIX	66
460.	erdha	Nji s'erdha të tjera herë	XIX	66
461.	Vije	Se ti vije somenat	XIX	66
462.	Pyproça	Ju përpoqa ndër vrielet	XIX	66
463.	Njoga	Njoha shtatin	XIX	66
464.	Njoga	Njoha te udh' e katundit	XIX	66
465.	lin	Ç'in të njom	XIX	66
466.	Doła	Dola posht sheshevet	XIX	66
467.	Zuu	Mua më zu malli	XIX	66
468.	U kin gapur	Delet tona u kishin gapur (ishin hapur)	XIX	66
469.	Zvççova	Kur të katërtën u zëgjova	XIX	66
470.	Culottynej	Ndonjë ka ati, këtu kullotënej	XIX	66
471.	Raar	Hëna rar	XIX	66
472.	m'u patakxa	Për së treti u m'u patakxa	XIX	64
473.		Mbi det dhezënej (ndizej)	XIX	64
474.	Mbuzati	Ka mbuzati hënëza	XIX	64
475.	Chvputtvjin	Gjumi më këputëjin	XIX	64
476.	Rumpularyçin	Delet rrupullarëshin	XIX	64

		(zhurmonin)		
477.	Fiivitin	Fjëjtin të mi vëllezër	XIX	64
478.	Rija	Rija si te dheu i huaj	XIX	64
479.	Kiçv garruar	Ushtrit kishë harruar	XIX	64
480.	Vinej	Kur vinej tatëmadhi	XIX	64
481.	Ngrogu	Ngrohu qumështin	XIX	64
482.	Vaita	Vajta t'imë vëllezër	XIX	64
483.	laan	Më lan të veshurat	XX	70
484.	Ruan	Ruan ti më ruan kasollen	XX	70
485.	Jaan të na martognyn	Priftëra janë të na martonjën	XX	70
486.	S'θughiet	Skutari më s'thuhet qytet	XX	70
487.	yy	Si bushtra ë, jot kunat	XX	70
488.	lam	Nëng jam u zonj e madhe	XX	70
489.	Zvcxova	Kur të katërtën u zëgjova	XIX	66
490.	Pe	Bardhullore un e pashë	XX	70
491.	Σολariet	Jeta së sholarjet (shkallëmohet)	XX	70
492.	θot	ill që thot	XX	68
493.	Oreksvn	Ill që zemërat oreksën (ngroh)	XX	68
494.	Zighet	S' më shihet plot habi	XX	68
495.	Proseksa	Më proseksa (diktova) vashëzën	XX	68
496.	Pyρipiçej	Përpiqej mb'udh	XX	68
497.	Si lej	Si lej e përpiqej mb'udh	XX	68
498.	λeghvmistin	Ljehëmistin (lehin) frushkuljet	XX	68
499.	Kin	Kin ullinjët	XX	68
500.	Ljën	Lënë njeriu	XX	68
501.	U roθ	Kur u rodh (ia dha) një shkundullim .	XX	68

Sikurse vihet re folja *ruaj* në mënyrën lidhore tek De Rada shfaqet me një temë tërësisht të ndryshme nga ajo e sotmja. Pavarësisht nga kjo, tema e foljes mbaron me zanore dhe merr mbaresa në tri vetat e para, kështu që sipas klasifikimit të sotëm ajo mund të shihet në grupin e foljeve të zgjedhimit të parë.

Nga ana tjetër, mbaresat që merr në të tashmen e dëftores ndryshojnë në një pjesë të tyre nga ato të sotmet. E kemi fjalën për vetën e parë dhe të tretë njëjës e cila del me –*n*.

Veta e dytë njëjës dhe shumës, shfaqet e njëjtë me formën e sotme. Duhet sqaruar se pavarësisht se në pamje të parë mbaresa është e njëjtë, në fakt këto dy veta dallohen nga ndryshimet në teme, pasi në vetën e tretë njëjës shfaqet një zanore e –*o*- e dyfishuar, që sipas nesh përfaqëson një zanore të gjatë.

Mbaresat e shumës të vetës së parë dhe të tretë gjithashtu dalin në variantin –*mi* dhe –*nën*, të cilat sipas nesh nuk janë shumë larg varianteve të sotme dhe mund të shpjegohen ndryshimet fonetike që vihen re me anë të rregullave të Fonetikës historike.

Të njëjtat vërejtje mund të themi dhe për foljen *rrëmpej*, e cila del si folje e zgjedhimit të parë

Në temë shfaqet me një bashkëtingëllore të pazëshme –*p*- e ndryshme nga forma e temës së sotme: *rrëmbe*.

E pakryera

E pakryera për të dy foljet shfaqet krejtësisht e ngjashme në mbaresa me format e sotme. Ndryshime hasen vetëm në vetën e tretë e cila del me –*j* dhe jo me –*jë*.

Në fakt ky nuk është markimi i vetëm, pasi në këtë vetë tema del me zanore të gjatë.

Koha e shkuar

Të keem, të keesh etj viuar –të kem ruajtur

Të keem, etj rrëmpier –të kem marrë

Numri i formave të kohëve të përbëra është mjaft i reduktuar. Mënyra e ndërtimit të kohës së kryer tësaj është e njëjtë me format e sotme, pra folja ndihmëse në këtë rast *kam* (shfaqet më të njëjtin ndryshim fonetik me të cilin e gjejmë dhe sot *a-e*), dhe pjesoret përkatëse që nuk shfaqin ndryshime.

E veçanta qëndron në tipare fonetike arkaike të tilla si : dyfishimi i zanores - *e*- në variantin e një zanoreje të gjatë dhe tema e pjesores *rrëmpej* e cila nuk shfaq zanoren -*y* si sot, por zanoren-*i*-.

Në poemë gjejmë këtë korpus foljesh në kohën e tashme të lidhore: *të kumandonj, të luajin, të ljëren, të friign, të arrësh(arrish), të vish, të vinj, të psovisënjën, të fitij, të hinj, të kultoneni, të pushonj, të ecinj, të ikënjën, të njog, të reshtëjën, të këpuunj, të dal, të rie, të kultonj, të shoh,*

Zgjedhimi i parë: të pusho-nj, ta kumando-nj, të na kulto-nj të lua-jin, të hi-nj, të fi-j të rua-njën

Vihet re përdorimi i temës së foljeve të zgjedhimit të parë, të cilat këtu shfaqen me formën më të vjetër ndajshesore me -nj- (të mos ndanjemi, të kujtonj etj shih më lart), e cila nuk shoqërohet me një *ë*, që i prapavitet formës së sotme (sot të komandojë, kurse në vepër: ta kumando-nj)

Mbaresa e vetës së tretë shumës të së tashmes lidhore, veprare del në formën *-in* dhe jo *j-në* si sot (kënga 3: të luajin përdorëz).

Zgjedhimi i dytë

Veta e parë (njëjës)---, Veta e dytë të vish, të njog,

Veta e tretë; gap-inj, të ec-inj, të përtroll-ën, ljevros-inj, të pështier-i, të psovis-ënjën, të resht-in, të rittien.

Nga foljet e zgjedhimit të dytë më së shumti del veta e tretë njëjës dhe shumë. Pak raste ka me vetën e dytë njëjës (*të vish*).

Mbaresa e vetës së dytë është zero, pra njësoj si sot.

Në vetën e tretë njëjës shfaqet mbaresa *-ën*, kurse për shumësin del *-inj*.

Zgjedhim i tretë

Veta e dytë; të di-*sh*, të lë-*sh*

Veta e tretë të ljer-*en*

Në zgjedhimin e tretë dalin dy forma, ajo e vetës së dytë njëjës, e cila del me mbaresën *-sh, të dish*.

Veta e tretë shumës shfaqet me mbaresën-*en*.

Strukturat në të cilat gjenden këto forma zakonisht janë të projektuara në gojën e personazhit kryesor që është dhe rrëfimtari i fabulës.

Natyrisht është i pashmangshëm përdorimi dialektor toskë në të cilin zanorja *y* mungon (ndikim i greqishtes *ky*), pavarësisht se transkriptimet e mëvonshme e mënjanojnë këtë fakt (Vini re: Të hiinj erë e detit; kënga 22) .

Foljet e zgjedhimit të tretë në veprare dalin pa *-j-në*, e cila sot del mes zanores së të temës dhe zanores së të mbaresës (bëhet fjalë për vetën e tretë të së tashmes lidhore, veprare që këtu e kemi: *të na rie*; kënga 28).

Ka raste kur folje gjysmë të çrregullta nuk dalin me ndryshimet fonetike që kanë shfaqur në shqipen e sotme, përkatësisht *-o-* nuk del e hapur në *-ua-* (si te rasti i këngës 25 :Doin të nareshhtëjën).

Natyrisht ka ndikime dhe nga temat e italishtes (si te rasti këngës 25:zonja dëshironj të kumandonj).

Kemi rënie të ë parafundore dhe asaj fundore (kënga 30 :të më shohsh; kënga 25 të më dal).

Mënyra lidhore, forma joveprore:

Foljet e përdorura:

Të nisset, të përmissiet, të vëhëej, vëhem, të bihen të më ulënej, të pririem, të kultoneni, të garaksënej, të reshtemi, të mos ndaghem, të nis-et

Format e foljeve në joveprore dalin me një temë më të zgjeruar se sot (kënga 6 :të më ulënej but).

Strukturat në të cilat përdoren këto forma, nuk kanë shmangie sintaksore nga përdorimet e sotme. Ato zakonisht janë folje, që shprehin modalitet, por me të njëjtat nuanca modale si sot.

Vihet re përdorimi në strukturë me foljen *vë* që këtu sillet si folje kauzative dhe realizon disa struktura të tilla (kënga 7; të më vëhej ture tjerr; kënga 13 :u më vihem të pështjeri etj).

Vetëm në ndonjë rast të veçantë kemi shfaqje të kohës së pakryer të mënyrës lidhore psh: *Të garroja kronjet e mbjella. Sa edhe të të dhunoja. Kënga XX*

Kohët e përbëra nuk shfaqen.

Duhet të shtojmë se lidhorja në strukturë me folje të tjera si ato modale, apo dhe të tjera shpreh edhe modalitetin e urdhërores;

Shën Mëri mos na lësh.(lidhore-dëshirore)¹²⁰. Edhe në shkrimet e autorëve të vjetër dhe në përdorime të veçanta në gjuhën e sotme, dëshmohet se sa herë fjala modale (e ndryshme nga *të*) përforcon a plotëson kuptimin modal përkatës të formës lidhore, pjesëza të nuk është shfaqur. Edhe në rastin tonë nuk përdoret pjesëza *të* , pasi modaliteti i dyshimit është përforcuar nga pjesëza modale e dyshimit *mos*.

Këto uudh ti të më *ruash*(Këng XV).

122. Shih E. Likaj “Format analitike në gjuhën shqipe”Tiranë 1999, f. 100.

II.8. KORPUSI I FOLJEVE TË MËNYRËS LIDHORE

Tabela II.18

Nr. rendor	Folja e perdorur nga De Rada	Folja e transkriptuar	Kënga	Nr. i faqes
Kënga 2				
502.	Të duash	Të duash- Sa të duash ti, birë zoti		18
Kënga 3				
503.	Nisset	Të niset- Ka të niset e magjepsur?	III	20
504.	Ti puçoogn	T'i pushonj- C'ë te kragu t'i pushonj	III	20
505.	Të luajin	Të Ijuajin-përdorez	III	20
Kënga 5				
506.	Të pyrmissiet	Të përmisjet- jeta e të përmisjet	V	24
Kënga 6				
507.	Të (v)garroja	Të harroja-kronjet e të mbiellat	VI	26
508.	Të Ijëren	Të Ijëren-këntimthin	VI	26
509.	Ty vë(v)hej	Të vëhej- ture tjerr	VI	26
510.	Të m' ulënej	Të m'uljënej- but shtran të m'uljënej	VI	26
Kënga 8				
511.	Ty friign	Të frinj- së di të frinj	VIII	34
Kënga 11				
512.	Potissyn	Potisën- kroin të m'e potisën	XI	36
513.	Të m'arrësh	Të më arrish-nd' atë katund cë sonte të më arrish	Vjershë e të bijës së Kallogres	44
514.	Jeem	Mos më bën të jem u ftes	XII	44
515.	Bën	Mos më bën të jem u ftes	XII	44
516.	θunoja	Dhunoja- sa edhe të të dhunoja	XII	44
Kënga 13				
517.	Të vish	Nën të huajt cë të vish	XIII	48
518.	Të gapinj	Të na happen këto rehje (brigje)	XIII	46
519.	Të rittien	Tim bilj të rris	XIII	46

520.	Vëghem	U më vëhem të pështieri (vihem te tjerr)	XIII	46
521.	Të pështieri	U më vëhem të pështieri	XIII	46
522.	Viç	Të na vish si ka jashti	XIII	46
Kënga 15				
523.	Lut	Lut të vinj përroin	XV	56
524.	Të ljevrosinj	Erdha të të ljevrosinj (të ngushëlloj)	XV	54
525.	Erθa	Erdha të të ljevrosinj(të ngushëlloj)	XV	54
526.	Psovisë(v)gnyn	Ljopt të provisënjën (pëlcasën)	XV	52
527.	Bighen	Arat të bihen shëndoshen	XV	52
528.	Ruaç	Këtë udhë ti të më ruash	XV	52
Kënga 17				
529.	Përpiqet	Përpiqet - ndë të përpiqet një herë	Vjershë e të bijës së Kallogres	60
530.	Diiç	Si të huaj ti të më dish	XIX	68
531.	Prieriem	Kur të prijem ndër të huaj	XIX	68
532.	erdha	Nji s'erdha të tjera herë	XIX	66
533.	Panteghia	S'mund të pandehja	XIX	66
534.	Mos na Avσ (lësh)	Shën Mëri mos të na lësh		
535.	Tv mv ghiign (hinj)	Pasi të hyj në shtëpi		
Kënga 22				
536.	sv dua tv fiyy	S'dua të fle		
537.	ty ghiign erë e detit	Të hyj erë e detit		
538.	të më ftoghign	Të më ftohinj		
539.	Ditët e mia te mira mbi dhe të cuAtoneni	Të kujtoheni		
Kënga 23				

540.	Si një re që së dii që të puçoogn (pushonj)	Që nuk di të pushonj	F.. 78	
Kënga 24				
541.	Tv garaxvnej (garaksënej)	Sapo agonte përmbi det më liraje shtratin		
542.	Te ruagnyn(ruanjën)	Lumbardhat të vështrojnë nga qeramidhet.		
543.	T'ezzign (ecinj)	S'është njeri të eci nëpër shtëpi		
544.	T'icehvgnyn të ikënej)	Deri sa të ikte këto ditë		
545.	Ty ghiign (hinj)	Të hyjë ndër yje		
546.	Ty me gnog (njog)	Të të njohë		

MËNYRA URDHËRORE

Kjo mënyrë shfaqet në poemë me format e saj në vetën e dytë njëjës dhe shumës në një pjesë rastesh. Duhet thënë se, nëse bëjmë një krahasim me mënyrat e tjera, mund të shohim se sa më shumë modalitet që të shprehë një mënyrë e caktuar, aq më pak forma shfaq ajo.

Nga shembujt që kemi vjelë vihet re një numër të madh nuancash modale të shprehura nga urdhërorja klasike, të cilat përfaqësohen vetëm nga dy forma.

Ky ka qenë koncepti tradicional mbi urdhëroren, por në fakt studimet moderne tregojnë se këto kuptime dalin në struktura dhe modele specifike. Një gjë e tillë është vënë në dukje si nga studimet gjenerative, ashtu dhe nga ato deskriptive.

Nga vëzhgimet (duke u mbështetur te përkufizimi i Gramatikës I) mund të vëmë re se modaliteti i urdhërores shfaqet mjaft i larmishëm, madje në disa raste mund të flitet për nuanca të kundërta që tradicionalisht shprehen nga e njëjta formë, për këtë arsye duhet të ishin theksuar projektimet specifike të shoqëruara nga modelet stereotipe, në të cilat shfaqet një nuancë, apo një tjetër.

Dihet në parim se urdhërorja projektohet zakonisht në kontekste situatave specifike, të cilat përgjithësisht janë dialogët, ku dhënësi dhe marrësi janë të pranishëm.

Në veprën e De Radës mënyra urdhërore dhe format përkatëse të saj dalin në rrafshet specifike, jo vetëm në lidhje me elemente dialektore të arbërishtes kështu por në rrafshin semantik ajo na shfaqet me struktura jo thjesht të urdhërores së fortë.

Në veprën e marrë për analizë, format e urdhërores përbëjnë numrin relativisht të vogël në krahasim me format e mënyrave të tjera foljore (gjithsej 42 përdorime).

Në fakt kjo është e kuptueshme, po të kemi parasysh makrostrukturën e veprës, e cila përgjithësisht karakterizohet nga ligjërata e zhdrejtë, dhe përkatësisht një stil tregimtar përshkrues.

Përshkrimi i ngjarjeve nga narratori eksplisit (personazhet më pak dhe autori më shumë) ose në vetën e parë, ose të tretë, në shumë pak raste jepet në formën e dialogëve, në të cilat ngjarja mund të shprehej dhe më lirshëm.

Në formën e urdhërores klasike dalin folje të tilla si: *jap* (*më jep, jepmë*), *qëndroj* (*qëndro*), *them* (*thuam, thomnie*), *hap* (*gapnie*), *marr* (*mir*), *puth* (*puthëm*), *ec*, *zgjoj* (*zëgjou*), *ngre* (*via*), *duroj* (*duro*), *ruaj* (*ruana, ruaj, më ruani*), *shtie* (*shtier*), *lus* (*ljut*), *ha* (*ga*), *mbledh* (*mbjith*), *mbyll* (*mos mbullij*), *rri* (*ri, mos rii*), *përpyjek* (*mos*

m'u përpiq), *běj* (*mos më bën, mos t'i bën*), *mbaj* (*mba tutje*), *duroj*, (*duro*), *qaj* (*mos më qai*), *hap* (*gapni ju*), *mbledh* (*mbjidh*), *lë* (*mos na lësh*).

Nuanca modale më e zakonshme e shprehur nëpërmjet këtyre rasteve në strukturë, del nuanca e lutjes deri në dëshirim dhe asnjëherë urdhërorja e fortë.

Përgjithsisht përdoret veta e dytë njëjës në formën veprorë.

Natyrisht që e vendosur në skenën ku gjenden zakonisht këto forma të urdhërores përdorime të tilla janë shumë të përshtatshme (kemi parasysh dialogët mes të dashuruarve).

Formalisht më tepër del forma pohore dhe më rrallë ajo mohore dhe në një pjesë të mirë rastesh shoqërohet me trajtat e shkurtra përkatëse.

Përgjithësisht ruhen format foljore të shqipes së sotme me ndonjë ndryshim fonetik, si rasti i përdorimit të mbylltores *g* në vend të aspirantes *h* te folja *hap-gapnie*, apo në vend të ndryshimit fonetik *a-e* del *a-i*, marr-mir. Po kështu edhe *thomnie*. Lut të vij përroit.

Në disa raste trajta e shkurtër shfaqet e përmbysur, si në rastin e foljes *puth* që del në formën *puthëm* në vend të *puthmë* që e gjejmë në shqipen e sotme.

Përveçse në fund të temës, trajta e shkurtër shfaqet dhe në trup të saj, pozicionim i njohur ky edhe në gjuhën shqipe. Një rast i tillë shfaqet te folja *them*, përkatësisht *thomnie*.

Vetëm në një rast një folje del në variantin italisht përkatësisht *ngre/via*.

Duhet të shtojmë se modalitetin e urdhërores e gjejmë dhe te mënyrat e tjera si lidhorja në strukturë me folje të tjera si ato modale, apo dhe të tjera (lutje, përgjërim etj.)¹²¹.

Gjithë të thonë *ti ruana*(*këng XV*)

*Shën Mëri mos na lësh. lidhore-dëshirore*¹²²

Këto uudh ti të më *ruash*(*Këng XV*)

Edhe në shembujt e mësipërm mund të vihet re se ato janë të inkuadruar në kuadrin e ligjërimi fetar, ku forma “urdhërore” ka marrë nuancat e lutjes.

¹²¹ Në studimet tona teorike tradicionale vihet re mungesa e studimeve në rrafsh semantik, si për foljen ashtu dhe për pjesët e tjera të ligjëratës. Një gjë e tillë mund të konstatohet dhe te modaliteti, i cili nuk ka përfshirë gjithë strukturat në përdorim me nuance të tilla.

¹²² Edhe në shkrimet e autorëve të vjetër dhe në përdorime të veçanta në gjuhën e sotme, dëshmohet se sa herë fjala modale (e ndryshme nga të) përforcon a plotëson kuptimin modal përkatës të formës lidhore, pjesëza të nuk është shfaqur. Edhe në rastin tonë nuk përdoret pjesëza të , pasi modalitetin e dyshimit është përforcuar nga pjesëza modale e dyshimit *mos*.

Shih E. Likaj “Format analitike në gjuhën shqipe” ShBLU, Tiranë 1999, f. 100.

MËNYRA DËSHIRORE

Dëshirorja në gjuhën shqipe shfaqet si një modalitet që markon tradicionalisht me element specifike të një mënyre që mban të njëjtin emër (mënyra dëshirore).

Numri i kohëve që ajo shfaq, përkatësisht edhe i vetave, është shumë më i reduktuar, krahasuar me pjesën më të madhe të mënyrave të tjera.

Një gjë e tillë është përligjur me nuancat modale karakteristike të saj, që projektohen zakonisht në struktura steriotipe. (Dihet se dëshirorja del në formula urimesh dhe mallkimesh zakonisht).

Nga ana tjetër, këto formula pozicionohen në makrostrukturë në perspektiva kontekstesh situative mjaft të veçanta.

Format e dëshirores

Kënga e 5-të

1. Vasha formadhja më **rëmpeft** për dorje at buzëhjeshmen
Mua me **sjellt** përparanith.
2. **Lumi u** , më thoi mali

Kënga e 13-të

3. **Vash** si nj' ill (vafsh si një yll që dritën nuk e bjerr udhës së tij)
4. Bir, me hljem të ritë e tu **mos të kioft** përljipurith (përzier)
5. **Kioft** i but dimri
6. Bilat e bëshme mëmat shumë **më martoshin**(bija të bëshme mëmat më martofshin shumë)
7. Siellësh ti një ushtëri fanëmiir(fatmirë)
8. Dox(lavdi) **paft** zotti ndër qiel

Kënga 16-të

Ruash e ftohtëza voree (këng XVI) si në camërisht

Formalisht, dëshirorja është karakterizuar nga ekzistenca e një mjeti sintetik specifik, si prapashtesa trajtëformuese që del me disa trajta alomorfesh të tilla *si fsh/sh/ç*.

Shprehje të dëshirores gjejmë edhe përmes përdorimeve të veçanta të kohëve a mënyrave të tjera. Sipas nesh këndvështrimi i deritanishëm në lidhje me shprehjen e këtij modaliteti në shqipe ka qenë krejtësisht formal dhe ka mënjeluar rastet e shprehjes së tij në struktura specifike të cilat jo domosdoshmërisht e kanë foljen përbërëse në dëshirore, sidomos në ligjërimin e shkujdesur. (Sa do të dëshiroja të isha atje! Ishalla vjen shpejt. etj *Lumi u* , më thoi mali!

Gjithsesi, korpusi i foljeve në mënyrën dëshirore (megjithëse me përdorime të kufizuara gjithsej 13 raste), te kjo vepër nuk na paraqet formalisht ndonjë shmangie në lidhje me mjetin specifik markues të saj dhe na paraqitet pothuajse në të njëjtën formë si në shqipen e sotme.

Haset vetëm ndonjë rënie tingulli tek -tuk. Folja *jam* del në temë pa ndryshimin *kj/q*, pra siç gjendet në gegërishten e sotme.

Nga ana semantike, nuk ka ndonjë përdorim me ndonjë semë të panjohur, po ashtu si dhe nga ana strukturore del në të njëjtat struktura.

Nga ana stilistike, gjithashtu ,veç nuancave modale, ndoshta të ndonjë përdorimi në pamje të parë të tepërt të vetës së parë njëjës, e cila bëhet për të treguar nuancat emocionale të ngritura të personazhit kryesor, nuk kemi shmangie të tjera.

Në poemë gjejmë vetëm përdorime të kohës së tashme të dëshirores , në vetën e dytë ose të tretë njëjës të ndërtuar me prapashtesat trajtëformuese *fsh/sh*. Edhe foljet e parregullta kam dhe jam ndërtohen njësoj si në shqipen standarde me ndonjë ndryshim fonetik. Folja ruaj del në një formë dytësore të ndërtuar nga tema me tog zanor - *ruash* e ftoghëtëza voree/ se më zgjon t'i më garepsën (këng XVI).

Në disa folje vihet re ndonjë rënie fonetikë, zakonisht e njërit tingull të pazëshëm të prapashtesës specifike trajtëformuese (përgjithësisht *-f-ja*.) Kështu kemi këto folje me këtë veçori: *Vashsi* nj' ill ; Mëmat shumë *tëmë martoshin*.

Vasha formadhja më *rëmpeft* për dorje at buzëhjeshten

Siç vihet re në shembuj e mëposhtëm, trajtat vetore të vetës së tretë numri njëjës kanë ruajtur mbaresën e trashëguar-*të'*, nëvetën e dytë njëjës dhe të tretë shumës dalin vetëm me *-sh* .

Na tërheqin vëmendjen edhe këto dy raste:

Ndër të veshura të zeza nusia *së fanaroset/* vallies cë dridhiet. Jetta e *të përmisiet* –le të përmbysset(bota u përmbystë) Kënga V.

Në këto dy raste vëmë re atë veçori të shqipes së sotme, që nuancat modale të dëshirores i realizon edhe me forma të tjera foljore, në shoqërinë e strukturave sintaksore specifike. Në këtë rast është lidhorja që është përdorur në këtë kontekst. Mendoj që dhe *së-ja* e foljes së dytë është *të-ja* e lidhores, e cila ndoshta për arsye të një rime të brendshme me fjalën e mëparshme del *-së*.

Në Gramatikë gjejmë edhe formën joveprorë të dëshirores, e cila del në kohët e thjeshta, dhe në ato të përbëra, ndërtuar me ndihmën e formatit psh;

Koha e tashme joveprorë :

U ljàisa, u ljàiš, u ljàitit , u ljàišim

Koha e kryer

Numri njëjës: pafsha passur - u pafsha kjenur

Interesant është shembulli i shkëputur nga Gramatika e De Radës, ku shfaqet përdorim i lidhore me kuptimin e dëshirores :

Të më ciòsh si ljulje të cuke – të më rúash si bubúke. Tw mw cosh si lule tw kuqe tw mw ruash si burbuqe.

MËNYRA HABITORE

Dihet se në Gramatikën I, habitorja klasifikohet të ketë katër kohë, të tashmen, të pakryerën , të kryerën dhe më se të kryerën. Realisht sot më shumë të përdorshme nga bashkësia folëse dalin e tashmja dhe e kryera. Studiuesit që janë marrë me arbërishten pohojnë se në të gjitha ligjërimet arbëreshe, mungon formalisht mënyra habitore. Edhe në tekstin e De Radës nuk gjejmë shfaqje formale të kësaj mënyre ,por gjejmë shfaqje të strukturave prej nga mund të ketë dalë.

Haborja shfaqet në struktura me folje të mënyrave të tjera, ashtu siç e gjejmë dhe shqipen e sotme. Në vepër gjejmë këto shprehje të habitores:

- ❖ Në shembullin e vjelë: Me këtë mot të bëje finjën/ Duart si *më t'u nkuqtin!*, Kënga XIV, vëmë re se folja është formalisht në lidhore, por kuptimisht e shprehur në strukturë, del me kuptimin e së kryerës habitore. Në temë është mjaft interesante, pasi mendojmë se ruan shenjat e një sintagme parafjalore të përgjitur, natyrisht me rënie fonetike(*në të kuq*).
- ❖ Tek “Fiamuri i Arbërit” ndeshim këtë shembull tjetër interesant:Atje pranë *t'u kish passur rritur* (qenkësh rritur)i pagëzuari i arbëresh. Në fakt kjo është një formulë tipike letrare e prozës popullore Ajo që na tërheq vëmendjen është ndërtimi i formës joveprorë me anë të pjesëzës -u. Mendojmë se kemi shprehje të habitore. Edhe në çamërisht kjo strukturë përdoret ende dendur në ligjërimin bisedor për të shprehur nuanca të habitës krahaso – Na qenka rritur i pagëzuari arbëresh.

Sikurse edhe jemi shprehur tek mënyra dëftore, në disa folje përdorimi i elementit *-ith*, shërben për të përcjellë ndryshime në kuptim dhe jo si një prapashtesë zvogëlimi e përkëdhelie. Gjurmë të këtij elementi pranë foljes gjejmë edhe në çamërisht tek folja qan- klanith, si rrjedhojë nuk mendojmë se përdorimi i saj si mbaresë foljore është një risi e arbërishtes, por është një element i vjetër që arbëreshët

e kanë mbartur nga gjuha mëmë. Foljet e pajisura me –th/ith, përgjithsisht shfaqen në poemë për të shprehur nuancat e habitë. Ky variant¹²³ mendojmë se është një mënyrë e veçantë, një dukuri e karakterit stilistik që përdoret për të shprehur afeksion, por në pjesën më të madhe të rasteve mendojmë se ky është gjithashtu një mjet i veçantë gramatikor me karakter stilistik që përdoret për të shprehur nuanca të mënyrës habitore .Krahaso: Dielli që dihet vashës i *qeshënith*, kënga XI(po i qeshka). Shkon e jëma e *klanith,këng XXIII* (e qaka).E rriti ajo zonjë , atë *kish gharruarith*,(paska harruar).

- ❖ Nuanca të habitores, në poemë shprehen edhe me anë të prapashtesa –z-/zë, e cila gjëllin dendur në çamërisht si e tillë edhe sot psh: Ish etje djegur-zë.*Qenkësh djegur(digjërkkaka nga etja)*. Etjen më i *shuan-iz*. (*i shuaka*).

MËNYRA KUSHTORE

Mënyra kushtore në gjuhën shqipe shfaqet mjaft e larmishme dhe formalisht paraqitet me dy kohë(e tashmja: do të punoja dhe e kryera: do të kisha punuar), të cilat shihen si homologe me një pjesë të formave të së ardhmes së dëftores.

Praktikisht, ajo përgjithësisht shihet si një formë, që realizohet në kuadrin e fjalive kushtore. Nga shqyrtimi i strukturave ligjërimore ku dalin këto të fundit, lehtësisht mund të dallohet se jo në pak raste fjalitë kushtore realizohen pa përdorur foljet e mënyrës kushtore. Për këtë arsye, pavarësisht se në pamje të parë duket se mënyra kushtore nuk gjendet ,formalisht në tekstin e Milosaos, ajo realizohet strukturalisht me folje të tjera dhe në struktura sintaksore karakteristike për të. Kështu kemi:

- Se ti më merr ti ku më çon;

Mendojmë se kemi një rast tipik që e kemi dhe në shqipen e sotme, i cili konstruktet e kushtores nuk i shpreh me format korresponduese, të paktën në fjalinë e varur kushtore, po me forma në kohë të tjera. Këtu të dyja foljet janë në të tashmen e dëftores, pa ndryshime në temë e mbaresë. Kuptimisht folja e dytë mund të ekuivalentohet me të ardhmen,e cila shfaqet në formën e një të ardhmeje të përmbysur me vlerën e së ardhmes së të shkuarës¹²⁴

¹²³ Gjurmë të prapashtesave zvogëluese, përkëdhelëse me –ith-, gjejmë edhe në çamërisht në përdorime pranë emrave, mbiemrave të gjinisë mashkullore: djalthim (*djalthi im*). *I voglthi* i nanës(në thirrore). Përdorim të saj gjejmë edhe tek folja qan- *klanith*.Ç’ më klanith këështu? Interesant është edhe fakti që kjo lloj mbarese nuk del në Gramatikën e De Radës dhe nuk e kemi gjetur as tek “Fiamuri Arbërit”. Fakti na bën të mendojmë se është element i vjetër i ligjerimeve popullore.

¹²⁴ Mendojmë se ky rast ku forma e së ardhmes përdoret me rendin e anasjelltë të elementeve formuese është bërë vetëm për qëllime stilistike.

Në shembullintjetër:Ç’ë së prita ,por u nisa?!*Ardhur kisha* me uratën, ku shfaqet një formë e përmbysur, në të cilën folja ndihmëse *kam* del pas pjesores, duke u nisur edhe nga konteksti i përdorimit të saj në poemë si shprehje e qëndrimit afektiv emocional të personazhit,na tërheq vëmendjen për t’u parë edhe si dëshmi pararendëse e procesit të krijimit të formave foljore të kushtores, si një moment kur format e përmbysura analitike të mënyrës dëftore marrin vlerën e mënyrës kushtore, për t’u zëvendësuar dalëngadalë me format e konsoliduara të kushtores. Kjo formë e përmbysur formalisht del si format e së ardhmes dëftore, por kuptimisht realizon kushtoren.

Në Gramatikë gjejmë shembullin:¹²⁵

- *Se nd’e dasha u per garee, për garee prana nch’e cam.*Ndë e daça për hare, për hare pranë nuk do ta kem. Siç vihet re struktura në të cilën shfaqet lidhëza *ndë* dhe folja në dëshirore është e njëjtë me lokucionin lidhëzor *nëqoftë se*.
- Në shembullin: *Fanëmir ndë pixënej* rëmpet e diellit (fatmir, nëse do të endte rrezet e diellit) /do ta ndiente veten të lumtur nëse do të endte rrezet e diellit.¹²⁶, tipi i së ardhmes së të shkuarës është përdorur edhe në funksion të mënyrës kushtore




Tabela II.19

¹²⁵Mënyra kushtore zë vendin e saj edhe në Gramatikë, për të De Rada shprehet se: “*Mënyra kushtore formohet me “ndë”, si edhe në format e tjera dyshuese ose shpjeguese*”.

¹²⁶ Në këtë etapë të zhvillimit të saj shqipja ende nuk e ka formuar mënyrën kushtore, por e shpreh me mjete të tjera gramatikore.

Format e pashtjelluara

Pjesorja

Kjo formë e pashtjelluar foljore përdoret dendur në vepër si pjesë përbërëse e trajtave foljore analitike, por edhe si gjymtyrë më vete.

Pjesorja në Gramatikën I përcaktohet në këtë mënyrë: “Quhet kështu ajo formë e pashtjelluar, që ka tipare gramatikore edhe foljore, edhe mbiemërore.¹²⁷”. Një hiperkarakterizim i tillë (pra dhe si folje dhe si mbiemër) e bën pjesoren një nga format e parapëlqyeranga autorët e letërsisë artistike.

Semantikisht mundësia e shprehjes së një informacioni të plotë (veçori e formave foljore) dhe, nga ana tjetër, kalimi shumë i lehtë nga skicimi i perspektivës së veprimit, gjendjes etj në tipizimin e saj si tipar i qëndrueshëm (kalimi në mbiemër) vetëm si formë e pashtjelluar, pra në mënyrë kaq sinkretike, i jep asaj attribute mjaft të pragmatike për shkrimtarët, veçanërisht në gjininë e poezisë.

Në vijim po identifikojmë korpusin e pjesoreve që gjendet në vepër dhe, më pas, do të mundohemi ta analizojmë atë sipas rrafsheve të ndryshme.

Korpusi i pjesoreve që gjenden në vepër është si më poshtë:

Kënga e parë

Ui të rii ndë deitit / **Kalthjëruar** te ditë e re

Kënga III

E vashat **ljëshuar** ka të bridhurit, ndër dier fjinis

Kënga IV

Me një dor **ngrejturith**/ mbanje mbi veshin e bardhë ljeshtë e saj.

Kënga V

Ndo mos **vdekurith** /mbi shtrat na vemënth/mos përpara shpive tona

Kënga VI

Të hedhurat kopjilet ljetënjën **garruamith** (harruar)

Kënga VIII

Ngrëjti deg ulliri **shkundur** / edhe vashëza e bukur

Kur ngrehja paidhet (grackat) **shegur**(fshehur) ullishtave

Kënga IX

E më pa të dashurin **pruar**(kthyer) / e uli kriphit

Perënduar dielli pa dalë illëzit

Si një anije **ngarkuar**

Kënga XII

Cë fërnuar (ja mbaruar)sëqethuri deljet u ljëshuan e vanë

Kënga XV

Im vëlla Koniati më doli **veshur** i bardhë

Kënga XIX

¹²⁷ Kur folësi nëpërmjet bashkëbiseduesit, dëshiron të urdhërojë një a disa persona që nuk marrin pjesë në bisedë, atëherë ai përdor me vlerën e urdhërores format e vetës së tretë njëjës e shumës të kohës së tashme të lidhore të prirë ose jo nga pjesëza “le”; Gramatika I, f. 331.

Për së treti u m' u pataka /hëna **rar (rënë)**/ kullotënej ndonjë kalë

Kënga XXVII

Mos më qaj ti bila ime/nani vete **martuar**/ te zoti fanëmir

Kënga XXVIII

Mos rri ti **helmuar**/ motra ime e vogla

Kënga XIX

Ujtë **humbur** (humbur)/ ra vorea (veriu)/male e sheshe u veshëtin

Kënga XIII

Bir me hljem të ritë e tumos të kioft **përljipurith** (përzier)

Kënga XXIV

Të vëdekta atto hjee/ *shejtërueme* ka malli.

Në rrafsh fonetik, mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me këto grupime.

- Format e pjesores të realizuara me prapashtesa trajtëformuese të njëjta me këto të sotme: *martuar, ngarkuar, perënduar, helmuar, shkundur, ljëshuar* etj.¹²⁸

Ky pozicion favorizon mjaft kalimin, edhe si mbiemër të këtyre formave. Një gjë e tillë konstatohet fare lehtë, sepse në të gjitha rastet mund të bëhet zëvendësimi me mbiemrin në këto struktura. Në poemë shfaqen dendur kalime të tilla, në të cilat mbiemrat shpesh janë të shoqëruar nga prapashtesa zvogëluese përkëdhelëse –*ëz p.sh; e përveshurëz, të pieksur, të përgjakura, e dhezurëz, e përflushur, të karpizur, e magjepsur.*

- Format e pjesores të realizuara me prapashtesën trajtëformuese të gegnishtes – m(e): *lëshueme, shenjtërueme.*

Të vëdekta atto hjee/ *shejtërueme* ka malli .Vashat *lëshueme* ka të bridhurit fjissin.

- Foljet të parregullta që dalin në variantin e normës letrare psh. *dhënë*
- Folja *dal*, bën: Daljur atje ish.

Hëna *rar(rënë)*/ kullotënej ndonjë kalë .Kjo formë del edhe në të folmet dhe toponimitë e krahinës së Labërisë psh; Te Lisi i Ra:rë.

- Në këtë grup shfaqet elementi karakteristik trajtëformues *ith*,¹²⁹ i cili nuk gjendet në shqipen e sotme: *vdekur-ith, garruam-ith, përljipur-ith, ngrëitur-ith.*

¹²⁸ Edhe gjatë analizimit që u kemi bërë kohëve të përbëra, të shprehura në vepër kemi vënë re se kjo formë e pashtjelluar del me të njëjtat prapashtesa fjalëformuese si norma letrare

¹²⁹ Në lidhje me këtë formë mund të konsultohet sqarimi që kemi dhënë për te format e tjera. Sipas nesh pavarësisht shpjegimeve të dhëna nga autorë të ndryshëm , ajo shfaqet më shumë si një element ndërtues i strukturës poetike, për më tepër se ajo nuk shfaqet vetëm te folje, por dhe tek ndajfolja, mbiemri, emri etj. Kjo do të thotë se nuk kemi konsistencë as gramatikore, as semantike.

- Pjesore të veçanta që nuk përputhen me shqipen e sotme, ku shfaqet prapashtesa trajtëformuese –*ën* psh; arrën (arritur).

Nga pikëpamja strukturore, vëmë re se kemi disa modele në të cilat gjendet e projektuar pjesorja në korpusin e mbledhur.

Në rastin e grupit të parë (ato me formë të njëjtë si sot), format e pjesores gjenden në pozicion komplementi të brendshëm ose dhe të jashtëm. Këtu e kemi fjalën zakonisht për strukturat, ku si komplement i brendshëm varet direkt nga një kokë emërore (e vashat ljëshuar), dhe si komplement i jashtëm, kur zakonisht luan rolin e përcaktorit kallëzuesor tradicional (Uji të ri ndë dejtit kalthjëruar te dit e re).

Në fakt, rasti i dytë është i diskutueshëm, pasi tradicionalisht, përderisa gjendet në një strofë eliptike nga pikëpamja stilistike, por mendojmë se ky funksion tradicional e përmbush deri diku marrëdhënien e dyfishtë me kokën *uji* dhe me kokën tjetër të pashprehur *është*.

Grupi i dytë me *ith* zakonisht gjendet në pozicion pasfoljor, model ky që nga teoria tradicionale është parë si funksion rrethanori.

Në shprehjen e tillë të pjesores: Vashat *lëshueme* ka të bridhurit fjissin.

Sipas nesh, këtu kemi të bëjmë me një pjesore në formën e kokës foljore të sintagmës fjali. Koncepti i sintagmës fjali në studimet tona haset rrallë. Ky është një term i Gramatikës Descriptive, e cila format foljore të pashtjelluara i sheh si koka foljore të atyre që i quan sintagma fjali.

Sot u tha që kur u di *:/e* si *besuar* ng'e ka njeri. Valtimi i Arkiopullit

Nani *vete martuar/* te zoti fanëmir.

Nga pikëpamja stilistike, vetëm ndonjë prej tyre shfaqet e markuar stilistikisht (Uji të ri ndë dejtit *kalthjëruar*). Pjesa tjetër zakonisht shfaqet në struktura neutrale, ose minimalisht të shuara (mos rri ti *helmuar* motra ime).

FORMAT E TJERA TË PASHTJELLUARA

Në lidhje me format e pashtjelluara në gjuhën shqipe ka pasur një sërë diskutimesh dhe propozimesh, si në lidhje me emërtimet e ashtu dhe me statusin e tyre {ashtu siç pamë dhe për pjesoren më lart}.

Ende sot vazhdojnë debatet, veçanërisht më funksionet e tyre, por tashmë të para jo vetëm në këndvështrim tradicional. Këtë fakt e pohon dhe një nga punimet më të gjera në lidhje me këtë problematikë, siç është ai i Prof. Mehmet Çeliku "Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe"¹³⁰.

Në Gramatikën I, format e pashtjelluara ndahen fillimisht në varësi të prejardhjes së tyre nga pjesorja ose nga emri prejfoljor asnjans dhe më pas diskutohen si vlerat semantike, ashtu edhe ato funksionale¹³¹.

Në Gramatikën II, ato shihen si forma foljore vetëm në rastet, kur lidhen me një kryefjalë direkt, ndërsa në rastet të tjera shihen si gjymtyrë të dyta, përkatësisht si rrethnorë. Aty thuhet shprehimisht: *'Mungesa e treguesve morfologjikë për mënyrën , kohën , vetën dhe arsyet që u vunë në dukje më lart, bëjnë që forma të tilla të pashtjelluara të mos u përgjigjen të gjithë kërkesave të kallëzuesit, po as dhe kërkesave të gjymtyrës kryesore të një fjalie njëkryegjymtyrëshe të nënrenditur. Prandaj vetëm në ato raste kur format e pashtjelluara lidhen me një emër a përemër në rasën emërore, me të cilin hyjnë në marrëdhënie kallëzuese, mund të flitet për funksion kallëzuesor të formave të pashtjelluara.'*¹³².

Shembujt që jepen në vijim të citimit dhe argumentet e tij në lidhje me këtë problem janë shumë problematike, pasi në shumicën e rasteve janë identike në strukturë me ato që jepen, kur ilustrohet fakti se këto ndërtime përdoren si rrethnorë të ndryshëm (Krahaso shembujt e citimit me ato të f. 273).

Edhe tradicionalisht, shembujt e dhënë, kur këto shfaqen të pazgjeruar (që do të përbënte dhe rastet më kokëforte të argumentimit tradicional), nuk janë marrë parasysh të gjithë modelet e projektimit të asaj koke foljore.

Përdorimet e shpeshta në struktura me rrethnorë, kundrinorë, në formë veprare dhe joveprare i japin këtyre formave statusin e lart përmendur¹³³.

¹³⁰ Mehmet Çeliku, Format e pashtjelluara në gjuhën shqipe, ribotim, Tiranë , Shblu, 2010.

¹³¹ Gramatika I, Akademia, Tiranë, 2002, f.337.

¹³² Gramatika II, f. 273, Tiranë, 2002

Një gjë e tillë është argumentuar dhe nga prof Ludmilla Buxheli, por në këndvështrimin gjenerativ. Kështu ajo shikon një kryefjalë të pashprehur *pro* në strukturën e tyre të thellë, që orienton këto forma foljore dhe për të¹³⁴.

E bëmë sqarimin e mësipërm për të thënë se dhe kur janë vetëm, duke qenë koka foljore, ato përcjellin informacionin e domosdoshëm, zakonisht për të plotësuar një kokë tjetër drejtuese foljore.

Në zhanre si poezia struktura të tilla janë të preferuara, pasi ashtu siç thamë më lart për pjesoren ato favorizojnë strukturalisht karakterin sinkretik të saj.

Në veprën e De Radës vihet re se ai preferon që këto struktura përgjithësisht t'i japë të zgjeruara me komplemente mbushëse, qoftë dhe jashtë shmangieve figurative, pra thjesht në rrafsh neutral.

Përcjellorja

Korpusi i trajtave të gjetura në poemë:

Kënga I

Por lumbardh e Anakreontit, mua më zgjoi **tue fluturuar** qelqeve finestrës

Kënga II

Më qëlonëj **tue fiantaksur** (duke ëndërruar), se përdore poshtë shkoim te shtëpitë e njerëzve

Gjumi mua më ljothënith(lodh), kurmi vette **tue m'u reshtur** (si një gruaje që mbrëmjes i largohet)

Oh, vasha kryegështenjë të vihej **ture tieerr**, gjysëm në terr e në dritë

Shpit e njerëzve na fanepsen (na shfaqen) **mbë të garaksun** (më të aguar). *Shikoje si mund ta marrim si rast*

Kënga XVII

Nesër mbi të **serpossurit** (në të ngrysur) shkon vasha nga dera ime e më sheh me shumë hare

Ndë të rarë të dimrit

Këng XIX

Mbi të ditur(Kur agonte)

Mos kujtoj të bardhën mëmë që e zbathur e pa frymë pyjeve po më rrëqiset **ture i thir** (duke i thirur)zotit të saj.

Kënga XXI

Shkrehet e më bie kumbora me gare(hare) **mbë të garaksur** (aguar)

Si më ftoghën vazhazit *mbë të skaljissur(këng XXII)*

Kënga 25

Kalames(sorrat) vinin **tue larissur** (sorrat vinin duke kukurisur) një lloj kënge sa u patakta (tremba).

¹³⁴ Ludmilla Buxheli, Konferenca për terminologjinë në shkencat e ligjërimit, Elbasan, 2012.

Siç dallohet nga shembujt e mësipërm, përcjellorja shfaqet në përgjithësi e ndërtuar nga paravënia e variantin të hershëm *tue*, ashtu siç e gjejmë dhe në gegërishten e sotme, ndërkohë, elementi i dytë, *pjesorja e foljes* shfaqet në variantin e normës së sotme letrare¹³⁵. Në poemë është përdorur megjithëse rrallë edhe varianti dialektor dytësor i cili gjendet vetëm në të folmet arbëreshe *ture*¹³⁶. Shembujt e përdorimit të këtij varianti dytësor pranë pjesores së foljeve *thir* dhe *tierr* mbështesin arsyetimin e Prof. Demiraj se: *Arsye e një dukurie të tillë duhet shpjeguar ndofta me ndikin e elementit të dytë të formës analitike që del me formatin –r(ë). Me fjalë të tjera këtu ka vepruar njëfarë asimilimi prapavajtës*¹³⁷.

Sikurse vihet re nga shembujtkjo formë e pashtjelluar ndeshet kryesisht në formën veprorë, me përjashtim të një rasti, ku forma joveprorë e përcjellores ndërtohet me anë të formatit -u, i cili ndërfutet midis pjesëzës së përcjellores dhe pjesores së foljes themelore: Gjumi mua më ljo dhënith, kurmi vette *tue m'u reshtur* si një gruajë që mbrëmjes i largohet.

Në lidhje me pjesën foljore përbërëse të këtyre formave, pra ose me pjesoren, ose me emrin prejfoljor, vihen re vetëm shmangie dialektore të leksikut, pa ndryshime të shumta si në rrafsh fonetik, ashtu dhe semantik.

Mjaft interesante janë dhe raste të tilla:

Shpit e njerëzve na fanepsen *mbë të garaksun*; E j'ëma e *mbë të qeshur* (duke *qeshur*); *Mbë të ditur* (kur agonte) këng. Si më ftoghën vazhazit *mbë të skaljissur*(këng XXII) Shkrehet e më bie kumbora me gare *mbë të garaksur*. Shembujt janë përdorime të emrave asnjëanës me parafjalë.

Siç mund të shihet kemi një strukturë e cila mund të shihet formalisht si një sintagmë parafjalore, por semantikisht ajo është ekuivalente me përcjellore.

Nesër *mbi të serpossurit* shkon vasha nga dera ime e më sheh me shumë hare

Ndë të rarë të dimrit

Mohorja

Forma e pashtjelluar mohore në poemë shfaqet rrallë, ajo del si formë analitike e ndërtuar mbi bazën e pjesores me paravendosjen e pjesëzës mohuese **pa**, duke shprehur moskryerjen e veprimit në të shkuarën.

Kënga 9-të

Tirr në shtëpi vasha e mjerë, /

Ashtu si bil të nëmurish(mallkuarish) **paa veshur, paa ngrëen/**

¹³⁵ Prirja e De Radës për të përzier format dialektore vihet re vecanërisht në Gramatikën e tij, në ndërtim e formave analitike, ku elementi i parë i tyre shfaq ngjashmëri me gegërishten, ndërsa elementi i dytë me toskërishten.

¹³⁶ Shih Sh. Demiraj, Gramatikë e gjuhës shqipe, f. 974, Tiranë, 1986

¹³⁷ Shih Sh. Demiraj, Gramatikë e gjuhës shqipe, f. 974, Tiranë, 1986

Si të ndajtur ka të ljumët .

Pa dalë illëzit(yjet)

Vihet re zgjatimi i zanores tek pjesëza mohuese paa me funksion theksimin e saj.

Paskajorja

Korpusi i formave:

Kënga XI

E stolisur në mes grave del kopilja **për martuar**

Kënga 28

Të zezën **për të varessur** për çfarë e do e nuk e lë?

Kënga 29

Pendët e zogjve i shkul burri, kryet **për të stolisur**

Më jep çehren **për të puthur**

Forma e pashtjelluar paskajore gjendet rrallë në të folmet arbëreshe, gjurmë të saj gjenden tek G. Dara, ndërkohë që nuk shfaqet tek autorët arbëresh të shek. XVIII¹³⁸. Në poemë sikurse dëshmohet nga shembujt e mësipërm De Rada përdor paskajoren, në variantin e dialektit toskë, e cila sot është edhe formë përfaqësuese e standardit, duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzat *për të*. Në vepër ajo del pa ndryshime, qofshin këto edhe fonetike.

Në Gramatikë ndeshim edhe raste të paskajores me pjesëzën *me + pjesore*, të cilat ngjajnë me ato të gegërishtes, pavarësisht se nuk dimë me siguri nëse ato i sajoi sipas ndonjë teze ku u mbështet, p.sh te ndonjë gramatikë e shqipes së këndej Adriatikut, apo ta ketë gjetur në ligjërimet arbëreshe. Duke iu referuar edhe pohimit të Prof. Demiraj se kjo formë duhet të ketë një zanafillë relativisht të vjetër dhe përdoret dendur në veprat e shkrimtarëve të të vjetër të Veriut, mendojmë se është një element me burim nga ligjërimet arbëreshe. Fjala është për forma të cilat këtu i ndeshim si “folje me shtirje”, p.sh: *me ljaar, me u ljar*.

Format e joveprores në të gjitha format e pashtjelluara edhe në Gramatikën e autorit shfaqin formantin analitik *u* përpara, që është karakteristik për këto forma edhe sot.

Sic vihet re nga analizimi i formave të shtjelluara ato shfaqen me përkime herë nga toskërishtja, herë nga gegërishtja, por vihet re edhe një prirje e autorit për të bërë një shkrimje mes dy dialekteve, pra një përpjekje e tij me sa duket për një shqipe të përbashkët.

¹³⁸ Shih Sh. Demiraj, Gramatikë e gjuhës shqipe, f. 985, Tiranë, 1986




Tabela II.20

KAPITULLI III

- ❖ **Leksiku foljor**
- ❖ **Folje të shqipes**
- ❖ **Folje të huazuara**

Në përpjekjet e De Radës për ruajtjen dhe vlerësimin e gjuhës shqipe “Si më të vjetrat dhe më të pasurat gjuhë”¹, nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes edhe punën e tij këmbëngulëse për ruajtjen e fjalës shqipe. Nisur nga materiali i mbledhur mund të themi se leksiku i foljeve të përdorura në vepër është i pasur. Foljet në pjesën më të mirë të tyre i përkasin leksikut të përbashkët të mbarë shqipes si nga kuptimi, ashtu edhe nga trajta, por hera-herës me ndryshime të trajtës fonetike e morfologjike, apo leksikore.

Në leksikun e foljeve të përdorura prej autorit në poemën “Këngët e Milosaos”, ashtu sikurse te të gjithë bashkëkohësit e De Radës, vihet re prirja për të përdorur sa më shumë folje të shqipes, qofshin këto edhe fjalë të përdorimit të kufizuar krahinor.

De Rada është mbështetur fort në gjuhën e folur popullore, ku sigurisht dallohen qartazi fjalë dialektore dhe krahinore, të lidhura me mënyrën e jetës, me bujqësinë, blegtorinë dhe fusha të tjera. Në leksikun foljor të nxjerrë prej veprës së tij dallohen frazeologjizma, lokucione foljore, arkaizma, fjalë me karakter krahinor, por edhe fjalë të reja etj. Duke parë numrin e foljeve të huazuara në raport me foljet e leksikut të shqipes, në këtë vepër vlerësojmë edhe njëherë punën e tij të çmuar për vlerësimin dhe lartësimin e gjuhës shqipe, ashtu sikurse ëndërronin rilindësit. Natyrisht që gjuha e De Radës, sikundër gjuha e çdo shkrimtari, sjell edhe lëndë pasuruese për leksikun e shqipes së sotme. Mund të themi zë plotë se fjalësi i përdorura prej tij është një pasuri e rrallë dhe e paçmueshme kombëtare për të gjithë, veçanërisht për gjuhëtarët. Nisur nga materiali që kemi marrë në shqyrtim tek “Këngët e Milosaos” mund të themi se gjuha e tij është:

- ❖ a) burim fjalësh, frazeologjie e kuptimesh prej një ligjërimi që ruan elemente të vjetra me vlerë, por edhe ka potencial pasurues si çdo e folme krahinore;

- ❖ b) burim krijimesh gjuhësore të autorit;
- ❖ c) burim pasurimi jo vetëm në kategorinë foljore, por në të gjitha pjesët e ligjëratës, si njësi leksikore dhe si njësi semantike
- ❖ ç) burim pasurimi edhe në vlerat mbishtresore, me ngjyrimet shprehëse, emocionues e stilistike, që zhvillohen e shpërfaqen në nivelin artistik të krijimtarisë.

Fondi i fjalëve shqip

Leksiku i foljeve tek Milosao ruan një pasuri të paçmuar foljesh dhe shprehjesh foljore të shqipes , të ruajtura ose të krijuara pas shpërnguljes nga atdheu i të parëve si me rrënjët e fjalëve të vjetra, ashtu edhe me elemente fjalëformues të shqipes.

Sikurse dallohet edhe nga grafiku bashkëlidhur, shumica e foljeve të përdorura janë nga leksiku i shqipes, duke nxjerrë edhe njëherë në dukje prirjen e De Radës për ta ruajtur gjuhën shqipe nga huazimet. Ato janë folje që gjëlljnë edhe sot në shqipe. Folje të tilla si : *ndien, mbajnë, ruaje, kujtoje, qeshën, zëgjoi, del, u zbulua, kish ëndërruar, përgjaku, gërvishtin, jam, të duash, niset, qëndro, thoshin, siellt, rëmbef, përbaltën, përljot, bie, shkundullin, vien, puthi, iku, do, bëri, dola/doli, u tund, del, shkon, lufton*, jo vetëm që i përkasin fondit leksikor të shqipes, por janë përdorur në përshtatje me ligjet fonetike dhe morfologjike të shqipes standarde . Ajo çfarë na tërheq vëmendje është se një pjesë e këtyre njësive leksikore, dalin me variante fonetike ose morfologjike të së njëjtës fjalë psh : *ruata* është folja e njohur *ruaj*, *shture* (sitë) është *shtie*, *kish lerë* është folja *lej*, *shtjer* është *shtie* “hedh”, *shiti* është *fshiu*, *frija* është *fryj*, *tjerros* është *tjerr*, *thaiti* është *thau*, *qeshënjën* është *qeshën*, *ngrëiti* është *ngriti* , *më presën* është *më presin*, *të përmissiet* është *të përmbysset*, *mir* është *merr*, *biu* është *mbiu* ,*shkepëtinë* është *shkrepin*, *nkuqin* është *skuqin* etj. Te këto nuk do të kërkojmë “fjalët”, por kuptimet e tyre.

De Rada përdor një grup fjalësh arkaike, të cilat hasen rrallë ose asfare në ndonjë të folme anësore. Disa prej tyre janë arkaizma leksikorë të tilla si, si: *pështjer, sqepet, buartin, (me bujt)rrumpullarëshin, bunarënej, u pruar*, etj, disa janë arkaizma kuptimorë të tilla si : *çonj* (gjej), *resht* (largoj), *rodhet* (dridhet); *shtiu* (hodhi) *përpiq* (ndal), *patën fjalë* (bënë fjalë), . Disa folje veçanërisht ato me prejardhje nga greqishtja dalin si arkaizma historikë si p.sh. *potis, parakaljesa¹, tagjis* etj.

Mes fjalëve dallojmë edhe huazimet e kalkimet nga italishtja e greqishtja, si: *më do mir* <it. *voler bene*; *via ri mir*(*shkofsh shëndoshë*), *via levrossu* (*ngushëllohu*).

Së fundi në vepër ka edhe fjalë që s'vihen në dyshim si njësi leksikore të standardit, qoftë edhe me kuptimet e ngushta të arbërishtes, si: *shkundullinj*, *prirjem*, *ljëshonej* (*lëshohej*), *tue m'u reshtur*, *dridhet*, *ruan*, *reshtja*, *përpiq*, *u errëtin* etj., si dhe shprehjet *besën e kanë mbi vete*, *s'e përgjaku akulli*, *e lja (e la) besa* etj. Tek të gjitha këto mund të ketë çështje të normativizimit të mëtejshëm në aspektin fonetik e semantik, por jo leksikor, prandaj këto dy aspekte në punime të mëtejshme duhen hetuar me kujdes e më gjerë dhe të argumentohen mirë duke i mbështetur edhe me shembuj të tjerë nga vepra e autorit. Nga leksiku i shqipes tërheqin vëmendjen edhe fjalë të formuara nga pasthirrat ose nga onomatopetë, të cilat flasin për zhvillime dhe formime të brendshme të leksikut të shqipes të tilla si: *shtrushullonj*, *tring*, *tringëllinj*, *shkarart*(*shkund degët e ullirit*),*shakëmis*(*shprish*), *takënej* sëpata etj.

Nga fondi i foljeve të shqipes të dalluara në vepër do të veçonim edhe këto përdorime interesante dhe pasuruese për shqipen.

Njësi frazeologjike, si të tilla mund të cilësonim: dherat *i vejin e i vijin*, *zemra i llaftarisën*, *mbain kangjellë*(*këndonin*) *e vë buzën mbë gaz*, *noerit më bienith*(*më ikën mendja*), *së dii të frijgn*(*s'marr frymë, më ndal fryma, ngrij*).

Grup tjetër janë lokucionet foljore me strukturë dy folje semantiksht komplementare (plotësuese) me vlerë përforcuese: *sillej e përpiqej*; ose me vlerë modale: *shkoi e muar*, *bëri e shiti*, *vete tue m'u reshtur*, *ver të shoh*,: si një flutur që *vente,vente*.

Grupi i tretë janë foljet e veçanta, me kuptim si tek arbëreshët, në bashkëvajtje zakonisht me një emër, me të cilin nuk formojnë as njësi frazeologjike e as lokucion foljor: *ec* (+*me shëndet*), *qëlloi* (+*gjum*), *trint* (+*kitara*), *thuhet* (+*qytet*), *është* (+*Milosao*), *u rodh* (+*hare*) *takënej*(+*sëpata*), *in* (+*këndime*) *këndonin*. Me këto kuptime specifike arbëreshe, De Rada dokumenton dhe sjell pasuri semantike të fjalët e përgjithshme të shqipes si: *eci*, *qëlloj*, *them*, *jam*, *rrjedh*, duke dhënë ndihmesat e tij për pasurimin e strukturës leksikore të shqipes

Në tekst gjenden dhe disa struktura me lokucione foljore, të cilat sipas nesh , pavarësisht se mund të jenë të dialektit dhe se një pjesë prej tyre nuk gjenden në shqipen e sotme, transmetojnë një forcë poetike të dallueshme nga këndvështrimi i një folësi të sotëm, të cilat të trajtuara nga ana semantike shfaqen si më poshtë:

Kur ia *dha një shkundullimë* “shkrepi një vetëtimë”. Ky është një lokucion foljor, në të cilën pjesa foljore ka dhe nuanca aspekte të fillimit të një veprimi. Është një përdorim dialektor i cili gjen përdorim edhe sot.

Unë më *vigham të pështieri* “ulem të tjerr”- Këtu kemi një strukturë, ku folja e parë sillet si gjysmëndihmëse aspekte, pasi këtu kuptimi i fillimit të veprimit është i qartë.

Vasha me një psherëtim / *bëri e shiti* lotëzit “zuri e fshiu lotët” –Edhe këtu folja *bëj* është në kuadrin e foljeve aspekte. Në fakt këtë strukturë e njohim dhe sot sidomos dialektin jugor.

Trim ti mua në *më do mir* “në më do të mirën?! ” (~ shumë < it. *voler bene*) Kjo formë njihet në shqipen e sotme, veçanërisht në gegërisht dhe është ekuivalente me strukturën në latinisht.

Ndër sheshet *sqepet* dielli “fshihet dielli”.Këtu kemi të bëjmë me një metaforë

Kali *më lëshonej*“më ikte” –Kjo është folje që përdoret me këtë kuptim në kontekstin situativ të jetës baritore. (I lëshoi lopët). Specifike shfaqet forma në arbërisht me trajtën e shkurtër dhe formën e foljes në joveprore. Kjo e fundit, pra pasivi sot është më i rrallë dhe e modifikon dhe kuptimisht, pasi i jep kuptimin e çlirimit e arratisjes, ndërsa sot përdoret më shumë në kuptimin e lëshimit për të kullotur, lirim i kontrolluar.

Kurmi *vete tue m'u reshtur* “më lodhet”/Me llërt përgjakur unë ka ballët *ia reshtja* “ia largoja

Te vargu i parë folja *resht* gjendet dhe në shqipen e sotme, por me kuptim tjetër (që gjithsesi është brenda grupit të foljeve të lëvizjes, shtyn , ysht bagëtitë). Mendojmë se sot na vjen si metafore e shuar, po që në arbërishte mund të mos e ketë parë këtë shmangie nga rrafshi neutral.

Në vargun tjetër shfaqet në të njëjtin kuptim (*shtyj, largoj*), po në rrafsh neutral.

Valljes *çë dridhet* mendojmë se pavarësisht përshtatjeve nga autorë të ndryshëm, kuptimi në të cilën folja del, sipas nesh është =*vallja se si rrotullohet, si merr formë*. Kemi një model tashmë dialektor dhe periferik mendojmë dhe në shqipe, pasi modeli është zëvendësuar nga folja *hedh*.

Delet *rrumpullarëshin* “zhurmonin”. Këtu dallohet një element që mendojmë se është i turqishtes –*llar-*, që na thotë se kemi të bëjmë me një formë relativisht të vjetër.

Shtjer ndë det ti mandilen “hidh në det.” Është në shqipen e sotme dialektore dhe si fjalë me të njëjtin kuptim dhe si model sintaksor.

Mbë të nisurit *e ruan* “e ndjek me sy, e vështron”. Kemi formën e vjetër të formës së sotme të pashtjelluar *me të ardhur*. Specifik është fakti se folja *nis* nuk del vetë përgjithësisht sot me këtë model, por me lidhëzën kohore dhe me trajtë të shtjelluar.

S’e përgjaku akulli –mendoj se kemi përdorim me efekte stilistike.

Udhëvet *mos më përpiq* “mos më ndal”. Folja *përpiq* natyrisht që sot nuk gjendet në kuptimin që del në varg. Nga analiza fjalëformuese vëmë re një temë fjalëformuese të gjallë në shqipen e sotme që na lejon dhe deskriptimin e strukturës. E kemi fjalën për foljen *piq*. Edhe sot në të folje gjejmë strukturën : U poqën në rrugë me X.

Mbahej kopilja “ruhej vajza”/ *Mba* tutje, “rri larg” Modeli i vargut të parë nuk gjendet sot në valencën e foljes *mbaj*, ndësa te vargu i dytë gjejmë një formë ekzistuese dialektore të jugut në urdhërore.

Nën throne pesë thëllëza *shkararëshin* “zhurmonin”. Edhe këtu mund të kemi prapë një huazim bazë nga turqishtja si sqarimi për foljen *rrumpallar*.

Gjtonit u errëtin: “*gjtonët u nxinë*” Mendojmë se kemi të bëjmë me metaforë, ose ndryshe me një strukturë që nuk e kemi sot.

Shi i but *bunarënej* “binte, buiste”. Nuk është në shqipen e sotme, por mund të kemi ndonjë neologjizëm fillimisht nga *bunar* si emër, i cili pastaj në këtë strukturë kalon në metaforë.

Ec me shëndet “lamtumirë”, përshëndetje karakteristike e cila në disa zona sot gjendet me foljen shkoj., po më shumë me formën e dëshirores e jo të dëftores.

Atje e qëlloi gjum “e zuri gjumi” / *Qëlluan gjuum* “fjetën”. Folja *qëlloi* këtu del në kuptimin e foljes aspektore zë. Mendojmë se është model i vjetër, ndoshta metaforë e shuar.

Trint kitara, është model që nuk e ka sot folja *tringëllin*, e cila e ka zanafillën në një onomatope.

Më *shture* sit “ më hodhe sytë”. Skemantilj *i ngit* mbë trual “shamia i prek tokën”

Janë struktura të cilën sot nuk i hasim, mendojmë se janë forma dialektore në të cilat mund të shohim ndonjë strukturë tashmë të shuar të foljeve *shtyj* dhe *ngit*.

Shkodra s’thuhet më qytet. Kemi elipsë në kuptimin që nuk mund t’i thuhet më qytet.

S’është më Milosao. Mendojmë se në kontekstin e veprës modeli ekzistues i foljes *jam* këtu merr një vlerë të veçantë stilistike, pasi nuk i referohet zhdukjes fizike, por dhe personalitetit të tij. Është në kuadrin e në pamje të thjeshtë pohuese, por që nga konteksti merr nuanca hidhërimi, humbjeje, vuajtjeje.

Një hare m’u rodh tek kurmi “një hare më pushtoi trupin”. Se te shoh / *kurmi më rrodhet* (dridhet). Mendojmë se kemi metaforë me nuancat semantike të foljes *rrjedh* si diçka që lëviz gjëllin, tipare të rinisë, të cilat krijojnë një kohezion semantik mjaft interesant.

Modele që nuk gjenden në shqipen e sotme

Të tilla dalin :

Sillej e përpiqej “sorollatej udhës”.

Mbrëmjeve thoin vashën e nëmur “përflasin vashën.”, një model që nuk e gjejmë sot për folje them.

Besën e kanë mbi vete “janë njerëz të besës”/E lja besa (i iku besimi) –Si modele nuk i gjejmë në shqipen e sotme, në të cilin emri besa del nëbashkëvajtje me foljen *kam /jam*. Natyrisht në rastin e parë është folja kam, po nuk është në asnjë rast e shoqëruar me sintagmën parafjalore me të cilën ndiqet.

Rasti i dytë nuk gjendet sot si model.

Noerit më bienith(më ikën mendja)

Së dii të friugn(s’ marr frymë, më ndal fryma, ngrij)

Patën fjalë (bënë fjalë)ndër vatra

Gjithë bota na *sqepën*“të gjithëve dheu na mbulon”

Pra çë shpin ti më rëzove “pas shpine ma punove”.

Lirisë çë *buartim* “që fituam”.në kuptimin që mirëseardhëm, folja *buart* mendojmë se është me origjinë nga turqishtja, është një arkaizëm historik.

Si përfundim mund të themi se mjaft folje dhe shprehje foljore të De Radës, por jo të vetmet, sigurisht sjellin vlera pasuruese, nuanca e ngjyrime emocionuese, larmi të shprehjes, zgjerojnë strukturat kuptimore dhe si të tilla e kanë të hapur udhën drejt standardit. Ato sikurse shprehet Akad. Jani Thomai: ¹“ *Janë shprehje të vlefshme që duhen mbledhur e futur në përdorim të përgjithshëm, sepse i sjellin pasurim të vërtetë gjuhës sonë standarde*”. Disa prej foljeve e shprehjeve foljore të tilla si: *Pas shpine më rëzove, sillej e përpiqej , e përgjaku akulli, e qëlloi gjumi*, tërheqin vëmendje për bukurinë e tyre, prandaj mund të rigjallërohen, të paktën me funksione e stile të veçanta: Kuptimi i ri që De Rada u jep fjalëve popullore, zgjerimi i kuptimeve është një rrugë e pasurimit të shqipes, e cila është përdorur gjerësisht nga rilindësit tanë, të cilët gjatë shekullit 19-të krijuan dhe futën në përdorim mjaft fjalë të burimit popullor. Edhe lokucioni foljor me vlerë futuri, por edhe infinitivi, i tipit *kam të vete*, sipas nesh, nuk duhet përjashtuar duke qenë se standardi është i hapur për të gjitha mjetet leksikore, semantike e gramatikore me vlerë pasuruese, pavarësisht nga burimi, prej të folmeje a prej autori.

Foljet e huazuara

Historia e gjuhës shqipe është ngushtësisht e lidhur me historinë e popullit shqiptar. Kështu të gjitha ngjarjet historike kanë lënë gjurmët e tyre edhe në gjuhën shqipe¹. Në rrugë kronologjike ndikimet e para në shqipe janë nga greqishtja e mandej ato nga latinishtja dhe gjuhët e bijave të saj, më pas shfaqen ndikime nga sllavishtja e turqishtja. Në veprën e De Radës gjejmë të shtresëzuara huazime kryesisht nga greqishtja, italishtja dhe fare pak nga turqishtja.

Foljet me origjinë nga greqishtja.

Sikurse gjuhëtarët pohojnë, takimi i shqipes me greqishten, duke qenë një takim mijërvjeçar, ka lënë gjurmë në gjuhën shqipe. Huazimet u përkasin dy fazave të gjuhës greke; greqishtes së vjetër dhe greqishtes së re. Foljet e huazuara nga greqishtja në gjuhën shqipe janë relativisht të shumta në numër. Shumica e tyre kanë hyrë në gjuhën shqipe nga koha e kryer e thjeshtë e greqishtes dhe vetëm një numër i vogël ka hyrë nga koha e tashme. Një pjesë e këtyre huazimeve kanë mbetur në disa të folme si krahinorizma, një pjesë tjetër ka dalë ,ose po del nga përdorimi (si fjalë të vjetruara ose historizma). Dialektet arbëreshe të Italisë janë të pasura me greqizma, disa prej të cilave mund të mos gjenden në asnjë prej të folme të dialektit jugor, ose mund t'i ketë vetëm e folmja e Çamërisë. Denduria e greqizmeve në arbërisht shpjegohet përmes arsytimit historike. Kështu është i pranuar fakti se arbëreshët e Italisë në përgjithësi origjinën e tyre e kanë prej Shqipërisë së Jugut(ku ndikimet e greqishtes janë më të rënda), një pjesë e tyre ishin të shkuar në Greqi, prej nga morën huazime greke dhe i përcollën në ngulimet e reja në Itali, mandej gjuhës së tyre i veshën edhe huazime nga greqishtja e kolonive të vjetra greke që shtriheshin në Italinë e jugut dhe ishujt. Në poemën “Këngët e Milosaos” numërohen rreth 40 folje të huazuara nga greqishtja bizantine. Aty-këtu gjejmë edhe folje me rrënjë nga fondi i shqipes të krijuara me prapashtesa greke, në përshtatje me rregullat gjuhësore të shqipes. Foljet e huazuar janë kryesisht të jetës shoqërore ose shtëpiake, të trupit të njeriut etj. Nga pikëpamja morfologjike ato na shfaqin interes, pasi shumica e tyre shfaqen të hibridizuara. Kështu kemi folje me bazë (rrënjë) leksikore-foljore greke, ose italiane + prapashtesë greke + mbaresë karakteristike të të folmeve arbëreshe, ose kombinime të tjera të këtyre elementëve. Këtij lloj trajtimi i janë nënshtruar edhe

huazimet nga italishtja. Nisur edhe nga materiali i vjelë në vepër, nga sfondin e huazimeve greke dallojmë dy shtresëzime:

1. Folje me rrënjë leksikore nga greqishtja + me prapashtesën greke **-is** < $\sigma\alpha$ + mbaresat foljore të arbërishtes/ ose elemente të tjera morfologjikë : *të* +*potiss+ën* (të pijë ujë), *u*+ *porsiljis(u ul)*,*lastimis+ej* (mërzitej), *të*+ *psovis+ënjën* (të pëlcastin),*u* + *hjimis+a* (zbrita),*tagjis+sën(ushqej)*,*shakëmiss*, *ljeghëmis+tin*(lehnin), *skotis*, *skaljiss* (prashis), *llaftaris+ën*, *terjoriss* (tjerr), *lampariss+ejin*, *tue*+ *laris+ur*, *shakëmiss* (prish).
2. Folje me rrënjë leksikore nga greqishtja + me prapashtesën greke **-es** < $\epsilon\sigma$ - - **os**,+ mbaresat foljore të arbërishtes/ ose elemente të tjera morfologjikë: *parakales+a* (lutesha), *parasten*(rri bashkë), *vares+sinj* (rëndon, mërzit), *ljeveros+su* (lirohu), *fanaros+set* (shfaqet)
3. Folje me **ps** < $\epsilon\psi\alpha$, ψ , me **-aks**, me- **ks** rrënjë leksikore nga greqishtja + me prapashtesën greke **-es** < $\epsilon\sigma$ - - **os**,+ mbaresat foljore të arbërishtes/ ose mjete të tjera gramatikore: *magjeps+ënth*, (magjeps), *faneps+ëjin* (shndrit), *të zileps+njën*, *pataks+et* (ngrihet në këmbë), *taks+ën* (premtinin), *tue+fiantaks+ur* (duke ëndërruar), *porseks+a* (dallova), *oreks+ën* (lehtëson), *u+pataks+a*(u shtanga nga habia), *piks+i*, *të +jem* +*fes* (të jem në faj), *pieks+ënej* (plekste, thurte), *pandeh+ja* (mendoja).
4. Elemente të greqishtes gjejmë edhe në folje të tipit: *garroj*, *garepsën*, *garaksën*, ku frikativja velarë e zëshme /gh/, e cila del në variantin me /g/ :*gapi* (hapi), është në fakt shkronja greke χ . Këtë e përforcon edhe fakti që dy foljet e fundit janë huazime të mbartura nga greqishtja.

Është për tu shënuar fakti se një pjesë e foljeve të huazuara nga greqishtja në tekst janë përdorur me ngjyrimë stilistikore, plotësuar edhe nga dëshmia se në vepër ato kanë sinonimin e tyre asnjënjës. Kjo mund të mbështesë edhe faktin që foljet e huazuara në gjuhën shqipe nga greqishtja kanë hyrë si huazime gjuhësore, pra si sinonime. Sikurse vihet re në vepër ato përdoren në mikrokonteste të caktuara dhe nuk gjejnë përdorim të plotë në vepër. p.sh.; folja *parakalesa* gjen vetëm përdorim të

karakterit religjioz. Udhës ashtu *parakaljesa*, shën Mëri e shpivët tona këtë udhë ti të më ruash (Këng. 15, f. 54).

Huazimet nga italishtja

Dukuria e depërtimit të huazimeve leksikore të italishtes në të folmet arbëreshe të Italisë sigurisht që nuk ka lënë pa prekur edhe sistemin foljor të tyre. Studiues të ndryshëm janë marrë me dukurinë e infiltrimeve të elementit italian në të folmet arbëreshe. Në trajtimin që i kanë bërë kësaj dukurie, të gjithë gjuhëtarët njëherazi janë ndeshur më së pari me problemin e ndarjes së elementit italian që ka hyrë në të folmet arbëreshe pas shpërnguljes nga trungu mëmë, nga elementi latin që kishte depërtuar në shqipe para se të niste mërgimi i arbëreshëve. Ne nuk po ndalemi në grupin e italianizmave, (apo edhe latinizmave të përbashkëta) për shqipen dhe për të folmet arbëreshe para se të niste shpërngulja e arbëreshëve, por në italianizma që kanë hyrë në arbërisht pas shpërnguljes nga trungu mëmë. Sigurisht që këto huazime dallohen për gjurmët e dukshme të shqiptimit në ndikimin e italishtes dialektore¹ prej nga janë marrë. Hyrja e tyre është bërë në varësi nga shkalla e ruajtjes dhe e gjallërimit të tyre. Siç dihet hapësirat dhe kufijtë e përdorimit të arbërishtes në Itali janë në varësi të disa faktorëve, prej të cilave do të veçonim :mjedisin dhe kontekstin shoqëror, marrëdhëniet midis bashkëfolësve dhe fushat semantike që mbulojnë. Huazimet nga italishtja, megjithëse në të folmet arbëreshe përbëjnë shumicën dërrmuese të huazimeve dhe kanë ndikim të madh, në to nuk zënë vend të madh në leksikun e De Radës

Nga huazimet prej italishtes në vepër dallojmë:

Dukurinë e ndërrimeve fonetike të natyrës shqiptarizuese, ndërkohë që në gjuhën shqipe kjo dukuria ka pushuar së vepruari. Në foljet që tregojnë *veprime apo gjendje*, në të folmet e arbëreshëve të Italisë, huazimi bëhet duke i kthyer foljet përkatëse nga paskajorja e italishtes në të tashmen në arbërisht me mbaresën *-onj, -enj, -inj*.psh; *cumand-onj*

1. Folje të huazuara me rrënjë leksikore nga italishtja: *fërnoi-* (nga it. *finire*),: *piugurosur-*(nga it. *polverizzato*), *dishëron -*(nga it. *desiderato*), *usse -* (nga it. *dëmtove*), *shollariet-* (nga it. *scialare*).

1. Së treti dallojmë huazimet e kalkimet nga italishtja, si: *më do mir* <it. *voler bene; via, ri mir, monu frija*

Huazime të përziera: italisht+ greqisht+ shqip

1. *via* (nga it.)+*levrossu* (nga greq.) – *rrugë e mbarë*
2. *(g)are+ ps(element nga greqishtja)+ën,*
3. *mbë+ të+ garaksur (+ara+(ks element nga greqishtja)+ur,- në të aguar*

Gjeografia e huazimeve leksikore në sistemin foljor të Milosaos mund të paraqitet edhe sipas këtij **grafiku:**

Folje të leksikut shqipes, folje nga greqishtja/ose elementë me nga greqishtja, folja nga italishtja/ose me elemente nga italishtja dhe huazime të përziera/ të tjera.




Tabela III.1

KREU IV

IV.1.FJALËFORMIMI

Formimi i fjalëve të reja shihet prej gjuhëtarëve si një nga rrugët kryesore për pasurimin e fjalësit në gjuhë. Fjalëformimi në gjuhën shqipe shfaqet i gjerë dhe në mjaft raste me modele prodhimore. Ky sistem parashikon tipet e fjalëformimit sipas prejardhjes (këtu futet parashtesimi, parapashtesimi, parashteso-prapashtesimi dhe fjalëformimi pa ndajshesë¹), përngjitje, kompozim, konversion dhe tipat e përzierë).

Nga një analizë e bërë në korpusin e foljeve të gjetura tek “Milosao” shohim të materializuar disa prej këtyre modeleve, ku tërheq vëmendje formimimi i fjalëve mbi bazën e disa parashtesave dhe prapashtesave prodhimore në gjuhën shqipe. Nga analiza arrijmë në përfundimin se një pjesë e konsiderueshme e foljeve të përdorura në të nga pikëpamja sinkronike janë të parme¹:

*Ndien(ndienj),¹, ronej; vatte(vatur); u pruar(pririer) them, tundënj, u rodh (mbanj);
vë(vura), del; thaiti(thanj); dukëshim; virëshin(varënj);vejim; jam-; ngrynej; ngit;
këntuan; erth; ecia; prittej; ndahëshin; zëi; fjissin; hinj, ftoh, bënj, dighet; vu;
pressën; gjegjën, resht,frij, ikën;;pjeksënej; çoi; dieg; lipën; ngjittej; lottënjën;
harronen;; leu; shinej; buten;; ikën; lërejnin; lëshonj, ruanjën; sheh; lodhënit; ra;
ri; e mbiedh; bie; holq); zgjonet(zgjonj); trëmbiet(trëmbënj);qeshënj;;
(gëzonj),pështonj, pushonj bëri; gapën; shuanith; u mbilëtin; qel; di; mer; rëmpeu;
rit; shtjer; shkonej; tundënej(tundënj); qettet; dredh; luttënjën;; uli; fiëiti; duan; rii;
tir;u gapëtin; ghipënej; leghen;; vdiq, bunarënej , martonj, shkonj, njoga,
sholariat(shkallmohet), qëllonj ,lanj, vir/var, etj,*

Folje të prejardhura

Folje me prapashtesim

Pas foljeve të parme numrin më të madh e zënë foljet e formuara me prapashtesim. Prapashtesimi është ai tip fjalëformimi, i cili përdor si formant fjalëformues prapavënës, një mjeti të tillë fjalëformues si prapashtesa. Në shqipen e sotme ky është

një tip prodhimtar në sistemin foljor. Edhe në këtë etapë të zhvillimit të shqipes spikat numri i foljeve me prejardhje. Kjo dëshmohet edhe në poemë, brenda saj hasim disa tipe prapashtesash me të cilat formohen foljet e prejardhura, të renditura si më poshtë.

Folje të formuara me:

- prapashtesën **-o**, e cila është edhe ndër prapashtesat më prodhimtare në sistemin foljor të shqipes:

bukuronj, pastronj, fërnonj, heljmonj, cumandonj. e parme), qëndronj, gjëmonj; luftonj, dhunonj, ëndërronj, dishironj, besonj .

- prapashtesën **-so-**: *lehtësonj (leht+ëso+nj)*,
- prapashtesën **-os**: *tjerr+os+ënj, fanarosënj, pjuhurosënj. (levross?)*
- prapashtesën **-s/-is**: *pik+s, tërjor+is+ënj, llaftarissënj, tagjisën lehtëmistin, llamparissinj, larissënj, shakëmis*
- prapashtesën **-llo**: *bardh+ëllo+nj, shtrushullonj, pikullonj*
- prapashtesat **-i, (ë)lli-**, të cilat nuk janë përfshirë në Gramatika I e ASH, pasi mendojmë se dalin si variante dialektore të prapashtesave **-o, -llo**:
ëndër+i+nj^l, trint+ëlli+nj^l
- prapashtesa **-(ë)zi-**: *nganj+ëz-it (ndjekin)*
- prapashtesa greke **-ps-**, : *gare+ps+ën (harepsën, gëzuan), ziljepsënj.*

Folje me parashtesim

Parashtesat që vihen re në teksti e De Radës janë parashtesa që gjallojnë edhe sot si mjaft prodhimtare në gjuhën shqipe si:

- Parashtesat **-sh, -s**.

Megjithëse formimet me këto parashtesa janë mjaft prodhimtare në gjuhën shqipe, në poemë na shfaqen të vogla në numër: *sh+prishën; shtëfrinej (shfryj), s+bardh, stisin.*

- Parashtesa *-për-* me te cilën në gjuhën shqipe janë formuar një numër ikonsiderueshëm foljesh nga vetë foljet ose emrat në vepër shfaqet në këto raste: *përlip, përbaltën, përljot, përflush(valëzoi), përtroll (tërheq)*.

Folje me parashteso-prapashtesim

Ngjitja njëkohësisht e një formati parashteso-prapashtesor është një tip fjalëformimi më i rrallë si te De Rada, ashtu dhe në shqipen e sotme. Në tekstin e Milosaos numri i foljeve të tilla është i kufizuar:

zbardhëllonj.

Folje me përngjitje

Përngjitja është një tip fjalëformimi i cili kërkon një analizë jo vetëm në rrafsh sinkronik, por dhe diakronik. Në shqipen standarte numri i foljeve të përngjitura është i pakët. Në vepër krahas lokucioneve foljore gjejmë rrallë edhe disa folje të përngjitura, të cilat janë të formuara me përngjitjen e parafjalës *në* dhe variantin dialektor *mbë*, të tipitstruktural parafjalë e rasës kallëzore + emër; *nkuqin, përgjaku*

Tipe të përziara: *mbuzati rrumpullarëshin, gërvishtëtin (o prapashtesim me ose tipa të perzier), mer+ign kundërmon), ngjet.*


PËRFUNDIME

Nga parashtrimet, analizat dhe krahasimet e sistemit foljor të De Radës, mbështetur kryesisht në veprën e tij “Këngët e Milosaos”, dhe në Gramatikën e hartuar prej tij, mund të nxjerrim këto përfundime të përgjithshme:

Sistemi foljor i përdorur prej De Radës, përgjithësisht nuk ndryshon nga ajo e Krahinës së Kozencës. Vihen re prirje të tij për të sjellë edhe ndërtime të veçanta që janë të rralla në të folmet arbëreshe, si përdorimi i paskajores.

Në krahasim me sistemin e parashtruar në Gramatikën e tij, duhet të themi se parimisht nuk mund të bëjmë një krahasim të mirëfilltë mes analizës së paraqitur për Gramatikën dhe analizës së bërë në veprën e Milosaos, pasi korpusi në Poemë paraqitet më i kufizuar, se ai që De Rada përdor për të hartuar Gramatikën. Fakti, që kemi të bëjmë me një tekst letrar sjell kufizim të elementëve. Mendojmë se në Gramatikë janë marrë parasysh përdorime me konotacion më neutral, ndërsa për Poemën nuk mund të thuhet e njëjta gjë.

- ❖ **Nga një vështrim i përgjithshëm i mjeteve gramatikore duhet të themi se:**
- ❖ Nuk mundet që, duke u mbështetur në mjetet gramatikore të bësh klasifikim teorik për mjete të veçanta.
- ❖ Ka përzierje të elementeve gramatikorë.
- ❖ Mjetet gramatikore paraqiten disa formëshe: të plota, veçanërisht në Gramatika, ku jepen paradigma të plota të sistemit foljor; të reduktuara, veçanërisht në Poemë, ku dalin kryesisht veta e parë njëjës dhe veta e parë dhe e dytë shumës.
- ❖ Gjejmë mjete gramatikore, të cilat shtrihen nga njëra kohë në tjetrën.
- ❖ Format gramatikore shfaqen sintetike, por një pjesë e mirë e tyre dalin analitike. si rrjedhojë e zhvillimeve të mëtejshme të ndryshimeve aspektore. Nga paraqitje grafike shohim se dendurinë më të mëdha në poemë e shfaq mënyra dëftore, e cila së bashku me lidhoren dalin si forma bazë për modalitetin e veprimit.
- ❖ Pavarësisht rasteve të veçanta, vihet re se paradigmat e mënyrave dhe kohëve shfaqen pa ndryshime të konsiderueshme me shqipen e sotme.
- ❖ Tërheqin vëmendjen ndryshimet fonetike me vlerë gramatikore, një pjesë të së cilave e gjejmë edhe në gegërishten e sotme, në të folmen e Çamërisë (me të cilën vëmë re ngjashmëritë më të mëdha si në strukturë edhe në trajtëformimi) dhe ndonjëherë me të folmet e arbëresheve të Greqisë.



Të skicuara sipas mënyrave dhe kohëve përkatëse, format foljore dalin sipas kësaj paraqitjeje:

Mënyra dëftore

Në sistemin foljor të gjuhës së De Radës, tek vepra “**Këngët e Milosaos**”, mënyra dëftore ka korpusin më të madh të foljeve që përdoren në poemë (rreth 730 raste). Kjo mënyrë paraqitet me një shumëllojshmëri formash, nëpërmjet së cilave shprehen dallime kuptimore me karakter kohor dhe aspektor. **Koha e tashme** në formën veprorë në foljet e zgjedhimin e parë dhe të dytë gjejmë të ruajtur mbaresën e vjetër -nj- (Më mirë të themi dhe të kombinuar me elemente të tjera, jo në të gjitha rastet vetëm.): v. I –(ë)nj, v. II –(ë)n, v. III –(ë)n; shumës: v. I –(ë)mi/(ë)njëmi/ëm, v. II –ni/ënjëni/ëni, v. III –njën/ (ë)njën/ën.

Mund të shihet se nuk kemi ndonjë ndryshim të rëndësishëm me sistemin e mbarsave që hasen sot të e njëjta folje. Duket dyfishimi i *i-ë-* në temë që mendojmë se është tregues i një zanoreje të gjatë. Mbarsë karakteristike, ndryshe nga shqipja e sotme e vetës së tretë shumës është –ën. Natyrisht është i kuptueshëm kalimi nga -nj në -j për vetën e dytë e të tretë njëjës dhe të dytë shumës (E cila shfaqet dhe këtu ndonjëherë.), pasi ky është një proces i përfunduar për shqipen e sotme.

Foljet e zgjedhimit të tretë në tre vetat e para marrin mbarsë zero, si në shqipen e sotme. Në vetat e shumës dalin me mbarsat –më, -ni, - në (pra mund të themi se kemi të njëjtat forma me të sotmet).

Në formën joveprorë pavarësisht ndryshimeve tematike të caktuara, mbarsat e foljeve shfaqen të njëjta si sot: v. I –(h)em, v. II –(h)e, v. III –(h)et; shumës: v. I –(h)emi(, v. II –(h)eni v. III – (h)en.

Trajta analitike e së tashmes (e tipit jam+ lidhëza e + folje në kohën e tashme) shfaqet vetëm në një rast: Ç’ është ikën si ajëri? Këng VI.

Në fakt në shembullin e përdorur nga De Rada lidhëza bashkërenditëse e, mungon si pasojë e kontraktimit (në prani të zanoreve të tjera) dhe folja *ikën* shpreh veprimin themelor në kohën e tashme, një veprim aspektor të zgjatur me kuptimin *po vij, jam*

duke ardhur, të cilat janë të ngjashme nga forma dhe krejt të njëjta nga kuptimi me ato të të folmeve arbëreshe.

Koha e pakryer del: me një trajtë të thjeshtë, mbaresat e së cilës, në pjesën më të madhe janë të njëjta ose afrojnë me ato të të folmeve më arkaike të skajit jugor. Për dy vetat e para të njëjësit dhe për tri vetat e shumësit mbaresat e së pakryerës (për foljet e trajtës veprorë) janë të njëjta si për foljet me zanore ashtu edhe për ato me bashkëtingëllore: v. I –(ë)nja, v. II –(ë)nje, shumë: v. I -njim, v. II -njit, v. III -njin, ndërsa në vetën e tretë njëjës gjendja është disaformëshe: me mbaresën -nej p.sh. *ljanej* “lante” -ij p.sh. *ljëij* “linte”, pa mbaresë p.sh. *prit* “priste”, *vej* “vente” etj. Për ta kthjelluar gjendjen e kësaj trajte po japim paradigmen e disa foljeve kryesore:

Në formën joveprorë vëmë re shfaqjen e alomorfrit të sotëm –*hesha/ësha, heshe/ëshe, he/ej, heshim/ëshim, hëshit/ëshit, hëshin/ëshin* me ndonjë ndryshim në foljet e zgjedhimit të dytë në vetën e dytë dhe të tretë shumë, ku reflektohet ndryshimi i ë-së në e, ndryshe nga shqipja e sotme, si një variant dialektor.

Karakteristikë e trajtave të së kryerës së thjeshtë është se në dallim nga gjuha e sotme shqipe, në vend të aoristit me -va për mbizotërojnë trajtat e aoristit me –ta: *ljaita, fiita. piejta; u dogja, i ljaita*. Specifike shfaqet mbaresa e vetës së parë shumë e cila del formë të ndryshme nga shqipja e sotme: *lja-itëm, frii-tëm, pie-jtëm*. Ajo, megjithëse nuk përputhet me standardin, përputhet me shumicën e të folmeve të shqipes.

Koha e ardhme e thjeshtë del në këto trajta:

- Kam + lidhore , *kam të rrëmpen/ kam të vion(ruaj)*
- Kam +infinitiv (paskajore), *kam me ljar/ kam me u ljar*

Koha e ardhme e së shkuarës shprehet me formën analitike

- Do +të në variantin arkaik; *Dee+ te (g)harronj*
- Kjo e ardhme në poemë është përdorur vetëm një herë në formën e **së ardhmes së të shkuarës**, ku vihet re ndryshim i konsiderueshëm fonetik për foljen *do*: *Dee të garroja* se te bora/ biren kronjet dhe të mbjellat që na mbajnë gjallë. Kënga VI. Mendojmë se varianti *dee* është një përdorim dialektor arkaik i foljes *do*, në kohën e pakryer me ndikim nga veta e dytë *do + e > dee*.
- **Kohët e përbëra** në përgjithësi nuk shfaqen në sasi të madhe numerike. Më së shumti dalin në veta të veçanta.

Koha e kryer

Koha e kryer strukturalisht del e njëjtë me formën e sotme: *Kam/ kee/ passur rëmpier*

Koha më se e kryer

Koha më se e kryer veç formës veprorë , shfaq dhe atë joveprorë. Strukturalisht shfaqet i njëjti kombinim si në shqipen e sotme, mes foljen ndihmëse dhe pjesores.

Natyrisht në të dy elementet vihen re ndryshime fonetike të sqaruara në kapitujt përkatës, pjesë e variantit ku ato shfaqen.

Unë kesh/ kishnja passur rëmpier u kesh/ kishnja passur rëmpier

Ti kije passur u kije passur

Ai kish passur u kish passur

Koha e kryer e tejshkuar është pothuajse e papërfillshme numerikisht, por pa dalë jashtë zhvillimit që vihet re në shqipen e sotme.

Patta/ patte passur rëmpier

Mënyra lidhore

Në korpusin e mbledhur nga mënyra lidhore nuk shohim të na shfaqet në të katërta kohët e saj, por numri i formave foljore të përdorura është i madh. Zakonisht shfaqet e pakryera dhe tashmja. Të dyja këto kohë i përshtaten konteksteve situative dhe stilit herë përshtatës dhe herë dialogues të veprës.

Në **kohën e tashme** në formën veprorë në foljet e zgjedhimin e parë dhe të dytë vihet re përdorimi i temës së foljeve të zgjedhimit të parë, të cilat këtu shfaqen me formën më të vjetër ndajshesore me -nj- (të mos ndanjemi, të kujtonj etj), e cila nuk shoqërohet me një ë, që i prapavihet formës së sotme (sot të komandojë, kurse në vepër: ta kumando-nj)

Gjejmë të ruajtur mbaresën e vjetër -nj-: v. I -nj, v. II -sh, v. III -(ë)n/inj; shumës: v. I -nëmi v. II -ni, v. III -jin/nën. Siç vihet re veta e tretë njëjës dhe shumës shfaqin variante mbaresash.

E pakryera shfaq mbaresa në të cilat dallohen forma dialektore: v. I -ja, v. II -je, v. III -ij; shumës: v. I -jim v. II -jit v. III -jin

Kohë të përbëra

Numri njëjës; të kem, të keesh, të keet passsur/ rëmpier

Numri shumës; të kimi, të kini, të kin passsur/ rëmpier

Mënyra urdhërore

Në veprën e De Radës mënyra urdhërore dhe format përkatëse të saj dalin në rrafshet specifike, jo vetëm në lidhje me elemente dialektore të arbërishtes, por në rrafshin semantik ajo na shfaqet me struktura jo thjesht të urdhërores së fortë.

Nuanca modale më e zakonshme e shprehur nëpërmjet këtyre rasteve në strukturë, del nuanca e lutjes deri në dëshirë dhe asnjëherë urdhërorja e fortë. më jep/ jepmë, qëndro, thuam/ thomnie, gapnie, mir, thërit, puth /puthëm, ec, zëgjou, duro, ruana/, ruaj/, më ruani, shtier/shtiir, ljut/ ljut-u, ha (ga), mbjith.

Përgjithësisht përdoret veta e dytë njëjës në formën veprorë, e shoqëruar shpesh me praninë e trajtave të shkurtra. (Në fakt kjo vetë induktohet nga skenari, sipas të cilit zhvillohen ngjarjet).

Mënyra dëshirore

Formalisht dëshirorja në poemë karakterizohet nga ekzistenca e mjeti sintetik specifik, si prapashtesa trajtëformuese që del me disa trajta alomorfesh të tilla *si fsh/sh/ç: vash(vafsh) kioft ,më martoshin, ruash.*

Mbaresat e mënyrës dëshirore që dalin për kohën e tashme në Gramatikë janë: *sha,shë, të/ftë/stë, shim, shit, shin.*

Ljagh-ësha , ljagh-ëshë, ljagch-të; ljë-sha, ljë-sh, ljë-ftë.

Forma joveprorë paraqitet me po të njëjtat mbaresa me paravendosjen e formatit –u: *U ljagchësha, u ljagchësh etj*

Interes paraqesin edhe paradigmat e foljeve *kam* dhe *jam* : *pash, pash, past, pashit, pashin, kiohë, kiotë, kiohim, kiohit, kiohim.*

Shprehje të dëshirores gjejmë edhe përmes përdorimeve të veçanta të kohëve a mënyrave të tjera të të projektuara në struktura specifike dhe me pjesë të tjera ligjërata.

Mënyra habitore

Mënyrat habitore, ende nuk është kristalizuar, por kuptimet e saj jepen semantikisht me mjete të tjera gjuhësore. Në tekstin e De Radës nuk gjejmë shfaqje formale të kësaj mënyre ,por gjejmë shfaqje të strukturave prej nga mund të ketë dalë.

Haborja shfaqet në struktura me folje të mënyrave të tjera, ashtu siç mund ta e gjejmë dhe shqipen e sotme. Në vepër gjejmë këto shprehje të habitores:

Në shembullin e vjelë: Me këtë mot të bëje finjën/ Duart si *më t'u nkuqtin!*, Kënga XIV,(krahaso: Duart si të skuqkan! vëmë re se folja është formalisht në lidhore, por kuptimisht e shprehur në strukturë, del me kuptimin e së kryerës habitore .Folja shfaqet mjaft interesante në lidhje me fjalëformimin, pasi mendojmë se ruan shenjat e një sintagme parafjalore të përgjitur, natyrisht me rënie fonetike (*në të kuq*).

Mënyra kushtore

Nga shqyrtimi i strukturave ligjërimore në poemë, lehtësisht mund të dallohet se jo në pak raste fjalitë kushtore realizohen pa përdorur foljet e mënyrës kushtore. Për këtë arsye, pavarësisht se në pamje të parë duket se mënyra kushtore nuk gjendet formalisht në tekstin e Milosaos, ajo realizohet strukturalisht me folje të tjera dhe në struktura sintaksore karakteristike për të siç janë: format koha e tashme e dëftores dhe e së ardhmes dëftore, që dalin pa ndryshime në temë e mbaresë , por kuptimisht realizojnë kushtoren psh; Se ti më merr ti ku më *çon*; Ç'ë së prita, por u nisa?!*Ardhur kisha* me uratën.

Në shembullin: Fanëmir *ndë pixënej* rëmpet e diellit (fatmir, nëse do të endte rrezet e diellit) /do ta ndiente veten të lumtur nëse do të endte rrezet e diellit, tipi i së ardhmes së të shkuarës është përdorur edhe në funksion të mënyrës kushtore.

Format e pashtjelluara

Për sa u përket përdorim më të gjerë shfaq **pjesorja**, e cila realizohet me anë të:


- Prapashtesave trajtëformuese të njëjta me këto të sotme: *martuar, ngarkuar, perënduar, helmuar, shkundur, lëshuar* etj.
- Prapashtesës trajtëformuese të gegnishtes –m(e): *lëshueme, shenjtërueme*.
- Elementit karakteristik trajtëformues *ith*, i cili nuk gjendet në shqipen e sotme: *vdekur-ith, garruam-ith, përlijpur-ith, ngrëitur-ith*.
- Prapashtesën trajtëformuese arkaike –*ën* psh; arrën (arritur).

Përcjellorja shfaqet në përgjithësi e ndërtuar nga paravënia e variantin të hershëm *tue*, ashtu siç e gjejmë dhe në gegërishten e sotme, ndërkohë, elementi i dytë, *pjesorja e foljes* shfaqet në variantin e normës së sotme letrare *tue larisur, tue m'u reshtur, ture i thir, ture tieerr*. Në poemë është përdorur megjithëse rrallë edhe varianti dialektor dytësor, i cili gjendet vetëm në të folmet arbëreshe *ture, i cili në gegërishten e sotme shfaqet me format tuj/tu..* Shembujt e përdorimit të këtij varianti dytësor pranë pjesores së foljeve *thir* dhe *tierr* mbështesin arsyetimin e Prof. Demiraj se: *Arsye e një dukurie të tillë duhet shpjeguar ndofta me ndikimin e elementit të dytë të formës analitike që del me formatin –r(ë). Me fjalë të tjera këtu ka vepruar njëfarë asimilimi prapavajtës.*

Forma e pashtjelluar **paskajore** tërheq vëmendje, pasi megjithëse gjendet rrallë në të folmet arbëreshe, përdor paskajoret prej De Radës në variantin e dialektit toskë, e cila sot është edhe formë përfaqësuese e standardit, duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzat *për të; për të puthur, për të varessur, për të stolisur*. Në vepër ajo del pa ndryshime, qofshin këto edhe fonetike.

Në Gramatikë ndeshim edhe raste të paskajores me pjesëzën **me + pjesore**, të cilat ngjajnë me ato të gegërishtes; *me ljaar, me u ljar*.

- ❖ Nga analiza e materialit të marrë në shqyrtim, si nëpërmjet krahasimit me trajtat e gjuhës letrare shqipe, edhe me ato të gjuhës dialektore të sotme në Shqipëri, vërejmë njëkohësisht ngjashmëri dhe dallime me gjuhën e sotme letrare dhe dialektet në të gjitha trajtat foljore si tek të thjeshtat, edhe tek trajta foljore të përbëra. Nga krahasime tona rezulton se përkimet më të mëdha janë me *dialektin toskë, ku dendurinë më të madhe e zënë përkimet me çamërishten*.



Siç vihet re edhe grafikisht, tiparet më të dendura sistemi foljor i De Radës i shfaq me dialektet, ku mes tyre vendin kryesor e zë dialekti toskë.

Duke veçuar pikëtakimet me gjuhën standarde dhe dialektet, kemi dhënë edhe raportin mes tyre për të arritur në përfundime të cilat hedhin më tepër dritë, si për sa i përket origjinës prej nga kanë ardhur më së shumti arbëreshët, por edhe për të ndihmuar në zbulimin e origjinës së këngëve popullore, ku De Rada u mbështet për krijimin e poemës madhështore “Këngët e Milosaos”.

Përkime me dialektin toskë

Pikëtakimet më të shpeshta i gjejmë me çamërishten, e cila sot shfaqet si një e folme që mbart mjaft elementë konservatorë:

- ❖ Në poemë në kohët e përbëra shfaqet një shprehje e veçantë e formës joveprores, e cila gjendet vetëm në të folmen e çamërishtes me paravendosjen e formatit *-u* :
 - U pati mbjedhur ai ndër shpi. Deljet tona u kinë gapur , /veç e mban nën një kumbul u kish uljur me trim (këng XX).*
- Mbaresa karakteristike, ndryshe nga shqipja e sotme del tek foljet me temë në bashkëtingëllore, veta e tretë shumës *-ën, si në çamërisht.*(*lampariss-ën, potiss-ën, pres-ën, shoh-ën, gareps-ën.*
- Folja *kam* në vetën e tretë shumës koha e pakryerën, del më mungesë të e *-sh* tek e cila del me trajtën e sinkopuar *kin*. Të dyja format janë variante dialektore të njëjta si në çamërisht prej së cilave forma e parë është më arkaike.
- Në paradigmat që jepen për foljet *jam* dhe *kam*, për kohën e pakryer: *ishënja/jesh, ishënje, ish, ishënjim/ jeshmë, ishënjit/ishënjin* dhe *chishënja/chesh, chishënje/cheshnje, chishënjim/cheshëm, chishënjit, chishënjin* varianti i parë tregon për trajta të këtyre foljeve, të cilat¹ janë ende të pranishme në disa të folme jugore, ndërsa varianti i dytë i cili përputhet plotësisht me çamërishten mendojmë se është formë arkaike.

Këtë mendim e përforcon edhe Prof. Demiraj në “Grammatikë historike e gjuhës shqipe” f. 741 kur pohon se: “Tek format e shumësit *jesh(ë)shëmë, kesh(ë)më, thosh(ë)më, më të vjetra janë ato pa zanoren mbështetëse –ë–*, si dhe kur shpjegon shndërrimin –e në i-, që foljet jam dhe kam, kanë pësuar në kohën e pakryer, e cila sipas tij është përfutur fillimisht në vetën e tretë shumës dhe në kohë më të vonë është shtrirë për analogji edhe në vetat e tjera.

- Realizimi i joveprores del mjaft specifik në këtë shembull :Atje prannë *t’u kish passur rritur* i pagëzuari i arbëresh. Përdorime të tilla shfaqen si formula tipike letrare të prozës popullore. Në të folurën e çamërishtes kjo formë përdoret ende dendur në ligjërimin bisedor, për të shprehur edhe nuanca të habitë. Krahaso: Atje na na *qenkësh rritur* i pagëzuari i arbëresh.

Duhet thënë se këtu kemi një formë të mbipërbërë, e cila në fakt gjendet jo vetëm në eposet e veriut me vlera stilistike karakteristike, por dhe në gegërishten veriperëndimore të sotme. Ndryshon nga çamërishtja veç nga trajta e pjesores në fund (*T’u kish pasë rritë Muji.*)

- E ardhmja e tipit do+ lidhore është përdorur në formën e ***së ardhmes së të shkuarës***, ku vihet re ndryshim i konsiderueshëm fonetik për foljen *do*¹: *Dee të garroja* se te bora/ biren kronjet dhe të mbjellat që na mbajnë gjallë. Kënga VI, Milosao. Mendojmë se varianti *dee* është një përdorim dialektor i foljes *do*, në kohën e pakryer me ndikim nga veta e dytë *do + e > dee*.

Natyrisht procesi i ngurtësimit të foljes ***dua*** për të dhënë të ardhmen, me sa duket nuk ka mbaruar ende në këtë periudhë. Ende sot në çamërisht gjejmë përdorime të tilla.

- Trajtat e kohës së ardhme me lidhore : *Ka të niset* e magjepsur? (kënga III) *Kur të pririam* ndër të guaj/të frighiesh/Si të guaj ti *të më diish*. (*si të huaj do të më dish*). Formalisht format foljore shfaqen të ngjashme me të tashmen lidhore joveprore, por kuptimisht zëvendësohen natyrshëm me të ardhmen.
- Trajta e kohës së ardhme me foljen “*kam*” (e cila e ruan trajtën e saj të pangurosur d.m.th. ndryshon sipas vetave dhe numrit) + lidhoren me ruajtje të pjesëzës të: p.sh. *jetër sa kam të rronj*, pra çë zot *kee të na ljëësh*; pse na *kem t’ikim?*
- Shfaqja e foljes *them* përgjithësisht në përdorim me trajtat e shkurtra: *Kujt të m’i thet?, Thuam* ndë do gjë. *Thomnie* ju të dashurit e mi.

Kjo folje dhe realizimi strukturor i gërshetuar me kuptimin që del, mendojmë se nuk është studiuar, ose të paktën sqaruar si duhet. Siç e kemi shprehur ajo shfaqet mjaft e shpeshtë në çamërisht, me të cilin kemi parë ngjashmëritë më të mëdha, e shoqëruar dhe me një pasthirmë *-o*. Ky bashkëshoqërim krijon dhe në ligjërimin e shkujdesur një formulë deiktike, e cila i jep nuancat e këngës recitative edhe ligjërimin të thjeshtë bisedor.

- Trajta e prezentit shumës me *-mi* (*thomi, shomi*).
- Përdorimi i së pakryerës të pazgjeruar (dheut të errët tek ti *flij*)

- Aoristi sigmatik *pe* (pashë)
- Zgjerimi me *-enj* i foljeve jo me temë në zanore: *qeshënj, lqip-ënj*
- Mbaresa *-ej* në të pakryerën joveprore veta e tretë njëjës, ndërtuar mbi bazën e kohës së tashme dërgo-*nej, marto-nej; ro-nej, shtrushullo-nej, qia-nej*
- Grupi- *fsh* në të gjitha pozicionet del në /sh/: *shinj* “fshij”, *qosha* “qofsha” si në çamërisht.
- Te foljet e zgjedhimit të dytë koha e tashme dëftore
- Veta e parë dhe e dytë (shumës) dalin: *shes-ëmi, nga-ssëmi dredh-ëm shitt-ëni, dredh-ëni, ngi-ttën*

1. *Prania e elementit -ith* si mbaresë foljore, pothuajse në të gjitha kohët e dëftores dhe kohën e tashme të lidhores: çehren më i *shuan-ith*, gjumi mua më *ljodhën-ith* (kënga VIII), dielli që dihet vashës i *qeshënth*, noerit më *bienith* (kënga XI), vera më e *magjepsënth* (kënga XXVI), shkon e jëma e *klanith* (kënga XXIII) bushtërën njerë të *kanith* (kënga XXVII), *kurmin t'im fiantaksënth* (shëmbëllen) kënga XI. Vashës lot i *ranith*, kurmi i vet i *qeshënth* (kënga XXII). Për këtë mbaresë Prof. Topalli është shprehur se përdorimi i këtij elementi pranë foljes është një dukuri e zhvilluar mbas shkëputjes së të folmeve arbëreshe nga trangu mëmë, duke qenë se nuk gjendet në të folme të tjerë. Por gjurmë të prapashtesave me *-ith* pranë foljes gjejmë ende sot në çamërisht, veçanërisht tek folja qan- *klanith*. Ky fakt na bën të pohojmë se elementi *-ith* pranë foljes nuk është një risi e krijuar në arbërisht, por një element i mbartur prej gjuhës mëmë. De Rada e përdor disa herë në poemë, ndërkohë që në Gramatikë nuk dëshmohet asnjë shembull me këtë trajtë. Duke pasur parasysh origjinën e Këngëve të Milosaos me bazë këngët e vjetra popullore, ku ky element është përdorur bashkëngjitur edhe në disa prej pjesëve të ligjëratës, sikurse do ta shohim edhe në shembujt e shkëputur, përforcuar nga fakti se ky element del në po të njëjtat pjesë të ligjëratës edhe në çamërisht, e cila është një prej të folmeve më koservatore të shqipëse, mund të arrijmë në përfundimin se elementi *-th/ith* është një element arkaik i toskërishtes.

Sikurse u shprehëm, kjo trajtë, tek De Rada del vetëm tek “Këngët e Milosaos”, në ndryshim edhe nga sa trajtohen në GASH, shfaqet bashkëngjitur pranë disa prej pjesëve të ligjëratës, jo vetëm me nuanca zvogëluese e përkëdhelëse, por edhe me nuanca të tjera semantike si p.sh tek :

4. Emrat, ku shfaqen njëkohësisht nuanca semantike dhe modale të zvogëlimit dhe përkëdhelëse p.sh : Uli *kriethit*, me ulla *qumështinth*, m'i ngriti *xerkëthin*, më këputi *gjumëthin*, bëmë *këshetëthin*;
5. Mbiemrat, ku vihen re nuanca stilistike përkëdhelëse: Me këshen të *pjeksurith/shpjeksurith*, vatte trimi i *nisurith* (i rrëmbyer), *gjunë e zbuluarith*
6. Ndajfoljet, ku vihet re se ky element shfaqet edhe si një mjet sintetik që jep nuanca të shkallëzimit të ndajfoljes; Me një dorë *ngrëjturith* (*krahaso ngrëjturzë*), me siellt *përparanith* (sa më afër, shumë afër), *rri vetëmith* (*krahaso- rri fare vetëm*), *vejim afërith* (*krahaso- shumë afër*)

Nga përdorimet vihet re se kjo prapashtesë, sikurse edhe prapashtesa tjetër zvogëluese *-z*, e shfaq qartë karakterin e saj përkëdhelës apo zvogëlues tek emrat e mbiemrat, por edhe si mjet sintetik i shkallës tek ndajfoljet.


Në përdorimin pranë foljes, vihen re ndryshime në kuptimin që ky element përcjell. Kështu foljet e pajisuara me *-ith*, përgjithësisht shfaqen për të shprehur nuancat e habitores dhe në ndonjë rast edhe të dëshirores, por përdoret edhe për të shprehur nuanca të aspektit të vazhdimësisë..

Krahaso: Dielli që dihet vashës i *qeshënith* (po i qeshka). Shkon e jëma e *klanith* (e na qaka). E rriti ajo zonjë , atë *kish gharruarith*(paska harruar). Vera më e *magjepsënith* (kënga XXVI) , vera po më magjepska.

- *Prania e elementit -z* si mbaresë foljore pranë ndonjë foljeve të kohës së tashme të mënyrës dëftore: Etjen më i *shuan-iz*. (*i shuaka*).
- Veta e parë njëjës në joveprore e foljeve që mbarojnë me temë në zanore e kryera e thjeshtë, bën *u lajta*, si në çamërisht.
- Kohët e përbëra të të gjitha mënyrave e ndërtojnë formën jo veprare me formatin *-u* psh. format foljore të zgjedhimit jovepror , në të gjitha mënyrat ndërtohen me anë të pjesëzës *u*, duke marrë pjesë edhe mbaresa vetore.
- Për formimin e kohëve të përbëra në zgjedhimin jovepror përdoret përgjithësisht folja *kam* (në vend të jam)+ *pjesëza u*; *U kin gapur*, *u kam ljaar*, *u pata ljaar*, por në raste të veçanta edhe folja *jam* + pjesëzën *u*.
- Edhe në disa folje të parregullta forma e vetës së tretë njëjës është ndërtuar mbi bazën e kohës së tashme, duke i shtuar mbaresën *-nej* që e ka burimin në joveprore psh; *dërgo-nej*, *marto-nej* etj
- E njëjtë me atë të çamërishtes del trajta e vetës së tretë njëjës me mbaresën *-nej*: *ikënej*, *dëgjonej*,
- Njësoj me çamërishten dalin edhe dhe mbaresat e tri vetave të shumësit *-jim*, *-jit*, *-jin*: *bijim* (= bënjim), *bijit bijin*
- Dyfishimi i zanoreve tek foljet; *friiti*, *paa* , *u ljaa*, *kee*, *kaa*, *jee*, *keem*, *theet*, *ngriin* etj, për të cilën mendojmë se është një dukuri dialektore arkaike, që ka shërbyer për të realizuar zgjatjen e veprimit, si në *e tashme të caktuar*, *ashtu edhe në të shkuarën e vazhduar*, duke realizuar një kundërvënie me të tashmen dhe të shkuarën e pacaktuar, një dukuri kjo që sot shfaqet ende në të folmen konservatore të çamërishtes. Në poemë del qartë se zgjatimi i zanoreve mbart përmbajtje shprehëse ose emocionale.
- Struktura të foljeve ndihmëse aspektore, të cilat njihen në dialektin e jugut :Unë më *vighem të pështieri* “. Vasha me një psherëtim / *bëri e shiti lotëzit*. Kur ia *dha një shkundullimë*”.

Përkime me dialektin e gegërishtes

Duhet të themi se pikëtakimet kryesore me gegërishten, dalin në Gramatikën e De Radës, fakt që na bën të mendojmë se elementet e këtij dialekti , ndoshta nuk janë aq veçori e ligjërimeve arbëreshe, sa një sporvë e autorit për të sjellë ndonjë afirm me shqipen e shkruar në dialektin gegë.



1. Format e pjesores të realizuara me prapashtesën trajtëformuese të gegërishtes *-m(e)*: *lëshueme, shenjtërueme*.

- Në Gramatikën e De Radës ndeshim edhe raste të paskajores me pjesëzën *me + pjesore, me ljaar, me u ljar*, në poemë: *me vajt*. të cilat ngjajnë me ato të gegërishtes të cilat i ndeshim si “folje me shtirje”.
- Në kohën e kryer të thjeshtë folja *jam* shfaqet njësoj si në dialektin e veriut më përjashtim të zgjatjes së zanores në vetën e dytë, të tretë shumës; *kjeva, kjeve, kje. kjem, kjeet, kjeen*.
- Përdorimi i foljes *vë* në joveprore si një folje aspektore (ajo ruan deitin/e *vëghet e më kënton* strofat që mi thoja vet (këng XI), Kët gherë *vëghet fjën(fle)* te shtrati im(këng XXI)
- Në format e së ardhmes gjendet edhe forma *kam+ paskajore* e dialektit geg: *kam me ljar, me u ljar*.
- Varianti i mbaresës për foljen *jam* në vetën e parë shumës dëftore e pakryer del në variantin *im*, si e folmja e Mbishkodrës.
- Ndërtim i së ardhmes me foljen ndihmëse *kam*, e cila është karakteristik kryesisht e dialektit gegë
- Dëftorja e kohës së tashme e foljes *dal* në vetën e parë shumës bën *dalmi*, njësoj si e folmja e Shkupit, po kështu edhe folja *them* del me variantin e foljes me zanoren *o*.
- Variantet e pjesëzës së formës foljore të përcjellores *duke* del në formën *tue*, ose *ture* njësoj si në gegërisht:
- Format e mbipërbëra *ka pasë dal, kisha pasë dalë* nuk shfaqen në poemë, por dalin në Gramatikë në variante si; *patta passur vraar/ patta kjenur vvarë; patta me passur/ patta me kjenur*.
- Fromat e kohës së tashme dëshirore të foljes *jam* dhe *kam*: *pash, pash, past, pashit, pashin; kioshë, kiotë, kioshim, kioshit, kioshim*.
- Në kohën e kryer të thjeshtë ndryshime të dukshme paraqet folja *jam*; *kjeva, kjeve, kje. kjem, kjeet, kjeen*. e cila del në një variant dialektor, i cili ndeshet në gegërisht.

Përkime me gjuhën standarde

Në mënyrën dëftore , e cila është dhe forma më e vjetër dhe formë bazë kemi:

- Mbaresat e kohës së tashme të formës veprare të vetës së parë dhe e dytë njëjës, dhe veta e dytë shumës në të tria zgjedhimet dalin si sot përkatësisht: v.II, -n, v.III-n, v.II.-ni. Mbaresat e formës joveprare tek foljeve e zgjedhimit të parë dhe të dytë dhe të tretë me përjashtim të vetës së dytë njëjës dalin njësoj si sot
- Në foljet e zgjedhimit të parë jo vepror vëmë re shfaqjen e alomorfit të sotëm: *-hesha, heshe, hej, heshim, hëshit, hëshin*.
- Tek foljet e zgjedhimit të dytë mbaresat e njëjësit dhe shumësit janë karakteristike dhe nuk janë të ndryshme nga ato të sotmet, me ndonjë përjashtim të vogël njëjës të alomorfit që del me -ë dhe jo me -e: *-ështa, ështe, ej, ëshim, ëshit, ëshin*.
- Në kohën e kryer të thjeshtë forma joveprare mbaresat e foljeve të tri vetave të njëjësit , për zgjedhimin e parë dhe të dytë shfaqen njësoj si sot: *-a, e*, mbaresë zero.
- Format e joveprores të së kryerës së thjeshtë shfaqin të gjitha formantin analitik a përpara, që është karakteristik për këto forma edhe sot.
- Foljet të parregullta që dalin në variantin e normës letrare: *dhënë*
- Kohës e tashme e dëshirores, në vetën e dytë ose të tretë njëjës ndërtohet me prapashtesat trajtëformuese *fsh/sh*. Edhe foljet e parregullta *kam* dhe *jam* ndërtohen njësoj si në shqipen standarde me ndonjë ndryshim fonetik: *rëmpeft, sjellt, paft, kioft*.
- Në mënyrën urdhërore përgjithësisht ruhen format foljore të shqipes së sotme me ndonjë ndryshim fonetik; *më jep/ jepmë, qëndro, duro, thuam, puthëm, ec, zëgjou, mos më qai, mbjidh*.
- Disa prej formave të pjesores realizohen me prapashtesa trajtëformuese të njëjta me variantin e normës së sotme letrare: *martuar, ngarkuar, perënduar, helmuar, shkundur, ljëshuar* .
- Paskajorja del edhe në formën përfaqësuese të standardit, duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzat *për të*, pa ndryshime, qofshin këto edhe fonetike: *për të stolisur, për të puthur, për tu martuar*.
- Forma e pashtjelluar mohore del si formë analitike e ndërtuar mbi bazën e pjesores me paravendosjen e pjesëzës mohuese *-pa*: *paa veshur, paa ngrëen, pa dalë*.


Përzierje formash dialektore

- Ndodh që format foljore të paraqiten me dy a më shumë pamje. Ato përkojnë herë me një pjesë të toskërishtes herë me tjetrën, herë me gegërishten, por kanë edhe një përkim tri gjymtyrësh duke u përputhur me njëren pjesë të toskërishtes dhe të dyja së bashku përputhen me ndonjë të folme të gegërishtes. Shembujt e mëposhtëm na paraqesin një gjendje të përzierjes së elementeve gjuhësorë të mbartur prej gjuhës mëmë nga analiza e së cilave mund të dallojmë edhe një tablo të zhvillimeve të mëtejshme të arbërishtes gjatë kësaj periudhe.
- Përcjellorja shfaqet në përgjithësi e ndërtuar nga paravënia e variantin të hershëm *tue*, ashtu siç e gjejmë dhe në gegërishten e sotme, ndërkohë,

elementi i dytë, *pjesorja e foljes* shfaqet në variantin e normës së sotme letrare. Në poemë është përdorur megjithëse rrallë edhe varianti dialektor dytësor i cili gjendet vetëm në të folmet arbëreshe *ture, ture tieerr*.

- Veta e dytë shumë e urdhërore e foljeve që mbarojnë me temë në zanore (lahu) bën *lahi* si të folmet e rrethinave të Vlorës, apo edhe në gegërisht.
- Dëshmia e dy formave dialektore të foljeve *jam* dhe *kam* (*kin, in*) mes së cilave forma arkaike përputhet me çamërishten dhe tjetra ka elemente që i gjejmë ende sot në disa të folme të gegërishtes. Na paraqet një gjendje të përzierjes së elementeve gjuhësorë të mbartur prej gjuhës mëmë, si dhe një tablo të zhvillimeve të mëtejshme të arbërishtes gjatë kësaj periudhe.

- ❖ Sistemi foljor te De Rada shfaq karakter **arkaik** duke ruajtur ende disa tipare të shqipes, që me kalimin e kohës janë zhdukur fare në të folmet e Shqipërisë, ose janë ruajtur pjesërisht në ndonjë nëndialekt konservator, siç është çamërishtja. Sic vihet re nga tiparet konservatore në sistemin foljor sasinë më të madhe kanë tiparet konservatore gramatikore gjë që tregon edhe njëherë se të folmet arbëreshe ndryshimet më të mëdha i kanë në fjalor dhe më pak në forma gramatikore .



Tipare konservatore fonetike

- Përdorimi i zanoreve të gjata, të cilat nga ana grafematike shfaqen me dyfishim zanoresh: Më *laan* të veshurat, *friin* asaj udhe, *ltheet/* “thot”, *ngriin/*, *rii/*
- Dyfishimi i bashkëtingëlloreve tek folja *kam*: *patta passur*
- Përdorimi i *-i-së* në vend të *-y-së* : *friinj* “fryj”, *ghiign*, “hyj”.
- Bashkëtingëllorja /lj/, që në shqipen e sotme del kudo /l/, p.sh., *ljaj* “laj” *ljehëmistin/* “lehin”

Tipare konservatore gramatikore.

Në poemë gjejmë disa ndërtime e trajta foljore të shqipes së vjetër që mbijetojnë në ligjërimet arbëreshe dhe në ndonjë të folme konservatore si variante gramatikore:

- Trajtat e së pakryerës së foljeve jam kam; *keshë, kesh, kesh; jeshë jeshë jesh*
 - Elementi karakteristik trajtëformues *ith*, i cili nuk gjendet në shqipen e sotme në shoqëri më foljen: *vdekur-ith, garruam-ith, përlijpur-ith, ngrëitur-ith*.
 - Pjesore të veçanta që nuk përputhen me shqipen e sotme p.sh.; *arrën* (ardhur), *daljur* dal, *rar*, rënë, për të cilën mendojmë se mbart ndryshime të hershme fonetike të temës
 - Shfaqja e foljes *them* përgjithësisht në përdorim me trajtat e shkurtra: *Kujt të m'i thet?, Thuam* ndë do gjë. *Thomnie* ju të dashurit e mi.
 - Trajta e prezentit shumës me *-mi* (*thomi, shomi*).
 - Përdorimi i së pakryerës të pazgjeruar tek folja *fle* (dheut të errët tek ti *flij*)
 - Aoristi sigmatik *pe* (pashë)
 - Zgjerimi me *-ënj* i foljeve jo me temë në zanore: *qeshënj, lqip-ënj*
- Forma *jam e vinj*- po vij
 - Foljet me zanore të tipit *bëj, frij, shkoj*, etj. dalin, në vetën e parë njëjës, shumës dhe të tretë shumës të së tashmes me mbaresën *-nj*: *bënj, frinj, shkonj*.
 - Paradigma e zgjedhimi e cila përputhet plotësisht me çamërishten, mendojmë se është formë arkaike.
 - Strukturën e formës së ardhme të së tashmes *kam + lidhore*:
 - Formën dëftore të së tashmes që tregon një veprim të caktuar në zhvillim e sipër, e cila ndërtohet sipas strukturës *jam + e + dëftore e tashme*
 - Në vetën e tretë shumës të mënyrës dëftore e lidhore *del e ruajtur mbaresa e vjetër me zanoren-i*; doi të na rreshti, lumi u me *thoi mali, të vioi (të ruaj)*.
 - Mbaresa e foljes *jam*, forma e vetës së parë njëjës, dëftore e pakryer *isha – kisha*, dalin në variantin *ina-ine*, e cila është unike arbëreshe, por kështu edhe veta e tretë njëjës e pakryer.


Tipare konservatore në leksik

Arkaizma leksikor : *pështjer, sqepet bota, lefteris cë buartin, delet rrumpullarëshin, shi i butë bunarënej, u pruar,*

Arkaizma kuptimorë : *çonj* (gjej), *resht* (largoj), *rodhet* (dridhet); *shtiu* (hodhi) *përpiq* (ndal), *patën fjalë* (bënë fjalë) *lampariss* (ndriçoj)

Arkaizma historikë si p.sh. *potis, parakaljesa, tagjis, skotis, serpos* etj.

- ❖ Mjaft interesante na doli edhe seleksionimi e analiza që u bëmë huazimeve. Duhet të themi se numri i huazimeve foljore është i reduktuar, megjithëse dialektet arbëreshe të Italisë janë të pasura me greqizma, disa prej të cilave mund të mos gjenden në asnjë prej të folme të dialektit jugor, ose mund t'i ketë vetëm e folmja e Çamërisë.



Nga vëzhgimet mbi fondin e leksikut të fjalëve shqip dhe atyre të huazuara, vëmë re se në poemën “Këngët e Milosaos” numërohen rreth 40 folje të huazuara nga greqishtja bizantine. Aty-këtu gjejmë edhe folje me rrënjë nga fondi i shqipes të krijuara me prapashtesa greke, në përshtatje me rregullat gjuhësore të shqipes. Foljet e huazuara janë kryesisht të jetës shoqërore ose shtëpiake, të trupit të njeriut etj. Nga pikëpamja morfologjike ato na shfaqin interes, pasi shumica e tyre shfaqen të hibridizuara. Kështu kemi folje me bazë (rrënjë) leksikore-foljore greke, ose italiane + prapashtesë greke + mbaresë karakteristike të të folmeve arbëreshe, ose kombinime të tjera të këtyre elementëve. Ndikimet nga italishtja në leksikon foljor janë të papërfillshme kjo tregon edhe njëherë se periudhën kur u shkrua poema arbërishtja ishte një botë gjuhësore e veçuar me karakteristikat e veta. Vihet re se megjithëse bëhet fjalë për një korpus që nuk i përket sinkronisë së shqipes standarde, nuk është larg nga një pjesë e mirë e strukturave të dy dialekteve. Në këtë kuadër pavarësisht rrethimit nga një kod tjetër gjuhësor (italisht), vihen re zhvillime gjuhësore pothuajse të njëjta me mbarë shqipen, si në trajtë ashtu edhe në strukturë. Këto pohime plotësohen nga fakti që huazimet nga kodi më i afërt, përkatësisht italishtja, në poemë janë të papërfillshme. Ishujt.

Nga ana tjetër, huazimet greke kanë një karakter mjaft specifik. Nëse i referohemi historikut të lëvizjes së kësaj bashkësie folëse nga Shqipëria, si dhe dyndjeve nga Greqia, mund të themi se të paktën në këtë korpus që kemi në dorë nuk vihen re shtresëzime të huazimeve sipas valëve të emigrimit. E themi këtë pasi pothuajse të gjitha foljet e huazuara nga greqishtja janë pjesë edhe e fondit të huazimeve greke në gjuhën shqipe (një pjesë e tyre sot shfaqen si arkaizma historike ose janë zëvendësuar me fjalë të tjera). Grafiku i paraqitur na jep një panoramë të plotë të huazimeve.

Kuptime të veçanta gramatikore dhe struktura specifike

Gjatë konsultimit të sistemit foljor kemi identifikuar dhe analizuar, veçanërisht në rrafsh morfologjik e semantik mjaft element trajtëformues dhe struktura specifike. Një pjesë e këtyre elementëve mund të ketë qenë nën fokusin e studimeve të tjera. Mendojmë se qasja jonë e mbështetur në analiza të rrafshëve të ndryshme gjuhësore dhe me krahasime dialektore ka sjellë edhe trajtime origjinale si në lidhje me strukturën ku elementet pozicionohen, ashtu edhe me kuptimet që ato mbartin. Po i paraqesim rast pas rasti:

Mënyra dëftore

Koha e ardhme

a. Kuptimi i së ardhmes realizohet kryesisht me formën e kohës së tashme të mënyrës dëftore: Pas vëdekur tha *na rommi* (kështu do rrojmë edhe ne pas vdekjes). Në katund *vëdes* e para (kam për të vdekur) këng XIII). Ëë gare e të birit të Zotit cë *vien* nesërith (me kuptimin që do të vij) këngaVII. Se ti *vije* somenat gjer këtej unë s'e pandehja kënga XIX. Ti më *ruan* kalivien e më *laan* të veshura kënga XX. Më atje *së zgjoniem* nga lulet që tund era kënga XXX.

Në shembullin :Ti tek hije e shtëpisë sate nën të huaj po të rrish/ cë ndër njerëz na *jemi*(çdo të *jemi* në mes njerëzve) kemi të tashme në kuptimin e mirëfilltë së ardhmes.

- Në shembullin; T'ënjëten bënet e bardhë/ di u ndë *pat* të dielën(në do të ketë të dielë), formalisht shfaqet forma supletive e foljes *kam* në të kryerën e thjeshtë, e cila e shoqëruar me lidhëzën kushtore *ndë* i jep kuptimin e një të ardhmeje të së shkuarës.
- Në poemë format e së pakryerës joveprore shfaqen më specifike në lidhje me kuptimet e tyre. Ka raste kur formalisht shfaqen si joveprore, por kuptimisht në strukturën e shqipes së sotme dalin si veprore Kënga 1: *ronej* në Temp e moçme.; Kënga 4: që këshen më *pleksënej*, mos njeri *shkonej* etj.
- Format kohës së tashme dëftore dhe të së ardhmes dëftore, që dalin pa ndryshime në temë e mbaresë, kuptimisht realizojnë kushtoren e cila nuk gjendet formalisht në tekstin e Milosaos p.sh; Se ti më merr ti ku më *çon*; Ç'ë së prita, por u nisa?/*Ardhur kisha* me uratën.
- E tashmja arbërisht, ose trajta analitike e së tashmes (e tipit jam+ lidhëza e + folje në kohën e tashme) shfaqet vetëm në një rast:
- Në fakt në shembullin e përdorur Ç'është *ikën* si ajëri? Këng VI struktura paraqet nuanca të aspektit të vazhdimësisë. E veçanta e saj është elipsa. Nuanca të tilla në shqipen e sotme i shprehin strukturat e së tashmes dëftore + pjesëzën po, ose vetë përcjellorja.
- Në shembullin : Ç'ë së prita ,por u nisa?/*Ardhur kisha* me uratën, shfaqet një formë e përmbytur, në të cilën folja ndihmëse *kam* del pas pjesores. Kjo formë e përmbytur formalisht del si format e së ardhmes dëftore, por kuptimisht realizon kushtoren.

- Në shembullin: Atje pranë *t'u kish passur rritur* (qenkësh rritur) i pagëzuari i arbëresh. Në fakt kjo është një formulë tipike letrare e prozës popullore Ajo që na tërheq vëmendjen është ndërtimi i formës joveprore me anë të pjesëzës -u. Mendojmë se kemi shprehje të habitore. Në çamërisht kjo strukturë përdoret ende dendur në ligjërimin bisedor për të shprehur nuanca të habitës krahaso; Na qenka rritur i pagëzuari arbëresh.
- *Shembulli: Lumi u*, më thoi mali!, është rast i shprehjes së dëshirores në struktura specifike, të cilat jo domosdoshmërisht e kanë foljen përbërëse në dëshirore, sidomos në ligjërimin e shkujdesur.

Mënyra lidhore

- Mënyrat lidhore përdoret edhe për të dhënë shprehje të mënyrës urdhërore në strukturë me folje të tjera si ato modale, apo dhe të tjera (lutje, përgjërimit etj). Gjithë të thonë *ti ruana(këng XV)*.
- Në shembullin e vjelë: Me këtë mot të bëje finjën/ Duart si *më t'u nkuqtin!*, Kënga XIV, vëmë re se folja është formalisht në lidhore, por kuptimisht e shprehur në strukturë, del me kuptimin e së kryerës habitore. Në temë është mjaft interesante, pasi mendojmë se ruan shenjat e një sintagme parafjalore të përgjitur, natyrisht me rënie fonetike (*në të kuq*).
- Në tekst e Milosaos shfaqet një rast i tillë: Prifëtëra janë të na martojnë, interpretimi i së cilit do të ishte:

Prifëtëra janë për të na martuar/me na martue. Siç shihet format e paskajores: janë për të na martue/ me na martue (këtë detyrë kanë), të cilat sot japin nuancat e domosdoshmërisë, në poemë këtu realizohen me foljen jam+ lidhore.

- Në Gramatikë gjejmë shemb: *Se nd'e dasha u per garee, për garee prana nch'e cam*. Ndë e daça për hare, për hare pranë nuk do ta kem. Siç vihet re struktura në të cilën shfaqet lidhëza *ndë* dhe folja në dëshirore është e njëjtë me lokucionin lidhëzor *në qoftë se*.

Mënyrat habitore

Në vepër nuk shfaqet e kristalizuar, por kuptimet e saj jepen semantikisht me mjete të tjera gjuhësore, në tekstin e De Radës nuk gjejmë shfaqje formale të kësaj mënyre, por gjejmë shfaqje të strukturave prej nga mund të ketë dalë.

- Nuancat e habitës janë markuar formalisht dhe semantikisht nga elementi *-ith*, i cili në disa folje shërben si një mjet i veçantë gramatikor me karakter stilistik dhe jo si një prapashtesë zvogëlimi e përkëdhelie. Gjurmë të këtij elementi pranë foljes gjejmë edhe në çamërisht tek folja qan- *klanith*, si rrjedhojë nuk mendojmë se përdorimi i saj si mbaresë foljore është një risi e arbërishtes, por është një element i vjetër që arbëreshët e kanë mbartur nga gjuha mëmë. Krahaso: Dielli që dihet vashës i *qeshënith*, kënga XI (po i qeshka). Shkon e jëma e *klanith,këng XXIII* (e qaka). E rriti ajo zonjë, atë *kish gharruarith*, (paska harruar).

Në përdorimin pranë foljes, vihen re ndryshime në kuptimin që ky element përcjell. Kështu foljet e pajisuar me –ith, përgjithësisht shfaqen për të shprehur nuancat e habitores dhe në ndonjë rast edhe të dëshirores.

1. Nuanca të habitores në poemë shënohen edhe me anë të prapashtesës –z-/zë, e cila gjëllin dendur në çamërisht si e tillë edhe sot psh. Etjen më i *shuan-iz*. (i *shuaka*).

Shprehje të dëshirores gjejmë edhe përmes përdorimeve të veçanta të kohëve a mënyrave të tjera. Sipas nesh këndvështrimi i deritanishëm në lidhje me shprehjen e këtij modaliteti në shqipe ka qenë krejtësisht formal dhe ka mënjeluar.

Nga materiali i analizuar shfaqet qartë karakteri kompleks i sistemit foljor të De Radës, ndikuar nga faktorë jashtëgjuhësor me peshë si faktori i *kohës* dhe *i vendit* nga u shpërngulen arbëreshët, ashtu edhe nga tipare e dukuri gjuhësore karakteristike, të cilat paraqesin interes për studime të mëtejshme sipas rrafshëve të ndryshme të studimit.

Nga përfaqja e korpusit foljor të De Radës jo vetëm me standardin e sotëm, por edhe me dy dialektet e gjuhës shqipe mund të themi se dallohen forma të vjetra të strukturës valentore të këtyre foljeve, mjaft prej së cilave ende funksionale edhe në shqipen e sotme. Mendojmë se një prirje dhe metodologji e tillë studimi, e pashteruar deri në fund, mund të çojë në rezultate kërkimore mjaft të suksesshme në kuadër të rrafshit historik, për të sqaruar më tej çështje që ende nuk kanë gjetur zgjidhje.

- Dyfishimi i zanore, kërkon studim në rrafsh historik morfologjik e sintaksor, pasi mendojmë se ato nuk shërbejnë thjesht për të theksuar ose zgjatur zanoren përkatëse, por mund të shihen si një mënyrë për të shprehur edhe vazhdimësinë e veprimi. Përdorimi i zanoreve të gjata mund të fsheh edhe nuanca modale të habitës, apo mbeturina të fjalive pyetëse tërësore.
- Ka vend për analiza të mëtejshme për praninë e elementit – *ith*, pranë foljeve, ndajfoljeve dhe mbiemrave në rrafsh morfologjik e sintaksor për origjinën dhe rolin e tij në ligjërim. Duhet parë më tej vlera e tij si element sintetik për shprehjen e shkallës tek ndajfolja dhe mbiemri. Kjo trajtë, tek De Rada del vetëm tek “Këngët e Milosaos”, në ndryshim edhe nga sa trajtohen në GASH, shfaqet bashkëngjitur pranë disa prej pjesëve të ligjëratës, jo vetëm me nuanca zvogëluese e përkëdhelëse, por edhe me nuanca të tjera semantike.
- Duhet studiuar edhe me tej për po të njëjtat arsye edhe vlera e elementit –z pranë foljeve, mbiemrave ndajfoljeve, veçanërisht në aftësinë që ka si mjet sintetik në ndërtimin e veçorisë gramatikore të shkallës.
- Interes për t’u studiuar në rrafsh historik dhe dialektologjik paraqesin të gjitha trajtat e mënyrat, veçanërisht ato ende të pastuduara mirë siç janë: lidhorja, dëshirorja habitorja apo kushtorja për të kuptuar më tej mënyrat e realizimit

- të tyre në struktura kuptimore dhe proceset e formimit të këtyre mënyrave në shqip deri në formën e tyre të sotme .
- Lokucioni foljor me vlerë futuri, por edhe infinitivi, i tipit *kam të vete*, sipas nesh, nuk duhet përjashtuar nga standarti duke qenë se standardi është i hapur për të gjitha mjetet leksikore, semantike e gramatikore me vlerë pasuruese, pavarësisht nga burimi, prej të folmeje a prej autori.
 - Interes nga pikëpamja sintaksore ka veçanërisht për fjalitë kushtore dhe shprehjen e kushtit.
 - Punimi hedh dritë mbi nuanca dhe ngjyrimë emocionuese, mbi larmitë e shprehjes së strukturave të veçanta kuptimore. Disa prej foljeve e shprehjeve foljore tërheqin vëmendje për bukurinë e tyre, prandaj mund të rigjallërohen, të paktën me funksione e stile të veçanta. Këto kuptime specifike të foljeve të arbëreshët, duhen parë si objekt studimi pasi sjellin pasuri semantike të fjalët e përgjithshme të shqipes si: *eci, qëlloj, them, jam, rrjedh*, duke dhënë ndihmesa të veçanta për pasurimin e strukturës leksikore të shqipes
 - Kuptimi i ri që De Rada u jep fjalëve popullore, zgjerimi i kuptimeve duhet parë si një rrugë e pasurimit të shqipes nga leksikografët.
 - Njohja konkrete e korpusit gjuhësor dhe sidomos e sistemit foljor të një vepre si kjo, përtej synimeve mirëfilli studimore të gramatikës shqipe, shpresojmë se do të vlejë edhe si ndihmesë për hapësira të reja e të vlefshme të analizës së tekstit në shkollat e mesme dhe të larta.

Jemi të vetëdijshëm se ka dhe çështje veçanërisht të rrafshit diakronik që duhen parë, por që nuk kanë qenë pjesë e studimit të paraqitur nga ne. Do ta mbyllim këtë punim me një pohim që shprehu së fundmi prof .M. Mandala, në promovimin e monografisë tij në lidhje me veprën e Lekë Matrëngës. Sipas tij, veprat e korpusit arbëresh kanë pasur mjaft interpretime të gabuara, të cilat kanë ardhur nga moskuptimi i strukturës dhe kuptimeve që ka përcjellë ajo, varësisht llojit të tekstit dhe stilit jo vetëm individual, por edhe variantit dialektor të përdorur.

Shpresojmë që analiza të tilla kaq të hollësishme, të strukturës së realizimit sintaksor, morfologjit dhe semantik të kokës foljore, si kryebërthama e organizimit të fjalisë, të kenë dhënë një pasqyrë të qartë, në të cilën mund të mbështeten studiues të tjerë, jo vetëm në deshifrimin e rrafshit neutral, por dhe atij figurativ.

BIBLIOGRAFI

1. ALTIMARI F, " Çështja alfabetike tek arbëreshët e Italisë para dhe gjatë Rilindjes: Historia e ë-së. Kumtesë.
2. ALTIMARI F, "La parlata di machia Albanese. Appunti fonologici, "Zjarri, anno 1984, n. 29.
3. ALTIMARI F., *La distribuzione del passato "presuntivo" nell' albanese d' Italia*, në "I dialetti italo-albanesi", a cura di F. Altimari e L.M.Savoia, Bulzoni Editore, Roma, 1994.
4. ALTIMARI F., *La parlata di Machia Albanese. Appunti fonologici*, "Zjarri", anno XVI, (1984), n. 29.
5. ALTIMARI F., *Lineamenti di storia della dialettologia arbëreshe*, në "I dialetti italo-albanesi", a cura di F. Altimari e L.M.Savoia, Bulzoni Editore, Roma, 1994.
6. ALTIMARI F., *Rassegna bibliografica degli studi sui dialetti albanesi dell' Italia Meridionale (1970-1983)*, "Zjarri", 1984, XVI, n. 28, f. 22-30.
7. Atlasi dialektologjik i Gjuhës shqipe, Tiranë- Napoli, Vëllimi i I-rë, 2007, dhe Vëllimi i II-të , 2008.
8. GJ.JORGJI, SHKURTAJ. GJ Dialektologjia, SHBLU, Tiranë, 2009
9. GJ. JORGJI, Dialektet e shqipes, Tiranë 1988
10. BOLLOGNARI M., *Il silenzio della tradizione*, Roma, 1978.
11. BREU È., *Forme verbali perifrastiche arbërisht*, në "Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia", Palermo, 1982.
12. BUCHOLZ O., *Konstruksione të arbërishtes me mbiemra në comparativ dhe në superlativ*, "Le minoranze etniche e linguistiche". Atti del II Congresso Internazionale, Palermo, 1989, f. 277-298.

13. ÇABEJ E., *Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetiakë*, në "St. fil.", 2, 1972, f. 23-34.
14. ÇABEJ E., *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë*, në "St. fil.", 2, 1975, f. 51-69 dhe *Në botën e arbëreshëve të Italisë*, Tiranë, 1977.
15. ÇABEJ E., *Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre*, në "Konferenca II e Studimeve Albanologjike", vëll. III, 1969.
16. ÇABEJ E., *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, në "Dialektologjia shqiptare", II, Tiranë, 1974.
17. ÇABEJ E., *Storia linguistica e struttura dialettale dell' albanese d' Italia*, në "Problemi morfossintassi dialettale", 1976, f. 5-30.
18. ÇABEJ.E, *Studime gjuhësore (I-IV)*, Rilindja, Prishtinë, 1976.
19. ÇABEJ.E, *Studime etimologjike (I-VI)*.
20. CAMAJ M., *Die albanische Mundart von Falconara albanese in der Provinz Cosenza*, Trofenik, Munchen, 1977.
21. CAMAJ M., *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino*, Olscki, Firenze, 1971.
22. CAMAJ M., *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia di Potenza*, Centro Universitario Librario dell Università della Calabria, Rende, 1993.
23. DE PADOVA C., *Anketa gjuhësore për të folmen arbëreshe të San Marcanos*, në "Dialektologjia Shqiptare", V, 1987, f. 372-713.
24. DE RADA J, " *Poesie Albanesi nel Secolo XV*". " *Canti di Milosao, Filio del Despota di Scutari*", Napoli 1836.
25. DE RADA J, " *Esule di Croja*", Krutan i Mërguar, 1841
26. DE RADA J, " *Fiamuri Arbërit*", Corgliano Calabro, 1883, Anno I, Nr 1
27. DE RADA J, " *Fiamuri Arbërit*", Corgliano Calabro, 1883, Anno I, Nr 2
28. DE RADA J, " *Fiamuri Arbërit*", Corgliano Calabro, 1883, Anno I, Nr 3
29. DE RADA J, " *Fiamuri Arbërit*", Corgliano Calabro, 1883, Anno I, Nr 8

30. DE RADA J, "Fiamuri Arbërit", Corgliano Calabro, 1883, Anno I, Nr 10
31. DE RADA J, Canti di Serafina Thopia Principessa di Zadrina nel Secolo XV, Napoli 1843.
32. DE RADA. J " Caratteri della lingua Albanese" *Suoi monumenti nell' eta preistorica*, Cataranzo, 1899.
33. DE RADA. J, " Grammatica della lingua albanese", Firenze, 1870
34. DE RADA. J, " Këngët e Milosaos", Përgatiti për Botim Adelina Toli, Alba Prim, Tiranë
35. DE RADA. J, " Këngët e Milosaos", Përgatiti për Botim Dhimitër Shuteriqi, Alba Prim, Tiranë
36. DE RADA. J, " Këngët e Milosaos", Përgatiti për Botim Gjergj Zhei, Alba Prim, Tiranë.
37. DE RADA. J, " Kangë të Milosaut", Përgatiti për Botim Jup Kastrati, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1965.
38. DE RADA. J, " I Canti di Milosao", Përgatiti për Botim Giuseppe Gradilone, Firenze, 1964
39. DE RADA. J, përkthim i "Antologia Albanese", Napoli 1896.
40. DEMIRAJ SH., Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Tiranë, 1962.
41. DEMIRAJ. Sh " Gramatikë historike e gjuhës shqipe", 8 Nëntori, Tiranë 1986
42. DEMIRAJ.SH, "Gjuhësi Ballkanike", Tiranë 2004
43. DEMIRAJ.SH, Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe, SF1969/1.
44. DEMIRAJ. SH, Kuptimet e kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, SF, Tiranë, 1971,4.
45. DEMIRAJ. SH, Morfologjia e gjuhës shqipe II, Tiranë, 1963.
46. DIALETTI ITALO- ALBANESI, Vëllimi i parë, Bulzoni, Roma 1994
47. FALCONE G., *Profilo dei dialetti italiani*, a cura di M. Cortelazzo, Pacini Editore, Pisa, 1976.

48. FAMIGLIETTI M., *Educazione e lingua in Arberia*, Bulzoni, Roma, 1976.
49. FAMIGLIETTI M., *Sociopsicologia dell' educazione e lingua*, Bulzoni Editore, Roma, 1976.
50. FERRARI G., *Grammatica albanese*, Messina, Molfetta, 1971.
51. FORTINO I.C., *Restaurime gjuhësore në fushën e arbërishtes*, "Gjuha jonë", 3, 1984.
52. GAMBARARA D., *Parlare albanese nell' Italia unita*, in "I dialetti italo-albanesi", a cura di F. Altimari e L.M. Savoia, Bulzoni Editore, 1994, f. 35-54.
53. GIORDANO E., *Dizionario degli Albanesi d' Italia (Fjalor i Arbëreshvet të Italisë)*, Il Coscile Bari, 1963.
54. GJINARI J., *Dialektet e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1989.
55. GJINARI J., *Ndërtime me folje që tregojnë fillimin e veprimit në të folmet arbëreshe të Italisë*, në "St. fil.", 3, 1975, f. 121-134.
56. GJINARI. J, SHKURTAJ. GJ, "Dialektologji", SHBLU, Tiranë, 2009.
57. GRADILIONE. G " I Canti Di Milosao", përshtatje në arbërisht e veprës së De Rada.J, Publikim i Institutit të Studimeve Albanologjike të Universitetit të Romës, 1965.
58. GUZZETA A., *Per una descrizione funzionale della morfologia del sostantivo nella parlata arbëreshe di Contessa Entellina*, in "Studi albanologici, balcanici, bizantini e orientali", in onore di Giuseppe Valentini, Firenze, Leo Olschi Editore, 1986.
59. GUZZETTA A., *Descrizione fonematica della parlata arbëreshe di Contessa Entellina in Sicilia*, in "Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia", 1983.
60. GUZZETTA A., *La parlata di Piana degli Albanesi, Parte I - Fonologia*, Palermo, 1978.

61. HAMP E., *Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo Albanese*, Centro Editoriale Librario, Università della Calabria, 1993.
62. HAMP E., *La parlata di Vaccarizzo Albanese: premesse fonetiche*, në "I dialetti italo-albanesi", a cura di F. Altimari e L.M. Savoia, Bulzoni Editore, Roma, 1994.
63. ISMAJLI R., *Etni dhe modernitet*, Prishtinë, 1993.
64. ISMAJLI R., *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë, 1991.
65. KAMSI K., *Shqiptarët e Italisë*, Phoenix, Shkodër, 2006.
66. KASTRATI J, Gramatika shqipe e De Radës e vitit 1870-71, në buletin shkencor ILPSH, nr 1, 1976.
67. KASTRATI J., *Jeronim de Rada, jeta dhe vepra*, Tiranë, 1980.
68. KASTRATI. J " Veprat gjuhësore të Jeronim De Radës", Tiranë 1964.
69. KLOSS H., Volker, *Sprachen, Mundarten*, në "Languages and Society", Monton, 1972.
70. KODRA Z., *Disa shënime gjuhësore të mbledhura në fshatrat arbëreshe të Kalabrisë*, në "St. fil.",1, 1966, f. 139-149.
71. KOSTALLARIA, Fjalë me strukturë kuptimore të gjerë, SF, 1977,1.
72. KOSTALLARIA, Kompozitat dëshirore dhe urdhësirore dhe urdhërore të shqipes, në "Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", I, Tiran", I, Tiranë 1972.
73. LAMBERTZ M., *Albanische Mundarten in Italien*, "Indogermanische Jahrbuch",II Band, Jahrgang 1914, Strassburg, 1915, f. 1-30.
74. LAMBERTZ M., *Die Mundarten des Albanischen*, "Leipziger Vierteljahreschrift für Sudesteuropa", 7, 1943.
75. LAMBERTZ M., *Italo-albanische Dialektstudien*. Die albanischen Mundarten in den italienischen Provinzen Campobasso und Foggia (Molise), në "Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung", 51 (1923), f. 259-290; 52 (1924), f. 43-90, 53 (1925), f. 66-79.
76. LIKAJ E., *Veçori të strukturës morfologjike të shqipes në dritën e të folmeve arbëreshe*, "Le minoranze etniche e linguistiche". Atti del Ii Congresso Internazionale, Palermo, 1989, I Volume, f. 75-87.
77. LIKAJ. E, Format analitike në gjuhën shqipe, 1977.

78. LIKAJ. E, Format analitike në gjuhën shqipe, SF 1978/3
79. LIKAJ. E, Mbi zhvillimin e disa formave gramatikore, SF 1977/4
80. LIKAJ. E, " Morfologjia e shqipes standarte dhe zhvillime të reja", Buletini Shkencor Nr1, Universiteti Planetar i Tiranës, Nëntor, 2010.
81. LIKAJ.E, "Eptimi emëror indoevropian", SHBLU, Tiranë, 1999.
82. LIKAJ.E, "Format analitike në gjuhën shqipe", SHBLU, Tiranë, 1997.
83. LLOSHI.XH, Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988.
84. LYONS.J, "Hyrje në Gjuhësinë Teorike", Dituria, Tiranë, 2001.
85. MANDALA M., *La parlata albanese di Contessa Entellina,(Pa)*, Parte I. Fonologia, Palermo, 1992.
86. MEMISHA. V, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prepjesorë në gjuhën shqipe. Gjirokastër 1999.
87. MEMISHA.V, Studime për fjalën shqipe, Botart, Tiranën shqipe, Botart, Tiranë 2011.
88. MEMUSHAJ. R. " Rreth lëvizjeve në sistemin foljor të shqipes" , Tiranë, 1996.
89. PELLEGRINI G. B., *Avviamento alla linguistica albanese*, Palermo, 1995.
90. PELLEGRINI G. B., *Introduzione allo studio della lingua albanese*, Padova,1977.
91. PERRONE LI., *Novellistica italo-albanese. Vol. I*, Leo Olschi Editore, Firenze, 1967, vol. II, 1970.
92. PIANA M. LA, *Studi linguistici albanesi*, 1949.
93. ROHR R., *Beitrage zur Morfologie und Syntax des Albanischen in Acquaformosa, nach dem Material des AIS, Punkt 751*, në "Zeitschrift fur Balkanologie", 1968, f. 153-170.
94. ROHR R., *Zur flexion der Substantioe des albanischen in Acquaformosa*, në "Beitrage zur Sudosteuropa Forchung", Munchen 1966, f. 79-102.

95. ROTHER K., *Die Albaner in Suditalien*, in "Mitteilungen der Osterreichischen Geographischen Gesellschaft", Bd. 110 (1968), f. 1-20.
96. SAVOIA L., *La parlata albanese di S. Marzano di S. Giuseppe: appunti fonologici e morfologici*, në "Zjarri", n. 27, anno XII, S. Demetri Corone, 1980.
97. SHKODRA Z., *Kontribut për historinë e diasporës shqiptare*, në "St. hist.", 3, 1971, f. 94-113.
98. SHKURTAJ GJ., *Disa shënime për të folmen arbëreshe të Marçeduzës*, në "Studime për nder të A. Xhuvanit", Tiranë, 1986, f. 513-17
99. SHKURTAJ GJ., *Eqrem Çabej për të folmet e diasporës shqiptare*, në "St. fil.", 3, 1988.
100. SHKURTAJ GJ., *L' influenza dell' italiano sulle parlate arbëreshe d' Italia*, në "I dialetti italo-albanesi", a cura di F. Altimari e L.M. Savoia, Bulzoni Editore, Roma, 1994.
101. SHKURTAJ GJ., *Ndihmesa të Prof. Shaban Demirajt në dialektologjinë dhe filologjinë arbëreshe*, në "Studime albanologjike", 2, 1996.
102. SHKURTAJ Gj., *Qualche particolarità delle parlate siculo-albanesi come dimostrazione della citalità e della originalità della lingua albanese*, "Le minoranze etniche e linguistiche. Atti del II Congresso Internazionale", Palermo, 1989, f. 235-241.
103. SHKURTAJ GJ., *Shënime për të folmen arbëreshe të San Marcanos*, në "St. fil.", 4, 1979, f. 113-141.
104. SHKURTAJ GJ., *Shpirti i Arbrit rron. Shënime dhe të dhëna për arbëreshët e Italisë*, Tiranë, 1984.
105. SHKURTAJ Gj., *Vështrim mbi trajtat foljore të mënyrës dëftore të të folmeve arbëreshe të krahinës së Kozencës*, në "St. fil.", 2, 1975, f. 71-87.
106. SHKURTAJ. GJ., " *Ligjërimet Arbëreshe*", Redona, Tiranë, 2007.
107. SOLANO F., *I dialetti albanesi dell' Italia meridionale. I. Appunti per una classificazione*, Quaderni di Zjarri, Castrovillari, 1979.

108. SOLANO F., *La parlata albanese di Firmo, Schema gramaticale e testi*, Quaderni di Zjarri, 1983.
109. SOLANO F., *Le parlate albanesi di San Basile e Plataci*, Quaderni di Zjarri, 4, 1979.
110. SOLANO F., *Manuale di lingua albanese, Elementi di morfologia e sintassi-Cenni sui dialetti*, Corigliano Calabro, 1972.
111. SOLANO F., *Osservazioni sulle parlate italo-albanese*, in "Shejzat", Roma, 1960, nr. 3-4.
112. SOLANO F., *Të dhëna për dialektet*, në librin "Manuale di lingua albanese", Corigliano Calabro, 1972.
113. THOMAI.J, "Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe", SF 1983,3
114. THOMAI.J, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë 2011.
115. THOMAI.J, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë 1989.
116. TOPALLI. K, "Evolucioni Historik i Përemrave të Shqipes", QNK, Tiranë, 2008.
117. TOPALLI. K, "Sistemi Foljor i Gjuhës Shqipe", Plejad, Tiranë 2010.
118. TOPALLI. K, *Tipare dialektore në sistemin foljor të sistemin foljor të arbëreshëve të Italisë*, QSA, Tiranë 2010.
119. TOPALLI. K, "Gramatikë historike e gjuhës shqipe", Kristalina, Tiranë, 2010.
120. TOTONI M., *Përkatësia e ligjërimeve arbëreshe të Italisë në strukturën dialektore të shqipes*, në "Zjarri", n. 27, anno XII, S. Demetri Corone, 1980.
121. TURANO G., *Assegnazione di caso e proprietà strutturali nelle costruzioni causative e percettive del dialetto arbëresh di San Nicola dell' Alto*, në "I dialetti italo-albanesi", a cura di F. Altimari e L.M. Savoia, Bulzoni Editore, Roma, 1994.

122. VADE-MECUM, " Manuale per imparare facilmente la lingua albanese senza maestro", "Shkodra", Tiranë 1939.
123. ZANGARI D., *Le colonie Italo-Albanesi di Calabria, Storia e demografia, Secoli XV-XVII*, Caselli, Napoli, 1941.
124. ZLLATKU R., *Me arbëreshët,"Rilindja"*, Prishtinë, 1976.

web-site të shfrytëzuara:

125. [Http://makj.jimdo.com/prezentazione/](http://makj.jimdo.com/prezentazione/)
126. <http://besa.unical.it/>

Abstract

The major goal is to describe and analyse the verb system in the works of Jeronim De Rada, as one of the ways to shed light on the state and the development of the verb system in the speech of the Arbereshi.

It is common knowledge that the Language of the Arbereshi still retains some features of the medieval Albanian, which have become extinct in the course of time in the Albanian Language spoken in Albania, or have partly survived in a minor dialect. Hence this research aims:

2. To identify and to analyse the diversity of the grammatical meanings and forms, in different moods, their endings in different (verb) numbers and persons, their inner developments, as these appear in the works of the author.
3. To analyze the vascillation of the grammatical forms and meanings, between the two major Works of De Rada: “Milosao’s Songs” and “The grammar of the Albanian Language”.

Focusing on a few specific cases of morphological constructions, together with the grammatical meanings they carry, the goal is to bring into light and to further analyse some of the developments of the Albanian Language verb system at this phase of its existence, which offers great values and helps to look into aspects of the history of the medieval Albanian.

Some of the verbs and verb phrases used by De Rada are brought up for their elegance. These may be enlivened, at least at certain function, style or marking, in view of the richness of our standard Language.

Key words: verb system, grammatical forms, grammatical meaning, Arbereshi language, history of the Albanian language.

Përmbledhje

Punimi është mbështetur në përshkrimin dhe analizimin e sistemit foljor në veprën e Jeronim de Dadës, si një prej rrugëve për të hedhur dritë mbi gjendjen dhe zhvillimin e sistemit foljor në ligjërimet arbëreshe.

Dihet se gjuha e arbëreshëve ruan ende disa tipare të shqipes së kohës së mesme, që me kalimin e kohës janë zhdukur fare në të folmet e Shqipërisë, ose janë ruajtur pjesërisht në ndonjë nëndialekt konservator, prandaj punimi synon në :

Njohjen dhe analizimin e larmisë së formave dhe kuptimeve gramatikore, sipas mënyrave, mbaresave të tyre që dalin sipas kohëve vetave e numrit , zhvillimet e tyre të brendshme, sikurse paraqiten në veprën e autorit.

Analizimin e lëkundjeve të formave dhe kuptimeve gramatikore, ndërmjet dy veprave madhore të De Radës, siç janë: “Këngët e Milosaos” dhe “Gramatika e gjuhës shqipe”.

Duke u ndalur në disa raste të veçanta të ndërtimeve morfologjike së bashku me kuptimet gramatikore që ato mbartin, hidhet dritë dhe analizohen edhe më tej disa prej zhvillimeve të sistemit foljor të gjuhës shqipe në këtë fazë të ekzistencës së saj, mjaft të vlefshme për të analizuar aspekte të historisë së shqipes mesjetare.

Punimi sjell në vëmendje disa prej foljeve e shprehjeve foljore të përdorura prej De Radës të cilat dallohen për bukurinë e tyre dhe që mund të rigjallërohen, të paktën me funksione e stile të veçanta për një pasurim të vërtetë të gjuhës sonë standarde, si dhe të dëshmojmë edhe njëherë përpjekjet e De Radës për ruajtjen dhe mirëpërdorimin e gjuhës sonë, duke dhënë kështu kontributin e tij të paçmuar si një ndër pararendësit e shqipes standarde.

Fjalë kyçe; sistem foljor, forma gramatikore, kuptime gramatikore, ligjërim arbëresh, histori e gjuhës shqipe.
